

ENTI RREGULLATORI I ENERGJISË

RAPORT VJETOR

Gjëndja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2020

Tiranë, 2021

Përmbajtja

Hyrje	8
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË ERE PËR PERIUDHËN 2021 - 2023	14
1. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE	30
1.1 STRUKTURA E SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK	30
1.2 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE	33
1.2.1 Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2020	33
1.2.2 Të dhënat teknike kryesore dhe prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese publike për vitin 2020.	36
1.2.3 Realizimi i Treguesve të Prodhimit dhe Menaxhimi i Rezervës Hidrike.	43
1.2.4 Gjëndja e TEC-it Vlorë.	44
1.2.5 Prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese private të pavarura dhe ato me përparësi .44	
1.2.6 Prodhimi nga centralet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2020	46
1.2.7 Prodhimi i energjisë elektrike sipas rrjetit ku janë lidhur centralet prodhuese	46
1.3 TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE	51
1.3.1 Bilanci energjistik.....	51
1.3.2 Veprimtaria e OST sh.a.....	53
1.3.2.1 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit.....	53
1.3.2.2 Investimet në Sistemin e Transmetimit nga OST sh.a. gjatë vitit 2020.	57
1.3.3 Gjendja e Përgjithshme e Sistemit Eelektroenergjetik referuar raportimit të OST sh.a, në zbatim të nenit 25, pika 2 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.....	58
1.4 SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE	70
1.4.1 Veprimtaria e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.)	70
1.4.2 Konsumi i Energjisë Elektrike	72
1.4.3 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike.....	74
1.4.4 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike	75
1.4.5 Treguesit e energjisë elektrike së furnizuar, shitur dhe humbur për çdo zonë dhe agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2020	77
1.4.6 Efektiviteti i shitjes së energjisë elektrike.....	82
1.4.7 Asetet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.....	88
2. TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE.....	89
2.1 Rregullorja për përcaktimin e kushteve për Nominimin e Operatorit të Tregut të Energjisë elektrike (NEMO)	90
2.2 Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike	90
2.2.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike.....	90

2.2.2 Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OST sh.a.....	92
2.2.3 Monitorime të tjera të lidhura me veprimtarinë e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike	94
2.2.4 Transaksionet e kryera nga KESH sh.a, OST sh.a dhe FTL sh.a. në Treg të hapur (parregulluar) gjatë vitit 2020.	95
3. LICENCIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË TË LICENCUARËVE NË SEKTORIN E ENERGIJË	98
3.1 Licencimet dhe Kërkesat e Trajtuarra gjatë vitit 2020.	98
3.2 Mbikqyrja e të licencuarve gjatë vitit 2020.....	106
3.3 Certifikimet	108
3.4 Programi i Pajtushmërisë për Operatorët e Rrjetit	109
4. AKTIVITETI I ERE-s NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË TARIFAVE DHE ÇMIMEVE TË ENERGIJË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR	112
4.1 Shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin 2020:	112
4.1.1 Lidhur me aplikimin e shoqërisë OST sh.a për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021.....	112
4.1.2 Lidhur me aplikimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020 dhe aplikimin e FSHU sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2020.	114
4.1.3 Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a’’ për vitin 2020 dhe vitin 2021.	120
4.1.4 Mbi miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës të shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.	120
4.1.5 Në lidhje me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2020.	121
4.1.6 Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW për vitin 2019, nga era me fuqi të instaluar deri në 3 MW për vitin 2020.	122
4.1.7 Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite.	128
4.2 Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2020	130
5. RREGULLIMI I SEKTORIT TE GAZIT NATYROR	131
5.1 Projekti TAP(Trans Adriatic Pipeline).....	131
5.2 Aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria për Sektorin e Gazit Natyror.	143
5.3 Aktet nënligjore të miratuara nga ERE gjatë vitit 2020 për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e Gazit Natyror.	144
5.4 Bashkëpunimi me ALBGAZ për vitin 2020.	153

5.5 Disa Probleme për të Ardhmen në Sektorin e Gazit Natyror	155
6. MBI RAPORTIMIN E ERE – s NË LIDHJE ME ZBATIMIN DHE NDJEKJEN E PLOTËSIMIT TË REKOMANDIMEVE TË “REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË PËR VITIN 2019”.....	156
7. AKTIVITETI I ERE-S NË ZHVILLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKONNDAR DHE NDRYSHIMET E TJERA LIGJORE TË NDODHURA GJATË VITIT 2020	173
7.1 Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të përshtatjes së tyre me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.	173
7.2 Proçeset gjyqësore në të cilat ERE ka qënë palë gjatë vitit 2020	181
7.2.1 ERE në Cilësinë e Palës së Paditur në proçeset gjyqësore.....	181
7.2.2 ERE në Cilësinë e Palës së Tretë në proçeset gjyqësore në kuadër zbatimit të kompetencave ligjore. 183	
7.2.3 ERE në Cilësinë e Palës Paditëse në proçeset gjyqësore.	185
7.3 Zhvillimi i seancave Dëgjimore në ERE.....	185
8. VEPRIMTARIA E ERE-S NË FUSHËN E MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE MBIKQYRJES SË STANDARTEVE.....	186
8.1 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë 2020.....	187
8.2 Cilësia e Shërbimit në rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike.	200
9. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ERE-s	204
9.1 Marrëdhëniet Ndërkombëtare.....	204
9.2 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare.....	204
9.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s.	205
10. STRUKTURA E ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË DHE ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE	206
11. ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE TË ERE-S GJATË VITIT 2019	209
SHTOJCA 1 Raporti Auditimit të Pasqyrave Financiare.....	212
SHTOJCA 2 Raporti i Performancës	213

TABELA E FIGURAVE

Figura 1 Skema e Sistemit Elektroenergjetik (Burimi: ERE)	31
Figura 2 Skema e Fluksit të Energjisë dhe Tregtar (Burimi: ERE)	32
Figura 3 Të dhëna mbi prodhuesit për vitin 2020.	34
Figura 4 Prodhimi neto vendas për vitin 2020.	34
Figura 5 Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2020 (MWh).....	35
Figura 6 Prodhimi mujor vendas për vitin 2020 krahasuar me mesataren e periudhës 2009-2020	35
Figura 7 Prodhimi neto vendas historik për periudhën 2009-2020 në raport me mesataren e prodhimit për këtë periudhë.....	36
Figura 8 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.).....	37
Figura 9 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: OST sh.a.).	37
Figura 10 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2020 (Burimi: KESH sh.a. , OST sh.a.).....	38
Figura 11 Shkarkimet e ujit pa prodhim energjie nga HEC-et e KESH sh.a gjatë vitit 2020.	38
Figura 12 Shkarkimet e Ujit nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (2002-2020) (Burimi: KESH sh.a).	39
Figura 13 Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2020 (m).	39
Figura 14 Niveli i Liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2020.....	40
Figura 15 Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2020.....	41
Figura 16 Prurjet mesatare mujore (m ³ /sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2020 krahasuar me mesataren historike.	42
Figura 17 Rezerva Energjetike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2020 (Burimi: KESH sha).....	42
Figura 18 Konsumi specifik i Ujit në HEC-et e KESH sh.a.	43
Figura 19 Shfrytëzimi i Kapacitetit gjenerues të Centraleve.	44
Figura 20 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi dhe ato të pavarur për vitin 2020.	45
Figura 21 Të dhëna mbi prodhuesit e pavarur për vitin 2020.	45
Figura 22 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi për vitin 2020.	45
Figura 23 Impiantet fotovoltaike viti 2020.	45
Figura 24 Prodhimi nga Impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2020.	46
Figura 25 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2020.	47
Figura 26 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2020	50
Figura 27 Bilanci Energjetik i OST sh.a për vitin 2020 krahasuar me atë të viteve 2015-2019 (MWh).	51
Figura 28 Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjetik shqiptar për vitin 2020.	52
Figura 29 Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë.	54

Figura 30 Skema e Sistemit të Transmetimit Shqiptar.....	55
Figura 31 Skema njëfazore e Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar në nivelin 400-220-150-110kV.	56
Figura 32 Asetet kryesore të Sistemit të Transmetimit.....	57
Figura 33 Situata e Investimeve në Sistemin e Transmetimit nga OST sh.a gjatë vitit 2020.	58
Figura 34 Parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për periudhën 2020-2040	62
Figura 35 Parashikimi i kërkesës për energji elektrike	62
Figura 36 Treguesit kryesorë të OSSH sh.a; FSHU sha;FTL sha (OSHEE Group sha) gjatë vitit 2020.....	71
Figura 37 Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike ndër vite.	72
Figura 38 Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës Import-Eksport në konsumin total të Energjisë Elektrike në Shqipëri.....	72
Figura 39 Komponentët për mbulimin e konsumit dhe komponentët e konsumit të energjisë elektrike të siguruar për vitet 2019 – 2020	73
Figura 40 Shpërndarja e Klientëve të OSSH sh.a sipas rajoneve dhe kategorive 2020.	74
Figura 41 Shpërndarja e numrit të Klientëve 2020 sipas kategorive (%).	74
Figura 42 Raportet e Faturimit sipas Kategorive të Klientëve 2020.....	75
Figura 43 Klientët Familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite.	75
Figura 44 Konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2020.	76
Figura 45 Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2020.	76
Figura 46 Profili dhe piku i ngarkesës në dhjetor 2020 (MW).	77
Figura 47 Profili dhe minimumi i ngarkesës në Mars 2020 (MW).....	77
Figura 48 Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2020.	78
Figura 49 Shpërndarja e Furnizimit me Energji Elektrike sipas Drejtorive rajonale (%).	79
Figura 50 Shpërndarja e Humbjeve të Energjisë Elektrike sipas Drejtorive rajonale (%).	79
Figura 51 Humbjet mujore dhe mesatare në sistemin e shpërndarjes krahasuar me targetin e humbjeve të energjisë elektrike sipas VKM nr.253, datë 24.04.2020 (%).	80
Figura 52 Sasia në Furnizim dhe Humbje të Energjisë Elektrike në Rajonet dhe Agjencitë e Rrjetit të Shpërndarjes (Burimi: OSSH sh.a)	80
Figura 53 Bilanci Energjetik viti 2020.....	81
Figura 54 Të dhëna të tregut të energjisë elektrike për vitin 2020 në raport me energjinë elektrike të konsumuar në Shqipëri.	82
Figura 55 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2020.	83
Figura 56 Grafiku i Humbjeve Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2020.....	83
Figura 57 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2020.....	84
Figura 58 Niveli i Arkëtimeve Mujore në periudhën 2011-2020.	85
Figura 59 Ecuria e treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatorit të Shpërndarjes (%).	85

Figura 60 Efektiviteti i shitjeve të OSSH 2009-2020 (Burimi: OSSH sh.a).....	86
Figura 61 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergjitik kundrejt konsumit.	87
Figura 62 Faturimi/Arkëtimi 2002-2020 me TVSH (Burimi: OSSH sh.a.).....	87
Figura 63 Të dhëna mbi asetet kryesore të OSSH (Burimi: OSSH).	88
Figura 64 Të dhëna mbi Ankandet e Alokimit të Kapaciteteve në Sistemin e Transmetimit gjatë vitit 2020.	92
Figura 65 Disbalancat totale për vitin 2020 (MWh), Burimi OST sh.a.	94
Figura 66 Transaksionet e kryera gjatë vitit 2020 nga KESH sh.a. ; FTL sh.a. (OSHEE Group sha) dhe OST sh.a.	96
Figura 67 Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite (Burimi: OST sh.a.).....	96
Figura 68 Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2020. Burimi OST sh.a.	97
Figura 69 Subjektet e licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2020	99
Figura 70 Subjektet e licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për vitin 2020.	102
Figura 71 Subjektet e licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për vitin 2020.	103
Figura 72 Subjektet e licencuar në aktivitetin e gazit natyror 2020.....	106
Figura 73 Çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për vitin 2019-2020 (Burimi: ERE)	117
Figura 74 Kurba levizëse e çmimit maksimal të blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për këtë kategori klientësh për vitet 2019 – 2020.....	118
Figura 75 Kurba lëvizëse e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të miratuar nga ERE për vitet 2019-2020	119
Figura 76 Ecuria e çmimeve të miratuara për Prodhuesit me Përparësi.	122
Figura 77 Ecuria e prodhimit në vite nga Prodhuesit me Përparësi dhe HEC ASHTA.....	124
Figura 78 Të ardhurat nga prodhuesit me përparësi (Burimi OSHEE sh.a.)	124
Figura 79 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për vitin 2020.....	125
Figura 80 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për vitin 2019.....	125
Figura 81 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2020.....	126
Figura 82 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2019.....	126
Figura 83 Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) për vitin 2019-2020	127
Figura 84 Sasia dhe të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për periudhën 2019-2020.	127
Figura 85 Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike të miratuara nga ERE ndër vite	128
Figura 86 Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike periudha 2008 - 2020.	128
Figura 87 Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për periudhën 2009 – 2020.....	129
Figura 88 Çmimi mesatar i realizuar i shitjes së energjisë elektrike për kategoritë e ndryshme të klientëve fundorë.	129
Figura 89 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve jofamiljarë në vendet e rajonit për vitin 2020	130

Figura 90 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve familjarë në vendet e rajonit për vitin 2020	130
Figura 91 Rrjeti i transmetimit të gazit në rajonin tonë	132
Figura 92 Projekti TAP në Shqipëri.....	141
Figura 93 Ankesat e regjistruara dhe të zgjidhura nga ERE	188
Figura 94 Struktura Organizative e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 78, datë 28.04.2020.	207

Hyrje

Vështrim i përgjithshëm mbi Sektorin e Energjisë

Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror në Shqipëri, i cili funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, si dhe akte të tjera ligjore të miratuar në zbatim të tyre.

ERE ushtron aktivitetin e saj me qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimeve të pjestarëve të tregut për të siguruar furnizimin me energji, me cilësi dhe me kosto sa më të ulët të klientëve. Kjo, duke patur në konsideratë interesat dhe të drejtat e klientëve, sigurinë dhe cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit; ERE kryen liçensimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në sektor; monitoron tregun e energjisë; harton kuadrin rregullator; shqyrton në përputhje me metodologjitë respektive aplikimet e tarifave dhe çmimeve, e nëpërmjet autoritetit vendimmarrës të saj, dhe në zbatim të ligjit, vepron rast pas rasti duke e shprehur vullnetin nëpërmjet vendimmarrjeve të Bordit.

Bordi i ERE-s, është organi vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ERE-s dhe përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen në detyrë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me një mandat 5 vjeçar.

Në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit “Për Sektorin e Gazit Natyror” është përgatitur ky raport mbi “Gjëndjen e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtarinë e ERE-s gjatë Vitit 2020”.

Në këtë raport janë paraqitur në mënyrë të detajuar të dhëna mbi ecurinë e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror për Vitin 2020, si dhe krahasimet e disa prej treguesve të këtij viti me vitet parardhës.

Përsa i takon prodhimin të Energjisë Elektrike, duke marrë në konsideratë dhe analizën e historikut të prodhimin të energjisë elektrike të regjistruar në vend, rezultojnë se gjatë Vitit 2020 janë 5,313 GWh. Sasia e prodhuar rezultojnë të jetë nën mesataren e prodhimin të energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2020, e cila është në vlerat 5,882 GWh. Prodhimi i realizuar për Vitin 2020 rezultojnë rreth 10 % më i ulët se mesatarja e prodhimin për periudhën 2009 – 2020. Kjo për faktin se, prurjet e ujit në basenet e impianteve kryesor të prodhimin të energjisë elektrike kanë qënë në tërësinë e tyre nën mesataren shumë vjeçare. Është vërejtur se gjithashtu se prurjet mesatare të ujit në basenin kryesor të administruar nga ana e KESH sh.a., në basenin e Hidrocentralit të Fierzës janë përgjithësisht nën mesataren historike dhe vetëm në muajin Tetor rezultojnë me rreth 23 m³/sek më të larta se mesatarja shumëvjeçare, duke krahasuar prej vitit 1991.

Në këtë kuadër Viti 2020 konsiderohet si një vit jo i mirë hidrologjik edhe për faktin se pavarësisht rritjes së kapaciteteve prodhuese përgjatë Vitit 2020, prodhimi total i energjisë elektrike për këtë vit ka rezultuar në sasinë **5,313 GWh**, ose rreth 569 GWh më pak se prodhimi mesatar i energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2020.

Gjithashtu, krahasuar me sasinë e energjisë elektrike prej 8,552 GWh të prodhuar gjatë vitit 2018, i cili konsiderohet viti me prodhimin më të lartë të energjisë elektrike në vendin tonë, prodhimi i KESH sh.a. për vitin 2020 rezultojnë të jetë 3,090 GWh ose rreth 38% më i ulët.

Ky vit, jo i mirë hidrologjik, shkaktoi realizimin e një importi të konsiderueshëm të energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës dhe furnizimin e pa ndërprerë të klientëve në vend. Balanca neto e

shkëmbimit të energjisë elektrike për Vitin 2020 ishte import neto në sasinë prej 2,275 GWh, e cila është rreth 31% të vlerës totale të konsumit, duke rezultuar si një ndër vitet me import të madh të energjisë elektrike gjatë dhjetëvjeçarit të fundit.

Balanca e shkëmbimit të energjisë elektrike (importi) për Vitin 2020 në total është 3,238 GWh, në dhënie rezulton në sasinë 963 GWh dhe në marrje 2,276 GWh. Prodhimi i energjisë elektrike në **5,313** GWh u realizua nga centrale në zotërim të kompanisë publike të gjenerimit KESH sh.a., në sasinë prej **3,090** GWh ose gati 58 % të të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në rang vendi. Pjesa tjetër e prodhimit prej **2,222** GWh u prodhuan nga centrale të tjera, e cila zë rreth 42%, të të gjithë prodhimit të energjisë elektrike.

Sikurse vërehet dhe nga këto shifra, pjesa e prodhimit, që realizohet nga prodhuesit e pavarur privatë të energjisë elektrike, zë një pjesë të konsiderueshme në prodhimin vendas. Numri i prodhuesve të pavarur të energjisë elektrike vjen duke u rritur nga viti në vit, duke rritur peshën e këtyre prodhuesve në treg, i cili është një hap i rëndësishëm për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në vendin tonë. Përsa i takon shtimit të kapaciteteve gjeneruese dhe me ngritjen e Bursës së Energjisë Elektrike nëpërmjet kontratave për diferencë, do të optimizohet edhe efekti financiar i tyre për klientët e energjisë elektrike.

Përgjatë Vitit 2020 kanë hyrë në prodhim gjithsej 20 centrale prodhuese të energjisë elektrike, me një fuqi të instaluar prej 227.8 MW, të cilët kanë prodhuar gjatë Vitit 2020 sasinë prej 182,816 MWh. Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë Vitit 2020 zë rreth 3.44 % të prodhimit total vendas të energjisë elektrike, që është një vlerë e cila ka arritur të mbulojë dhe tejkalojë ecurinë e parashikuar të rritjes së kërkesës së energjisë elektrike në vitet në vijim.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë Vitit 2020 është rreth 2,200 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 4,712,074 MWh. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë Vitit 2020 është rreth 306 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 601,090 MWh.

Për vitin 2020, numri total i centraleve prodhuese private të cilat kanë prodhuar energji elektrike është 216, ku 8 prej tyre janë prodhues privat të pavarur të cilët zotërohen nga 3 subjekte të licënuara, kurse pjesa tjetër prej 208 centrale janë prodhues me përparësi të energjisë elektrike, të cilët zotërohen nga 155 subjekte në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

Në total, kapaciteti i instaluar i centraleve prodhuese private është 1,058 MW, ku kapaciteti i instaluar i centraleve të prodhuesve të pavarur është 436 MW, ndërsa 622 MW i përket centraleve të prodhuesve më përparësi të energjisë elektrike.

Kërkesa për energji elektrike në vitin 2020 arriti në vlerën prej 7,589 GWh. Krahasuar me Vitin 2019 vërehet një ulje e lehtë e konsumit të energjisë elektrike në vend me 23 GWh krahasuar me kërkesën e cila për vitin 2019 ishte në vlerat prej 7,612 GWh. Ulja e kërkesës e vërejtuar përgjatë këtij viti, e cila duhet thënë se është vënë re dhe më parë, ka të bëjë kryesisht me ndryshimet klimatike, eficientë energjetike apo dhe vazhdimin e zbatimit të masave për uljen e vjedhjes së energjisë elektrike dhe kryesisht me masat e ndërmarra nga ana e Qeverisë Shqiptare për kufizimet që lidhen me përhapjen e pandemisë duke filluar nga Marsi i vitit 2020. Këto masa ndër të tjera kanë ndikuar dhe në uljen e kërkesës për energji elektrike pasi një pjesë e bizneseve kanë qënë të detyruara të punojnë me orare të reduktuara ose të mbyllën krejtësisht.

Në këtë kontekst, humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes për Vitin 2020 sipas të dhënave të raportuara nga ana e kompanisë, arrijnë në vlerat 21.48%, duke shënuar një ulje të lehtë të nivelit të humbjeve krahasuar me vlerën prej 21.79% të vitit 2019. Niveli i humbjeve të energjisë elektrike vijon të ketë një rënie nga viti në vit, duke tentuar të arrijë në nivelet e përcaktuara me VKM-në Nr. 253, datë 24.04.2019.

Për Vitin 2020, humbjet totale të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe të transmetimit sipas raportimeve të shoqërive kanë qënë në vlerat 1,632 GWh. Krahasuar me Vitin 2019 kemi një ulje të humbjeve totale të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe të transmetimit me 19 GWh.

Niveli total i arkëtimeve për vitin 2020 është në vlerat prej 95.8 %, kundrejt energjisë elektrike të faturuar tek klientët. Ky tregues është i konsoliduar pasi vitet e fundit ka qënë në nivelin mbi 95 %. Kjo shifër është një tregues kryesor që tregon për stabilitetin e operatorit në këtë fushë.

Struktura e klientëve të energjisë elektrike edhe për vitin 2020 është kryesisht e përqëndruar tek klientët familjarë. Klientët familjarë zënë rreth 86.17 % të numrit total të klientëve të energjisë elektrike në vend. Në pjesën e konsumit të energjisë elektrike klientët familjarë për Vitin 2020 zënë rreth 38.96 % të konsumit të përgjithshëm, shifër kjo më e lartë se ajo e realizuar për vitin 2019 e cila ishte 36.1%

Shpërndarja e vlerës së faturimit të energjisë elektrike për vitin 2020 në klientët e furnizuar nga Shërbimi Universal rezulton të jetë në vlerat prej 51.8% për klientët familjar, 34.9% klientët privatë, dhe pjesa tjetër prej klientët buxhetorë me rreth 5.8% dhe jo buxhetorë 7.6%. Klientët buxhetorë dhe jo buxhetorë vazhdojnë të jenë problem përse i takon pagesave të faturave të Energjisë Elektrike, duke akumuluar një borxh për shoqëritë pjesë të OSHEE Group sh.a. dhe duke krijuar edhe gjatë këtij viti vështirësi financiare.

Përse i takon çmimeve të klientëve fundorë të furnizuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal përgjatë Vitit 2020, nuk pati rritje të tyre dhe tarifave të tyre apo dhe tarifave të Operatorit të Sistemit të Transmetimit kanë mbetur në fuqi ato të Vitit 2019.

Përse i takon klientëve, të cilët janë furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, si rrjedhojë e mosdaljes së tyre në treg të lirë, megjithë krijimin e kushteve teknike dhe ligjore për këtë dalje, çmimi mesatar i Furnizimit të Mundësisë së Fundit për Vitin 2020 ka qënë në vlerën mesatare prej 11.09 Lekë/kWh, një ulje prej 3.01 Lekë/kWh krahasuar me çmimin mesatar të Vitit 2019 ose një ulje prej 21%.

Për Vitin 2020 evidentohet një ulje të konsiderueshme e energjisë së furnizuar për klientët të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit në masën 32% krahasuar me atë të Vitit 2019, e cila ka ardhur si pasojë e lidhjes së kontratave të furnizimit në tregun e lirë nga një pjesë e klientëve të cilët furnizoheshin në kushtet e mundësisë së fundit në periudhat e mëparshme.

Në zbatim të përcaktimeve të Metodologjisë përkatëse të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 687, datë 22.11.2017, çmimi blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për Vitin 2020, rezultoi 8.0532 Lekë/kWh. Ky çmim rezulton për Vitin 2020 më i ulët në vlerën 0.405 Lekë/kWh nga ai i viti 2019 prej 8.4582 Lekë/kWh. Kjo ulje e çmimit për Vitin 2020 ka ardhur rrezultat i rënies së çmimit të tregut në rajon, i cili shërben si referencë për përcaktimin e këtij çmimi.

Në kuadër të mbrojtjes së klientëve, si një ndër detyrat kryesore të rregullatorit, është monitoruar implementimi i planit të masave për shoqëritë bija të OSHEE Group sh.a, të miratuar në shtator të vitit 2018. Në këtë kontekst u vlerësua e nevojshme rishikimi i planit të masave dhe për këtë qëllim me Vendimin e Bordit Nr. 217, dt. 15.12.2020, ERE ka vendosur për rishikimin e “planit të masave për Operatorin e Shpërndarjes të Energjisë Elektrike, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr. 201, datë 03.09.2018. Rishikimi i planit të masave mbështetet në detyrat e lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe lidhet me ndryshimet strukturore në shoqërinë OSHEE sh.a.. Në këtë prizëm janë trajtuar me transparencë ankesat në kuadër të kushteve të përgjithshme të furnizimit apo ankesave të tjera që lidhen me klientët.

Në Sektorin e Gazit Natyror, Viti 2020 ka qënë një vit shumë i rëndësishëm pasi në 15 Nëntor 2020, projekti TAP përfundoi realizimin e tij. Ndërtimi i tubacionit tokësor i cili kalon përmes Shqipërisë ka përfunduar në përputhje me të gjitha kriteret dhe standartet e një projekti të përmasave kaq të mëdha. ERE me Vendim Nr. 97, datë 15.06.2020, miratoi “Kodin e Rrejtit TAP”. Kodi i Rrejtit i TAP do të aplikohet për të gjithë Tregëtarët/Furnizuesit në mënyrë jo diskriminuese, në këtë mënyrë do të krijohen kushtet e nevojshme për përdorim të kapacitetit të këtij gazsjellësi nga Tregëtarët/Furnizuesit e mundshëm në të ardhmen.

Në të njëjtën kohë, me Vendimi e Bordit Nr. 149, datë 10.09.2020, është miratuar “Programi i përputhshmërisë rregullatore/regulatory compliance programme” paraqitur nga TAP AG në bazë të “Opinionit të Përbashkët përfundimtar/Final joint Opinion” në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP AG”.

Projekti TAP ka përfunduar 100% në Shqipëri, Greqi dhe Itali. Në datën 15 Nëntor 2020 TAP ka filluar funksionimin komercial. Që nga data 15 Nëntor dhe në vazhdim TAP ka filluar ankandet për rezervimin e kapacitetit tek Platforma për Rezervimin e Kapacitetit PRISMA. Në datën 31 Dhjetor 2020 TAP filloi transportin e parë të gazit në Itali dhe Greqi.

Përveç kontributit të tij të rëndësishëm për krijimin e tregut të gazit në Shqipëri, TAP është i veçantë/unik nga ana rregullatore, për Shqipërinë si vënd kandidat për në BE.

TAP tejkalonë juridiksionin e vendit tonë, si një Palë Kontraktore në Komunitetin e Energjisë, e cila po transponon dhe përafron në mënyrë aktive legjislacionin kombëtar me bazën ligjore të BE për energjinë(energjinë elektrike dhe gazin natyror) dhe të dy Shteteve Anëtare të BE (Italia dhe Greqia).

ERE i ka dhënë TAP, së bashku me Autoritetet Rregullatore Greke dhe Italiane (Autoritetet Rregullatore në vend NRA) (respektivisht RAE dhe ARERA), *përjashtimin nga dispozitat thelbësore të Direktivës së Tretë të BE për Gazin* (aksesin e palës së tretë, tarifën e rregulluar dhe veçimin e pronësisë) për një periudhë 25 vjeçare nga data e vendosjes në funksion të TAP.

Marrja e Vendimit të Përjashtimit përfshin një bashkëpunim të shkëlqyer midis ERE dhe dy Autoriteteve të tjera Rregullatore. Kjo tregohet tek dokumenta të ndryshëm të përbashkët që janë nxjerrë nga Autoritetet Rregullatore, si Opinioni i Përbashkët mbi Përjashtimin, Vendimi i Përbashkët për Çertifikimin e Operatorit të Pavarur të Transmetimit, Udhëzimet për menaxhimin dhe ndarjen e kapacitetit, dokumenta që kanë lidhje me testimin e parë të tregut, miratimin e Programit Rregullator të Pajtuëshmërisë së TAP, të Kodit të Tarifave, miratimin e Kodit të Rrejtit të TAP etj.

Është bërë një punë e madhe për hartimin e legjislacionit sekondar për sektorin e gazit natyror kjo si nga ministria e linjës ashtu edhe nga ERE dhe Albgazi, rreth 80 akte ligjore, nënligjore dhe urdhëra kanë kompletuar të gjithë kornizën ligjore për një funksionim normal të tregut të gazit në vëndin tonë

Për momentin, nga Shqipëria nuk del gaz, mbetet për t’u ndërtuar rrjeti i transmetimit dhe shpërndarjes së gazit si dhe mundësia e rezervimit të kapaciteteteve në Fier ose në Kuçovë i planifikuar për pikat e daljes. Është tepër emergjente ngritja e infrastrukturës së gazit sepse jo vetëm është më ekonomikë përdorimi i tij, por ka edhe emetime shumë herë më të vogla, duke ulur në masë të konsiderueshme ndotjen e ambientit. Konsumatori i parë duhet të jetë TEC-i i ndërtuar në Vlorë. Me përfundimin e Projektit TAP AG, vazhdimin e ndërtimit së shpejti të Projektit IAP (Jonian Adriatik Pipeline) i cili do të shërbejë si një magjistral kryesor përsëgjati në vëndin tone dhe njëkohësisht do të lidhë edhe Malin e Zi, Kosovën dhe Bosnjë-Hercegovinën deri në Kroaci, ndërtimin e Terminalit të LNG (Gazit Metan të Lëngëzuar) nga firmat prestigjioze Exxon Mobil dhe Axelerate si dhe projekti

i ruajtjes nëntokësore i gazit në Dumre, tashmë e lidhur marrëveshja me SNAM, të gjitha këto do të bëjnë që vëndi jonë të jetë një nyje për Gazin Natyror në rajon.

Në të njëjtën kohë nga Albgaz janë realizuar procedurat për projektimin dhe ndërtimin e dyja qëndrave të mirëmbajtjes së Gazsjellësit TAP në Shqipëri, konkretisht: Qendra e Mirëmbajtjes në Fier (në operim) dhe Qendra e Mirëmbajtjes në Korçë në faze ndërtimi, pas përmbylljes të procedurave tenderuese. Këto projekte u realizuan në kuadër të marrëveshjes ndërmjet TAP AG dhe Albgaz sh.a me objekt realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes së gazsjellësit nëpërmjet ndërmarrjes së përbashkët Albanian Gas Services Company sh.a.

Sikurse evidentohet TAP bashkëpunon ngushtë me ERE-n për miratimin e akteve nënligjore të cilat kanë për qëllim të rregullojnë operimin e sistemit të transportit të TAP. Në të njëjtën kohë TAP e ka paraqitur këto akte dhe ka marrë miratimet përkatëse tek Autoritetet Rregullatore të vëndeve në të cilët kalon gazsjellsit TAP. ERE ka bashkëpunuar me dy rregullatorët e tjerë, atë të Greqisë dhe të Italisë për kordinimin e punës në miratimin e akteve rregullatore për TAP.

Përgjatë Vitit 2020 një rëndësi të vecantë ka patur dhe mbarvajtja e punës së sektorit përgjatë kufizimeve, të cilat vinin si rezultat i masave të Qeverisë Shqiptare për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Në këtë kuadër nga ana e të licensuarve të ngarkuar me shërbimin publik janë marrë të gjitha masat e nevojshme për furnizimin me cilesi dhe siguri të konsumatorëve si dhe dhënies së shërbimeve të nevojshme për konsumatorët. Në këtë kuadër nga ana e ERE-s janë ndërmarrë masa të cilat i janë përgjigjur situatës së krijuar si;

- VENDIM Nr. 51, Datë 26.03.2020 “Mbi disa ndryshime të përkohëshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid19 dhe shpalljes së gjëndjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”.

Vendim i cili i dha mundësinë shoqërive të licensuara, të cilave i përfundonte licensimi përgjatë periudhës së pandemisë të rinovonin në menyrë automatike licensat deri në përfundim të fatkeqësisë natyrore për të mundësuar vijimin e punës së tyre në sektor.

- VENDIM Nr. 58 Datë 26.03.2020 “Mbi përcaktimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike, gjatë periudhës së zbatimit të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr.8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Aktin Normativ Nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid – 19”, të ndryshuar si dhe VKM Nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”

Vendim, i cili duke ju përshtatur kushteve të krijuara nga fatkeqesia natyrore për të ruajtur shëndetin e konsumatorëve dhe të punonjësve të OSSH sh.a., minimizonte lëvizjet e lexuesve të OSSH dhe kontaktet me konsumatorët përgjatë kryerjes së detyrës së leximit të matësave të konsumatorëve të energjisë elektrike duke faturuar sipas vlerave referuese deri në përfundim të fatkeqësisë natyrore. Vendim i cili zgjati për një periudhë 3 (tre) mujore.

Përgjatë pandemisë ERE ka vijuar takimet nëpërmjet platformave online duke ju përmbajtur rregullave të vendosura për ditancimin social si dhe ruajtjes së distancës fizike. Gjatë Vitit 2020 janë zhvilluar 53 mbledhje Bordi dhe janë marrë 275 Vendime nga ana e Bordit të ERE-s.

Po ashtu dhe nëpërmjet platformave online janë zhvilluar dhe trajnimet apo dhe takimet në organizmat ndërkombëtar, ku ERE bën pjesë aktive. Vlen të theksohet se së fundmi, Kryetari i ERE-s është përzgjedhur në Asamblenë e Nëntorit si President i MEDREG (Shoqatës së Rregullatorëve të Mesdheut) për një periudhë 2 (dy) vjeçare.

Pavarsisht arritjeve dhe performancës së mirë të Sektorit të Energjisë Elektrike në përgjithësi dhe në planin e përgatitjes së Legjislacionit Sekondar dhe Rregullator, ku përfshihet dhe Sektori i Gazit Natyror për Vitin 2020, ndër fushat të cilat kanë qënë ndër objektivat kryesore të punës së ERE-s për vitin dhe që kaloi janë si:

- Ecurinë e kënaqshme të ndarjes së Operatorit të Shpërndarjes.
- Krijimin e Bursës së Energjisë elektrike në Tetor 2020 me pjesmarrjen e OST dhe KOSTT
- Hapjen e tregut të konsumatorëve të energjisë elektrike të furnizuar në 35 kV në Mars
- Realizimi i projektit TAP në nëntor 2020.

MBI REKOMANDIMET E PROGRESRAPORTIT TË BE.

Rekomandimet e progresraportit të BE për vitin 2020 lidhur me kapitullin 15 “Energjia” janë si më poshtë vijon:

- Diversifikimi i burimeve të prodhimit të energjisë elektrike përtej burimeve hidrike dhe promovimi i tyre
- Ngritja e tregut të organizuar të energjisë elektrike në Shqipëri, pra Bursa Shqiptare e Energjisë.
- Finalizimi i ndarjes ligjore dhe funksionale së shoqërive publike në sektorin e energjisë elektrike.

Lidhur me sa më sipër, bëjmë me dije se ERE gjatë vitit 2020 ka miratuar çmimin e blerjes së energjisë elektrike të të prodhuar nga impiantet eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MË.

Gjithashtu, ka filluar procedurat për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020 dhe ka ftuar subjektet mbajtëse të miratimit përfundimtar të lëshuar nga MIE, të paraqesin dokumentacionin mbështetës.

Përsa i përket ngritjes së Bursës Shqiptare të Energjisë, në zbatim të Vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave është përcaktuar struktura dhe kapitali i saj, janë përcaktuar aksionerët e saj dhe aktualisht jemi në fazën e tenderimit të platformës elektronike, e cila do të shërbejë për kalimin në Go-Live të bursës. Ky kalim parashikohet të ndodhë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021.

Finalizimi i ndarjes ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, është tashmë një proces i përmbyllur me sukses, ku viti 2020 shënoi dhe vitin e parë të operimit individual të secilës prej shoqërive OSSH sh.a, FSHU sh.a dhe FTL sh.a. Shoqëritë e lartpërmendura kanë zhvilluar në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra aktivitetin përkatës, sipas licencave që ato zotërojnë.

Në këtë kuadër, mund të themi që aktiviteti i ERE-s gjatë vitit 2020 është zhvilluar në përputhje me rekomandimet e progresraportit të vitit 2020 për Shqipërinë, të miratuar nga Komisioni Europian

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË ERE PËR PERIUDHËN 2021 - 2023

Me këtë dokument, Enti Rregullator i Energjisë, në vijim ERE, adreson objektivat strategjike dhe aspektet kryesore të veprimit për periudhën 2021 – 2023 në kuadër të dinamikës së zhvillimit të sektorit në kontekstin kombëtar, si dhe atë të integritimit rajonal.

MISIONI DHE OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Veprimtaria e ERE në fushat objekt i rregullimit, drejtohet nga qëllimet e përgjithshme të përcaktuara sipas ligjeve nr. 43/2015 dhe atë nr. 102/2015. Në kuptim të këtyre ligjeve, ERE është përgjegjës për “Rregullimin e sektorit të Energjisë Elektrike dhe atë të sektorit të Gazit natyror”. Rregullimi kryhet nga ana e ERE – s, përmes miratimit të akteve nënligjore normative apo individuale që rregullojnë veprimtarinë e subjekteve të sektorit. Rregullimi, përfshin edhe vendosjen në tregun e rregulluar të një sistemi tarifor të besueshëm, transparent e të bazuar në kriteret e paracaktuara në ligj, duke mbajtur në konsideratë interesat e konsumatorëve, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore që sigurojnë një furnizim të vazhdueshëm kundrejt kostove të drejta dhe të argumentuara. Në përcaktimin e tarifave, ERE duhet gjithashtu “të harmonizojë objektivat ekonomiko – financiare” të subjekteve që ushtrojnë aktivitet të rregulluar, me objektivat e përgjithshme të sektorit në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit apo politikës shtetërore lidhur me zhvillimet sektoriale.

Një aspekt tjetër i rregullimit përfshin funksione monitoruese përmes kontrollit të të licencuarve dhe vendosjes së masave që synojnë të garantojnë pajtueshmërinë e operimit të të licencuarit me rregullat në fuqi. Qëllimi është të mbrojmë dhe të kemi një impakt pozitiv për të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike apo gazit natyror. Për këtë fokusohemi në punën për të promovuar sigurinë e furnizimit dhe qëndrueshmërinë për të tashmen, po ashtu dhe të ardhmen. Për të realizuar këtë objektiv ushtrojmë rregullimin dhe implementimin e skemave mbështetëse, si dhe mbikëqyrjen e tregut. Në punën e saj, ERE bashkëpunon me aktorët kryesorë të sektorit, duke mbajtur të pa cënuar pavarësinë institucionale të Entit si një qëllim i shenjtë i punës së rregullatorit. Sa më sipër kryhet brenda një kornize ligjore të përcaktuar në ligjet që rregullojnë veprimtarinë e ERE në sektorin e energjisë elektrike apo dhe atë të gazit natyror.

Ndër objektivat kryesor të ERE është mbrojtja e interesave të konsumatorëve, në lidhje me shërbimet e rregulluara të ofruara nga operatorët e sektorit. ERE kryen funksionet e saj në vlerësim të çuarjes përpara të objektivave të përcaktuar në ligj, duke promovuar konkurrencë efektive dhe transparente midis pjesëmarrësve të tregut. Në metodologjinë e punës së ERE për të kryer funksionet e saj për qëllime të promovimit të konkurrencës, ERE mban në konsideratë shkallën në të cilën interesat e konsumatorëve duhet të mbrohen si rrjedhojë e ushtrimit të këtyre funksioneve, si dhe nëse ato do të promovojnë ose jo transparencën në veprimtarinë në treg.

Në përcaktimin e Objektivave Strategjike, ERE bazohet në realizimin e qëllimeve të ligjeve të sipërcituara dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, për garantimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët si një shërbim i domosdoshëm në terma ekonomike, teknike, e mjedisore, të shtrirë në të gjithë vendin, dhe i harmonizuar me parimet e objektivat strategjike të vendit.

KUADRI STRATEGJIK

Kuadri Strategjik paraqitet më poshtë i orientuar në dy drejtime kryesore:

- **Objektivat strategjikë**, në të gjithë aktivitetet e rregulluar të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror.
- **Planet e veprimeve** të cilat përshkruajnë masat kryesore që ERE synon të përdorë për realizimin e secilit objektiv strategjik në funksion edhe të një afati kohor dhe me veprime konkrete që afektojnë pozitivisht aktivitetet në këto fusha.

Objektivat strategjikë dhe linjat e veprimit nuk e shterojnë kuadrin e veprimtarive që ERE do të duhet të ndërmarrë për rregullimin dhe kontrollin e sektorëve në fushën e saj të përgjegjësisë, por ato përfaqësojnë pikat kryesore në të cilat synohet të ndërhyhet me përparësi, gjithashtu në kontekstin e zhvillimeve sektoriale në vend.

OBJEKTIVAT STRATEGJIKË PËR VITET 2021 - 2023

1 - Mbrojtja e Konsumatorëve përmes ndërgjegjësimit

Prioriteti kryesor i rregullatorëve është “Mbrojtja e interesave të konsumatorëve”, dhe pikërisht konsumatorët janë në thelbin e strategjisë së ERE – s për 2 vitet pasardhëse. Në shoqërinë e informacionit aspekte të rëndësishme të mbrojtjes konsumatore janë jo vetëm tarifa të arsyeshme që reflektojnë kostot e argumentuara por edhe shërbim në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në fushën e informacionit, aspekte të rëndësishme të mbrojtjes konsumatore janë jo vetëm tarifa të arsyeshme, që reflektojnë kostot e argumentuara, por edhe shërbim në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e palëve ofruese dhe marrëse të këtij shërbimi.

Në kontekstin e përgjithshëm të objektivave dhe veprimeve të përshkruara më tej, inovacioni dhe zhvillimi teknologjik (nga të cilat dixhitalizimi përfaqëson një ndër elementët kyç) përbëjnë faktorë të rëndësishëm të evolucionit, i lidhur ngushtë me benefitet që vijnë nga përdorimi i teknologjisë, por i shoqëruar paralelisht edhe me rrezikun e mundshëm të kostove ekstra të krijuara nga ky përdorim teknologjie, çka kërkon vëmendje të vazhdueshme ndaj kostove të shërbimeve.

Në aspektin e kuadrit rregullator ERE është angazhuar për të konsoliduar koherencën e mekanizmave rregullatorë në aktivitetet e ndryshme të fushës së përgjegjësisë së tij. Brenda këtij kuadri, konsumatori merr një rol vendimtar e në rritje. Në këtë kontekst, ndërgjegjësimi i konsumatorit për t’u bërë klient i aftë në vlerësimin e ofertave, kuptimin e drejtë të mekanizmave të tregut, deri në mundësinë për të marrë pjesë në mënyrë aktive në shërbimet e lidhura me furnizimin, siç është rasti i Vetprodhuesve që prodhojnë dhe konsumojnë vetë energji, merr një rëndësi të veçantë. Ky është një aspekt tjetër i rolit të konsumatorit dhe spektrit të të drejtave e mundësisë së zgjedhjes prej tij, jo vetëm të furnizuesit të energjisë, por edhe të kryerjes aktiv të funksionit të prodhuesit/konsumator të energjisë elektrike, duke minimizuar kostot individuale për sigurimin e energjisë elektrike, dhe pse jo rritjes së rolit të tij në treg. Në këtë aspekt, është me mjaft rëndësi ndërgjegjësimi i konsumatorit për mekanizmat e ndryshëm rregullator, por edhe rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me rolin e tyre të konsumit, në kuadër të lehtësirave që krijojnë proceset e hapjes së tregut në sektor. Nga ana tjetër, rregullimi jo vetëm që duhet të reflektojë një politikë të qëndrueshme që lejon konsumatorin të bëj

vlerësime, por nga ana tjetër duhet të harmonizojë nevojën për investime në teknologjinë e informacionit me vlerësimin e kujdesshëm të kostove të lidhura me investimet në sektor.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i objektivave që ERE merr në kuadër të rregullimit, por edhe integritimit të praktikave bashkohore të përdorimit të energjisë elektrike, është ai që lidhet me hapjen e diskutimit publik, si dhe kryerjes së analizave konstatuese mbi impaktin dhe efikasitetin e përdorimit të burimeve të tjera të energjisë, si një alternativë ndaj përdorimit të energjisë elektrike me qëllim uljen e impaktit që kjo e fundit ka në mjedis. Novacionet teknologjike, gjithmonë e më shumë po ecin në drejtim të maksimizimit të efikasitetit për sigurimin e shërbimeve me impakt të ulët në mjedis, e kosto më të ulëta. I tillë, por jo i vetëm është dhe përdorimi i energjisë elektrike si një burim energjie për mjetet levizëse të transportit (taksitë, makinat vetjake apo edhe transporti publik).

Energjia është një mall me kosto, e në varësi të të ardhurave të një familjeje, e nevojës për përdorimin e energjisë elektrike, është i një rëndësie të veçantë, sensibilizimi i konsumatorëve mbi racionalizimin e energjisë elektrike. Vendosija e urave të bashkëpunimit mes ERE dhe Agjensive për efikasitetin e energjisë elektrike me qëllim sensibilizimin e konsumatorit dhe rritjen e ndërgjegjes kolektive mbi rëndësinë e përdorimit të energjisë elektrike si një produkt i çmuar, i cili nuk duhet të përdoret me efikasitet dhe efikasitet, do të jetë ndër targetat e punës së ERE – s përgjatë tre vjeçarit në vijim.

2 - Dhënia zë konsumatorit

ERE, në përputhje me objektivat e përcaktuar në ligj, synon të mbështesë dhe promovojë kalimin nga një konsumator pasiv, subjekt i tarifave të rregulluara, akteve rregullatore, në një pjesëmarrës aktiv të tregut të energjisë. Hapi i parë në këtë drejtim është duke i siguruar konsumatorit mjete për të kuptuar më mirë nevojat e veta në terma cilësore, në mënyrë që të mund të funksionojë koncepti i pjesëmarrjes aktive në treg. Një nga mekanizmat që mund të përdoren për këtë qëllim është fokusimi i punës së ERE në 3 vjeçarit në vijim, në shfrytëzimin më të mirë të mjeteve të informacionit, organizimit të trajnimeve apo tryezave informuese, vënien në efikasitet të numrit pa pagesë në shërbim të konsumatorit, si dhe transparencës sa i përket ligjëbërjes në favor të konsumatorëve. Këto mekanizma do t'i shërbejnë ERE edhe në funksion të adresimit, përmes kuptimit të problematikave apo barrierave që konsumatorët konstatojnë dhe arrijnë të vlerësojnë.

3 - Ndërgjegjësimi i konsumatorëve dhe transparenca në vlerësim të shërbimit

Ndërhyrjet e rregullatorit lidhen kryesisht me zhvillimin dhe përditësimin e një sistemi të menaxhimit dhe trajtimit të ankesave, dhënies së informacionit të saktë e të shpejtë, në kuadër të mundësive të reja teknologjike, që mundesojnë trajtimin në një kohë sa më të shkurtër e me mjete më të thjeshta. Lehtësimin e aksesit për shërbimet e kërkuara në kuadër të zgjedhjes alternative të mosmarrëveshjeve (ZAM) si një mjet për zgjidhjen e shpejtë të problematikave që normalisht kërkojnë më shumë kohë dhe kosto përmes zgjidhjeve gjyqësore.

Për këtë qëllim, me mjaft rëndësi është edhe vendosja e protokolleve të bashkëpunimit me organizatat e shoqatat që kanë në fokus mbrojtjen e konsumatorëve apo njësitë përgjegjëse në shërbim të konsumatorit pranë pushtetit lokal apo qëndror.

4 - Forcimi i mekanizmave mbështetës për konsumatorët në nevojë

Ligji për Sektorin e Energjisë Elektrike ka adresuar në mënyrë të veçantë mbrojtjen e Klientëve në nevojë, në kuadër të sigurimit të një të drejte thelbësore e shumë të rëndësishme, siç është e drejta për të patur energji elektrike. Ky ligj, i cili përcakton ndër objektivat e ERE – s, mbrojtjen e klientëve në nevojë, ka parashikuar, veç të tjerave, detyrimin për furnizuesin e shërbimit universal që të furnizojë në mënyrë të pandërprerë klientët në nevojë, duke respektuar kushtet e përcaktuara në ligj, si dhe kushtet e veçanta që duhen marrë në konsideratë nga ana e ERE – s për të garantuar mbrojtjen e atyre klientëve të energjisë që kanë përfituar këtë status, mbështetur në kriteret dhe procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë, të përcaktuar në aktet ligjore për këtë qëllim.

Energjia elektrike është një shërbim jetësor dhe thelbësor që ndikon në mirëqenien dhe cilësinë e jetës së njerëzve, dhe si të tillë ERE vlerëson se, një aspekt i rëndësishëm i mirëfunksionimit të tregut lidhet me përmbushjen e nevojave specifike për furnizimin me energji elektrike të kategorive të konsumatorëve në rrethana të caktuara. Për këtë qëllim ERE konsideron hartimin e politikave të qarta rregullatore për të adresuar të gjitha sfidat dhe pengesat që lidhen me implementimin e politikave në mbrojtje të konsumatorit në nevojë në sektorin e energjisë elektrike si një target të domosdoshëm për t'u arritur gjatë tre vjeçarit të ardhshëm.

Mbështetja dhe mbrojtja e konsumatorëve është një prioritet kyç i lidhur me përgjegjësitë e Entit. Vizioni është që të mundësojmë një treg të energjisë për të gjithë konsumatorët duke përfshirë edhe konsumatorët në nevojë. Puna dhe detyrat e ERE – s në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë do të kërkojë një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe aktiv me institucionet përgjegjëse për politikën e mbrojtjes së konsumatorëve në tërësi. Megjithatë Ligji nuk ia adreson ERE – s përcaktimin e konsumatorëve në nevojë dhe kriteret e përfitimit të statusit të klientit në nevojë, në rolin e tij si rregulator i sektorit, roli i ERE – s është tejet i rëndësishëm në krijimin e kushteve për mundësinë e furnizimit të tyre në mënyrë të vazhdueshme dhe me cilësi.

Aktet nënligjore të miratuara nga ERE, kanë adresuar rrethanat e ndërprerjes së energjisë elektrike për klientët në nevojë që rezultojnë debitorë. Në vijim, në fokus të punës së ERE – s mbetet ndërmarrja e aktiviteteve të pajtueshmërisë dhe zbatimit për të siguruar që të liçensuarit që ofrojnë shërbim furnizimi, të kenë vëmendjen e nevojshme dhe kujdesin që aktiviteti i tyre të jetë në përputhje me konceptet e mbrojtjes të konsumatorëve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

PLANI I VEPRIMEVE

1 - Aktivizimi i konsumatorit

Në kuadër të bashkëpunimit me shoqatat dhe organizatat, që në objekt të veprimtarisë së tyre kanë mbrojtjen e konsumatorëve do t'i kushtohet vëmendje e veçantë promovimit të transparencës e qartësisë në dialogun me konsumatorët, duke përmirësuar të gjitha kanalet aktuale të komunikimit nga ana e ERE – s, që lejojnë një mënyrë më efektive për përhapjen e njohurive për të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve e që forcojnë shkallën e tyre të besimit, nëpërmjet vendosjes së një marrëdhënie të drejtpërdrejtë dhe inovative me një audiencë sa më të gjerë duke shfrytëzuar nga njëra anë, mundësitë teknologjike, por duke vijuar me mjetet tradicionale, për ata konsumatorë që kanë nevojë për të.

Zhvillimi i një Portali të Konsumatorit, i cili të jetë aktiv e në dispozicion të këtij të fundit, në përputhje dhe me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe që ofron shërbim mbi të dhënat historike të konsumit të tij përmes Sistemit të Informacionit të Integruar me Operatorin përgjegjës për regjistrimin e konsumit të energjisë, të klientëve.

Realizimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuere që synojnë të përmirësojnë ndërgjegjësimin e konsumatorit/përdoruesit mbi funksionimin dhe rregullimin në fushat e kompetencës së ERE.

2 - Ndërgjegjësimi për konsumatorët dhe transparencë për vlerësim të shërbimit

Veprimet për qëllim të këtij objekti, përfshijnë ndjekjen e praktikave më të mira ndërkombëtare në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për të ndihmuar në zgjidhjen e tyre. Një analizë e praktikave rajonale do të shërbente përditësimit të këtyre rregullave në procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Kjo analizë do të përfshijë ndër të tjera studimin mbi përmirësimin e procedurave ekzistuese të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, krijimit të një strategjie për të mbështetur një komunikim efektiv duke u angazhuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes konsumatorëve dhe të licensuarve, në mënyrë interaktive me ERE – n dhe këtyre të fundit.

Qasja rregullatore për tregun e energjisë është sigurimi se opinioni i konsumatorëve, apo dhe nevojat e tyre aktuale dhe të ardhshme janë marrë në konsideratë në çdo rast që ka patur apo ka nevojë për rregullim.

Për këtë qëllim praktikat rregullatore do të vijojnë të përfshijnë zhvillimin e seancave dëgjimore dhe konsultimeve mes palëve, për një gjykim të drejtë të problematikave të ngritura dhe zgjidhjeve respektive të tyre.

Furnizimi i energjisë konsiston kryesisht në ofrimin e shërbimit në mënyrë cilësore dhe me standarde të tij. Për këtë qëllim, ERE do të përgatisë treguesit e matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj Klientit që garanton çdo i licensuar në furnizim.

Këta tregues do të percaktojnë nivelin e kënaqësisë së klientit ndaj shërbimit të ofruar, parë në këndvështrimin e të gjitha aspekteve të marrëdhënies së tij me ofruesin e shërbimit. Sa më sipër lidhet me kushtet e garantimit dhe zbatimit të një kontrate furnizimi dhe më tej, aspekte të tilla si vlerësimi konsumator mbi procedurat dhe afatet për lidhjen e një kontrate, ndryshimin e furnizuesit, emetimin

e faturave në afat, trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave nga ana e ofruesit të shërbimit dhe garantimi i aksesit në të dhënat vetjake që lidhen me konsumin e energjisë.

Paralelisht do të vendosen dhe monitorohen rregullisht standardet e cilësisë së shërbimit. Për këtë qëllim do të vijohet me përcaktimin e kriterëve të standardeve të cilësisë në përputhje me rregulloren për cilësinë e shërbimit, si dhe përditësimin e tyre periodik mbështetur në të dhënat e gjeneruara përgjatë një viti kalendarik si dhe pritshmërinë e vlerësimit të shërbimit të cilësisë së shërbimit, të investimeve të propozuara dhe miratuara për ofruesit e shërbimit publik, kjo bazuar dhe në praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Po ashtu do të zhvillohet dhe çdo formë tjetër përfshirje, për qëllime të marrjes së opinionit të konsumatorëve, për të kuptuar më mirë objektivat e tyre në të ardhmen dhe atë që konsumtarët presin nga ERE.

3 - Forcimi i mekanizmave mbështetës për konsumatorët në nevojë.

Adresimi i zgjidhjeve për një furnizim të qëndrueshëm të konsumatorëve në nevojë kërkon veprime të përbashkëta ndërmjet qeverisë, rregullatorit dhe pjesëmarrësve të tjerë të sektorit të energjisë. Vulnerabiliteti është një çështje komplekse për të trajtuar ku të gjithë politikëbërësit, grupet e interesit, organizmat apo shoqatat me fokus konsumatorin, si dhe ofruesit e shërbimeve duhet të bashkëpunojnë për të adresuar sfidat që lidhen me këtë kategori.

Një vëmendje e veçantë do të kushtohet bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse për politikën e mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë. Për këtë qëllim do të vijohet komunikimi me institucionet përgjegjëse për vendosjen e kriterëve të përcaktimit të klientëve në nevojë.

Në përputhje me zhvillimet e këtyre politikave synohet përditësimi i akteve rregullatore që lidhet me sigurimin me cilësi të furnizimit me energji elektrike të këtyre konsumatorëve. Nisur nga praktikatat më të mira rajonale dhe më gjërë, nga ERE do të përgatiten edhe propozimet e nevojshme për të shtyrë përpara iniciativat ligjore, për rregullimin e kuadrit ligjor plotësues për këtë kategori, në rolin e një aktori më aktiv në drejtim të kompetencave rregulluese për këtë kategori konsumatorësh.

Për këtë qëllim, kryerja e një studimi lidhur me politikatat më të mira rregulluese për mbrojtjen e klientëve në nevojë në vendet e BE-së, do të shërbejë për të propozuar pranë institucioneve kompetente ndryshimet e nevojshme në aktet ligjore dhe nënligjore, përfshirë ndryshimet e nevojshme me aktet rregullatore të ERE. Sfidë më vete në drejtim të politikave të mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë është aspekti i shmangies së ndër – subvencioneve dhe rolit që duhet të luajmë për rishpërndarjen e kostove në grupe të ndryshme të konsumatorëve, apo dhe në nevojën për aplikimin e politikave që lidhen me efikasitetin në energji.

Në kuadër të studimit për ndryshimet e nevojshme në kuadrin rregullator, po ashtu vëmendje e veçantë do të kushtohet dhe aspekteve që lidhen me barrierat me të cilat përballen këta konsumatorë në krahasim me klientët e tjerë. Eksperiencia ka treguar se konsumatorët në nevojë mund ndihen të paafër për të marrë vendime që lidhen me furnizimin në energji. Studimi i barrierave mund të përfshijë bashkëpunimin edhe me organet përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit apo me shoqatat e konsumatorit. Klientëve në nevojë duhet t'u sigurohet mbështetje edhe nga organet përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorit apo shoqatat e konsumatorëve, si edhe ndërgjegjësimi i të licënsuarve apo

pjestarëve të tregut për hartimin e politikave brenda kompanive lidhur me mënyrën se si ata projektojnë dhe realizojnë shërbimet e tyre për klientët në nevojë.

Hartimi i një Programi të Mbrojtjes së Konsumatorëve do të shërbente për të siguruar njohuri të mjaftueshme dhe të vazhdueshme në politikat mbështetëse për konsumatorët.

ZHVILLIMI I TREGJEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR GJITHNJË E MË EFIKAS DHE TË INTEGRUAR.

ERE do të përqëndrohet në punën e saj ndër të tjera, në promovimin e konkurrencës dhe inovacionit me qëllim uljen e çmimeve dhe në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimeve;

Mbështetur kjo, në sa më poshtë:

- Parimi i hapjes së tregut – përdorimi i mekanizmave të tregut kudo që është e mundur për të përfituar plotësisht nga inovacioni dhe konkurrenca;
- Parimi i koherencës – rregullim efikas dhe i përgjegjshëm ku është e mundur, që shfrytëzon mundësitë e mëdha të ekonomisë dixhitale (smart), dhe
- Parimi i shpërndarjes së drejtë – konsumatorët e të gjitha llojeve duhet të paguajnë një pjesë të drejtë të kostove të sistemit në përputhje me shërbimin që marrin dhe kostot që shkaktojnë.

Në këtë drejtim prioritetet e ERE gjatë kësaj periudhe do të jenë:

Zhvillimi i një reforme tarifore nisur nga riorganizimi dhe hapja e tregut.

- Për këtë qëllim është e nevojshme një analizë e plotë e problematikave të konstatuara pas miratimit të metodologjive dhe adresimi i zgjidhjeve përmes praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim. Për këtë qëllim, do të përdoren raportet, studimet e kryera nga donatorët apo dhe organizatat rajonale ku ERE aderon.
- Realizimi i një studimi në mënyrë që të vlerësohen mundësitë që çojnë në uljen e kostove për konsumatorët dhe mbështesin tranzicionin drejt liberalizimit të plotë.
- Analizë të detajuar mbi një vlerësim se si rregullimi ndikon në grupe të ndryshme të konsumatorëve; dhe
- Zhvillimi i mënyrave efektive të vendosjes së bazës së rregulluar të aseteve (RAB).

Nevoja për të lejuar një pjesëmarrje gjithnjë e më të gjerë aktive të pjesëmarrësve të tregut me transaksione të orientuara në tregun e ditës në avancë dhe intrada, do të duhet të gjejnë zgjidhje, në mënyrë që të përfshijnë kostot e sistemit në lidhje me shërbimet e ofruara në treg.

Objektivi i kësaj strategjie synon të sigurojë që politikat rregullatore, mekanizmat dhe praktikat operacionale do të zbatohen në përputhje me praktikat më të mira rregullatore dhe dispozitat e zbatueshme të legjislativës të Komunitetit të Energjisë, si dhe Kodet e zbatueshme të Rrjetit.

Enti Rregullator i Energjisë, miraton rregullat dhe rregulloret e nevojshme për të përmbushur detyrimet sipas Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror të vitit 2015, i ndryshuar. ERE lëshon licencat për operimin e aktivitetëve në fushën e gazit natyror. Përcakton tarifat dhe çmimet në përputhje me

kushtet e Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror të vitit 2015. Monitoron, kontrollon dhe siguron pajtueshmërinë me kushtet, ligjet dhe liçensat.

Siguron mbrojtjen e konsumatorit në lidhje me tarifat.

Sa i përket sektorit të gazit natyror, ERE ka marrë masat e nevojshme për draftimin e kuadrit të plotë ligjor që faciliton operimin në këtë sektor, pavarësisht se aktiviteti në sektorin e gazit në Shqipëri është në stadin foshnjor. Në objektivat afatgjatë 3 vjeçarë të ERE do të jenë:

1. Identifikimi i nevojës dhe kërkesave për gaz dhe skenarët e mundshëm për të mundësuar furnizimin me gaz të konsumatorit shqiptar, qoftë ai familjar apo edhe jo familjar.
2. Studimi i Politikave të çmimeve, tarifave dhe implementimit të rregulloreve të gazit të miratuara nga ERE dhe jo vetëm.
3. Zhvillimin e njohurive dhe aftësive brenda Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për të identifikuar në kohë mundësinë për rregullim dhe ndërhyrje aty ku është nevoja,
4. Adresimi i çështjeve që lidhen me kuadrin institucional kombëtar të sektorit të gazit, dhe dhënia e rekomandimeve për zhvillimin e mëtejshëm të tij, si dhe mbështetja në zhvillimin e njohurive në fushën e gazit dhe aftësimin profesional të punonjësve të ERE nëpërmjet trajnimeve të targetuara për specifikat e zhvillimit të këtij sektori në Shqipëri.
5. Vlerësimi i rrjetit ekzistues të gazit në Shqipëri, dhe dhënia e rekomandimeve për integrimin e tij të mundshëm në sistemin e ardhshëm kombëtar të gazit.

1 - Integrimi rajonal

Memorandumi i Mirëkuptimit të WB6, i nënshkruar më 27 Prill 2016 në Vjenë nga 6 vende, përfshirë Shqipërinë dhe Kosovën. Në kuadër të këtij Memorandumi, në përputhje me kompetencat e tyre ligjore, rregullatorët do të përdorin autoritetet e tyre për:

- Të hequr pengesat rregullatore dhe monitorojnë zhvillimin e vazhdueshëm në nivel teknik dhe rregullator.
- Të miratojnë procedurë të përbashkët dhe efikase të vendimmarrjes, që do të ndihmojnë në krijimin e mundshëm dhe të duhur të Bursës (PX).

Ligji Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë”, i ndryshuar, përcakton ERE – në cilësinë e Autoritetit përgjegjës për garantimin e promovimit të konkurrencës dhe efikasitetin në sektor. Modeli i Tregut i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.07.2016, thekson ndër të tjera se, Shqipëria është e angazhuar të zbatojë një sërë masash afatshkurtra, në kuadrin e procesit të Berlinit (Ballkani Perëndimor 6). Modeli i tregut synon të mbështesë zbatimin e angazhimeve të ndërmarra në kuadrin e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar dhe rregulloret përkatëse. Ky model synon ndër të tjera të sigurojë një strukturë të qëndrueshme dhe të krijojë kushtet për integrimin e mëtejshëm rajonal, midis Shqipërisë dhe vendeve fqinje. Mekanizmi i Bashkimit të Tregut është pjesë e projektit Evropian për krijimin e Tregut të Brendshëm të Energjisë për të rritur efikasitetin e tij.

Aktualisht nën asistencën dhe mbështetjen e USAID janë hedhur hapa të rëndësishëm në kuadër të bashkimit të tregjeve ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës.

Në vijim puna e rregullatorit do të fokusohet ndër të tjera në:

- Kontrollin dhe azhurnimin e legjislacionit në fuqi nëse ka pengesa ligjore në procesin e bashkimit të tregut, përfshirë bashkëpunimin për liçensimin në tregjet reciproke, operimin e pjesëmarrësve në treg, alokimin e kapacitetit ndërkufitar përmes ankandit eksplícit apo dhe zbatimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në këtë drejtim.
- Mbështetjen për zbatimin e rregullave teknike për operimin e tregjeve të përbashkëta nga të dy TSO-të.
- Përpilimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve midis OST – ve dhe Rregullatorëve për implementimin e bashkimit të tregjeve.
- Nominimin e NEMO – s për operimin e të dy tregjeve në përputhje me kushtet e nominimit, si dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare.

2 - Forcimi i aksesit në informacion për funksionimin korrekt të proceseve të tregut.

ERE në përputhje me kompetencat rregullatore do të fokusojë punën e saj për të mbledhur dhe menaxhuar flukset në rritje të të dhënave që bëhen të disponueshme, dhe në mënyrë më të dukshme të bazojë metodat e saj analitike dhe vendimmarrjen në bazë të këtyre të dhënave. Përdorimi më i mirë i të dhënave do të mundësojë që ERE të veprojë në mënyrë më efektive dhe transparente.

Në këtë kontekst, ERE synon të forcojë angazhimin e saj për integrimin e tregut kombëtar të energjisë në kontekstin rajonal, në koordinim të ngushtë me ministrinë përgjegjëse për energjinë, operatorët e rrjetit, dhe rregullatorët fqinjë duke siguruar transparencën e nevojshme ndaj palëve të interesuara.

Evolucioni i veprimtarisë së operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe asaj të shpërndarjes, si dhe marrëdhënia e tyre me përdoruesit, gjithashtu do të analizohen në kontekstin e shmangies së barrierave dhe në adresimin në kuadër të miratimit të investimeve, që i shërbejnë cilësisë së shërbimit, por edhe sigurisë së sistemit, i cili në të njëjtën kohë ka përfitimet e veta nga dixhitalizimi, por njëkohësisht është edhe vulnerabël për mbrojtjen nga sulmet kibernetike. Në këtë kontekst ERE do të fokusohet edhe në analizën e nivelit të implementimit të Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike nga operatorët si dhe shtrirjen e saj dhe në sektorin e gazit natyror.

Krahas rregullimit klasik përmes mbikëqyrjes apo përmes përpunimit të të dhënave, është e nevojshme që, në mënyrë progresive të forcohen aktivitetet për monitorimin e sjelljes së operatorëve të tregut, veçanërisht në zbatimin e Rregullores Evropiane REMIT, me qëllim garantimin e kushteve transparente konkurruese dhe luftimin dhe parandalimin e sjelljes abuzive duke identifikuar menjëherë çdo nevojë për të përshtatur vetë rregulloren (edhe për qëllimet e sigurisë së sistemit), si dhe për çdo raport mbi konkurrencën në treg.

Implementimi i REMIT do të bazohet në Kuadrin ligjor dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare të orientuar në:

- Detyrimin për të publikuar informacione të brendshme
- Ndalimin e abuzimit të tregut (tregtimi i brendshëm dhe manipulimi i tregut)

- Monitorimin e Tregut (regjistrimi i pjesëmarrësve në treg)
- Mekanizmin e Raportimit të detajuar, mbledhja e të dhënave
- Kompetencat hetimore dhe të zbatimit të penalteteve të rregullatorit
- Aspekte të tjerë në lidhje me mbrojtjen dhe besueshmërinë e të dhënave
- Lista e kontratave dhe të dhënave që do të raportohen
- Palët përgjegjëse dhe afatet
- Udhëzime, rekomandime
- Njohja e palëve me detyrimet e zbatimit të kësaj rregulloreje
- Bashkëveprimi ndër rajonal për zbatimin e saj në rajon e më gjerë

Pikërisht politikat rregullatore edhe në vijim do të këndohen për qëllim që të sigurojnë qëndrueshmëri ligjore dhe rregullatore për të menaxhuar potencialin për praktika abuzive që dëmtojnë në mënyrë të padrejtë tregun.

Brenda vitit 2021 synohet të realizohet procesi i konsultimit të draftit të Rregullave për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë (REMIT) të cilat do të hyjnë në fuqi dhe do të jenë të detyrueshme për tu zbatuar brenda tremujorit të parë të vitit 2021.

PLANI I VEPRIMEVE PËR ZHVILLIMIN E TREGJEVE

1- Racionalizimi dhe thjeshtimi i rrjedhës të informacionit për të vlerësuar funksionimin e proceseve të tregut

Qëllimi është të përfundojnë reformat që synojnë racionalizimin dhe thjeshtimin e flukseve të informacionit i cili garanton funksionimin e duhur të tregjeve dhe marrja e informacionit sa më thjeshtuar për konsumatorin. Në këtë kontekst është e nevojshme të përfundohen reformat e proceseve tregtare që kanë të bëjnë me të drejtën për ndryshimin e furnizimit dhe administrimit të procedurave të ndërhyrjes në rast të borxheve midis palëve, si dhe ndërhyrjet rregullatore në fushën e menaxhimit të të dhënave në lidhje me përdorimin e të dhënave të klientëve fundorë të përpunuara nga operatorët e rrjetit.

Për këtë do të analizohen të dhënat lidhur me detyrimet e raportimit, metodat dhe kohën e vënies së tyre në dispozicion, përdorimi i të dhënave për palët e interesuara dhe, në veçanti për pjesëmarrësit e tregut. Në këtë kontekst në përputhje me gjetjet gjatë vitit 2021, në vijim në vitin 2023 do të përpunohen edhe propozimet për ndryshimet e nevojshme në aktet rregullatore. Sa më sipër do të jetë produkt i vlerësimit të kornizës rregullatore që identifikon çdo pengesë në legjislacionin primar dhe atë sekondar për të vendosur mbi ndryshimet e mundshme atje ku vlerësohet e nevojshme.

Në po këtë prizëm, rregullatori do të shërbejë dhe si një ndërfaqe për dhënien e informacionit të nevojshëm për konsumatorët dhe mundësitë që ofrojnë furnizuesit në mënyrë që konsumatori të ketë

një panoramë të qartë të mundësive që i ofrohen, përfshirë këtu çmimet dhe cilësia me të cilën këto shërbime ofrohen, si dhe detyrimet që ka ndaj kontratës së furnizimit me ofruesit e këtij shërbimi.

2 - Realizimi i bashkimit të tregjeve Shqipëri – Kosovë

Bashkimi i tregut midis Shqipërisë dhe Kosovës filloi nën një qasje vullnetare. Qeveritë e të dy vendeve janë përfshirë që në fillim për të mbështetur projektin. Rregullatorët do të luajnë një rol të rëndësishëm duke nxitur marrëveshjet e bashkëpunimit dhe marrëveshjet operationale të propozuara nga ana e TSO – ve, OST dhe PX.

Gjithashtu do të jetë në fokus ndër të tjera dhe:

- Identifikimi se cilat pjesë të CACM mund të transpozohen në kornizën ligjore aktuale;
- Kontrolli nëse ka pengesa ligjore në legjislacionin kombëtar që pengojnë ose vonojnë bashkimin e tregjeve;
- OST dhe PX përgjegjës për zbatimin e iniciativës dhe trajtimin e fazës operationale.

Më tej do të punohet në drejtim të zgjerimit të integritetit duke ftuar rregullatorët e tjerë të Ballkanit për t'u bashkuar në projektet në kaudër të WB6.

3 - Forcimi i aksesit në informacion për funksionimin korrekt të proceseve të tregut.

ERE gjithmonë ka vlerësuar aksesin në informacion dhe transparencën si kritike për arritjen e misionit dhe qëllimit të saj, politikë e cila qëndron në themel të praktikave të vendmarjes. ERE ka funksionuar gjithmonë si një organ publik i hapur duke publikuar vendimet e saj, pa shmangur paralelisht edhe detyrimet për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe privatësisë. Vendimet e ERE janë thjeshtësisht të aksesueshme nëpërmjet faqes së internetit, por edhe nëpërmjet publikimit në Fletoren Zyrtare.

Përdorimi i Teknologjive të reja vlerësohet si një nga mjetet për të çuar edhe më tej praktikën e një organi të hapur ndaj publikut dhe palëve të interesuara. Në këtë drejtim, është në fokusin e ERE duke amplifikuar këtë politikë në kuadër të hartimit të një strategjie të dixhitalizimit që shërben si një bazë për të ndihmuar në krijimin e një kulture, ku të dhënat luajnë një rol të madh në vendimet rregullatore. Për këtë qëllim është e rëndësishme të sigurohet në vijimësi :

- Aksesin e rregullatorit në të dhëna, në mënyrë që të prodhojnë vendime, të garantuara nga ky informacion.
- Aplikimi i teknologjisë në praktikën rregullatore, duke ofruar shërbime të klientëve dhe më efektive, duke shfrytëzuar platforma të përbashkëta për të përmirësuar shpërndarjen e informacionit në të gjithë aktorët e tregut të energjisë me synimin që të mundësojë shpërndarjen më efektive dhe të koordinuar të informacionit dixhital në të gjithë sektorin ku ERE është marrës por, dhe burim informacioni për tregun. Plani i veprimit në këtë drejtim përfshin edhe shfrytëzimin e mundësive për të blerë pajisjet, aplikacionet dixhitale mbi përpunimin e të dhënave.

VLERËSIMI I NDIKIMIT RREGULLATOR

1 - Transparenca dhe integriteti në veprimtarinë administrative

Në studimin e Organizatës për zhvillim dhe bashkëpunim ekonomik (OECD), vlerësohet se është e rëndësishme që rregullatorët të jenë të vetëdijshëm për ndikimet e veprimeve dhe vendimeve të tyre rregullatore. Një indeks matës për shumë rregullatorë mund të jetë koha e përpunimit të akteve rregullatore ose vendimeve të tjera. Vonesat e panevojshme në proceset rregullatore që mund të imponojnë kosto shtesë për biznesin dhe komunitetin, dhe kështu rregullatorët duhet të përshpejtojnë kohën e tyre të përpunimit për vendimet kryesore në kuadër të standardeve të përcaktuara.

ERE është një organ administrativ i pavarur, në përputhje me ligjin për Energjinë dhe Gazin Natyror, që ushtron kompetencat me paanësi dhe transparencë.

Është parimi i konsoliduar në veprimtarinë e ERE, që ushtrimi i kompetencave rregullatore të përfshijë procedura të bazuara në pjesëmarrje, si përmes konsultimit të personave, ekspertëve të fushës, ashtu edhe në drejtim të grupeve të gjëra të interesit. Sa më sipër, është vlerësuar si një aspekt i rëndësishëm i llogaridhënies, duke informuar mbajtësit e interesave në treg në mënyrë adekuate dhe mbledhjen dhe marrjen e mendimeve, opinioneve dhe propozimeve.

2 - Plani i veprimit konsiston në:

Përfshirja e palëve të interesuara në përcaktimin e strategjive dhe politikave rregullatore, jo vetëm duke u siguruar që të dëgjohen, por edhe duke u kujdesur për angazhimin për të siguruar një raport të aktiviteteve, për angazhimin e tyre periodik mbi ndikimin e akteve rregullatore.

Për këtë qëllim do të vlerësohen edhe praktikatat më të mira për ngritjen e strukturave konsultative të përhershme të tilla si komisione të përbashkëta të palëve të interesit që do të shërbejnë vendimarrjes.

Vendosja e indikatorëve të performacës për vlerësim nga vetë rregullatori përbën një element kyç dhe mjaft të rëndësishëm të kësaj strategjie.

3 - Linjat e veprimit

Në këtë drejtim identifikohen linjat e veprimit si vijon:

Transparenca e vendimarrjeve,

- Publikimi i vendimeve, relacioneve dhe aplikimeve.
- Verifikimin ex post i ndikimit të rregullores.
- Studim i praktikave më të mira për vlerësimin e efekteve të rregullimit me mbështetje nga ekspertë akademikë dhe ekspertë të tjerë me përvojë në fushë.

Të gjitha këto lejojnë rregullatorin që, nga njëra anë të kuptojë përgjigjen e operatorëve apo palëve të tjera të interesit, ndaj ndërhyrjeve të rregullatorit, nga ana tjetër për të zbatuar çdo veprim korrigjues pas hetimeve, analizave e zbulimit të fakteve, kontrolleve dhe inspektimeve e dokumentave që lidhen

me zbatimin e këtyre akteve. Për këtë qëllim, ERE do të vijojë të kryejë anketime për të vlerësuar ndikimin rregullator.

ERE është e fokusuar për të krijuar një kornizë analitike për të vlerësuar vazhdimisht ndikimin e politikave tona për grupe të veçanta të konsumatorëve në situata të ndryshme. Për këtë, do të përqendrohemi në hartimin e një kornize rregullatore për kriteret e vlerësimit e ndikimit të parimeve të Rregullatorit.

Kjo kornizë rregullatore do të përdoret, për të kuptuar ndikimin e politikave tona për grupe të veçanta të konsumatorëve që mund të jenë në situata vulnerabël.

Qëllimi jonë është që kur marrim vendime, ta bëjmë këtë në një mënyrë që, më së miri mbron interesat e konsumatorëve ekzistues dhe të ardhshëm, çka përfshin balancimin e përfitimeve të çdo veprimi që marrim kundër kostove që mund të lindin për shkak të këtyre vendimmarrjeve.

4 - Promovimi i zvogëlimi të barrierave rregullatore dhe shkurtimi i kohës së procedurave rregullatore.

Ka disa pengesa për konsumatorët që të bëjnë zgjedhje të mira në tregun aktual të energjisë, duke përfshirë mos njohjen e opsioneve në dispozicion të tyre dhe mungesën e informacionit të plotë e kompleks nga shoqëritë e licensuara që ushtrojnë aktivitetet. Kuptimi i këtyre pengesave, dhe sjellja e konsumatorëve dhe kompanive në përgjigje të tyre, merr një rëndësi të veçantë.

Kuadri rregullator duhet t'u mundësojë investitorëve dhe konsumatorëve që të maksimizojnë mundësitë. Në një treg me pakicë të përqendruar, duhet të menaxhojmë ato shërbime universale dhe detyrime të tjera sociale dhe mjedisore, me qëllim garantimin e një tregu konkurrues ku infrastruktura qendrore e teknologjisë dhe standardeve që mbështesin tregun me pakicë të shërbejë si një mekanizëm për rritjen e ndershme të konkurrencës midis furnizuesve për të mbajtur kosto të ulëta për furnizim.

ERE do të marrë përsipër një numër aktivitetesh me qëllim që të sigurohet që tregu të punojë në mënyrë efikase. Këto përfshijnë mbikëqyrjen e rregullave, monitorimin e aktivitetit të tregut dhe të mundësive të abuzimit në treg. Në veçanti, analiza do të përfshijë shqyrtimin nëse tregu i energjisë elektrike po punon për të siguruar transaksione efikase të tregtisë apo nëse është e nevojshme reforma e tregut për të lejuar mënyra më efektive për të tregtuar, duke lejuar përdorimin më efikas të energjisë dhe zvogëlimin e kostove.

PËRDITESIMI I KUADRIT RREGULLATOR

1 - Promovimi i rregullave në përputhje me zhvillimin e kuadrit ligjor të Komunitetit të Energjisë dhe në vlerësim të specifikave të sistemit energjitik në vendin tonë

Shqipëria ka nënshkruar Traktatin e Komunitetit të Energjisë, i cili mbulon një sërë fushash në lidhje me marrëdhëniet e Shqipërisë dhe BE – së, duke përfshirë energjinë. Ky traktat vendos disa shtylla në lidhje me sigurinë e furnizimit, efikasitetin e energjisë së rinovueshme dhe statistikën si dhe përafrimin me kuadrin rregullator të vendeve të rajonit me ato të BE – së.

Pikërisht në përputhje me angazhimet e vendit në kuadër të integritit evropian, ERE do të vazhdojë të punojë me qeverinë dhe aktorët e tregut të energjisë, në vend dhe në Evropë, për të siguruar që korniza rregullatore të jetë në përputhje me detyrimet që lindin nga ky angazhim. Një nga pjesët më të rëndësishme të legjislacionit të BE – së për tregjet e gazit evropian dhe të energjisë elektrike është paketa e tretë e përbërë nga tre rregullore dhe dy direktiva. Një nga synimet kryesore të paketës së tretë është liberalizimi i tregut të energjisë, caktimi i autoritetit kombëtar rregullator të energjisë (NRA) të pavarur, përgjegjës për rregullimin e tregut të energjisë në vend.

Një nga aspektet kryesore të paketës së tretë është që të sigurohet që operatorët e sistemit të transmetimit (OST) të jenë të ndara (ose të pavarura) nga interesat e prodhimit, dhe furnizimit dhe të jenë të certifikuar si të tilla.

ERE tashmë ka miratuar certifikimin e pajtueshmërisë së OST – së në përmbushje të kërkesave ligjore, proces i cili është në monitorim të vazhdueshëm nga ana e ERE – s.

Përveç kësaj, paketa legjislative inkurajon investime afatgjata duke kërkuar Entso-G dhe Entso-E përditësimin e planeve dhjetëvjeçarë të zhvillimit të rrjetit çdo dy vjet. Kjo politikë është reflektuar në rregullore e miratuar nga ERE për miratimin e planit të investimeve të OST sh.a. Fokus për punën tonë dhe një element kryesor i paketës së tretë, është kërkesa për të siguruar që konsumatorët të mbrohen. Paketa e tretë përcakton detyrimet për furnizuesit që kanë të bëjnë me çështje të tilla si: Faturat e konsumatorëve, Përmbajtja e kontratave të furnizimit, Kohën dhe kohëzgjatjen në të cilën të dhënat e furnizimit duhet të ruhen, kohën që duhet të marrë një konsumator për të ndryshuar furnizuesin, etj. Paketa e tretë krijoi një kuadër rregullator për të mbështetur një treg të vetëm evropian të energjisë duke zhvilluar kodet e rrjetit evropian. Kodet e rrjetit do të formojnë një grup të detyrueshëm ligjor të rregullave dhe detyrimeve të përbashkëta teknike dhe tregtare që rregullojnë qasjen dhe përdorimin e Rrjeteve Europiane të Energjisë. Kodet e rrjetit kanë qenë dhe do të zhvillohen në mekanizmat e alokimit të kapaciteteve, balancimin e energjisë, strukturat tarifore të transmetimit dhe ndërveprimin e palëve.

ERE ka punuar ngushtë me palët e interesit duke diskutuar opinione gjatë hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore që përbëjnë kuadrin rregullator të sektorit dhe që mbrojnë konsumatorët.

2 - Masat rregullatore

Masat që do të merren nga ERE do të jenë:

- Ndryshime të nevojshme në rregulloret dhe procedurat e liçensimit për njohjen reciproke të liçensave;
- Angazhimi me operatorët mbi administrimin e kodeve të rrjetit;
- Angazhimi me aktorët brenda vendit dhe organizmat evropiane apo dhe me homologë për plotësimin e kuadrit rregullator;
- Bashkëpunim ndërinstitucional dhe me institucionet evropiane të lidhura me mekanizma që promovojnë një treg eficient dhe të qëndrueshëm.

Ne do të punojmë që qasjet tona rregullatore të mbështesin një treg konkurrues me përfitime për konsumatorët dhe që nuk çënon interesat e ligjshme të tyre.

Po ashtu do merren masat e ligjshme dhe të rregullave në vend për të siguruar që ne kemi një regjim të fuqishëm rregullator që punon me fokus për konsumatorët dhe promovon hapjen e tregut.

Praktikat rregullatore do të vijojnë të kenë fokus bashkëpunimin me pjestarë të tjerë dhe të kenë një kuadër rregullator transparent dhe efektiv.

BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET E TJERA PËR ÇËSHTJE RREGULLATORE, PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

1- Shtirja e bashkëpunimit

Objektivat strategjikë të përshkruar më sipër kërkojnë bashkëpunim të ngushtë me organet e tjera. Duke pasur parasysh natyrën radikale të ndryshimeve në perspektivë dhe kërkesat e tyre për legjislacion të ri, është veçanërisht i rëndësishëm bashkëpunimi i ngushtë me institucionet e tjera. ERE e konsideron të rëndësishëm vijimin e bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse për energjinë përmes ekipeve të përbashkëta për një sërë objektivash, duke filluar nga reforma në tregun e shitjes me pakicë, te roli i funksionimit të sistemeve/operatorëve.

I një rëndësie të veçantë është dhe bashkëveprimi me institucione të tjera, të tillë si Autoriteti Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në kuadër të bashkëpunimit për çështjet që lidhen me Zbatimin e masave të plota organizative dhe teknike të sigurisë kibernetike në sistemet e komunikimit dhe të informacionit, Autoritetit të Konkurrencës apo dhe Avokatit të Popullit.

ERE do të vijojë të thellojë angazhimin me organizatat dhe institucionet evropiane, duke e konsideruar bashkëpunimin me organizatat të tilla, si një ekspertizë të mirë, për të ndihmuar në sigurimin e rezultateve pozitive për konsumatorët.

Është e qartë që politika që lidhet me sektorin e energjisë është në shumë mënyra ndër – sektoriale, me lidhje të qarta me fushat e politikave të përgjithëshme në vend, të tilla si, çështjet që lidhen me shërbimet publike, mbështetjen qeveritare për prodhuesit e burimeve të rinovueshme të energjisë, konsumatorët në nevojë apo planet e zhvillimit në vend në tërësi. Prandaj, ne do të vazhdojmë të angazhohim drejtpërdrejt burimet tona me institucionet politikëbërëse për të siguruar kuptimin e ndërsjellë të objektivave tona përkatëse brenda fushës së përgjegjësisë dhe kompetencës. Bashkëpunimi do të përfshijë edhe mbajtjen e takimeve vjetore të ERE me konsumatorë, organizata, investitorët për t'i dëgjuar pikëpamjet e tyre, por edhe për të promovuar kuadrin rregullator. Në punën tonë rregullatore, ne mbështetemi dhe jemi mirënjohës për bashkëpunime me organizmat e ndryshëm të përfaqesimit të konsumatorëve, por edhe të pjesëmarrësve të tjerë të tregut në mënyrë të veçantë në drejtim të proceseve konsultuese që ERE zhvillon me qëllim që aktet rregullatore të reflektojnë një ekuilibrim të interesave të konsumatorëve, investitorëve dhe shtetit. Do të merren masa për përmbushjen në vijim të detyrimit për të qenë transparentë, për të arsyetuar vendimarrjet, dhe për të sinjalizuar synimet tona paraprakisht. Eksperienca në shërbimet e furnizimit në këndveshtrimin e konsumatorëve por edhe të ofruesve të shërbimit konsiderohet një aset me mjaft rëndësi, që reflekton një shmangie të barrierave apo krijim të lehtësirave në treg.

ERE do të vijojë ti japë rëndësi krijimit dhe ruajtjes së lidhjeve të ngushta me konsumatorët e energjisë të të gjitha llojeve: familjet, bizneset, dhe përdoruesit e mëdhenj.

2- Plani i Veprimit

Periudha e adresuar në këtë strategji është afatshkurtër, por ajo gjithsesi kërkon kryerjen e ndryshimeve të rëndësishme jo vetëm në atë që bëjmë, por edhe në mënyrën se si e bëjmë atë.

Fillimi i kësaj periudhe do të shohë gjithashtu implementimin e strukturës së re organizative të rregullatorit për të zbatuar masat e përshkruara më sipër. Sidoqoftë, ato imponojnë sfida të reja, të cilat mund të përmbushen vetëm nga një ndryshim i madh në mënyrën se si të gjithë punojmë: shkathësi dhe shpejtësi më e madhe, më shumë punë midis grupeve të punës për ta bërë ERE një autoritet më efektiv, më të aftë për të bërë një ndryshim pozitiv për konsumatorët dhe mbi të gjitha që ecën e përshtatet me hapat e shpejtë të zhvillimit teknologjik e ekonomik të sektorit energjistik. Vetë Bordi është i vendosur të ndryshojë natyrën e kontributit të tij, aty ku është e mundur drejt një fokusi më selektiv dhe strategjik mbi ndikimin e përgjithshëm të ERE në ofrimin e shërbimeve që rezultojnë në benefite për klientët fundorë të energjisë, qofshin ekzistues apo dhe të ardhshëm. Synimi ynë është të botojmë udhëzime më të hollësishme se si kjo strategji dhe përparësitë tona për këtë periudhë do të drejtojnë punën e ERE dhe planin tonë të punës.

Gjatë periudhës së implementimit të kësaj strategjie, ERE do të përgatise udhëzime të tilla në drejtim të analizës së impaktit të kuadrit rregullator. Bordi do të rishikojë rregullisht progresin që ERE po bën në shpërndarjen e përparësive dhe në ndryshimin e mënyrës së punës.

Përmes raportit tonë vjetor të ndikimit të konsumatorit, ne do të matim dhe publikojmë rregullisht progresin tonë në mbrojtjen e konsumatorëve dhe shpërndarjen e përparësive të përcaktuara në këtë dokument.

PËRFUNDIME

ERE do të kryejë analiza/studime të aspekteve të rëndësishme të kuadrit rregullator që kanë të bëjnë me çështjen e shërbimeve të rregulluara.

ERE do të shqyrtojë se si kuadri rregullator duhet të evoluojë në mënyrë dinamike për të mbajtur ritmin me ndryshimet e nxitura nga Covid-19 dhe të gjitha ndryshimet e tjera që ndikojnë në sistemin e energjisë.

ERE do të monitorojë zhvillimet në CyberSecurity gjithashtu.

ERE do të mbajë në fokus të punës dhe vëmendjes Konsumatorët dhe tregjet me pakicë.

Një pjesë e madhe e programit tonë të punës 2021 – 2023 është i dedikuar për mbrojtjen dhe fuqizimin e konsumatorit, dhe për tregjet e pakicës dhe nxitjen e konkurrencës së tregut të pakicës.

ERE do të promovojë, dhe bëjë përpjekjet më të mira për të përfshirë palët e interesit në vendimmarrje, për të përçarur besimin tonë në vlera të tilla si integriteti, thjeshtësia, gjithëpërfshirja, dhe mbi të gjitha Besimi dhe Respekti i ndërsjellë.

Këto vlera përbëjnë Kulturën tonë të punës, një kulturë ku të gjithë kanë përgjegjësi për të vepruar për interesin afatgjatë të shoqërisë.

1. SEKTORI I ENERGJISË ELEKTRIKE

1.1 STRUKTURA E SISTEMIT ELEKTROENERGJETIK

Sistemi elektroenergjetik në Republikën e Shqipërisë përbëhet nga: prodhimi, transmetimi dhe shpërndarja e Energjisë Elektrike me qëllim furnizimin e klientëve të energjisë elektrike. Secili nga këto aktivitete ushtrohet nga subjekte të licencuara në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar. Prodhimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëritë publike KESH sh.a. dhe HEC Lanabregas sh.a. me 100% të aksioneve shtetërore, si dhe nga subjektet private dhe me koncesion të licencuara në këte aktivitet. Transmetimi i energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a, e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore, e licencuar për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Shpërndarja e energjisë elektrike realizohet nga shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a, e cila është një shoqëri me 100% të aksioneve shtetërore, e licencuar për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Më poshtë paraqitet Skema e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar si dhe Skema e Fluksit të Energjisë Elektrike dhe Tregtare.

Evidentojmë se si pasojë e pandemisë globale COVID-19, përgjatë vitit 2020 është vështirësuar procesi i verifikimit dhe monitorimeve në terren i të dhënave të përdorura në hartimin e këtij raporti, këto të dhëna janë siguruar nga raportimet periodike të pjesëmarrësve të tregut të energjisë dhe të të licencuarve në sektorin e energjisë, por verifikimi dhe monitorimi i tyre mbetet në fokusin e ERE-s përgjatë vitit 2021, në përputhje me udhëzimet përkatëse.

SKEMA E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK




Figura 1 Skema e Sistemit Elektroenergjetik (Burimi: ERE)




Figura 2 Skema e Fluksit të Energjisë dhe Tregtar (Burimi: ERE)

1.2 PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Prodhimi i Energjisë Elektrike në vendin tonë realizohet nga subjektet e licensuara në ERE për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike si dhe veteprodhues, bazuar në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndyshuar.

Aktualisht prodhimi i energjisë elektrike përbëhet nga dy komponent kryesor. Prodhimi që realizohet nga Shoqëria publike KESH sh.a. dhe prodhimi që realizohet nga subjektet e tjera që zhvillojnë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

KESH sh.a, është shoqëria më e madhe prodhuese e energjisë elektrike në Shqipëri, me kapital tërësisht shtetëror. KESH sh.a. është e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për furnizimin me Energji Elektrike të Furnizuesit Universal sh.a. dhe mbulimin e humbjeve të Energjisë Elektrike në rrjetin e Shpërndarjes, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 244 datë 30.03.2016, e ndryshuar.

Shoqëritë e tjera prodhuese të energjisë elektrike janë subjekte private, të tilla si: prodhuesit me përparësi dhe ato të pavarur të energjisë elektrike, si dhe HEC Lanabregas dhe veteprodhuesit. Këto subjekte të licensuara në vite nga ERE shfrytëzojnë centralet ekzistuese apo të reja, kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të koncesionit apo kontratave për shfrytëzimin dhe administrimin e impianteve prodhuese të Energjisë Elektrike. Këto kontrata janë të nënshkruara me Qeverinë Shqiptare si dhe Autoritete të tjera përgjegjëse të përcaktuara me ligj, po ashtu dhe disa prej centraleve prodhuese që operohen në kuadër të marrëveshjeve të privatizimit. Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në vendin tonë deri në 31 Dhjetor 2020 është **2,506 MW**. Ky kapacitet ka pasur një nivel rritje në vitin 2020 prej 231 MW, krahasuar me vitin 2019.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i kompanisë publike KESH sh.a. është 1448 MW dhe përbën rreth 58 % të fuqisë totale të instaluar në vendin tonë.

Kapaciteti total i instaluar i prodhuesve të tjerë të energjisë elektrike është 1 058 MW dhe përbën rreth 42 % të fuqisë totale të instaluar në vendin tonë.

1.2.1 Prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2020

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike i realizuar për vitin 2020 është **5,313,033 MWh**.

3,090,199 MWh u prodhuan nga centralet në zotërim të kompanisë publike KESH sh.a.

2,222,834 MWh u prodhuan nga centralet e tjera.

Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a. zë 58 % të gjithë prodhimit të energjisë elektrike në vendin tonë dhe prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit e tjerë zë rreth 42 %.

Centralet e prodhimit të energjisë elektrike janë të lidhura si në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike ashtu dhe në rrjetin e shpërndarjes. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2020 është rreth 2,190 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 4,712,074 MWh. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes përgjatë vitit 2020 është rreth 306 MW dhe prodhimi neto i tyre ka rezultuar të jetë 600,958 MWh.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT 2020		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2020 (MWh)
P.Pub	Prodhues Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)	Lidhur në OST	1	4	1,448	3,090,199
P.Pav	Prodhues të Pavarur (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OST	3	8	436	855,441
PPE	Prodhues me Përparsi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	29	44	306	766,434
	Prodhues me Përparsi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	115	153	285	568,693
	Prodhues me Përparsi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	11	11	21	32,265
			159	220	2,496	5,313,032

Figura 3 Të dhëna mbi prodhuesit për vitin 2020.

Në figurën më poshtë paraqitet prodhimi neto vendas për Vitin 2020, duke evidentuar kontributin në prodhimin e energjise elektrike të KESH sh.a., si prodhuesi i vetëm publik si dhe kontributet e prodhuesve të tjerë Privat/me Koncesion. Prodhimi i realizuar nga kompania publike KESH sh.a., vazhdon të ketë peshën kryesore në prodhimin vendas dhe për Vitin 2020.

PRODHIMI NETO VENDAS 2020 (MWh)	2020
HEC-et / PPE (Private/Konc.) ne rrjetin e OSSH sha	540,050
HEC-et / PPE (Private/Konc.) ne rrjetin e OST sha	579,212
HEC-et e pavarur IPP ne rrjetin e OST sha	855,441
HEC Lanabregas	28,643
HEC Ashta	187,223
Centralet Fotovoltaike	32,265
Prodhimi nga HEC-et e KESH sha	3,090,199
TOTAL VENDAS 2020	5,313,032

Burimi OST sha; KESH sha; FTL sha




Figura 4 Prodhimi neto vendas për vitin 2020.




Figura 5 Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2020 (MWh)

Figurat më poshtë paraqesin krahasimin e prodhimit mujor neto përgjatë vitit 2020 me mesataren e prodhimit të periudhës 2009 – 2020.




Figura 6 Prodhim i prodhimit vendas për vitin 2020 krahasuar me mesataren e periudhës 2009-2020




Figura 7 Prodhimi neto vendas historik për periudhën 2009-2020 në raport me mesataren e prodhimit për këtë periudhë

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, rezulton se viti 2020 me sasinë e prodhuar prej 5,313 GWh, vazhdon të jetë nën mesataren e prodhimit të energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2020. Mesatarja e prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2020 është 5,882 GWh. Prodhimi i realizuar për Vitin 2020 rezulton rreth 9.7 % më i ulët se mesatarja e prodhimit për periudhën 2009 – 2020.

Prodhimi maksimal mujor i energjisë elektrike për Vitin 2020, është shënuar në muajin Tetor me sasinë **551,275 MWh**. Ky prodhim është realizuar nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a. në masën deri **61 %**, ndërkohë që prodhimi minimal mujor i energjisë elektrike gjatë Vitit 2020 rezulton në muajin Shtator në sasinë **334,730 MWh**.

Në grafik vihet re se Viti 2020 konsiderohet si një vit jo i mirë hidrologjik, kjo për faktin se pavarësisht rritjes së kapaciteteve prodhuese përgjatë Vitit 2020, prodhimi i energjisë elektrike për këtë vit ka rezultuar në sasinë **5,313 GWh**, pra 569 GWh më pak se prodhimi mesatar i energjisë elektrike në periudhën 2009 – 2020. Duke marrë në konsideratë faktin se vendi ynë e bazon prodhimin e energjisë elektrike kryesisht në burimet hidrike, në vitet jo të mira hidrologjike ku futet edhe Viti 2020, prodhimi i energjisë elektrike është më i ulët se mesatarja shumë vjeçare në periudhën 2009 – 2020.

1.2.2 Të dhënat teknike kryesore dhe prodhimi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese publike për vitin 2020.

Prodhimi publik i energjisë elektrike kryhet nga shoqëria aksionere KESH sh.a. me 100% të aksioneve shtetërore. Shoqëria KESH sh.a ka në zotërim tre hidrocentralet e kaskadës së Lumit Drin si dhe termocentralin e Vlorës. Përbërja e grupit të centraleve të zotëruara nga KESH sh.a dhe fuqia e instaluar e secilit prej tyre, të cilët realizojnë prodhimin publik është paraqitur në tabelë.

Karakteristikat e Centralit	Centralet Prodhuese Publike			
	HEC Fierzë	HEC Koman	HEC V.Dejës	TEC Vlorë
Nr. Agregateve.	4	4	5	2
Fuqia e Agregateve. MW	125	150	50	70 + 28
Fuqia Instaluar e centralit MW	500	600	250	98
Fuqia Totale MW	1,448			

Figura 8 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.)

Fuqia e përgjithshme e instaluar në zotërim nga KESH sh.a., arrin në 1,448 MW, nga të cilat fuqia e instaluar e HEC-ve në kaskadën e lumit Drin është 1,350 MW dhe e TEC Vlorë 98 MW.

Prodhimi neto nga centralet prodhuese të KESH sh.a për Vitin 2020 rezulton të jetë 3,090,199 MWh, e cila përbën 58 % të prodhimit neto total vendas përgjatë këtij viti. Ky prodhim është realizuar në masën 1 417 GWh nga HEC Koman, 978 GWh nga HEC Fierza dhe 702 GWh nga HEC Vau i Dejës.




Figura 9 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: OST sh.a.).

Prodhimi maksimal i enegjisë elektrike i realizuar nga KESH sh.a. për periudhën 2009 – 2020 është arritur në vitin 2010 në sasinë 7 014 GWh. Prodhimi i energjisë elektrike i vitit 2010 është rreth 2.2 herë më i lartë se prodhimi i energjisë elektrike i arritur në vitin 2020 i cili rezulton në sasinë 3,097 GWh. Ky tregues, paraqet në mënyrë të qartë shkallën e lartë të riskut hidrologjik në stabilitetin e prodhimit të Energjisë Elektrike në vendin tonë, i cili e bazon prodhimin e energjisë elektrike kryesisht në burime hidrike.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të detajuar prodhimi mujor i energjisë elektrike nga hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin në administrim të KESH sh.a.




Figura 10 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2020 (Burimi: KESH sh.a., OST sh.a.).

Prodhimi maksimal i KESH sh.a. është regjistruar në muajin Tetor në sasinë 551 275 MWh dhe minimal në muajin Shtator në sasinë 334,730 MWh.

Sipas raportimeve të KESH sh.a., shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike ka qenë në kushte optimale. Koeficientët e ngarkimit të agregatëve, të paraqitur në tabelën e mëposhtme për vitin 2020 në përqindje, janë më të lartë për të tre HEC-et në kaskadën e lumit Drin krahasuar me mesataren shumëvjeçare për secilin HEC.

Ngarkesa e Agregateve 2020	HEC Fierze	HEC Koman	HEC V.Dejes
Ngarkesa mesatare e agregateve (%)	91%	78%	86.2%
Mestarja Shumevjeçare (%)	85%	78%	84%

Figura më poshtë tregon shkarkimet nga hidrocentralet gjatë vitit 2020.

DERDHJET E UJIT NGA H/C-ET E KASKADES SE DRINIT GJATE VITIT 2020 (million m3)													
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	2020
Fierzë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Koman	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	64	64
Vau Dejës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	150	150

Figura 11 Shkarkimet e ujit pa prodhim energjie nga HEC-et e KESH sh.a gjatë vitit 2020.

Shkarkimet e ujit pa prodhim energjie nga HEC-et e kaskadës së lumit Drin rezultojnë në vlera minimale dhe kanë ndodhur vetëm gjatë fundit të muajit dhjetorë 2020. Kjo pe

riudhë ka qenë e karakterizuar nga prurjet e mëdha të ujit në basenin e HEC Koman (basën me kapacitet rezervues të vogël) dhe në zbatim të Rregullores së Shkarkimit të Plotave, në kushtet e

ngarkimit maksimal të njësive prodhuese në HEC Koman, është realizuar shkarkimi i ujit pa prodhim energjie.

Në figurën 12, janë paraqitur në mënyrë grafike shkarkimet e ujit nga HEC-et e KESH sh.a në Kaskadën e lumit Drin, për secilin vit në periudhën 2002 - 2020.




Figura 12 Shkarkimet e Ujit nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (2002-2020) (Burimi: KESH sh.a).

Më poshtë paraqitet niveli në metra i Liqenit të Fierzës për vitin 2020 në fund të çdo muaji.




Figura 13 Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2020 (m).

Baseni i HEC-it të Fierzës funksionon si rregullator vjetor i rezervës hidrike të lumit Drin, e cila ndikon drejtpërdrejtë në shfrytëzimin e gjithë kaskadës mbi lumin Drin.

Të dhënat historike mbi nivelin e liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2020 paraqiten më poshtë duke evidentuar kuotat minimale dhe kuotat maksimale.

	NIVELI I FIERZES 1991-2020											
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1991	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1992	278.0	274.1	268.0	278.8	281.0	279.6	275.2	268.7	263.9	271.4	281.9	280.6
1993	275.2	265.3	264.7	278.5	280.5	277.3	271.0	261.1	253.6	249.9	255.6	270.2
1994	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1995	253.8	260.3	262.5	275.3	289.0	288.7	284.5	282.2	288.2	283.8	279.9	287.5
1996	287.1	288.7	286.5	294.7	295.8	293.1	287.6	282.2	285.1	284.3	289.2	291.3
1997	289.4	284.5	281.7	285.2	294.1	292.0	287.0	280.0	272.9	272.4	270.8	277.2
1998	273.7	270.0	265.2	278.9	288.1	287.4	281.8	277.6	276.0	277.1	279.0	277.1
1999	272.7	275.6	281.5	290.5	295.9	293.3	288.3	279.5	271.0	257.6	263.6	276.9
2000	276.4	276.7	276.8	286.9	286.6	280.1	273.5	267.5	261.6	248.4	249.3	252.1
2001	253.6	258.2	275.1	282.9	287.6	283.8	273.7	271.1	269.2	263.6	263.2	252.1
2002	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	267.8	274.3	281.1	285.3	284.0
2003	291.1	289.5	286.3	287.0	292.3	290.3	285.9	280.8	276.0	282.6	285.6	283.3
2004	284.7	290.8	293.4	296.0	296.2	296.2	293.1	286.3	281.1	280.0	286.1	288.0
2005	281.2	281.5	293.3	296.1	295.6	294.1	286.7	277.2	266.5	256.9	253.6	279.0
2006	283.5	288.6	294.4	295.9	296.5	295.9	293.8	290.2	285.3	278.7	266.2	256.2
2007	256.1	263.7	272.0	276.8	276.8	274.8	268.5	263.6	261.8	261.1	275.8	282.1
2008	285.1	289.7	290.9	295.5	295.3	295.7	294.3	288.6	283.9	280.9	285.2	286.5
2009	283.6	281.8	283.4	292.5	293.7	292.4	288.0	281.2	276.2	271.6	266.3	280.1
2010	290.1	289.2	293.9	296.0	296.3	294.4	291.8	288.6	284.9	285.2	284.3	287.5
2011	281.6	274.4	275.0	276.6	281.0	286.1	284.7	279.0	273.9	268.2	261.6	264.5
2012	265.8	267.7	262.0	280.2	293.4	294.4	288.4	280.4	261.4	261.6	269.0	276.6
2013	278.3	281.5	294.8	296.9	296.9	294.2	289.7	283.6	280.8	281.4	282.5	276.1
2014	275.1	277.5	274.6	285.3	292.9	294.9	291.7	286.8	285.5	285.0	284.8	286.3
2015	288.7	289.4	292.2	296.3	296.1	293.3	287.5	280.1	272.1	275.4	278.9	275.9
2016	289.9	292.4	291.8	296.5	296.2	295.6	290.5	285.4	283.3	288.4	288.9	281.6
2017	271.5	277.7	280.9	278.7	281.6	272.4	270.2	268.0	271.0	264.6	269.6	289.9
2018	289.7	292.0	295.0	296.5	296.4	296.0	294.0	287.5	277.9	270.2	266.5	267.3
2019	267.3	268.2	272.7	279.9	289.9	292.7	287.6	278.5	274.2	268.6	273.2	275.6
2020	271.62	271.98	283.50	288.55	293.6	291.7	284.6	276.5	273.5	274.1	268.7	272.7

Figura 14 Niveli i Liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2020.

Më poshtë paraqitet grafikisht niveli i ujit në metra në rezervuarin e Fierzës për çdo muaj të vitit 2020, krahasuar me nivelet mesatare historike mujore për periudhën 1991– 2020.




Figura 15 Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2020.

Siç shihet, deri në muajin Shkurt 2020, niveli i ujit në liqenin e Fierzës ka qenë më i ulët krahasuar me nivelin mesatar historik. Në vijim niveli i ujit në liqenin e Fierzës për një periudhë 5 mujore Mars – Korrik ka qenë pak më i lartë se mesatarja shumëvjeçare duke arritur në muajin Korrik gati sa niveli mesatar dhe më pas deri në muajin Dhjetor ky nivel ka qenë nën mesataren shumëvjeçare.

Në Figurën në vijim paraqiten prurjet mesatare për vitin 2020 në Liqenin e Fierzës krahasuar me prurjet mesatare historike për çdo muaj.




Figura 16 Prurjet mesatare mujore (m3/sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2020 krahasuar me mesataren historike.

Gjatë vitit 2020 prurjet mesatare të ujit janë përgjithësisht nën mesataren historike (ku më të lartat rezultojnë në muajin Tetor me rreth 23 m³/sek më të larta se mesatarja historike).

Në grafikun e figurës që vijon është paraqitur shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike në Kaskadën e lumit Drinit gjatë vitit 2020.




Figura 17 Rezerva Energjetike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2020 (Burimi: KESH sha).

Rezerva hidroenergjetike e kaskadës së lumit Drin administrohet nga KESH sh.a. bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Optimizim i portofolit të KESH sh.a., dhe të sektorit në përgjithësi.
- Operim në nivele optimale të HEC-it dhe shfrytëzimit sa më të mirë të baseneve.
- Operim sipas përcaktimeve të rregullores së sigurisë së digave.
- Të gjenerojë në mënyrë të qëndrueshme e me cilësi, duke garantuar furnizim me energji elektrike të sigurt dhe me kosto sa më të ulët të konsumatorëve fundorë.

- Të ofrojë në kohën dhe masën e duhur shërbimet ndihmëse, për të garantuar operim të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit elektroenergjitik.

1.2.3 Realizimi i Treguesve të Prodhimit dhe Menaxhimi i Rezervës Hidrike.

Sipas raportimeve të shoqërisë KESH sh.a , viti 2020 rezultuan jo i favorshëm nga pikëpamja hidrike, kjo si pasojë e thatësisë së trashëguar që nga viti 2019, e cila pati ndikim të ndjeshëm tek prurjet dhe niveli i liqenit të HEC Fierzë, e për rrjedhojë edhe në rezervën energjetike që KESH sh.a. menaxhon në funksion të plotësisë të detyrimeve publike dhe veprimtarisë tregtare të shoqërisë KESH sha.

Në ngjashmëri me 6 mujorin e parë të vitit 2019 dhe për këtë periudhë për vitin 2020, prurjet mesatare rezultuan me 154.2 m³/sek ose pothuajse 36% më të ulta se mesatarja shumëvjeçare (për të njëjtën periudhë prej 240.4 m³/sek). Niveli mesatar i prurjeve prej rreth 155 m³/sek është pothuajse në të njëjtën vlerë me situatën analoge të 6-mujorit I (të parë) 2019, duke përsëritur pothuaj të njëjtin skenar situatë hidro-meteorologjik si të 2019. Një përmirësim u evidentua me reshjet lokale gjatë muajit Mars, që rezultoi me një rritje të prurjeve në Fierzë në 253 m³/sek

Në muajin Janar ishte 271.6 m, thënë ndryshe rreth 5 m më i ulët se referenca shumëvjeçare 1993-2019, kjo si pasojë e situatës jo të favorshme hidrologjike të trashëguar edhe nga viti 2019. Në fund të muajit Qershor 2020 niveli i Fierzë rezultuan 291.66 m ose +2.55 m më i lartë se niveli referues shumëvjeçar 1993-2019, prej 289.11 m. Në muajin Qershor 2020, KESH rriti prodhimin nga HEC-et e kaskadës dhe gjeneroi për nevojat e klientëve fundorë 286 GWh. Në Korrik, Gusht dhe Shtator rezultuan me prurje më të ulta, në krahasim të muajve të tjerë në vite dhe me mestaren shumëvjeçare.

Prodhimi bruto i energjisë elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit në 6-mujorin e parë ishte 1,327 GWh ose 44 % më pak se prodhimi mesatar shumëvjeçar për të njëjtën periudhë të vitit. Gjatë muajit Tetor kishte një rritje të ndjeshme të prurjeve me 22 % në krahasim me mesatren shumëvjeçare, e cila u reflektua dhe me prodhimin me rreth 343 GWh. Ndërkohë edhe në muajt Nëntor dhe Dhjetor situata hidrike vijoi me prurjet respektivisht 70% dhe 50% më pak se mestarja e prurjeve shumëvjeçare e cila u reflektua me prodhim respektivisht 239 GWh dhe 227 GWh.

Sipas informacioneve të KESH sh.a, më poshtë paraqiten zhvillimet në menaxhimin e situatave të krijuara gjatë vitit 2020.

KONSUMI SPECIFIK I UJIT NE (m ³ /kWh) NGA HEC-et E KESH sh.a GJATE VITIT 2020 (krahasuar me mestaren shumevjeçare)													
HEC		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qeshor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Fierze	(2020 (m ³ /kWh)	4.17	4.26	3.94	3.76	3.45	3.53	3.67	3.93	4.19	4.07	4.22	4.39
	Mesatare(2006-2020)	4.00	3.98	3.87	3.72	3.57	3.57	3.68	3.88	4.04	4.16	4.15	4.03
Koman	(2020 (m ³ /kWh)	4.14	4.16	4.16	4.11	4.21	4.14	4.14	4.10	4.15	4.22	4.18	4.19
	Mesatare(2006-2020)	4.21	4.21	4.21	4.18	4.18	4.17	4.15	4.16	4.16	4.17	4.19	4.21
V.Dejes	(2020 (m ³ /kWh)	8.53	8.53	8.56	8.52	8.47	8.54	8.53	8.51	8.55	8.53	8.62	8.66
	Mesatare(2006-2020)	8.50	8.50	8.48	8.43	8.41	8.45	8.46	8.46	8.47	8.47	8.49	8.51

Figura 18 Konsumi specifik i Ujit në HEC-et e KESH sh.a..

TE DHENAT PER SHFRYTEZIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PER VITIN 2020					
HEC	Prodhimi	Fuqia mes.lejuar per Agregat (MW)	Koef.mes.ngark .Agregatit (%)	Total ore pune	Koef.mes.shfrytz. Agregatit (%)
Fierze	984,010	104.8	91%	10183	29%
Koman	1,429,244	150.0	78%	12243	35%
Vau Dejes	707,982	46.60	86.2%	17668	40%

Figura 19 Shfrytëzimi i Kapacitetit gjenerues të Centraleve.

Të dhënat e mësipërme tregojnë se koeficientët e shfrytëzimit për vitin 2020 kanë qënë mbi mesataren shumëvjeçare për të tre HEC-et e kaskadës së lumit Drin.

1.2.4 Gjëndja e TEC-it Vlorë.

Shoqëria KESH sh.a. është aksionere e vetme e shoqërisë Termocentrali Vlorë sh.a. (TEC Vlora sh.a.), shoqëri kjo e cila ka në administrim asetin gjenerues TEC Vlora.

Përgjatë vitit 2020, shoqëria TEC Vlora sh.a., ka ushtruar veprimtarinë e saj në lidhje me konservimin e asetit gjenerues i cili nuk është në gjendje pune për shkak të defektit të shfaqur në sistemin e ftohjes që nga viti 2012.

Ndërkohë, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, më datë 28.12.2019, u bë shpallje publike për oferta për konçesionin me objekt “Për rehabilitimin dhe vënien në punë të Termocentralit të Vlorës si dhe të ndërtimit të tubacionit Fier-Vlorë të furnizimit me gaz të TEC-it, të formës R.O.O.T.”.

Proçedura kishte si autoritet kontraktor Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila organizoi edhe garën për kalimin në konçesion të këtij aseti gjenerues, e cila sikurse edhe publikuar është anuluar si procedurë.

Meqë TEC Vlora sh.a. ndodhet në kushte konservimi, konsumi vetjak i TEC Vlorës garantohej nëpërmjet linjës së furnizimit 220 kV, N/Stacioni Babicë dhe mbulohet nga KESH sh.a.,

1.2.5 Prodhi i energjisë elektrike nga centralet prodhuese private të pavarura dhe ato me përparësi

Prodhi i energjisë elektrike i realizuar nga centralet prodhuese private për vitin 2020 është 2,979,252 MWh ose rreth 42 % e prodhimit total vendas.

Për vitin 2020, numri i centraleve prodhuese private të cilat kanë prodhuar energji elektrike është 216, ku 8 prej tyre janë prodhues të pavarur të cilët zotërohen nga 3 subjekte të licensuara, kurse pjesa tjetër prej 208 centrale janë prodhues me përparësi të energjisë elektrike të cilët zotërohen nga 155 subjekte në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike. Në total, kapaciteti i instaluar i centraleve prodhuese private është 1,058 MW, ku kapaciteti i instaluar i centraleve të prodhuesve të pavarur është 436 MW, kurse 622 MW i përket centraleve të prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.

Të dhënat mbi grupimet e prodhuesve, janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur më poshtë.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT 2020		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2020 (MWh)
P.Pub	Prodhues Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)	Lidhur në OST	1	4	1,448	3,090,199
P.Pav	Prodhues të Pavarur (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OST	3	8	436	855,441
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	29	44	306	766,434
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	115	153	285	568,693
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	11	11	21	32,265
			159	220	2,496	5,313,032

TË DHËNA MBI PRODHUESIT E PAVARUR DHE ATO ME PËRPARËSI 2020		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2020 (MWh)
P.Pav	Prodhues të Pavarur (Prodhues në treg të Hapur)	Lidhur në OST	3	8	436	855,441
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	29	44	306	766,434
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	115	153	285	568,825
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	11	11	21	32,265
			158	216	1,048	2,222,965

Figura 20 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi dhe ato të pavarur për vitin 2020.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT E PAVARUR 2020					
	HECET	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	Prodh.2020
P.Pav	HEC "Ulez"	25.200	"Kurum International" sh.a.	110 kV	303,063
P.Pav	HEC "Shkopet"	24.000		110 kV	
P.Pav	HEC "Bistrica 1"	22.500		110 kV	
P.Pav	HEC "Bistrica 2"	5.000	"Ayen As Energji" sha	110 kV	78,962
P.Pav	HEC "Peshqesh"	27.940		220 kV	
P.Pav	HEC "Fangu"	74.600	"Devoll Hydropower" sha	220 kV	177,918
P.Pav	HEC "Banje"	73.000		110 kV	135,775
P.Pav	Hec "Moglice"	184.000		111 kV	159,722
		436.240			855,441

Figura 21 Të dhëna mbi prodhuesit e pavarur për vitin 2020.

TË DHËNA MBI PRODHUESIT ME PËRPARËSI 2020		Rrjeti	Numri Subjekteve	Numri Impianteve	Kapaciteti instaluar (MW)	Prodhimi 2020 (MWh)
PPE	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)+Ashta	Lidhur në OST	29	44	306	766,434
	Prodhues me Përparësi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)	Lidhur në OSSH	115	153	285	568,825
	Prodhues me Përparësi Fotovoltaikë(Përfitojnë nga Skemat Mbësht)	Lidhur në OSSH	11	11	21	32,265
			155	208	612	1,367,524

Figura 22 Të dhëna mbi prodhuesit me përparësi për vitin 2020.

PRODHIMI GJATE VITIT 2020 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)					
	CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	Progr.2020
PPE	UKKO (pa sistemuame sistem)	1	"UKKO" sha (Ujsjell.Kanal.Korce)		
PPE	Seman – 2	2	"SEMAN2SUN" sh.p.k	35 kV	4,119
PPE	Topojë	2	"SONNE" sh.p.k	35 kV	4,095
PPE	Topojë 2	2	"AED SOLAR" sh.p.k	35 kV	4,088
PPE	Topojë (Sheq Marinas)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,100
PPE	Topojë (Sheq Marinas) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,124
PPE	Seman Isolar	2	"SEMANISOLAR" sh.p.k	35 kV	4,079
PPE	ES 2019 sh.p.k	2	ES 2019 sh.p.k	36 kV	244
PPE	SMART WATT sh.p.k	2	SMART WATT sh.p.k	37 kV	243
PPE	Tren Bilisht	2	"RTS" sh.p.k	35 kV	3,228
PPE	Plug, Lushnje	2	"AEE" sh.p.k	10 kv	3,946
TOTAL MUJOR					32,265

Figura 23 Impiantet fotovoltaikë viti 2020.

1.2.6 Prodhimi nga centralet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2020

Prodhimi vjetor neto i energjisë elektrike nga impiantet të cilat kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2020 paraqitet në Figurën në vijim. Siç shihet përgjatë vitit 2020 kanë hyrë në prodhim gjithsej 20 impiante me një fuqi të instaluar prej 227.8 MW, të cilët kanë prodhuar gjatë vitit 2020 sasinë prej 182,816 MWh. Prodhimi i energjisë elektrike i realizuar nga impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2020 zë rreth 3.44 % të prodhimit total vendas të energjisë elektrike për këtë vit.

PRODHUES QË KANË HYRË NË PRODHIM GJATË VITIT 2020 (MWh)																		
Hec-e të Lidhur në rrjetin e Transmetimit																		
	Impianti	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	PRODH.2020	
P.Pav	Hec "Moglice"	184		111 kV	-	-	295	15,367	22,287	14,766	10,913	14,379	35,245	21,654	6,719	18,097	159,722	
PPE	HEC Egnatia	5	REMI shpk	110 kV	70	731	1,706	1,242	1,241	472	309	202	119	429	369	329	7,218	
PPE	HEC Seka & Zais	15	Seka Hydropower shpk	110 kV	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	30	30	
		204															166,970	
Hec-e të Lidhur në rrjetin e Shpërndarjes																		
	Impianti	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	PRODH.2020	
PPE	HEC OSOJE	1.9	OSOJA HPP shpk		35	126	762	1,426	1,421	545	326	307	327	69	182	203	545	6,239
PPE	Hec Voskopoje	1.9	FAVINA 1 shpk		35	-	312	1,078	730	329	191	230	98	62	134	93	398	3,656
PPE	Hec Nderfushas	1.34	SGD Energji shpk		35	-	68	346	201	93	27	3	-	98	25	228	1,090	
PPE	Hec Rreshen	0.38	Nikolli Energy shpk		10	112	45	69	48	39	19	13	-	54	76	54	91	619
PPE	Hec Gurra	0.5	Uleza Nderim shpk		6	-	-	-	-	-	162	68	53	37	77	85	85	567
PPE	Hec Vile	1.994	Hydro Power Panariti shpk		35	-	-	-	-	59	106	57	48	33	97	45	280	724
PPE	Hec Dukona	0.800	Dukona shpk		20	-	-	-	17	7	4	1	-	10	4	26	68	
PPE	Hec Prevalli	1.750	Gega-Gshpk		35	-	-	-	-	-	-	2	16	385	123	476	1,003	
PPE	HEC Camerice	0.800	Rei Energy shpk		35	-	-	-	-	-	-	-	-	43	14	329	385	
PPE	Hec Storr	2.000	Era Hydro shpk		35	-	-	-	-	-	-	-	-	350	116	263	729	
PPE	Hec Mivas	1.940	Elva 2001 shpk		35	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	97	98	
PPE	Hec Spathare	1.038	Lucente concensionare shpk		10	-	-	-	-	-	-	-	-	0	11	25	36	
PPE	Hec Miraka	0.600	Kuarci Blace shpk		10	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	17	17	
PPE	Hec Shegjin	2.000	Irraba Energji shpk		10	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	101	101	
PPE	Hec Dobrunje	0.840	W.T.S. Energji shpk		10	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	27	27	
		19.8															15,359	
Fotovoltaike të Lidhur në rrjetin e Shpërndarjes																		
	Impianti	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR	PRODH.2020	
PPE	ES 2019 sh.p.k	2	ES 2019 sh.p.k	36 kV	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	78	165	244	
PPE	SMART WATT sh.p.k	2	SMART WATT sh.p.k	37 kV	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	78	165	243	
		4															487	

Figura 24 Prodhimi nga Impiantet që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2020.

1.2.7 Prodhimi i energjisë elektrike sipas rrjetit ku janë lidhur centralet prodhuese

Fuqia e instaluar e centraleve të lidhur në sistemin e transmetimit për vitin 2020 është 2,200 MW. Prodhimi total i energjisë elektrike nga këto centrale është 4,712,074 MWh. Prodhimi i detajuar për secilin nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2020 paraqitet në tabelën në vijim:

PRODHIMI GJATE VITIT 2020 NGA CENTRALET E LIDHURA NE RRRJETIN E TRANSMETIMIT (MWh)					
	HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	Prodh.2020
P.Pub	HEC "Fierze"	500.000		220 kV	3,090,199
P.Pub	HEC "Koman"	600.000	"KESH" sha	220 kV	
P.Pub	HEC "V. Dejes"	250.000		220 kV	
P.Pub	Tec Vlora	98.000	"KESH" sha	220 kV	303,063
P.Pav	HEC "Ulez"	25.200		110 kV	
P.Pav	HEC "Shkopet"	24.000	"Kurum International" sh.a.	110 kV	
P.Pav	HEC "Bistrica 1"	22.500		110 kV	
P.Pav	HEC "Bistrica 2"	5.000		110 kV	
P.Pav	HEC "Peshqesh"	27.940	"Ayen As Energji" sha	220 kV	78,962
P.Pav	HEC "Fangu"	74.600		220 kV	177,918
P.Pav	HEC "Banje"	73.000	"Devoll Hydropower" sha	110 kV	135,775
P.Pav	Hec "Moglice"	184.000		111 kV	159,722
PPE	Hec "Ashta"	48.200	"Energji Ashta" shpk	110 kV	187,223
PPE	Hec "Bishnica 2"	2.500	"HEC Bishnica 1,2" shpk	110 kV	7,751
PPE	Hec "Dardhe"	5.800	"Wenerg" shpk	110 kV	10,277
PPE	Hec "Truen"	2.500	"TRUEN" shpk	110 kV	8,160
PPE	Hec "Temove"	0.921	"TEODORI 2003" shpk	110 kV	93,483
PPE	Hec "Gjorice"	29.610	"DITEKO" shpk	110 kV	43,889
PPE	Hec "Slabinje"	13.800	"Power Elektrik Slabinje" shpk	110 kV	110,190
PPE	Hec "Bele 1"	5.000	"Euron Energy" shpk	110 kV	
PPE	Hec "TopoJan 2"	5.800			
PPE	Hec "Bele 2"	11.000	"Alb-Energy" shpk		
PPE	Hec "TopoJan 1"	2.900	"Energial" shpk		
PPE	Hec "Orgjost I Ri"	4.800	"Energy partners AI" shpk		
PPE	Hec "Cerunje-1"	2.300		110 kV	11,301
PPE	Hec "Cerunje-2"	2.800			
PPE	Hec "Rrupe"	3.600			
PPE	Hec "Rapuni 1,2"	8.100	"C & S Construction Energy" shpk	110 kV	26,887
PPE	Hec "Rapuni 3,4"	8.850	"C & S Energy" shpk	110 kV	24,091
PPE	Hec "Llapi"	13.620	"Gjo.Spa.POWER" shpk	110 kV	42,562
PPE	Hec "Lengarice"	8.940	"Lengarica & Energy" shpk	110 kV	15,408
PPE	Hec "Lura 1"	6.540		110 kV	28,275
PPE	Hec "Lura 2"	4.020	"Erdat Lura" shpk	110 kV	
PPE	Hec "Lura 3"	5.660		110 kV	
PPE	Hec "Malla"	5.455	"Gjure Rec" shpk	110 kV	10,002
PPE	Hec Prella	14.970	"Prella Energji"	110 kV	22,280
PPE	HEC Cemerica 1	0.880		110 kV	8,215
PPE	HEC Cemerica 2	1.080	"REJ ENERGY" shpk	110 kV	
PPE	HEC Cemerica 3	2.100		110 kV	
PPE	HEC TUÇ	4.470	MC Inerte Lumzi	110 kV	21,729
PPE	HEC Lumzi	11.000		110 kV	
PPE	Hec Denas	14.500	"Denas Power" shpk	110 kV	20,891
PPE	Llënga 1	1.730		110 kV	5,540
PPE	Llënga 2	0.300	"HEC LLËNGË" sh.p.k	110 kV	
PPE	Llënga 3	1.500		110 kV	
PPE	HEC Shpella Poshte 2	2.300	Liria Energji shpk	110 kV	7,302
PPE	HEC Germani 1	4.800	SA'GA-MAT shpk	110 kV	5,965
PPE	HEC Germani 2	1.500		110 kV	
PPE	Hec Lashkiza 1	4.076	HEC Lashkiza shpk	110 kV	2,920
PPE	Hec Lashkiza 2	0.882		110 kV	
PPE	Hec Seta 1+2	7.454		110 kV	25,636
PPE	Hec Seta 3	2.722	"Hydro Seta" sh.p.k	110 kV	
PPE	Hec Seta 4	4.724		110 kV	
PPE	HEC Darsi 1,2,3	2.240	Henz Energy shpk	110 kV	19,211
PPE	HEC Egnatia	5.100	REMI shpk	110 kV	7,218
PPE	HEC Seka & Zais	14.960	Seka Hydropower shpk	110 kV	30
		2,190			4,712,075

Figura 25 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2020.

Fuqia e instaluar e centraleve të lidhura në rrjetin e shpërndarjes është 306 MW. Kjo fuqi e instaluar e centraleve në rrjetin e shpërndarjes përbëhet nga 285 MW fuqi e instaluar në burime Hidrike dhe 21 MW fuqi e instaluar në impiante fotovoltaike. Prodhimi i realizuar nga centralet hidrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2020 është në sasinë 568,693 MWh, ndërsa prodhimi i realizuar

nga impiantet fotovoltaike është në sasinë 32,265 MWh. Në mënyrë të detajuar prodhimi i tyre paraqitet në tabelën në vijim:

PRODIMI GJATE VITIT 2020 NGA CENTRALET E LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)					
	HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	Progr.2020
PPE	Hec "Lanabregas" me fuqi 5 MW	5.000	"Hec Lanabregas" sha	35	28,643
PPE	Hec "Lenie" me fuqi 400 kW	0.400	"EMIKEL 2003" sh.p.k	10kV	2,494
PPE	Hec "Çorovode" me fuqi 200 kW	0.200		10kV	384
PPE	Hec "Smokthine" me fuqi 9,2 MW	9.200	"Albania Green Energy" sh.p.k	35 kV	26,316
PPE	Hec "Bulqize" me fuqi 0,6 MW (Diber)	0.600	"Balkan Green Energy" shpk	10kV	1,118
PPE	Hec "Homesh" me fuqi 0,395 MW (Diber)	0.395		10kV	272
PPE	Hec "Zerqan" me fuqi 0,625 MW (Diber)	0.625		6kV	881
PPE	Hec "Arras" me fuqi 4,8 MW (Diber)	4.800		20kV	14,031
PPE	Hec "Orgjost" me fuqi 1,2 MW (Kukes)	1.200		10kV	4,734
PPE	Hec "Lekhibaj" me fuqi 1,4 MW (Tropoje)	1.400		10kV	6,068
PPE	Hec "Dukagjin" me fuqi 0,64 MW (Shkoder)	0.640		10kV	2,223
PPE	Hec "Marjan" me fuqi 0,2 MW (Korce)	0.200		10kV	0
PPE	Hec "Lozhan" me fuqi 0,1 MW (Korce)	0.100		10kV	318
PPE	Hec "Barmash" me fuqi 0,83 MW (Kolonje)	0.830		10kV	660
PPE	Hec "Treske 2" me fuqi 0,25 MW (Korce)	0.250		10kV	493
PPE	Hec "Nikolice" me fuqi 0,7 MW (Korce)	0.700		10kV	1,033
PPE	Hec "Funares" me fuqi 1,92 MW (Librazhd)	1.920		10kV	5,452
PPE	Hec "Lunik" me fuqi 0,2 MW (Librazhd)	0.200		10kV	819
PPE	Hec "Kerpice" me fuqi 0,42 MW (Gramsh)	0.420		6kV	848
PPE	Hec "Ujanik" me fuqi 0,63 MW (Skrapar)	0.630		10kV	997
PPE	Hec "Borsh" me fuqi 0,25 MW (Sarande)	0.250		6kV	833
PPE	Hec "Leshnice" me fuqi 0,38 MW (Sarande)	0.380		10/6kv	413
PPE	Hec "Velcan" me fuqi 1,2 MW (Korce)	1.200		10kV	2,636
PPE	Hec "Muhur" me fuqi 0,25 MW (Diber)	0.250		6kV	673
PPE	Hec "Rajan" me fuqi 1,02 MW (Kolonje)	1.020	10kV	1,500	
PPE	Hec "Lure" me fuqi 0,75 MW (Diber)	0.750	10kV	147	
PPE	Hec "Gjanç" me fuqi 2,96 MW	2.960	"Spahiu Gjanç" sh.p.k.	35 kV	3,952
PPE	Hec "Bogove" me fuqi 2,5 MW	2.500	"Wonder power" sha	35 kV	4,034
PPE	Hec "Xhyre" me fuqi 570 kW	0.570	"Amal" sh.p.k	10kV	1,580
PPE	Hec "Stranik" me fuqi 4,6 MW	4.600	"Hidroinvest 1" shpk	35kV	8,912
PPE	Hec "Zall Tore" me fuqi 3 MW	3.000		35kV	8,362
PPE	Hec "Klos" me fuqi 1,95 MW	1.950	"Malido-Energji" shpk	6kV	2,284
PPE	Hec "Borje" me fuqi 1,5 MW	1.500	"HIDROALBANIA Energji" shpk	35kV	18,048
PPE	Hec "Cernaleve" me fuqi 2,95 MW	2.950	"HIDROALBANIA Energji" shpk	35kV	6,586
PPE	Hec "Cernaleve 1" me fuqi 3,27 MW	3.270	"HIDROALBANIA Energji" shpk	35kV	7,844
PPE	Hec "Murthar 1" me fuqi 2,68 MW	2.680	"HydroEnergy" shpk	10kV	8,054
PPE	Hec "Murthar 2" me fuqi 1 MW	1.000		10kV	4,596
PPE	Hec "Dishnice" me fuqi 0,2 MW	0.200	"Dishnica Energy" shpk	10kV	382
PPE	hec "Lubonje" me fuqi 0,3 Mw	0.300	"Elektro Lubonje" shpk	10kV	259
PPE	Hec "Peshke" me fuqi 3,43 MW	3.430	"Koka & Ergi Energy Peshk" shpk	35kV	8,551
PPE	Hec "Labinot –Mal" me fuqi 0,25 MW	0.250	"Ansara Koncension" shpk	6kV	209
PPE	Hec "Pobreg" me fuqi 12,3 MW	12.300	"Energy Plus" shpk	35kV	37,285
PPE	Hec "Vlushe" me fuqi 14,2 MW	14.200	"Hec Vlushe" shpk	35kV	23,293
PPE	Hec "Belesova 1" me fuqi 0,150 MW	0.150	"Korkis 2009" shpk	6kV	116
PPE	Hec "Faqekuq 1,2" me fuqi (3 MW; 3,4 MW)	6.400	"HP OSTROVICA" shpk	35kV	10,217
PPE	Hec "Shemri" me fuqi 1 MW	1.000	"Erald Energjitik" shpk	10	2,030
PPE	Hec "Mgulle" me fuqi 0,28 MW	0.280		10kV	1,398
PPE	Hec "Kryezi 1" me fuqi 0,6 Mw	0.600	"Bekim Energjitik" shpk	10kV	2,457
PPE	Hec "Selishte" me fuqi 2 MW	2.000	"Selishte" shpk	35kV	4,264
PPE	Hec "Carshove" me fuqi 1,5 Mw	1.500	"ERMA MP" shpk	10kV	1,626
PPE	Hec "Ura e Dashit" me fuqi 1,2MW	1.200		10kV	5,469
PPE	Hec "Gizavesh" me fuqi 0,5 MW	0.500	"Dosku Energy" shpk	10kV	2,322
PPE	Hec "Koka 1" me fuqi 3,2 MW	3.200	"Snow Energy" shpk	35kV	3,689
PPE	Hec "Stravaj" me fuqi 3,6 MW	3.600	"Stravaj Energji" shpk	35kV	8,198
PPE	Hec "Picar 1" me fuqi 0,2 MW	0.200	"Peshku Picar 1" shpk	6kV	386
PPE	Hec "Vertop" me fuqi 1,52 Mw	1.520	"Hydro Salilari Energy" shpk	35kV	2,124
PPE	Hec "Martanesh" me fuqi 10,5 MW	10.500	"Albanian Power" shpk	35kV	11,935
PPE	Hec "Verba 1,2" me fuqi (2 MW, 3 MW)	5.000	"Hydro power Plant Of Korca" shpk	35kV	7,041
PPE	Hec "Fterra" me fuqi 1,08 MW	1.080	"Hidro Borshi" shpk	35kV	7,252

PPE	Hec"Ostren i Vogel" me fuqi 0,32 MW	0.320	"Lu & Co Eco Energy" shpk	10kV	653
PPE	Hec"Kozel" me fuqi 0,5 MW	0.500		10kV	624
PPE	Hec"Helmes 1" me fuqi 0,8 MW	0.800	"E.T.H.H. "shpk	10kV	1,526
PPE	Hec"Helmes 2" me fuqi 0,5, MW	0.500		10kV	688
PPE	Hec"Qafezeze" me fuqi 0,4 MW	0.400	"Caushi Energji" shpk	10kV	2,273
PPE	Hec"Trebisht" me fuqi 1,775 MW	1.775	"SA.GLE.Kompani "shpk	10kV	2,607
PPE	Hec"Mollaj" me fuqi 0,6 MW	0.600	"Energji Xhaci" shpk	10kV	270
PPE	Hec"Tucep" me fuqi 0,4 MW	0.400	"Tucep" shpk	10kV	2,471
PPE	Hec"Treska4" me fuqi 3,6 MW	3.600		35kV	6,450
PPE	Hec"Treska3" me fuqi 0,3 MW	0.300	"Hec-Treske"shpk	35kV	823
PPE	Hec"Treska 2T" 5 me fuqi 0.62 MW	0.620		35kV	1,536
PPE	Hec"Sotire 1 & 2" me fuqi 2,2 MW	2.200	"Hidro Energy Sotire"shpk	35kV	3,443
PPE	Hec"Shutine" me fuqi 2,4 MW	2.400	"Shutina energji"shpk	10kV	2,600
PPE	Hec"Cekrez 1,2" me fuqi (0,23 MW; 0,43 MW)	0.660	"Zall Herr Energji 2011"shpk	6kV	4,306
PPE	Hec"Qarr" me fuqi 1 MW	1.000	"Hec Qarr & Kaltanj"shpk	35kV	2,789
PPE	Hec"Bisak" me fuqi 1,3 MW	1.300	"Bardhgjana" shpk	6kv	2,759
PPE	Hec"Shales" me fuqi 1,08 MW	1.080		35kV	9
PPE	Hec"Strelce" me fuqi 1,174 MW	1.174	"Gjoka Konstruksion Energji" shpk	35kV	3,548
PPE	Hec "Shpelle" me fuqi 400 kW	0.400	"Saroll" sh.p.k	10kV	1,087
PPE	Hec "Treska 1" me fuqi 130 kW	0.130	Star NRG sh.p.k	10kV	-
PPE	Hec "Bicaj" me fuqi 3,1 MW	3.100	"EN-KU" sh.p.k	10kV	-
PPE	Hec "Leskovik 1" me fuqi 1072 kW	1.072		10kV	309
PPE	Hec "Leskovik 2" me fuqi 1100 kW	1.100	"Maksi Elektrik" sh.p.k	10kV	381
PPE	Hec "Orenjë" me fuqi 875 kW	0.875	"Juana" sh.p.k	10kV	950
PPE	Hec "Tamarë" me fuqi 750 kW	0.750	"WTS Energji" shpk	10kV	-
PPE	Hec "Benë" me fuqi 1000 kW	1.000	"Marjakaj" shpk	6kV	1,286
PPE	Hec "Vithkuq" 1,2 me fuqi 2,715 MW	2.715	"Favina 1" shpk	35/10kV	7,138
PPE	Hec "Selce" me fuqi 1600 kW	1.600	"Selca Energji" shpk	10kV	3,848
PPE	Hec" Kumbull- Merkurth" me fuqi 0.83 Mw	0.830	"DN & NAT Energy"shpk	6kV	1,214
PPE	Hec "Sasaj" me fuqi 8,6 MW	8.600	"Energjo – Sas" shpk	35kV	21,870
PPE	Hec "Tervol" me fuqi 10.6 MW	10.600	"Hec i Tervolit" shpk	35kV	23,106
PPE	Hec "Radove" me fuqi 2,5 MW	2.500	"MTC Energy" shpk	10kV	5,220
PPE	Hec" Gurshpat 1" me fuqi 0,84 MW,	0.840		10kV	2,643
PPE	Hec" Gurshpat 2" me fuqi 0,83 MW	0.830	"Gurshpat Energy" shpk	10kV	3,019
PPE	Hec" Bistrica 3" me fuqi 1,57 MW,	1.570	"Bistrica 3 Energy" shpk	6kv	7,282
PPE	Hec" Hurdhas 1" me fuqi 1,71 MW,	1.710	"Komp Energji" shpk	6kV	6,016
PPE	Hec" Perrollaj" me fuqi 0,5 MW	0.500	"Fatlum" shpk	10kV	273
PPE	Hec" Koxheraj" me fuqi 0,62 MW	0.620	"Koxherri Energji" shpk	10kv	1,217
PPE	Hec" Kacni" me fuqi 3,87 MW	3.870	"Kisi-Bio-Energji" shpk	20kV	3,824
PPE	Hec" Lena 1" me fuqi 1,95 MW,;	1.950		35kV	
PPE	Hec" Lena 2" me fuqi 2,3 MW	2.300	"Gama Energy" shpk	35kV	5,041
PPE	Hec" Lena 2A" me fuqi 0,25 MW	0.250		35kV	
PPE	Hec "Driza" me fuqi 3,408 MW	3.408	"Mesopotam Energy" shpk	35kv	1,945
PPE	Hec Strelca 1,2,3 (1.504 MW, 0.325 MW, 3.52 MW)	5.349	"Strelca Energy" shpk	35kv	10,839
PPE	Hec "Ujanik 2" me fuqi 2,5 MW	2.500	"HP Ujaniku Energy" shpk	35kv	3,748
PPE	Hec "Nishove" me fuqi 1,36 MW	1.360	"Nishova Energy" shpk	35kv	932
PPE	Hec "Shtika" me fuqi 1,3 MW	1.300	"Perparimi SK" shpk	10kv	966
PPE	Hec "Ballenje" me fuqi 1,9 MW	1.900	"Ballenja Power Martanesh" shpk	35kv	2,381
PPE	Hec Gavran 1	0.998	"Gavran Energy" shpk	35kv	1,800
PPE	Hec Gavran 2	1.215	"Gavran Energy" shpk	35kV	1,452
PPE	Hec Kasollet e Selces 1	4.000	"Xhango Energji" shpk	35kV	7,159
PPE	Hec Holta Kabash	2.200		35kV	
PPE	Hec Holta Poroçan	3.300	HEC Kabash Poroçan shpk	35kV	9,860
PPE	Hec Lusen 1	0.315	"Eurobiznes" shpk	35kV	397
PPE	Hec Ura e Fanit	1.000	"Ayen As Energji" sha	35kV	5,341
PPE	HEC Gorice	1.747	"THE BLUE STAR" sh.p.k	35kV	2,852
PPE	HEC Kabash 1&2	5.800	"Univers Energji" shpk	35kV	3,360
PPE	HEC "Tucep 2"	1.7	"DUKA T2" shpk	35kV	2,506
PPE	Hec Dobrenje Tomorrice	2.4	DAAB Energy Group shpk	35kV	3,224
PPE	Hec Razzoll	0.765	Hidro Vizion shpk (I pa licens nga ER	35kV	1,322

PPE	Hec Dragostunje	3.1	"HEC-i Dragostunje" shpk	35kV	8,838
PPE	Hec Stebleve	3.4	"PURE ENERGY STEBLEVA" shpk	35kV	1,918
PPE	Hec Zerec 1	0.55	"EnRel Hydro" shpk	35kV	3,821
PPE	Hec Zerec 2	1.315			
PPE	Hec Shëngjon 1	0.651	"EDIANI" sh.p.k.	35kV	1,636
PPE	Hec Shëngjon 2	0.356			
PPE	HEC Blaç	1.3	"BLAC ENERGY" sh.p.k	35kV	956
PPE	HEC Qarrishtë	0.3	"IDI-2005" SHPK	35kV	1,085
PPE	HEC Vendresh	0.456	"HP VENDRESH ENERGY" SHPK	35kV	188
PPE	HEC "Antena"	1.105	"DERBI-E" shpk	35kV	1,625
PPE	HEC "Kamenicë"	0.973	HP Kamenica shpk	10	1,941
PPE	HEC "Qytezë"	0.9	Muso hec Qytezë	10	1,379
PPE	HEC Marjan Gura e Vesheve	0.63	Marituda Shpk	10	869
PPE	HEC Skatinë	2.677	Skatina Hec Shpk	10	2,604
PPE	HEC Kaparjel	0.2	ABV Konstruksion Shpk	10	526
PPE	HEC Letaj	0.54	Asi-Tre Shpk	10	720
PPE	HEC Nice	2.133	MP-HEC Shpk	35	1,395
PPE	HEC Meshurdhe	1.8	SIMA-Com Shpk	10	4,347
PPE	HEC Thanez	1.95	AFRIMI K Shpk	35	5,570
PPE	HEC OSOJE	1.9	OSOJA HPP shpk	35	6,239
PPE	Hec Voskopoje	1.9	FA VINA 1 shpk	35	3,656
PPE	Hec Nderfushas	1.34	SGD Energji shpk	35	1,090
PPE	Hec Rreshen	0.38	Nikolli Energy shpk	10	619
PPE	Hec Gurra	0.5	Uleza Ndertim shpk	6	567
PPE	Hec Vile	1.994	Hydro Power Panariti shpk	35	724
PPE	Hec Dukona	0.800	Dukona shpk	20	68
PPE	Hec Prevalli	1.750	Gega-G shpk	35	1,003
PPE	HEC Camerice	0.800	Rei Energy shpk	35	385
PPE	Hec Stror	2.000	Era Hydro shpk	35	729
PPE	Hec Mivas	1.940	Elva 2001 shpk	35	98
PPE	Hec Spathare	1.038	Lucente concensionare shpk	10	36
PPE	Hec Miraka	0.600	Kuarci Blace shpk	10	17
PPE	Hec Shegjun	2.000	Irarba Energji shpk	10	101
PPE	Hec Dobrunje	0.840	W.T.S. Energji shpk	10	27
		285			568,693
PRODHIMI GJATE VITIT 2020 NGA CENTRALET FOTOVOLTAIKE TË LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWh)					
	CENTRAL FOTOVOLTAIK	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	Progr.2020
PPE	UKKO (pa sistemuame sistem)	1	"UKKO" sha (Ujsjell.Kanal.Korce)		
PPE	Seman – 2	2	"SEMAN2SUN" sh.p.k	35 kV	4,119
PPE	Topojë	2	"SONNE" sh.p.k	35 kV	4,095
PPE	Topojë 2	2	"AED SOLAR" sh.p.k	35 kV	4,088
PPE	Topojë (Sheq Marinas)	2	"AGE SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,100
PPE	Topojë (Sheq Marinas) 2	2	"SEMAN SUNPOWER" sh.p.k	35 kV	4,124
PPE	Seman Isolar	2	"SEMANISOLAR" sh.p.k	35 kV	4,079
PPE	ES 2019 sh.p.k	2	ES 2019 sh.p.k	36 kV	244
PPE	SMART WATT sh.p.k	2	SMART WATT sh.p.k	37 kV	243
PPE	Tren Bilisht	2	"RTS" sh.p.k	35 kV	3,228
PPE	Plug, Lushnje	2	"AEE" sh.p.k	10 kv	3,946
	TOTAL MUJOR				
	Kapaciteti Instaluar i gjithe prodhuesve	21	MW		32,265
LEGJENDA					
P.Pub	Prodhuës Publik (Ngarkuar me detyrimin e shërbimit Publik)				
P.Pav	Prodhuës të Pavarur (Prodhuës në treg të Hapur)				
PPE	Prodhuës me Përparesi (Përfitojnë nga Skemat Mbështetëse)				

Figura 26 Prodhimi nga centralet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit 2020

1.3 TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Transmetimi i Energjisë Elektrike në Shqipëri kryhet nëpërmjet rrjetit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV, 150 kV, dhe 110 kV.

Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar përcakton se : “Sistemi i Transmetimit” është sistemi i përdorur për transmetimin e Energjisë Elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e Energjisë Elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

1.3.1 Bilanci energjetik

Tabela e mëposhtme paraqet bilancin energjetik të OST sh.a. për vitin 2020 krahasuar me periudhën 2015 – 2019.

Nr.	Bilanci Energjetik i OST sh.a (MWh)	2015	2016	2017	2018	2019	2020
I	ENERGJI TOTALE HYRËSE NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT	7,830,157	8,462,262	7,577,242	9,848,433	7,943,380	8,130,759
1	- Prodhimi vendas i injektuar ditë nga prodhuesit e lidhur në sistemin e transmetimit	5,378,588	6,474,557	4,051,512	7,809,069	4,537,484	4,712,074
2	- Energji në marrje (import në interkoneksion)	2,355,358	1,826,753	3,403,043	1,772,000	3,176,515	3,238,631
3	- Energji në ngritje në rrjetin e transmetimit nga prodhuesit e lidhur në shpërndarje.	98,049	162,833	122,687	269,530	229,380	180,053
II	ENERGJIA TOTALE DALËSE NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT	7,671,575	8,272,253	7,419,336	9,605,727	7,774,759	7,958,561
1	- Energji në dhënie (eksport në interkoneksion)	955,941	1,868,605	488,415	2,685,045	770,480	963,027
2	- Energji e transmetuar për OSSH sh.a.	6,105,827	5,900,753	6,149,450	5,963,357	6,137,250	6,184,178
3	- Energji transmetuar për klientët lidhur në rrjetin e transmetimit	610,207	502,895	781,471	957,323	867,029	810,571
III	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+Nevojat Vetjake	158,582	190,008	157,906	242,705	168,621	172,198
	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+Nevojat Vetjake (%)	2.03	2.25	2.08	2.46	2.12	2.12

Figura 27 Bilanci Energjetik i OST sh.a për vitin 2020 krahasuar me atë të viteve 2015-2019 (MWh).

Niveli i Humbjeve në sistemin e transmetimit për vitin 2020 është 172,198 MWh ose 2.12 % e energjisë elektrike të transmetuar. Niveli i humbjeve në Sistemin e Transmetimit është i lidhur me sasinë e energjisë elektrike të transmetuar si dhe me nivelin e prodhimit të HEC-eve të lidhura në Sistemin e Transmetimit.




Figura 28 Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjitik shqiptar për vitin 2020.

Paraqitja skematike e flukseve të energjisë elektrike në sistemin elektroenergjitik Shqiptar jepet në mënyrë të detajuar në figurën më sipër. Sasia totale e energjisë elektrike e injektuar në sistemin e transmetimit për vitin 2020 është 8,131 GWh. Sasia totale e energjisë elektrike e injektuar në sistemin e shpërndarjes është 6,605 GWh. Energjia elektrike në sistemin e shpërndarjes injektohet nga sistemi i transmetimit dhe nga impiantet gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes. Sistemi i transmetimit injekton në rrjetin e shpërndarjes sasinë prej 6,184 GWh, ndërsa impiantet gjeneruese të lidhura në rrjetin e shpërndarjes injektojnë në këtë rrjet sasinë neto të energjisë elektrike prej 421 GWh. Një pjesë e sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar në impiantet e lidhura në rrjetin e shpërndarjes injektohet në rrjet nëpërmjet sistemit të transmetimit. Kjo dukuri ndodh për shkak të konfiguracionit të rrjetit dhe pamundësisë së konsumatorëve në ato zona ku janë të lidhura këto impiante për të

konsumuar energjinë elektrike të gjeneruar. Element tjetër që ndikon në këtë dukuri është dhe fakti se njesitë gjeneruese hidrike të lidhura në rrjetin e shpërndarjes janë pa basene të grumbullimit të ujit dhe në periudha me rreshje të larta gjenerojnë me kapacitet maksimal.

1.3.2 Veprimtaria e OST sh.a.

Operatori i Sistemit të Transmetimit është personi juridik i licencuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, i cili ka në pronësi sistemin e transmetimit dhe respekton parimin e pavarësisë, të përcaktuar në Nenin 54 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar. Në vendin tonë Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) është shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore. Operatori i Sistemit të Transmetimit ushtron veprimtarinë e tij i ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në ligj.

OST sh.a. aktualisht kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Tregut si dhe Operatorit të Sistemit të Dispeçerimit të sistemit.

OST sh.a. garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

- Furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes, si dhe klientëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit,
- Transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit,
- Tranzitimin dhe shkëmbimin e nevojshëm me vendet e rajonit.

Në këtë kuadër OST sh.a. zhvillon Sistemin e Transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me Energji Elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të Energjisë Elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkonjeksionit me vendet fqinje. OST sh.a. dispeçeron sistemin Elektroenergjitik Shqiptar nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera fqinje.

1.3.2.1 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike të Shqipërisë përfshin të gjitha linjat me tension 400 kV, 220 kV, 110 kV dhe nënstacionet lidhëse midis tyre që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike dhe interkonjeksionit.

Gjatësitë e linjave të sistemit të transmetimit (përfshirë edhe investimet e bëra nga investitorë privatë), sipas nivelit të tensionit janë:

- | | |
|--------------------------------|----------|
| • Linjat e transmetimit 400 kV | 445.7 km |
| • Linjat e transmetimit 220 kV | 1,250 km |
| • Linjat e transmetimit 150 kV | 34.4 km |
| • Linjat e transmetimit 110 kV | 1,693 km |

Në përbërje të linjave të mësipërme janë pjesë e sistemit të Transmetimit dhe linjat e interkonjeksionit me vendet fqinje si:

- Linja e interkonjeksionit 400 kV Zemblak (Shqipëri) – Kardia (Greqi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Prishtinë (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Fierzë (Shqipëri) – Prizren (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Koplík (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Linjë e interkonjeksionit 150 kV Bistricë (Shqipëri) – Myrtos (Greqi).



Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Prishtinë (Kosovë) është vënë në operim në datën 14 dhjetor 2020.

Kapaciteti teknik i shkëmbimit me vendet fqinje është i mjaftueshëm për të realizuar shkëmbimet e nevojshme dhe tranzitimet e kërkuara në çdo kohë, megjithatë në periudha të caktuara ka konxhestion të kapaciteteve transmetuese në interkonjeksion.




Figura 29 Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë.




Figura 30 Skema e Sistemit të Transmetimit Shqiptar




Figura 31 Skema njefazore e Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar në nivelin 400-220-150-110kV.

Më poshtë janë listuar Nënstationet kryesore të Sistemit të Transmetimit.

Nr.	Tipi Nenstacionit	Fuqia e instaluar	Njesia operative	
1	400 kV	N/St. 400/220 kV, Koman	345 MVA	Shkodër
2		N/St. 400/220/110 kV, Tirana2	840 MVA	Tiranë
3		N/St. 400/220 kV, Elbasan2	600 MVA	Elbasan
4		N/St. 400/110 kV, Zemblak	300 MVA	Korcë
5	220 kV	N/St. 220/110 kV, V.Dejës	240 MVA	Shkodër
6		N/St. 220/110 kV, Fierzë	120 MVA	Shkodër
7		N/St. 220/110 kV, Koplik	90 MVA	Shkodër
8		N/St. 220/110 kV, Burrel	120 MVA	Shkodër
9		N/St. 220/110/20 kV, Tirana1	486 MVA	Tiranë
10		N/St. 220/110 kV, Sharrë	190 MVA	Tiranë
11		N/St. 220/110 kV, Rrashbull	200 MVA	Tiranë
12		N/St. 220/110 kV, Elbasan1	330 MVA	Elbasan
13		N/St. 220/110 kV, Fier	360 MVA	Fier
14		N/St. 220/110 kV, Babicë	200 MVA	Fier
15	150 kV	N/St. 110/150 kV, Bistrica1	80 MVA	Fier
TOTAL		4501 MVA		




Figura 32 Asetet kryesore të Sistemit të Transmetimit

1.3.2.2 Investimet në Sistemin e Transmetimit nga OST sh.a. gjatë vitit 2020.

Plani i investimeve për vitin 2020 dhe përditësimi i planit 10 (dhjetë) vjeçar i zhvillimit të rrjetit i OST sh.a, për arsye të korespondencave të vazhdueshme me shoqërinë dhe nevojave për plotësimin e dokumentacionit dhe informacioneve nga shoqëria, rezultojnë akoma në proces shqyrtimi në ERE. Megjithatë sipas raportimeve në formë operative nga OST sh.a. Investimet e realizuara për vitin 2020 paraqiten në tabelat e mëposhtme.

Realizimi i Investimeve me fondet e OST sh.a., per periudhen Janar -Dhjetor 2020							
Viti	Nr.	Pershkrimi	Vlera Kontrates	Vlera realizuar deri 2019	Realizimi 2020		Vlera e Mbetur e Kontrates
					Vlera Realizuar	Realizimi Kontr. %	
2020	1	Blerje materialesh dhe vegla pune te sigurimit teknik si dhe pajisjet (laborator) per testimin e mjeteve te sigurimit teknik	28,990,460		28,990,460	100%	0
	2	Instalimi i trosit OPGW ne linjen 154 Kv Bistrice-Kufi	30,735,775		30,735,775	100%	0
	3	Nderhyrje per raset emergjente	36,950,000		36,950,000	100%	0
	4	Blerje e moduleve shtese per sofini ODMs dhe sherbim mirembajtje per nje periudhe 3 vjeçare	30,593,800		30,593,800	100%	0
	5	Blerje materiale per Nenstacionet	97,393,771		97,393,771	100%	0
	6	Ndërtimi i linjës me dy qarqe 110 kV Fibër-Librazhd dhe traktet e linjave përkatëse në N/st Fibër e Librazhd	386,942,700		77,388,540	20%	309,554,160
	7	Punime civile per rikonstruksionin e traktit , Nenstacioni 110 kV Kuçove	5,938,478		5,938,478	100%	0
	8	Zgjerimi i sistemit te lokalizimit e defekteve ne linjat e Tensionit te Larte	99,730,002		98,650,001	99%	1,080,001
	9	Përmirësimi i rrugëve të komunikimit sistem lokal-rele/ mbrojtje/kontroli	4,720,000		4,720,000	100%	0
	10	Zgjerimi i monitorimit në Qendrën e Emergjente me N/st 110 kV të rehabilituara dhe komandimi i tyre nga NDC	23,942,300		23,942,300	100%	0
	11	Perditesimi i moduleve, topologjise dhe analizave per aplikonet e rrejetit EMS	17,800,000		17,800,000	100%	0
	12	Ndërtimi i linjës së re 110 kV me një qark Cerrik-Kajan Kuçovë-Jagodinë	655,700,000		131,140,000	20%	524,560,000
	13	Blerje e licensave per software-in e menaxhimit te logjikes se PLC ne RTU e implementuara ne HTC-ve dhe analizatorit te protokollit	4,788,100		4,788,100	100%	0
	14	Punimet civile për riparime dhe rikonstruksionin e nënstacioneve Rrashbull dhe Zemblak	10,420,500		10,420,500	100%	0
	15	Mbikqyrje e punimeve me objekt: Punime civile per riparime dhe rikonstruksion te objekteve te nenstacioneve Rrashbull dhe Zemblak	91,204		91,204	100%	0
	16	Mbikqyrja e punimeve me objekt : Punime civile per rikonstruksionin e traktit 110 kV te linjes Fier Kuçove	54,621		54,621	100%	0
	17	Ndërtimi i linjës së re 110 kV me një qark Cerrik-Kajan Kuçovë-Jagodinë	570,250,000		114,050,000	20%	456,200,000
	18	Blerje pajisje elektrike për riparimin e defektit për të normalizuar funks. sistemit mbrojtës kundër zjarrit te Tr2. & monitorimit online BMT TR1	2,390,000		2,390,000	100%	0
	19	Punime per perfundimin e linjes kablore 110 kV Tirana-Selite dhe lidhja me nenstacionin 110/20 kV Kombin	36,779,640		23,613,213	64%	13,166,427
	20	Përmirësimi i infrastruktures se rrejetit dhe rritja e sigurise brenda infrastruktures TI	20,785,500		20,485,500	99%	300,000
	21	Rikonstruksion i linjave 110 kV Laç2-Ura e Matit dhe Skuraj Ura e Matit	2,100,000		1,092,000	52%	1,008,000
	22	Blerje e një licence USB për programin kompjuterik PSSE për analizën e rrejetit	4,147,500		4,147,500	100%	0
	23	Mbikqyrja e punimeve per kontraten : Rehabilitimi i anës 110 kV te nenstacionit Prrenjas	1,250,000		1,250,000	100%	0
	24	Mbikqyrja e punimeve per kontraten : Rehabilitimi i anës 110 kV Fushe Arrez-Puke	1,620,000		1,620,000	100%	0
	25	Spostim i linjes ajrore 220 kV dojqo qark Tirana 2 - Elbasan 2	27,830,459		5,566,092	20%	22,264,367
	26	Instalimi i trosit OPGW ne linjen 154 kv Bistrice1-Kufi	270,088		270,088	100%	0
	27	Implementimi i nje sistemi Backup dhe Disaster Recovery	9,370,000		9,370,000	100%	0
	28	Ndërtimi i linjës 220 kV ME DY QARQE Koms-i-Shumit	6,303,477		2,750,000	44%	3,553,477
	29	Mbikqyrje punimesh Ndërtimi i linjes Sallmone-Gjiri Lalzit&trakti I linjave 110 kV Sallmone	2,000,000		2,000,000	100%	0
	30	Furnizimi, instalimi dhe konfigurimi i 2 sistemeve online te izolatoreve dhe shkarkimeve pjesore TR e fuqise AT1 dhe AT2 ne n/st 220/110/10 kV Burrel	34,160,000		32,360,000	95%	1,800,000
	31	Mbikqyrje per objektin e kontrates: Nderhyrje per raste emergjente	323,398		323,398	100%	0
TOT Kontrata te investimeve te vitit 2020			2,154,371,773	0	820,885,341	38%	1,333,486,432

Realizimi i Investimeve me fondet e huaja, per periudhen Janar -Dhjetor 2020										
Nr.	Pershkrimi	Vlera Kontrates		Vlera realizuar deri 2019		Realizimi 2020			Vlera Mbetur Kontrates	
		EUR	ALL	EUR	ALL	EUR	ALL	Realizimi Kontr. %	EUR	ALL
1	Projekti "Eficenca Energjëtike"	40,141,726	4,888,058,019	1,286,051	164,706,381	2,268,463	280,766,858	9%	36,765,886	4,464,665,119
	Kontraktor	37,683,111	4,588,672,470	0	0	1,729,000	214,027,155	5%	35,954,111	4,374,645,315
	Konsulence	2,458,615	299,385,549	1,286,051	164,706,381	360,789	44,659,364	67%	811,775	90,019,803
	Interesa&Komisone angazhimi dhe Kosto Lokale					178,673	22,080,338			
2	Projekti "Linja 400kV Shqiperi-Maqedoni"	1,857,350	226,169,510	576,907	71,222,841	125,000	15,449,375	38%	1,280,444	154,946,669
	Kontraktor								0	0
	Konsulence	1,857,350	226,169,510	576,907	71,222,841			31%	1,280,444	154,946,669
	Interesa&Komisone angazhimi dhe Kosto Lokale					125,000	15,449,375			
3	Instalim Matjes/Qendra e te dheneve	13,543,045	1,649,136,554	10,065,222	1,256,928,954	2,184,234	304,315,580	90%	1,293,588	121,955,115
	Kontraktor	13,543,045	1,649,136,554	10,065,222	1,256,928,954	2,184,234	270,252,485	90%	1,293,588	121,955,115
	Konsulence			0					0	0
	Interesa&Komisone angazhimi dhe Kosto Lokale						34,063,095		0	0
TOT		55,542,121	6,763,364,082	11,928,179	1,492,858,175	4,577,697	600,531,813	30%	39,339,918	4,741,566,902

Figura 33 Situata e Investimeve në Sistemin e Transmetimit nga OST sh.a gjatë vitit 2020.

1.3.3 Gjendja e Përgjithshme e Sistemit Elektroenergjitik referuar raportimit të OST sh.a, në zbatim të nenit 25, pika 2 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

OST sh.a, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrejetit të sistemit të transmetimit, bazuar në kërkesat dhe parimet e sigurisë operative, duke garantuar funksionimin e Sistemit të Transmetimit në nivel të lartë koordinimi, besueshmërie, cilësie dhe qëndrueshmërie.

a) Siguria operative e rrjetit

Siguria operative e rrjetit është aftësia e sistemit të transmetimit për të qëndruar në gjendje normale dhe/ose aftësia për t'u kthyer në gjendjen normale në një kohë sa më të shkurtër.

Sipas Kodit të Transmetimit, OST sh.a përcakton limitet e sigurisë operative për çdo element të rrjetit të transmetimit, si nga ana e gjenerimit ashtu edhe nga ana e kërkesës, si dhe për çdo interkonjektor në koordinim me OST-tën përkatëse, për përcaktimin e limiteve të sigurisë operative duke përfshirë:

- limitet e rrymës në përputhje me limitin termik,
- mbingarkesën e lejuar tranzitore dhe diapazonet e tensionit.
- operimin e sigurtë dhe zhvillimin e rrjetit të Sistemit të Transmetimit, në përputhje me zhvillimet në Tregun Shqiptar dhe Rajonal të Energjisë,
- marrëveshjet dypalëshe,
- marrëveshjen operationale të zonës sinkrone dhe angazhimet e Shqipërisë në rajon.

OST sh.a është gjithashtu përgjegjëse për çdo proces të planifikimit të rrjetit, planifikimit operacional dhe skedulimit, operimit në kohe reale, alokimit e planifikimit të rezervave dhe shërbimeve ndihmëse si dhe për masat e mara për mbrojtjen dhe restaurimin e sistemit. Këto parime të sigurisë operative janë thelbësore për të menaxhuar përgjegjësitë e OST sh.a për mirëfunksionimin e Sistemit të interkonjeksionit, me një nivel të lartë të koordinimit, besueshmërisë, cilësisë dhe qëndrueshmërisë.

Gjithashtu sipas deklarimeve të OST sh.a edhe investimet e realizuara në rrjetin e transmetimit kanë dhënë rezultate në rritjen e sigurisë së sistemit.

Operatori i sistemit të transmetimit me qëllim përmbushjen e detyrimeve, për sa i takon sigurisë operative të rrjetit, ka mbështetur këtë veprimtari në dispozitat e Kodit të Transmetimit, i cili është në përputhje me Kodin e ENTSO-e dhe në legjislacionin në fuqi për këtë qëllim.

Ndër komponentët kryesorë që vijnë në ndihmë për të garantuar sigurinë operative të rrjetit është mundësia e një panarome dhe aftësia për të operuar në kohë reale lidhur me gjëndjet e sistemit elektroenergjetik.

Për të realizuar me efikasitet menaxhimin e Sistemit Elektroenergjetik dhe përgatitjen e veprimeve përmirësuese, në mënyrë që të mbahet sistemi në gjendjen normale apo të kthehet në normalitet sa më shpejt të jetë e mundur në raste të avarive ose incidenteve, OST sh.a ka implemtuar dhe ka në operim platformën SCADA/ EMS, e cila ka të integruar një sërë aplikacionesh që janë në shfrytëzim të vazhdueshëm nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, për të garantuar në mënyrë sa më efikase operimin e sigurtë të sistemit elektroenergjetik në përputhje me parashikimet e Kodit të Transmetimit dhe standartet e ENTSO-E.

Element tjetër, i cili vjen në shërbim të sigurisë operative të rrjetit si dhe sistemet SCADA dhe sistemin e matjes së energjisë si dhe monitorimin e parametrave kryesor teknik në distancë, është rrjeti i ndërlidhjes dhe telekomunikacionit të dedikuar për përdorim ekskluziv të funksionimit të rrjetit të transmetimit, ky Rrjet kryesor i telekomunikacionit që përdoret në veprimtarinë e OST sh.a, bazohet në infrastrukturën e Fibrës Optike me OPGW të instaluar në linjat e tensionit të lartë në nivelet e tensionit: 400kV; 220kV; 110kV.

OST sh.a garanton gjithashtu ruajtjen e parametrave të duhur të tensionin, frekuencës së sistemit të ngarkesës dhe fuqisë reaktive duke mbajtur sistemin brenda parametrave të sigurisë operacionale.

OST sh.a, me qëllim mbrojtjen e aseteve të sistemit të transmetimit nga dëmtimet, ka instaluar pajisjet e mbrojtjes së nevojshme dhe ato të mbrojtjes rezervë, duke koordinuar me mbrojtjen e pajisjeve të përdorueseve të rëndësishëm të rrjetit. Çdo pesë vjet, OST sh.a shqyrton dhe analizon konceptet dhe strategjinë e mbrojtjes. OST sh.a kryen mbrojtjen e sistemit të transmetimit me tarime (set-point) që sigurojnë besueshmëri, shpejtësi dhe selektivitet të pastrimit të avarisë (l.sh.), duke përfshirë mbrojtjen rezervë për pastrimin e l.sh., në rast të mosfunksionimit të sistemit kryesor të mbrojtjes. Funkcionaliteti dhe statusi i gjendjes së sistemit monitorohen, komunikohen dhe koordinohen ndërmjet OST-ve fqinje dhe palëve të tjera të prekura nga sistemi i mbrojtjes.

Gjatë vitit 2020 në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nuk janë shënuar ngjarje apo çenim i kufijve të sigurisë operacionale, sistemi i transmetimit ka funksionuar qëndrueshëm në kushte normale operimi.

b) Balanca e parashikuar e kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë 5 (pesë) vjeçare

Në bazë të të dhënave historike të OST sh.a., duke konsideruar rritjen potenciale të gjenerimit të prodhuesve me përparësi dhe atyre të pavarur të energjisë elektrike (PPE + PVE) dhe reduktimin e humbjeve jo teknike në rrjetin e shpërndarjes, është pranuar që rritja e pritshme e vëllimit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST sh.a, të jetë e rendit 1%. Mbi këtë bazë, duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i parametrave kryesore energjetikë dhe sigurimi i balancës së sistemit për pesë vjeçarin në vijim 2020-2025, siç jepet në tabelat e mëposhtme:

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2021
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	930	820	803	686	736	709	705	754	697	732	764	908	9,245
a)	Prodhim vendas	"	592	520	573	466	476	459	385	394	422	422	414	528	5,652
b)	Energji ne marrje	"	338	300	230	220	260	250	320	360	275	310	350	380	3,593
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	911	803	786	672	722	695	691	740	684	718	748	890	9,061
a)	Energji elektrike e dhene	"	190	198	193	184	223	178	97	137	131	124	134	156	1,945
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	661	550	533	433	439	449	519	528	465	489	499	614	6,180
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	60	55	60	55	60	68	75	75	88	105	115	120	936
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	19	17	17	14	14	14	14	14	13	14	16	18	184
b)	Humbjet ne %	%	2.04%	2.07%	2.12%	2.04%	1.90%	1.97%	1.99%	1.86%	1.86%	1.91%	2.09%	1.98%	1.99%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2022
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	868	760	838	780	790	700	680	690	605	760	865	1015	9,351
a)	Prodhim vendas	"	530	460	620	560	530	450	360	340	330	470	515	635	5,800
b)	Energji ne marrje	"	338	300	218	220	260	250	320	350	275	290	350	380	3,551
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	850	745	823	764	773	684	663	672	591	745	849	997	9,156
a)	Energji elektrike e dhene	"	122	134	224	271	272	165	64	62	32	145	228	255	1,976
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	667	555	539	437	440	450	524	534	470	494	504	620	6,235
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	61	56	61	56	61	69	76	76	89	106	116	121	945
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	18	15	15	16	17	16	17	18	14	15	16	18	195
b)	Humbjet ne %	%	2.07%	1.97%	1.79%	2.05%	2.15%	2.29%	2.50%	2.61%	2.31%	1.97%	1.85%	1.77%	2.09%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2023
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	868	775	838	775	795	690	650	655	595	765	875	1025	9,306
a)	Prodhim vendas	"	550	480	630	565	540	460	360	340	330	480	525	645	5,905
b)	Energji ne marrje	"	318	295	208	210	255	230	290	315	265	285	350	380	3,401
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	849	760	822	759	778	673	632	637	580	750	859	1,007	9,106
a)	Energji elektrike e dhene	"	79	165	196	239	238	138	42	17	45	189	263	245	1,856
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	670	520	536	435	450	455	520	550	455	471	481	642	6,185
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	100	75	90	85	90	80	70	70	80	90	115	120	1,065
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	19	15	16	16	17	17	18	18	15	15	16	18	200
b)	Humbjet ne %	%	2.19%	1.94%	1.91%	2.06%	2.14%	2.46%	2.77%	2.75%	2.52%	1.96%	1.83%	1.76%	2.15%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2024
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	893	770	860	775	770	675	645	655	615	775	865	1035	9,333
a)	Prodhim vendas	"	570	500	660	580	560	480	370	340	350	490	545	655	6,100
b)	Energji ne marrje	"	323	270	200	195	210	195	275	315	265	285	320	380	3,233
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	873	754	843	759	753	658	627	637	601	759	848	1,016	9,128
a)	Energji elektrike e dhene	"	103	164	218	229	218	123	12	2	61	204	238	236	1,808
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	655	500	510	420	425	430	520	540	435	440	470	635	5,980
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	115	90	115	110	110	105	95	95	105	115	140	145	1,340
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	20	16	17	16	17	17	18	18	14	16	17	19	205
b)	Humbjet ne %	%	2.24%	2.08%	1.98%	2.06%	2.21%	2.52%	2.79%	2.75%	2.28%	2.06%	1.97%	1.84%	2.20%

Nr	Emertimi	Njesia e matjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti 2025
I.	Energjia Totale qe hyn ne sistemin e OST	GWh	904	795	848	805	772	720	753	740	650	730	820	900	9,437
a)	Prodhim vendas	"	560	520	570	600	580	500	420	410	390	450	530	590	6,120
b)	Energji ne marrje	"	344	275	278	205	192	220	333	330	260	280	290	310	3,317
II.	Energjia totale e transmetuar	GWh	883	779	831	789	755	703	735	721	635	714	802	880	9,227
a)	Energji elektrike e dhene	"	108	174	221	239	210	133	60	31	105	184	252	105	1,822
b)	Energji elektrike per OSHEE sh.a.	"	640	480	480	410	400	420	520	530	410	415	430	625	5,760
c)	Energji elektrike per konsumatoret e kualifikuar	"	135	125	130	140	145	150	155	160	120	115	120	150	1,645
III.	Humbjet ne rrjetin e transmetimit	GWh													
a)	Humbjet ne GWh	"	21	16	17	16	17	17	18	18	19	15	16	18	210
b)	Humbjet ne %	%	2.32%	2.01%	2.00%	1.99%	2.20%	2.36%	2.39%	2.57%	2.31%	2.19%	2.20%	2.22%	2.23%

c) Niveli i Pritshëm i kërkeses dhe perspektivës së sigurisë së furnizimit për një periudhë (5) pesë deri në (15) pesëmbëdhjetë vjetore nga data e raportit

Në bazë të të dhënave historike të zhvillimit të ngarkesës për një periudhë 20 vjeçare, duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji sipas matjeve në transmetim, është bërë parashikimi i kërkesës për energji elektrike sipas tre skenarëve të mundshëm, optimist, realist dhe pesimist, siç jepet në tabelën e mëposhtme,:

Skenari realist i kërkesës për energji elektrike merr në konsideratë një rritje të kërkesës për energji elektrike në vend rreth 2 % në vit. Skenari optimist i kërkesës për energji elektrike merr në konsideratë një rritje të kërkesës për energji elektrike në vend rreth 3 % në vit. Skenari pesimist i kërkesës për energji elektrike merr në konsideratë një rritje të kërkesës për energji elektrike në vend rreth 1.3 % në vit. Skenari bazë për vlerësimin e ecurisë së kërkesës për energji elektrike në vend për periudhën në vijim merret skenari realist i rritjes së kërkesës për energji elektrike në vendin tonë rreth 2 % në vit.

Parashikimi i Kerkeses sipas Skenareve			
Vitet	Sk. Optimist (GWh)	Sk. Realist (GWh)	Sk. Pesimist (GWh)
2020	7,174	7,174	7,174
2021	7,425	7,317	7,246
2022	7,685	7,486	7,318
2023	7,954	7,658	7,391
2024	8,232	7,826	7,465
2025	8,520	7,998	7,540
2026	8,750	8,174	7,645
2027	8,987	8,354	7,752
2028	9,229	8,538	7,861
2029	9,478	8,726	7,971
2030	9,734	8,918	8,083
2031	9,978	9,105	8,196
2032	10,227	9,296	8,327
2033	10,483	9,492	8,460
2034	10,734	9,691	8,595
2035	10,992	9,894	8,733
2036	11,256	10,102	8,873
2037	11,526	10,314	9,015
2038	11,803	10,531	9,159
2039	12,086	10,752	9,305
2040	12,376	10,978	9,454

Figura 34 Parashikimi afatgjatë i kërkesës për energji elektrike për periudhën 2020-2040




Figura 35 Parashikimi i kërkesës për energji elektrike

- Siç vërehet edhe në tabelën më lart parashikimi i kërkesës për energji elektrike për energji elektrike për vitin 2020, në të tre skenarët e marrë në konsideratë nga OST sh.a rezulton rreth 5% më i ulët se fakti i vitit 2020 prej 7,588 GWh .

d) Kapaciteti shtesë prodhues i propozuar, i planifikuar apo në fazë ndërtimi

Të dhënat e parastruara më poshtë nga OST sh.a paraqesin centrale të energjisë elektrike të cilat janë lidhur në rrjetin e transmetimit në vitin 2020, janë në fazë ndërtimi, ose kanë marrë miratimin paraprak për lidhjen me rrjetin e transmetimit, të cilët janë:

- Centrale Hidrike që kanë lidhur marrëveshje për lidhje në vitin 2020 dhe priten të energjizohen gjatë viteve 2021-2022:
 1. HEC-et Gjadër (24.938 MW) – S.P.E.Gjadër sh.p.k.
 2. HEC Arsti (4 MW) – HEC ARSTI sh.p.k. (energjiuar në fund të muajit dhjetor 2020)
 3. HEC-et Dragobia & Ceremi (22 MW) – Dragobia Energy sh.p.k.
 4. HEC-et Stavec (14.77 MW) – KOKA&ERGI sh.p.k.
 5. HEC-et Kalivarë (5.597 MW) – BE-IS ENERGY sh.p.k.
 6. HEC-et Gostimë (48.864 MW) – Egnatia Hydropower sh.p.k.
 7. HEC-et Bushtrica (10.03 MW) – ELENERGJI sh.p.k.+BUSHTRICA 2017 sh.p.k.
 8. HEC-et Veleshica (13.9 MW) – KALISI HYDROPOWER sh.p.k.

- Centrale që kanë nënshkruar marrëveshje lidhje në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2020:
 1. HEC-et Gostimë (48.864 MW) – Egnatia Hydropower sh.p.k.
 2. HEC Arsti (4 MW) – HEC ARSTI sh.p.k.

- Centrale që kanë marrë miratim në parim për lidhje në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2020:
 1. Park Eolik Pilur (3 MW) - DAAM sh.p.k.
 2. Park Eolik Pilur (3 MW) – ECO WIND sh.p.k.
 3. Park Eolik Pilur (3 MW) - NET-GROUP sh.p.k.
 4. Park Eolik Pilur (3 MW) – SPARK WIND sh.p.k.

- Centrale që kanë marrë opinion paraprak për lidhje në sistemin e transmetimit përgjatë vitit 2020:
 1. Park Fotovoltaik Povelçë (30 MW) - CONSTAL sh.p.k.
 2. Park Fotovoltaik Blue1&2 (100 MW) – BLESSED INVESTMENT sh.p.k.
 3. Park Fotovoltaik ERSEKA SOLAR (62.328 MW) - FAVINA sh.p.k.
 4. Park Fotovoltaik Sheq Marinës (70 MW) - VERBUND Green Power GmbH
 5. Park Fotovoltaik EURON (50 MW) - EURON sh.p.k.
 6. Park Fotovoltaik ALB-Solar1 (50 MW) - INFO-Telecom sh.p.k.
 7. Park lundruer Fotovoltaik (12.972MW)- KESH sh.a
 8. Park Fotovoltaik Qyrsaq (5.14 MW) - KESH sh.a.
 9. Park Eolik Gjadër (15 MW) – CONSTAL sh.p.k.
 10. Park Fotovoltaik Karaburun (3 MW) - NIKOLICA SKI RESORT sh.p.k.
 11. Park Fotovoltaik Karaburun (3 MW) - RENEW POWER ALBANIA sh.p.k.
 12. Park Fotovoltaik Karaburun (3 MW) - SunPro sh.p.k.
 13. Park Fotovoltaik Karaburun (3 MW) – Suntech Power sh.p.k.
 14. Park Fotovoltaik Karaburun (3 MW) - A.Great Company sh.p.k.

Sipas raportimeve të OST sh.a, për periudhën Janar-Dhjetor 2020 janë vënë në operim tre burime gjeneruese, (Centrale Hidrike), të lidhura në rrjetin e transmetimit 110 kV. Në vijim jepet lista e centraleve të vënë në punë:

- HEC Egnatia, lidhur në linjën 110 kV Librazhd - Prrenjas,
- HEC-et Seka (Seka apo Seta?) dhe Zais, lidhur në N/Stacionin 110/20 kV Prellë.
- HEC Arsti, lidhur në linjën 110kV Fierzë- Dardhë

e) Parashikimi i investimeve, për jo me pak se 5 (pesë) vitet e ardhshme, që OST sh.a apo çdo palë tjetër planifikon të realizojë në lidhje me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkoneksionit.

1. Parimet e menaxhimit të kufizimit të kapaciteteve në linjat ekzistuese dhe ato të planifikuara të sistemit të transmetimit.

Me investimet e bëra gjatë viteve të fundit në sistemin e transmetimit, është bërë i mundur plotësimi i kriterit të sigurisë N-1 në rrjetin e brendshëm të Sistemit, për të gjitha regjimet e punës dhe nuk janë hasur probleme të kufizimit të kapaciteteve transmetuese. Lidhur me menaxhimin e kapaciteteve ndërkufitare, në zbatim të rregullave të ENTSO-E, OST sh.a ka zbatuar procedurat e mëposhtme.

Përcaktimi i kapacitetit transmetues ndërkufitar, NTC, aktualisht bëhet sipas marrëveshjeve bilaterale ndërmjet OST-ve fqinje, dhe bazohet në marrëveshjen SAFA, dhe anekset e saj. Është e rëndësishme të theksohet dallimi i qartë ndërmjet vlerave komerciale dhe atyre fizike, pasi siç dihet, ekzistojnë dy sete definimesh, një i lidhur me vlerat e programit (skedulimit) dhe tjetri me fluksin fizik të energjisë elektrike, që në shumicën e rasteve nuk përputhen kur merret në konsideratë një interkonjektor i veçuar nga pjesa tjetër e rrjetit. Kompleksiteti i anës fizike të fluksit të energjisë trajtohet nga OST-të, që janë përgjegjëse përkundrejt Autoriteteve përkatëse për kryerjen e kësaj detyre në mënyre jo diskriminuese. Pjesëtarët e tregut nuk duhet të përfshihen në këtë proces.

Përdorimi i këtyre kapaciteteve transmetuese është pjesë e tregut të energjisë, nëse pjesëtarët e tregut janë të motivuar për t'i përdorur të dy drejtimet e fluksit ndërkufitar, atëherë kjo do të lehtësonte qarkullimin e fluksit ndërkufitar duke kontribuar në rritjen e nivelit të sigurisë operacionale të punës së Sistemit Elektroenergjetik.

Përllogaritja e NTC bëhet sipas rregullave dhe metodologjive në fuqi, NTC për sistemin tonë sipas kufinjëve gjatë vitit 2020 rezulton si vijon :

Kufiri	NTC (MW/h)
AL->GR	400
AL->KS	400
AL->ME	300-400
Total	1100 -1200

2. Modelet e pritshme të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit, duke mundësuar marrjen e masave për menaxhimin e kërkesës.

Për pesë vitet e ardhshme, 2021-2025, është përlogaritur parashikimi i kërkesës për energji elektrike, mbulimi i saj nëpërmjet prodhimit vendas dhe importit. Të gjitha këto të dhëna jepen të grupuara në tabelën e mëposhtme:

Viti	2021	2022	2023	2024	2025
Gjenerimi [GWh]	5652	5800	5905	6100	6120
Shkëmbimi [GWh]	-1648	-1575	-1545	-1425	-1495
Konsumi [GWh]	7300	7375	7450	7525	7615

3. Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe europian

OST sh.a kryen studime të vazhdueshme si për zona të veçanta të rrjetit të transmetimit ashtu edhe të lidhjes së sistemit elektroenergetik Shqiptar me sistemet e vendeve fqinje. Studimet më të rëndësishme dhe që kanë rëndësi të veçante kryhen në bashkëpunim me institucionet studimore ndërkombëtare në kuadrin e WBIF.

Gjatë fazave të planifikimit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit me qëllim: (i) Rehabilitimin dhe fuqizimin e rrjetit të transmetimit, (ii) Krijimin e nyjeve të reja lidhëse, (iii) përmirësimin e procesit të menaxhimit, kontrollit, matjes etj., OST sh.a merr në konsideratë zhvillimin kombëtar dhe rajonal në përputhshmëri të plotë me direktivat e ENTSO-E (Rrjetit Europian të Operatoreve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike).

Të gjitha projektet në proces implementimi dhe ato të planifikuara janë të lidhura me shërbimin e sistemit të transmetimit, i cili mund të kryhet plotësisht vetëm nëpërmjet realizimit të investimeve të nevojshme për fuqizimin dhe modernizimin e tij.

4. Informacion i OST sh.a për investimet e parashikuara për linjat e interkonjeksionit dhe për ndërtimin e linjave të brëndshme të rrjetit, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në linjat e interkonjeksioneve ndërkufitare

Nga pikëpamja strategjike, projektet që përforcojnë lidhjet interkonjektive me rajonin si dhe krijojnë kushte më të mira për shkëmbime tregtare dhe shkëmbime pa kufizim të energjisë elektrike në rajonin e Europës Jug-lindore janë:

- Ndërtimi i linjës së interkonjeksionit 400 kV Elbasan2 (Shqipëri) – Bitola (Maqedonia e Veriut) dhe Elbasan2 – Fier si dhe zgjerimi i nënstacioneve Elbasan2 dhe Fier.

Financimi i këtij projekti, do të sigurohet nga Bashkëpunimi Gjermano-Shqiptar i Zhvillimit.

Ky projekt përforcon lidhjet interkonjektive me rrjetin rajonal të energjisë elektrike, duke krijuar kushte për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajon, zhvillon rrjetin 400 kV në zonën Jugore të Shqipërisë ku parashikohen të zhvillohen burimet e ardhshme të

prodhimit të energjisë elektrike dhe, si pjesë e infrastrukturës së Korridorit të Tetë Evropian, krijon mundësi të mira për lidhje nëpërmjet kabllit nënujor me Italinë.

Projekti përfshin:

- Ndërtimin e një linje të re transmetimi 400 kV me një qark, për të implementuar një lidhje dypalëshe mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut dhe për të përforcuar lidhjen ekzistuese të transmetimit 220 kV të tej ngarkuar dhe të vjetër midis Elbasanit dhe Fier. Traseja e Linjës Elbasan-Bitola do të ketë një gjatësi përafërsisht 56 km ndërsa linja Elbasan –Fier përafërsisht 74 km.
- Ndërtimin e nënstacionit të ri Elbasan 3 dhe përforcimin dhe zgjerimin e nënstacionit ekzistues të Fierit. Nënstacioni i ri Elbasan 3 do të zgjerojë nënstacionin ekzistues 400/220 kV Elbasan 2, me një impiant në nivelin 400 kV për të lidhur linjat Tiranë 2, Zëmlak, Fier dhe Maqedoni e Veriut si dhe instalimin e një shunt reaktori. Gjithashtu nënstacioni Fier do të zgjerohet dhe pajiset me transformatorë 400/220 kV dhe një impiant në nivelin 400 kV për të lejuar lidhjen e 400 kV drejt Elbasanit 3.

Rikonstrukcioni i linjës së interkonjeksionit 220kV Vau i Dejës (Shqipëri) - Podgoricë (Mali i Zi)

Ndërtimi i kabllit të planifikuar HVDC midis Italisë dhe Malit të Zi do të mundësojë evakuimin e tepricave të gjenerimit të ardhshëm në zonën e Ballkanit dhe në të njëjtën kohë do të sjellë forcimin e mëtejshëm të rrjetit të transmetimit në rajon.

Shumë iniciativa të reja për ndërtimin e centraleve të burimeve të rinovueshme janë duke u zhvilluar në veri të Shqipërisë dhe për këtë arsye nevojiten përforcime të linjave ekzistuese të interkonjeksionit për të siguruar shkëmbimet ndërkuftare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi.

Linja ajrore aktuale e interkonjeksionit Vau i Dejës (Shqipëri) - Podgorica (Mali i Zi) është ndërtuar në 1972 dhe ka një kapacitet të fuqisë së transmetueshme rreth 278 MVA.

Projekti përfshin:

Rikonstrukcionin e linjës ajrore 220 kV Vau i Dejes - Koplik (AL) - Podgoricë me një linjë të re ajrore me qark të dyfishtë, afërsisht 45 km e gjatë me përcjellës të llojit alumin-çelik 490/65 mm².

Përfitimet që arrihen nga kryerja e këtij investimi janë:

- Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë së rrjetit shqiptar dhe të Malit të Zi
- Rritja e shkëmbimit ndërkuftar midis dy vendeve
- Rritja e kapaciteteve neto të transferimit midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, në dritën e shkëmbimeve të energjisë elektrike midis Shqipërisë, Malit të Zi dhe Italisë nën shkëmbimet e sigurisë
- Reduktimi i konxhestioneve të rrjetit
- Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike
- Ulja të humbjeve teknike
- Reduktimi i niveleve të CO₂

f) Cilësia dhe niveli i mirëmbajtjes së rrjetit

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2020, OST sh.a ka ndjekur në vazhdimësi realizimin e punimeve të planifikuara (remontet e planifikuara) dhe problemet, shqetësimet dhe avaritë që janë ndeshur gjatë operimit të sistemit të transmetimit duke bërë ndërhyrjet e nevojshme rast pas rasti, me masat parandaluese, duke shmangur avaritë e mundshme. Kur këto të fundit janë bërë prezente, është realizuar ndërhyrja për eliminimin e tyre dhe kthimin e skemës në gjendje normale.

Situata e pazakontë, që u krijua gjatë këtij viti për shkak të pandemise COVID-19 si dhe masat që u morën për të kontrolluar përhapjen e këtij infeksioni, krijoi një situatë jo normale dhe solli vështirësi të veta përse i përket realizimit të remonteve, punimeve të planifikuara dhe eliminimin e avarive.

Me gjithë vështirësi dhe pavarësisht shtrëngesave të krijuara, përgjithësisht u bë i mundur realizimi i të gjitha remonteve të planifikuara si dhe është ndërhyrë në kohë për eliminimin e të gjitha avarive që janë shfaqur gjatë kësaj periudhe.

Punimet për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit, që realizohen nga specialistët e OST sh.a klasifikohen në tre kategori :

- punime të planifikuara në përputhje me grafikun e remonteve
- Punime jashtë rradhe (të pa planifikuara)
- punime për eliminimin e avarive të shfaqura në sistem .

Këto punime janë realizuar nga specialistët e njësisve operative të OST sh.a, në koordinim dhe me mbështetjen e specialistëve të sektorëve përkatës pranë zyrave qendrore të OST sh.a. .

Në tabelën në vijim po japim rezultatin e punimeve të realizuara për mirëmbajtjen e rrjetëve të OST sh.a.. Treguesit e pasqyruar janë pozitivë krahasuar me vitet e kaluara.

Emertimi	stakime gjithsej	tranzi tore	qendru eshme	kushte atmosf.	difekt linje	paisje primare	paisje konda	SHAMSHA	SHEFte tjere	ndry me	kohe zgjatja
Linja 400kV	23	14	9	18	1	3	1	0	0	0	11h
Linja 220kV	61	25	36	28	13	9	2	0	5	4	100h
Linja 110kV	326	175	151	184	32	11	65	1	16	17	307h 10'
Linja gjithsej	410	214	196	230	46	23	68	1	21	21	

Në lidhje me cilësinë e punës së sistemit të transmetimit, bëjmë me dije se gjatë vitit 2020 cilësia e frekuencës ka qenë brenda diapazonit +/- 200mHz .

Cilësia e tensionit ka qenë brenda standarteve të përcaktuara në Nenin 38 të Kodit të Transmetimit ku për vitin 2020 rezulton që nuk ka patur ankesa sa i takon cilësisë së tensionit.

Të gjitha kërkesë/ankesave të ardhura gjatë vitit 2020, OST sh.a u është përgjigjur brenda afateve (maksimumi 45 ditë).

g) Masat e marra nga OST sh.a për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike si dhe masat e mara për rritjen e sigurisë së furnizimit në rast nevoje.

Masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve të furnizimit, si dhe masa të tjera në rast nevoje, për të ruajtur sigurinë e punës së Sistemit përmblihen në të ashtuquajturat veprime përmirësuese, që paraqesin masat e zbatuara nga OST-ja, me qëllim ruajtjen e sigurisë operationale. Në mënyrë të veçantë, veprimet përmirësuese shërbejnë për të përmbushur kriterin (N-1) dhe për të ruajtur limitet e sigurisë operationale. Ato kategorizohen si veprime përmirësuese para-avari (d.m.th. parandaluese) ose pas-avari (d.m.th. korrigjuese ose kurative) brenda zonës së kontrollit të OST-së ose ndërmjet OST-ve të ndërlidhura.

Veprimet përmirësuese parandaluese zbatohen normalisht në fazën e planifikimit të operimit, për të ruajtur gjëndjen normale të Sistemit në situatën e ardhshme operative, dhe për të parandaluar përhapjen e avarive jashtë zonës së përgjegjësisë të OST-së.

Veprimet përmirësuese parandaluese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në sa më poshtë:

- Veprime të ri-dispeçimit (të agregatëve) ose të lejimit të tregtimit në kah të kundërt (kur kjo është e mundur);
- Ndryshime në topologjinë e rrjetit;
- Komutime manuale të pajisjeve të energjisë reaktive (reaktorët, bllloqet e kondensatorëve statikë), ose ndryshimin e nivelit të “set-point” të kontrollorëve të tyre;
- Kërkesa për suport shtesë të energjisë reaktive nga centralet;

Veprimet përmirësuese - korrigjuese janë veprime, të cilat zbatohen menjëherë ose relativisht shpejt pas ndodhjes së një emergjence, e cila çon në një gjëndje të ndryshme nga situata normale. Pas veprimeve korrigjuese Sistemi kthehet përsëri në gjëndje normale.

Veprimet përmirësuese - korrigjuese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Veprime të ri-dispeçimit ose të tregtimit në kahë të kundërt, duke përfshirë aktivizimin e rezervave të OST-së;
- Kontroll të pajisjeve të energjisë reaktive (reaktorët, bllloqet e kondensatorëve, etj);
- Menaxhim të tensionit me anë të gjenerim/absorbimit të energjisë reaktive nga centralet,
- Veprime të skemave të sistemit të mbrojtjes, p.sh. ndryshimi i topologjisë së rrjetit, kufizim i prodhimit apo i ngarkesës, në varësi të specifikimeve të mbrojtjes.

h) Plani i sistemit të mbrojtjes së OST sh.a në rast të një situatë emergjente:

Siguria operationale nënkupton aftësinë e OST për të siguruar funksionimin normal të Sistemit, për të kufizuar kohëzgjatjen dhe numrin e çrregullimeve, për të parandaluar shqetësime të mëdha, dhe për të kufizuar pasojat e një shqetësimi të madh (në rast se kjo ndodh), dhe gjithashtu për të lehtësuar rivendosjen e Sistemit në parametra normale të funksionimit, pas një shqetësimi të madh (black-out).

Plani i mbrojtjes së Sistemit është i lidhur me egzistencën e një gjëndjeje emergjente, procesin përkatës të marrjes së informacionit, veprimeve përmirësuese dhe përbëhet nga një sërë masash të koordinuara, të cilat synojnë të ruajnë integritetin e Sistemit, në kushte trazirash ekstreme. OST sh.a konsideron gjendje emergjence praninë e së paku një devijimi nga Limitet e Sigurisë Operacionale dhe limiteve kohore të përcaktuara në Nenin 109 (1) të Kodit të Transmetimit dhe kur operatorët nuk marrin dot masa përmirësuese për të rivendosur sistemin në gjendje normale.

Në planin e mbrojtjes së sistemit të hartuar nga OST sh.a janë gjithashtu të përmbledhura të gjitha masat teknike dhe organizative, të marra për të parandaluar përhapjen apo përkeqësimin e një incidenti në Sistemin e Transmetimit, incident që mund të shkaktojë shmangien, zgjerimin e avarisë madje edhe rënien e Sistemit;

Plani i Mbrojtjes Sistemit i hartuar nga OST sh.a përfshin si më poshtë :

- skemën e kontrollit automatik nga mbi/ nën-frekuenca
- skemën e kontrollit automatik nga kolapsi i tensionit
- procedurat që ndiqen gjatë aktivizimit të planit të mbrojtjes si dhe kushtet e aktivizimit të veprimeve përmirësuese

i) Masat e Planit të Mbrojtjes të Sistemit

Masat e Planit të Mbrojtjes së Sistemit paraqiten si veprime emergjente përmirësuese. Në vijim, jepen shembuj të masave të aplikueshme të Planit të Mbrojtjes së Sistemit në rastet e kufizimeve për ngarkesën, frekuencën, flukset e energjisë dhe të tensionit.

Kufizime të ngarkesës/frekuencës

- Lëshimi ose ndalimi i njësisë të prodhimit të energjisë;
- Rritja ose zvogëlimi (automatiksht ose me kërkesë) i nivelit të prodhimit të njësisë gjeneruese;
- Përshtatja e mënyrës së kontrollit të LFC aktive;
- Përdorimi manual apo automatik i reduktimeve, shkarkimit të ngarkesës;
- Ndryshimet e pikave të punës të rregullatorëve të tensionit të transformatorëve në nivelin e shpërndarjes.

Kufizime të flukseve të energjisë elektrike

- Anullimi i remonteve të elementëve të rrjetit dhe vënia e tyre sa më parë në punë;
- Stakimi automatik i njësisë (gjeneruese) që aktivizohet nga stakimi i një linje përkatëse të transmetimit;
- Tregtimi në kah të kundërt me zonat fqinje të përgjegjës;
- Ngrirja e shkëmbimeve të planifikuara;
- Reduktimi i programit të shkëmbimit;
- Reduktimi i kapaciteteve të interkonjeksionit;
- Shkarkimi manual i ngarkesës i objekteve me marrëveshje për ndërprerje;

- Shkarkimi automatik i objekteve me marrëveshje për ndërprerje, shkaktuar nga stakimi i një linje transmetimi;
- Shkarkimi i mëtejshëm i ngarkesës në varësi të situatës.

Kufizimet e tensionit

- Kërkesa për vlera maksimale apo minimale të gjenerimit të fuqisë aktive dhe reaktive;
- Zvogëlimi i fuqisë aktive në favor të prodhimit shtesë të fuqisë reaktive;
- Parandalimi i njësive me ofrimin, injektimin e energjisë reaktive shtesë;
- Ndalimi i mirëmbajtjes, dhe kyçja e elementeve që më parë ishin në remont;
- Bllokimi i pozicionit të rregullatorëve të tensionit në transformatorët me rregullim nën ngarkesë.

1.4 SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

1.4.1 Veprimtaria e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSSH sh.a.)

Shpërndarja e energjisë elektrike në vendin tonë kryhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), i licencuar nga ERE sipas dispozitave të Ligjit nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi asetet në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, me qëllim lëvrimin e energjisë elektrike tek klientët. Kufiri i sistemit të shpërndarjes me sistemin e transmetimit është i përcaktuar në ligj.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes, përbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike; mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është licencuar. Në përputhje me ligjin "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", OSSH sh.a. prokuron energji elektrike në tregun e hapur dhe nga burimet e rinovueshme, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ERE dhe nëpërmjet platformës elektronike për procedurat e blerjes së energjisë elektrike.

Në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe VKM Nr. 244, datë 30.3.2016, të ndryshuar, OSSH sh.a, deri më 31.12.2020, ka vijuar të kryej funksionin e Furnizuesit të Shërbimit Universal për furnizimin e klientëve fundorë që përfitojnë nga ky shërbim.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.) është organizuar në 11 Zona Shpërndarje dhe 42 Agjenci .

Sipas të dhënave të OSSH, energjia totale e hyrë në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2020 është 6,605,083 MWh, nga e cila 5,080,314 MWh është energjia e lëvruar në rrjetin e shpërndarjes dhe 1,457,740 MWh janë humbjet në rrjetin e shpërndarjes.

Në tabelën më poshtë paraqiten të dhënat mbi treguesit kryesorë të Operatorit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2020.

1.4.2 Konsumi i Energjisë Elektrike

Konsumi total vjetor i Energjisë Elektrike (duke përfshirë edhe konsumin e klientëve në treg të parregulluar) në Shqipëri për periudhën 2003 deri në 2020 paraqitet në mënyrë grafike si më poshtë:




Figura 37 Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike ndër vite.

Siç vërehet në paraqitjen grafike, konsumi më i ulët i energjisë elektrike i regjistruar në vendin tonë është në vitin 2007 me 5,767,652 MWh dhe konsumi më i lartë i energjisë elektrike është ai i regjistruar në vitin 2013 me 7,855,698 MWh. Për vitin 2020 konsumi i energjisë elektrike në vendin tonë është 7,588,637 MWh. Krahasuar me vitin 2019 vërehet një ulje e lehtë e konsumit të energjisë elektrike në vend me 23,442 MWh.




Figura 38 Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës Import-Eksport në konsumin total të Energjisë Elektrike në Shqipëri.




Figura 39 Komponentët për mbulimin e konsumit dhe komponentët e konsumit të energjisë elektrike të siguruar për vitet 2019 – 2020

1.4.3 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike

SHPËRNDARJA E KONSUMATORËVE SIPAS RAJONEVE DHE KATEGORIVE 2020 (%)						
	Buxhetor	Familjare	Jo-Buxhetore	Konsum vetjak	Privat	2020
Berat	0.077	7.107	0.028	0.003	1.115	8.330
Burrel	0.054	4.323	0.025	0.003	0.499	4.904
Durres	0.072	11.977	0.026	0.002	1.508	13.586
Elbasan	0.075	7.568	0.035	0.003	1.036	8.717
Fier	0.055	5.809	0.019	0.002	0.805	6.688
Gjirokastr	0.100	5.533	0.022	0.002	0.789	6.446
Korce	0.076	6.504	0.022	0.002	0.756	7.359
Kukes	0.027	1.472	0.007	0.001	0.180	1.687
Shkoder	0.076	7.863	0.028	0.002	1.116	9.084
Tirane	0.122	22.292	0.035	0.004	4.102	26.556
Vlore	0.045	5.718	0.015	0.001	0.864	6.642
TOTAL	0.779	86.166	0.263	0.024	12.768	100.000

Figura 40 Shpërndarja e Klientëve të OSSH sh.a sipas rajoneve dhe kategorive 2020.




Figura 41 Shpërndarja e numrit të Klientëve 2020 sipas kategorive (%).

Të dhënat e paraqitura më sipër tregojnë se numri i përgjithshëm i klientëve për vitin 2020 është 1 273 000. Dhe për vitin 2020 pjesën më të madhe të klientëve të OSSH sh.a. e zenë klientët familjar që shkojnë në 86.17 % të numrit total të klientëve të OSSH sh.a. Në shpërndarjen demografike të klientëve të OSSH sh.a. dhe për vitin 2020 pjesa më e madhe është në Tiranë në rreth 26.5 % e gjithë klientëve që ka OSSH sh.a.

Struktura e klientëve të OSSH sh.a. reflektohet dhe në strukturën e faturimit të energjisë elektrike të realizuar për vitin 2020. Klientet familiar zenë pjesën më të madhe në OSSH sh.a. dhe pjesën më të madhe të energjisë së faturuar për vitin 2020 respektivisht 51.8 % të gjithë faturimit të realizuar për vitin 2020.




Figura 42 Raportet e Faturimit sipas Kategorive të Klientëve 2020.

Në figurën e mëposhtme paraqiten peshat specifike në faturim që zënë kategoritë e klientëve tariforë.




Figura 43 Klientët Familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite.

Klientët familjare zënë rreth 38.96 % të konsumit total, shifër më e lartë kjo krahasuar me konsumin për të njëjtën kategori për vitin 2019 i cili ishte në masën 36.1 %.

1.4.4 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike

Nga studimi i profilit vjetor të konsumit të Energjisë Elektrike, tipari karakteristik i këtij profili është simetria thuajse e plotë e konsumit dimër – verë.

Ashtu sikurse në raportimet e viteve të mëparshme, edhe këtë vit vërehet i njëjti fenomen, ai i përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje në dimër. Çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit

reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë elektrike, pikërisht prej efektit të përdorimi ose mospërdorimit të ngrohjes me energji elektrike të banesës.

Gjatë stinës së verës, në muajt Korrik dhe Gusht tendenca e pikut është në rritje, i cili nga viti në vit po bëhet më evident dhe lidhet me ndryshimet klimatike, përmirsimin e kushteve të jetesës që çon në përdorimin gjithnjë e në shkallë më të gjerë të pajisjeve klimatizuese gjatë muajve të nxehtë.

Më poshtë paraqiten të dhënat e konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2020 krahasuar me të dhënat mesatare të periudhës 2009-2019.




Figura 44 Konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2020.

Në grafikun më poshtë jepet profili mesatar ditor me bazë orare të ngarkesës për vitin 2020.




Figura 45 Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2020.




Figura 46 Profili dhe pikë i ngarkesës në dhjetor 2020 (MW).




Figura 47 Profili dhe minimumi i ngarkesës në Mars 2020 (MW).

1.4.5 Treguesit e energjisë elektrike së furnizuar, shitur dhe humbur për çdo zonë dhe agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2020

Më poshtë paraqiten të dhënat lidhur me treguesit e energjisë elektrike së Furnizuar, shitur dhe humbur për çdo zonë dhe agjenci të OSSH sh.a. gjatë vitit 2020 (MWh).

VITI 2020					
Drejtoria Rajonale	Agjensia	Energjia e Hyre MWh	Energjia e Shitur MWh	Humbjet MWh	Humbjet ne %
TIRANË	Tirana1	854,796	744,722	110,074	8.1
	Tirana2	799,608	691,423	108,185	8.0
	Tirana3	657,029	550,532	106,494	7.9
DURRËS	Durres	383,610	320,365	63,245	4.7
	Kavaje	151,442	130,259	21,184	1.6
	Kruje	139,843	93,014	46,828	3.5
	Shijak	182,429	136,854	45,574	3.4
FIER	Ballsh	45,521	40,586	4,936	0.4
	Fier	331,386	285,826	45,560	3.4
	Patos	69,107	55,574	13,533	1.0
ELBASAN	Elbasan	305,972	263,361	42,611	3.1
	Gramsh	22,213	19,388	2,827	0.2
	Librazhd	68,408	55,603	12,805	0.9
	Peqin	34,350	26,966	7,385	0.5
KORÇË	Bilisht	35,475	29,804	5,670	0.4
	Kolonje	17,579	15,084	2,496	0.2
	Korce	201,223	165,027	36,195	2.7
	Pogradec	71,229	62,074	9,156	0.7
GJIROKASTËR	Delvine	17,648	14,603	3,046	0.2
	Gjirokaster	102,404	81,382	21,022	1.6
	Permet	22,364	19,069	3,294	0.2
	Saranda	107,083	90,475	16,609	1.2
	Tepelene	33,386	22,044	11,342	0.8
SHKODËR	Koplik	71,074	34,217	36,856	2.7
	Lezhe	161,872	105,449	56,423	4.2
	Puke	25,754	14,209	11,546	0.9
	Shkoder	397,009	252,936	144,073	10.6
BERAT	Berat	113,802	93,792	20,009	1.5
	Kuçove	65,015	55,950	9,064	0.7
	Lushnje	192,629	157,251	35,378	2.6
	Skrapar	44,464	37,913	6,552	0.5
KUKËS	Has	31,728	14,747	16,980	1.3
	Kukes	102,780	61,745	41,034	3.0
	Tropoje	65,415	26,253	39,162	2.9
BURREL	Bulqize	54,840	49,508	5,332	0.4
	Diber(Peshkopi)	68,881	44,741	24,141	1.8
	Lac	186,160	120,735	65,426	4.8
	Mat (Burrel)	57,009	40,030	16,979	1.3
	Mirdite	48,581	32,798	15,783	1.2
VLORË	Himare	24,107	21,497	2,610	0.2
	Selenice	44,060	17,344	26,715	2.0
	Vlore	264,074	224,158	39,915	2.9
				1,354,049	100.0

Figura 48 Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSSH sh.a. gjatë vitit 2020.

Humbjet më të larta i takojnë Drejtorive Rajonale Tirane dhe Shkodër, ndërkohë nivel më të ulët të humbjeve gjatë vitit 2020 kanë patur Axhensite Përme, Gramsh e Himarë.




Figura 49 Shpërndarja e Furnizimit me Energji Elektrike sipas Drejtorive rajonale (%).

Sikurse evidentohet edhe në figurë, pjesën më të madhe të konsumit të energjisë elektrike në vend për vitin 2020 e zë Drejtoria Rajonale Tiranë, ndërkohë që pjesën më të vogël të konsumit e zë Drejtoria Rajonale Kukës.




Figura 50 Shpërndarja e Humbjeve të Energjisë Elektrike sipas Drejtorive rajonale (%).

Krahasimi i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes me targetat e vendosura në VKM-në nr. 253, datë 24.04.2020.




Figura 51 Humbjet mujore dhe mesatare në sistemin e shpërndarjes krahasuar me targetin e humbjeve të energjisë elektrike sipas VKM nr.253, datë 24.04.2020 (%).

Paraqitja e kontributit në furnizim dhe në humbjet respektive sipas agjensive .




Figura 52 Sasia në Furnizim dhe Humbje të Energjisë Elektrike në Rajonet dhe Agjencitë e Rrjetit të Shpërndarjes (Burimi: OSSH sh.a).

Bazuar në të dhënat e mësipërme të tabelave dhe informacioneve periodike apo specifike të operatorëve të tregut të energjisë u ndërtua Bilanci Energjetik për vitin 2020 si më poshtë.




Figura 53 Bilanci Energjetik viti 2020.




Figura 54 Të dhëna të tregut të energjisë elektrike për vitin 2020 në raport me energjinë elektrike të konsumuar në Shqipëri.

1.4.6 Efektiviteti i shitjes së energjisë elektrike

Gjatë vitit 2020 efektiviteti i shitjes të energjisë elektrike vazhdon në vlera të rritura në referencë gjithnjë të faktorëve përcaktues në nivelin e efijencës së konsumit të energjisë elektrike të cilët janë:

1. Niveli i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje.
2. Niveli i arkëtimeve të energjisë elektrike së faturuar.

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga shoqëria për vitin 2020, arrijnë në **21.48 %**, duke shënuar ulje të nivelit të humbjeve krahasuar edhe me vitin 2019

Niveli total i arkëtimeve i raportuar nga OSSH sh.a. është **95.8 %** kundrejt energjisë elektrike të faturuar (shih tabelën e Faturim – Arkëtimeve).

Shifra e arkëtimeve përfshin edhe arkëtimet e prapambetura .



Figura 55 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2020.




Figura 56 Grafiku i Humbjeve Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2020.




Figura 57 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2020.




Figura 58 Niveli i Arkëtimeve Mujore në periudhën 2011-2020.

PERFORMANCA E OPERATORIT TE SHPERNDARJES 2009-2020 (%)												
NIVELI I HUMBJEVE (%) 2009-2020												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	40.75	37.05	38.05	32.93	33.44	30.75	32.60	30.20	25.34	30.67	33.44	36.89
2010	38.62	35.41	36.90	31.37	35.17	31.45	26.94	29.69	21.47	20.61	22.16	29.05
2011	55.55	38.00	36.95	23.11	24.85	21.29	21.88	19.41	22.95	25.15	32.20	35.70
2012	35.72	59.16	55.23	45.41	38.87	39.77	45.51	45.51	42.09	35.53	41.89	49.32
2013	51.12	48.71	48.29	39.66	39.52	40.33	43.33	38.50	35.08	45.98	48.08	53.04
2014	47.00	42.14	42.78	35.69	36.85	34.10	36.59	36.36	31.67	34.52	32.88	37.54
2015	36.68	31.82	32.88	30.54	31.24	28.60	30.62	29.29	25.30	29.92	30.82	34.50
2016	34.69	29.00	29.93	26.07	26.97	24.35	25.97	25.15	22.12	27.11	29.30	30.99
2017	33.50	27.63	28.66	25.81	25.88	28.31	24.69	23.29	19.79	23.76	23.55	27.90
2018	30.65	24.91	27.22	23.33	23.03	20.76	21.46	20.77	19.32	21.53	22.73	26.70
2019	29.25	23.21	26.5	21.36	22.10	19.92	20.42	19.81	17.54	20.40	21.58	24.76
2020	28.22	21.61	28.36	17.39	19.10	18.65	19.69	18.87	16.80	21.21	22.79	20.49
												26.41
												23.9
												21.79
												21.48
Niveli i Arkëtimeve (%) 2009-2020												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	69.32	85.95	74.38	86.58	86.31	76.37	75.40	72.46	83.20	80.82	61.77	70.01
2010	55.37	66.28	86.63	89.46	86.70	79.42	74.84	124.98	84.20	70.81	56.15	66.48
2011	67.26	57.61	87.66	71.61	96.73	73.00	65.00	81.00	66.00	63.86	51.47	87.30
2012	59.80	79.20	78.50	78.00	94.70	83.50	91.60	102.90	74.00	98.00	72.60	78.00
2013	61.40	63.70	86.20	80.70	79.10	69.60	87.90	90.10	78.50	84.30	89.00	102.00
2014	84.90	77.10	85.90	85.50	81.90	80.20	86.70	83.60	102.60	101.00	101.90	141.00
2015	112.70	120.50	103.70	86.60	95.70	97.10	98.40	104.70	95.30	100.30	92.20	100.70
2016	92.10	87.00	95.60	90.10	99.10	92.00	94.20	96.70	91.50	96.70	90.30	96.70
2017	85.20	87.60	105.70	94.50	105.70	91.80	104.80	97.40	94.60	103.80	92.70	100.10
2018	96.39	95.69	105.82	98.92	111.64	100.16	105.00	102.12	93.03	108.76	96.24	108.94
2019	90.7	92.6	99.8	102.4	102.50	94.00	104.40	99.30	93.90	104.70	89.60	110.70
2020	91.4	91.6	77.5	106.8	101.80	102.20	96.80	95.30	96.60	101.10	91.50	101.80
												96.6
												101.6
												98.4
												95.8
Efektiviteti i shitjeve (%) 2009-2020												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	41.1%	54.1%	46.1%	58.1%	57.4%	52.9%	50.8%	50.6%	62.1%	56.0%	41.1%	44.2%
2010	34.0%	42.8%	54.7%	61.4%	56.2%	54.4%	54.7%	87.9%	66.1%	56.2%	43.7%	47.2%
2011	29.9%	35.7%	55.3%	55.1%	72.7%	57.5%	50.8%	65.3%	50.9%	47.8%	34.9%	56.1%
2012	38.4%	32.3%	35.1%	42.6%	57.9%	50.3%	49.9%	56.1%	42.9%	63.2%	42.2%	39.5%
2013	30.0%	32.7%	44.6%	48.7%	47.8%	41.5%	49.8%	55.4%	51.0%	45.5%	46.2%	47.9%
2014	45.0%	44.6%	49.2%	55.0%	51.7%	52.9%	55.0%	53.2%	70.1%	66.1%	68.4%	88.1%
2015	71.4%	82.2%	69.6%	60.2%	65.8%	69.3%	68.3%	74.0%	71.2%	70.3%	63.8%	66.0%
2016	60.2%	61.8%	67.0%	66.6%	72.4%	69.7%	69.7%	72.4%	71.3%	70.5%	63.8%	66.7%
2017	56.7%	63.4%	75.4%	70.1%	78.3%	65.8%	78.9%	74.7%	75.9%	79.1%	70.9%	72.2%
2018	66.8%	71.9%	77.0%	75.8%	85.9%	79.4%	82.5%	80.9%	75.1%	85.3%	74.4%	79.9%
2019	64.2%	71.1%	73.4%	80.5%	79.8%	75.3%	83.1%	79.6%	77.4%	83.3%	70.3%	83.3%
2020	65.6%	71.8%	55.5%	88.2%	82.4%	83.1%	77.7%	77.3%	80.4%	79.7%	70.6%	80.9%
												71.1%
												77.3%
												77.0%
												77.0%
												75.2%

Figura 59 Ecuria e treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatorit të Shpërndarjes (%).

Efektiviteti i shitjeve të OSSH sh.a. praktikisht përfaqëson përqindjen (%) e energjisë elektrike që është shitur dhe arkëtuar. Për vitin 2020 efektiviteti i shitjeve për OSSH sh.a. është 75.2 %, ose 1.8 % më i ulët se në vitin 2019.

Efektiviteti i shitjeve për periudhën 2009-2020 jepet dhe në grafikun e në vijim:




Figura 60 Efektiviteti i shitjeve të OSSH 2009-2020 (Burimi: OSSH sh.a).




Figura 61 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergjitik kundrejt konsumit.

Në figurën e mësipërme jepet ecuria e humbjeve totale të energjisë elektrike e cila përfshin humbjet në sistemin e shpërndarjes edhe ato në sistemin e transmetimit, gjatë periudhës 2005 – 2020. Të dhënat tregojnë se humbjet e energjisë elektrike në vlera absolute kanë ardhur duke u ulur nga viti në vit. Për vitin 2020 humbjet e energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes dhe të transmetimit janë 1,632 GWh. Krahasuar me vitin 2019 kemi një ulje të humbjeve totale të energjisë elektrike me 19 GWh.

Në figurën më poshtë është paraqitur marrëdhënia e faturim-arkëtimeve të energjisë elektrike përgjatë periudhës 2005 - 2020. Siç shihet dhe në figurë deri në vitin 2014 diferenca ndërmjet faturimit dhe arkëtimit ka qënë e konsiderueshme. Diferenca ndërmjet faturimit dhe arkëtimit arrin nivelin maksimal në vitin 2011, në rreth 30 %. Për vitin 2020 diferenca ndërmjet faturimit dhe arkëtimit është 3.1 %. Ulja e ndjeshme e diferencës ndërmjet energjisë elektrike të faturuar dhe asaj të arkëtuar fillon në vitin 2015 dhe vijon të jetë një proces i konsoliduar në vitet në vijim.




Figura 62 Faturimi/Arkëtimi 2002-2020 me TVSH (Burimi: OSSH sh.a.).

1.4.7 Asetet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

Tabela e mëposhtme paraqet të dhëna mbi asetet në administrim nga OSSH sh.a. për vitin 2020, si nënstationet, linjat, kabinat dhe transformatorët në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Të dhënat mbi asetet e OSSH sh.a. përfshijnë të dhëna mbi elementet kryesor të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike. Numrin e nënstationeve, numrin e transformatorëve, gjatësinë e linjave ajrore dhe kabllore si dhe numrin e kabinave elektrike. Numri total i kabinave elektrike në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2020 është 25,820 nga të cilat 13,218 janë në pronësi të OSSH sh.a. dhe pjesa tjetër është në pronësi të subjekteve private.

Gjatësia totale e linjave të tensionit të mesëm në sistemin e shpërndarjes është 16.6826 km. Gjatësia totale e rrjetit të tensionit të ulët në sistemin e shpërndarjes është 36.912 km. Në mënyrë më të detajuar të dhënat jepen në tabelën më poshtë:

TË DHËNAT E RRJETIT OSHEE PER VITIN 2020																																
NENSTACIONE,KABINA DHE TRANSFORMATORE		KABINAT		TIPIT DHE NUMRI I KABINAVE												FUQIA E INSTALUAR (kVA)				NUMRI I TRANSFORMATORVE TE FUQISE IMTU												
				METALIKE			MURATURE			BOX			SHYLLORE			NUMRI TOTAL I KABINAVE	6 kV			20kV	6 kV			20kV	Total							
				6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV		6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	Total									
Numri i Nënstationeve	181																															
Numri i Transformatorëve në nënstatione	310	Gjithsej	335	275	10	2647	3727	3942	56	87	1741	6943	5847	87	25696	1601391	1797666	2633679	6032686	10043	9995	6300	26328									
Numri i Kabinave total	25696	Pronesi OSHEE	256	200	2	1675	2620	2072	42	52	1676	2020	2387	51	13,053	790010	1053947	1583065	3427022	4022	5295	4047	13364									
Numri i Transformatorëve TM/TU	26328	Pronesi Jo e OSHEE	79	75	8	972	1107	1870	14	35	65	4923	3460	36	12,643	811281	743719	1050614	2605664	6021	4700	2253	12974									
Gjatesia Totale e rrjetit TM(km)	17389.6	Gjatesia Totale e rrjetit TU(km)	56,070																													
Linja 35 kV (km) Ajrore	1244.6	Ajror me perçjelles te xhvështur (km)	17,771																													
Linja 35 kV (km) Kabllore	17.5	Ajror me kabell ABC(km)	5,039																													
Linja 20 kV (km) Ajrore	192.4	Kabllor PVC, XLPE	13,374																													
Linja 20 kV (km) Kabllore	2396.9	Kabllor Koaksial	19,885																													
Linja 10 kV (km) Ajrore	7528.9																															
Linja 10 kV (km) Kabllore	419.0																															
Linja 6 kV (km) Ajrore	4827.2																															
Linja 6 kV (km) Kabllore	763.1																															
SHPERNDARJA SIPAS TIPIT DHE PRONESISE KABINAVE(%)																																
KABINAT		METALIKE			MURATURE			BOX			SHYLLORE			TOTAL %																		
		6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV																			
Gjithsej		335	275	10	2647	3727	3942	56	87	1741	6943	5847	87	100																		
Pronesi OSHEE		256	200	2	1675	2620	2072	42	52	1676	2020	2387	51	50.8																		
Pronesi Jo e OSHEE		79	75	8	972	1107	1870	14	35	65	4923	3460	36	49.2																		

Figura 63 Të dhëna mbi asetet kryesore të OSSH (Burimi: OSSH).

2. TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE.

Edhe përgjatë vitit 2020, Tregu i Energjisë Elektrike ka funksionuar bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016, i ndryshuar “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e Energjisë Elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me Energji Elektrike. Për sa përcaktuar nga Këshilli i Ministrave ky vendim shërben si Model i Përkohshëm Tregu deri në zbatueshmërinë e VKM Nr. 519, datë 13.07.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, implementimi i së cilës lidhet me bërjen efektive të tregut të një dite më parë dhe operimin e Bursës së Energjisë Elektrike. Veç të tjerash, modeli aktual, ka përcaktuar qartë pjesëmarrësit e tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri (TEE), si dhe rolin dhe përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës në treg të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë, me qëllim reflektimin e kërkesave të këtij ligji, ka vijuar punën për të miratuar aktet rregullatore nënligjore në zbatim të tij.

Për sa është parashikuar dhe në nenin 98 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe në VKM-në Nr. 244, datë 30.03.2016, të ndryshuar, miratuar nga ana e ERE, me Vendimin Nr. 139, datë 15.08.2016, të ndryshuar ka miratuar rregullat e përkohshme të tregut të energjisë elektrike, të cilat kanë qënë në zbatim përgjatë gjithë vitit 2020.

Gjithashtu, me Vendimin e ERE-s Nr. 193, datë 27.11.2017, janë miratuar "Rregullat e përkohshme për mekanizimin balancues të Energjisë Elektrike", me qëllim dhënien e një zgjidhje të pranueshme dhe transparente për të gjithë pjesëmarrësit e tregut në trajtimin e balancimit të sistemit Elektro-Energjistik Shqiptar dhe përgjegjësitë e tyre. Në vijim Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 214, Datë 28.12.2017 miratoi “Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike dhe Marrëveshjes së Pjesëmarrjes në Bursën Shqiptare të Energjisë”, që do të hyjnë në fuqi me bërjen të zbatueshëm të Modelit të Tregut, në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të Energjisë, siç parashikuar në pikën 8, të VKM-së Nr. 519, datë 13.07.2016.

Janë hedhur hapa konkrete për liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike për sa i përket krijimit të kushteve teknike dhe të kuadrit nënligjor e rregullator për daljen në treg të hapur edhe për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe akteve nënligjore përkatëse që ka mundësuar daljen e tyre në treg të lirë gjatë vitit 2020 dhe me tej, në mënyre që të mos jenë më pjesë e furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit. Ky proces do të vijojë në vitet në vijim me daljen në treg të lirë të klientëve të lidhur në tensionin 20 kV, 10 kV dhe 6 kV. Me qëllim garantimin e të drejtave si të furnizuesve, ashtu edhe të klientëve të energjisë elektrike, ERE ka plotësuar kuadrin ligjor rregullator me bazën e nevojshme për të grantuar operimin e sigurt, transparent dhe mbi baza jo diskriminuese të tregut. Për këtë qëllim janë miratuar një sërë aktesh nën ligjore ndër të cilat përmendim,

- (i) Marrëveshjen e Shërbimit të Shpërndarjes në mes të OSSH sh.a. dhe furnizuesve të energjisë elektrike,
- (ii) Rregullore për kriteret standarte të cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike,
- (iii) Rregullore mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë- shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të Energjisë Elektrike,
- (iv) Rregullore mbi Ndryshimin e Furnizuesit të Energjisë Elektrike,
- (v) Rregullore mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë,

(vi) Rregullorja mbi kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me Energji Elektrike për klientët fundorë.

Po ashtu ERE ka udhëzuar FSHU për të sensibilizuar klientët për daljen në treg të parregulluar nëpërmjet njoftimit të këtyre të fundit lidhur me detyrimet që dalin nga zbatimi i Ligjit të Sektorit si dhe pamundësisë së Furnizimit si mundësi e Fundit pas daljes në treg të parregulluar.

Aktualisht numri i klientëve për të cilat është bërë e mundur krijimi i kushteve teknike është mbi 90, gjithsesi në këtë drejtim pritet të bëhet më tepër në krijimin e kushteve teknike nga ana e OSSH sh.a. për liberalizimin e mëtejshëm të tij.

2.1 Rregullorja për përcaktimin e kushteve për Nominimin e Operatorit të Tregut të Energjisë elektrike (NEMO)

Bordit të ERE-s me vendimin e Nr. 40, datë 06.03.2020, miratoi “Rregulloren për kërkesat dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të energjisë elektrike (NEMO) dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO- s dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të energjisë në Tregun e Bashkuar”.

Sa më sipër, vlen të përmendim se, Bordi i Rregullatorëve të Komunitetit të Energjisë (ECRB) ka mbështetur masat rregullatore për implementimin e kushteve të Bashkimit të Tregjeve të ditës në avancë dhe të tregut brenda të njëjtës dite në palët kontraktore të Komunitetit të Energjisë.

Rregullorja për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongestionëve (capacity allocation and congestion management) (CACM) përcakton qartë se për të bërë të mundur funksionimin e Bashkimit të Tregjeve të ditës në avancë dhe të tregut brenda të njëjtës dite të sektorit të energjisë elektrike në vendet anëtare të Sekretariatit dhe Bashkimit Evropian, duhet të përcaktohen përgjegjësitë e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatorëve të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO).

ECRB ka sugjeruar se palët kontraktore të Komunitetit të Energjisë duhet të përshkruajnë përgjegjësitë e NEMO-s dhe OST në një akt rregullues, i cili në varësi të kornizës rregullatore të Palëve Kontraktuese mund të jetë në formën e një vendimi rregullues të veçantë, rekomandim ose të përfshirë në vendimin rregullator për miratimin e alokimit të nënkuptuar ose bashkimit e tregut.

Miratimi i këtyre akteve është një përgjigje fleksibile dhe e përshtatshme për angazhimet rregullatore nga Palët Kontraktuese dhe më saktësisht për autoritetet rregullatore kombëtare të WB6, angazhime të ndërmarra me nënshkrimin e memorandumit të WB6.

Me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 40, datë 06.03.2020, u miratua “Rregullorja për kërkesat dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të energjisë elektrike (NEMO) dhe rolet dhe përgjegjësitë e NEMO- s dhe Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të energjisë në Tregun e Bashkuar”.

2.2 Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike

2.2.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike

Në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, Neni 7, Neni 20, gërma ç), d), f) dhe g), Neni 22, Neni 58, pika 9, Neni 62, pika 4 si dhe Neni 72, gërma dh); Vendimi i Këshillit të

Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016, i ndryshuar “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, neni 13; si dhe kushtet e licencave të lëshuara nga ERE, shërbimet e operatorëve të licencuar nga ERE janë objekt i monitorimit në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore si dhe zbatimin e rregullave, vendimeve dhe urdhërave të ERE-s.

Në zbatim të sa më sipër, dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit të sektorit por edhe detyrimeve të përcaktuara në Vendimin Nr. 134/2019 të Kuvendit të Shqipërisë, “Mbi miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, ERE ka detyrimin të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me gjetjet gjatë ushtrimit të funksionit të vetë monitorues.

Në lidhje me sa më sipër, ERE, gjatë vitit 2020, me qëllim grumbullimin e të dhënave të cilat japin një pasqyrë të plotë të funksionimit dhe zhvillimeve të tregut të energjisë elektrike, ka ushtruar këtë detyrë në dy forma:

1. Nëpërmjet mbledhjes së të dhënave e marrjes së informacionit dhe të dhënave nëpërmjet raportimeve periodike nga të licensuarit dhe monitorimit në vijimësi duke kryer verifikimet e këtyre të dhënave të së njëjtës natyrë të marra nga burime të ndryshme raportimi.
2. Nëpërmjet monitorimeve specifike të kryera pranë të licencuarve me objekte specifike monitorimi.

Në lidhje me pikën e parë lartpërmendur, rezultatet dhe analizat janë paraqitur në Pjesën I-rë “Gjendja Sektorit dhe Tregut të Energjisë Elektrike” të këtij raporti, duke dhënë edhe mundësinë e krahasimit me vitet paraardhëse si dhe në mënyrë krahasuese me ecurinë e të dhënave, për të cilat janë vendosur targete në Kapitullin VI “Plani i zbatimit” të VKM-së Nr. 253, datë 24.4.2020 “Mbi miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik.

Në mënyrë që të sigurohen raportime sa më korrekte dhe në kohë nga të licensuarit dhe pjesmarrësit e tregut të energjisë elektrike me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 203, datë 12.12.2020, miratoi “Rregullat për monitorimin e tregut të energjisë elektrike”.

ERE në bashkëpunim me donatorë të sektorit është duke parë mundësinë e zhvillimit të një platforme elektronike e cila do ti mundësojë pjesmarrësit në tregun e energjisë për të plotësuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Direktivat dhe Rregulloret e KE-së si dhe Ligjet 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, njëkohësisht do ti shërbejë të gjithë të interesuarve për marrjen e informacioneve dhe të dhënave të nevojshme në një kohë sa më të shpejtë.

Nga analizimi i rezultateve dhe përpunimi i problematikave e informacioneve të marra, nga ERE, është gjykuar sipas rastit të zhvillohen verifikime, analiza, seanca dëgjimore dhe monitorime në terren.

Githashtu është analizuar situata e raportimeve periodike të të licencuarve ku konstatohen mangësi nga ana e tyre në respektimin e detyrimit për raportim periodik, lidhur me sa konstatuar ERE ka vijuar me korespondencat përkatëse në kuadër të përmirësimit të këtyre praktikave dhe përmirësimit të mangësive

Përfaqësues të ERE-s janë anëtarë të grupeve të punës së organizmave ndërkombëtare me të cilat ERE ka vendosur tashmë marrëdhënie bashkëpunimi.

Në këtë kuadër ERE dërgon informacionet e kërkuara nga këto institucionet e organizatat e ndryshme bashkëpunuese me ERE-n, si dhe merr pjesë në takime, që janë në objektin e punës së ERE.

Në mënyrë që të rritet transparenca në tregun e energjisë elektrike, me Vendimin e ERE-s Nr. 118, datë 27.07.2017, u miratuan “Rregullat për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë

elektrike”. Të dhënat kryesore katërmujore për funksionimin e tregut të energjisë elektrike publikohen rregullisht në faqen e internetit të ERE-s, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndyshuar. Për të siguruar zbatimin e parashikimeve ligjore dhe nënligjore të detyrimeve që lidhen me transparencën në tregun e energjisë, ERE ka monitoruar periodikisht faqet e internetit të operatorëve kryesorë në tregun e energjisë. Rezulton se për vitin 2020 këto detyrime zbatohen kryesisht nga operatorët në kuadër të rritjes së transparencës, dhe për çdo rast nga ana e ERE-s janë bërë shkresa, për ku i kërkohet operatorëve përmirësimi i këtij procesi duke i evidentuar detyrimet përkatëse. Nga ana e operatorëve, është vërejtuar shtimi i informacionit që publikohet në kuadër të transparencës, kryesisht OSTsh.a, në faqen e saj të internetit dhe nëpërmjet platformës së transparencës së ENTSO-e. Gjithësesi, përmirësimi të këtij procesi duhet të vijojnë, dhe do të jenë objekt i punës së ERE-s në vijimësi.

Disa ndër monitorimet specifike për të licencuarit dhe pjesëmarrësit e tregut paraqiten shkurtimisht si vijon :

2.2.2 Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OST sh.a.

I. Alokimi i kapaciteteve në interkonjeksione

Në tabelën e mëposhtme paraqiten alokimet e kapaciteteve të interkonjeksionit sipas kufijve.

Tabela me të dhënat e Alokimit të ATC 2020																			
Ankandi	Periudha	Shqipëri - Mali Zi						Shqipëri - Greqi						Shqipëri - Kosove					
		Ankand		Ankand		Cmimi Ankandit		Ankand		Ankand		Cmimi Ankandit		Ankand		Ankand		Cmimi Ankandit	
		Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import
		[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]
Janar	01.01.2020-31.01.2020	250	250	250	250	0.07	1.11	100	100	99	100	4.87	0.34	125	125	125	125	0.12	0.48
Shkurt	01.02.2020-29.02.2020	200	250	199	250	0.06	1.86	125	125	125	125	2.67	0.61	125	125	125	125	0.31	1.49
Mars	01.03.2020-15.03.2020	100	100	99	100	0.12	3.16							125		125			1.33
	16.03.2020-20.03.2021	0	0	0	0			100	100	100	99	3.52	0.09	125	50	125	50	0.1	2.94
	21.03.2020-15.03.2022	100	100	99	100	0.12	3.16							125		125			1.24
Prill	01.04.2020-03.04.2020	0	0	0	0	0	0							105	105	105	105	0.16	0.15
	04.04.2020-13.04.2020							100	100	100	100	5.91	0.06						
	14.04.2020-30.04.2020	100	100	100	100	0.24	2.38							105	105	105	105	3.51	4.55
Maj	01.05.2020-31.05.2020							50		50		3.06							
	01.05.2020-15.05.2020							50		50		2.35		105	105	105	105	0.1	4.3
	16.05.2020-24.05.2020	100	100	100	100	0.28	4.3		100		100		0.12						
	25.05.2020-29.05.2020							0		0		2.35		105	105	105	105	0.1	2.2
	30.05.2020-31.05.2020							50		50		2.35							
Qershor	01.06.2020-14.06.2020							100	100	100	100	2.09	0.32	105	75	105	75	0.03	2.55
	15.06.2020-29.06.2020	100	100	100	100	0.15	1.91		0	0	0	0	0	105	75	105	75	0.12	3.39
	30.06.2020-30.06.2020							100	100	100	100	2.09	0.32						
Korrik	01.07.2020-31.07.2020	100	100	100	100	0.05	1.97	150	150	150	150	1.42	0.15	105	105	105	105	0.11	2.05
Gusht	01.08.2020-31.08.2020							100	100	100	100	1.89	0.18						
	01.08.2020-14.08.2021	100	100	100	100	0.08	1.89		50	50	50	1.32	0.10	105	105	105	105	0.17	1.69
	15.08.2020-17.08.2022							0	0	0	0	1.32	0.10						
	18.08.2020-31.08.2023							50	50	50	50	1.32	0.10						
Shtator	01.09.2020-07.09.2020													105	105	105	105	0.19	2.77
	08.09.2020-09.09.2020		100		100		2.56							-	-	-	-	-	-
	10.09.2020-14.09.2020	100		100		0.08		150	150	150	150	1.01	0.05						
	15.09.2020		0		0		-							105	105	105	105	0.19	2.77
	16.09.2020-30.09.2020		100		100		2.56												
Tetor	01.10.2020-31.10.2020	100	100	100	100	0.06	4.56	150	150	150	150	1.08	0.19	125	125	125	125	0.07	3.17
Nëntor	01.11.2020-30.11.2020	150	150	150	150	0.06	2.73	150	150	150	150	2.01	0.18	125	125	125	125	0.51	2.22
Dhjetor	01.12.2020-31.12.2020	100	100	100	100	0.12	4.88	150	150	150	150	1.13	0.43	100	200	100	200	0.05	0.11

Figura 64 Të dhëna mbi Ankandet e Alokimit të Kapaciteteve në Sistemin e Transmetimit gjatë vitit 2020.

Sikurse shihet, në shumicën e rasteve ka patur konxhestion në alokimin e kapaciteteve në të dy krahët import/eksport.

Për alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione, gjatë vitit 2020 janë ndjekur procedurat sipas rregullave të miratuara nga ERE me Vendimin Nr. 140, datë 22.11.2013, të ndryshuar “Rregullorja mbi alokimin e kapacitetit në interkonjeksione” për kufirin Shqipëri - Kosovë dhe “Rregullores të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO)” versioni 1.4, miratuar me Vendimin Nr. 167, datë 18.10.2016, për kufinj të Shqipëri-Mal i Zi dhe Shqipëri-Greqi. Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 197, datë 26.11.2020, miratoi “Rregullat e harmonizuara të alokimit të SEE CAO, për kufijtë Shqipëri-Greqi, Shqipëri-Mal i Zi dhe Shqipëri-Kosovë” gjë që bën që tashmë në gjithë pikat kufitare me Shqipërinë, për sa i përket ankandeve të kapaciteteve të transmetimit, të aplikohen rregullat e harmonizuara të SEE CAO.

- Ankandet e kapaciteteve në interkonjeksion janë zhvilluar në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara, në rregulloret apo vendimet përkatëse të ERE-s.
- Vlen të theksojmë se nuk ka patur asnjë ankimim të Pjesëmarrësve të Tregut, pjesëmarrës në ankand, për afatet, procedurat, procesin e zhvillimit të ankandit, procesin e vlerësimit të ofertave, përcaktimit të fituesve dhe çmimeve të ankandit, komunikimit dhe publikimit të njoftimit të ankandit dhe rezultateve të tyre.
- Implementimi i Tregut të energjisë është edhe një proces bashkëpunimi dhe i vlerësimit të ndërsjelltë ndërmjet OT dhe Pjesëmarrësve të Tregut, sipas rolit përkatës të tyre në tregun e energjisë.

II. Disbalancat

Në zbatim të Rregullave të Përkohshme të Tregut dhe Rregullave të Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike (Rregullat për Mekanizmin Balancues) për sa i përket trajtimit të çështjes së tregut balancues, mbi bazën e të dhënave orare të marra nga sistemi i matjes që zotëron OST sh.a. ka bërë llogaritjet e disbalancave për secilin pjesëmarrës tregu të cilët janë përgjegjës për disbalancat që shkaktojnë, në bazë orare.

Në vijim Bordi i ERE-s, me Vendimin Nr. 106, datë, 02.07.2020, miratoi “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, të cilat gjatë vitit 2020 u zbatuan pa efekte financiare nga pjestarët e tregut të energjisë elektrike. Këto rregulla vendosin parime të qarta të një tregu konkurrues dhe dinamik për sa i përket balancimit të energjisë elektrike.

Disbalancat e pjesëmarrësve të tregut gjatë vitit 2020 janë llogaritur dhe faturuar në bazë mujore.

Operimi i tregut është objekt i monitorimit të vazhdueshëm të ERE-s.

Në tabelën në vijim paraqiten disbalancat për vitin 2020 për palët përgjegjëse balancuese.

Pale Përgjegjëse Balancuese	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTALI 2020													
	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]	Dis. Negative [MWh]	Dis. Pozitive [MWh]												
KURUM	996	552	625	1,205	781	829	1,204	277	1,888	499	1,730	749	1,444	546	1,247	1,323	945	1,054	1,708	980	1,749	708	1,257	911	15,574	9,633
DEVOLL HP	36	16	9	7	182	692	22	95	70	137	62	65	68	34	47	74	158	60	75	97	152	104	75	72	956	1,453
ENERGIA GAS & POWER	427	2	483		514	0	517	0	569	-	746	-	1,074	-	621	20	395	11	1,052	126	1,261	227	1,369	125	9,026	510
AYEN AS ENERGJI	98	117	26	116	33	118	61	31	55	105	134	24	67	24	66	43	49	92	75	217	132	69	115	87	911	1,044
GSA	458	1,389	297	480	630	909	204	942	721	1,240	477	987	1,360	581	933	1,130	2,244	553	1,583	576	1,545	1,890	1,941	345	12,394	11,822
GEN-I	316	93	282	218	323	355	361	97	536	268	776	240	520	62	929	516	779	109							4,823	1,958
AES	488	283	641	96	1,370	147	674	190	1,200	101	1,260	113	1,626	77	1,747	124	1,400	83	1,883	87	1,175	79	1,019	198	14,482	1,577
ASHTA	760	836	233	717	1,014	1,056	1,046	1,285	802	1,013	523	841	650	663	572	456	695	887	933	765	596	743	1,592	1,348	9,417	10,612
FTL (OSHEE Grup)	3,278	23,605	7,905	16,209	5,633	28,847	7,229	14,410	5,541	10,483	4,628	7,355	2,992	10,964	2,424	12,833	3,132	12,793	5,789	24,205	3,189	13,126	3,891	33,846	55,630	208,777
#REF!	-	75																							-	75
KESH (Pale Përgjegjëse Balancuese)	58	15	12	73	7	120	-	250	1	198	1	121	0	138	0	140	3	150	1	111	3	88	5	106	91	1,510
EZ-5 ENERGY (KASTRATI ENERGY)	235	64	169	62	285	101	388	111	441	99	402	98	387	150	303	91	224	135	503	23	372	42	351	41	4,062	1,018
DANSKE COMMODITIES ALBANIA shpk																					2		119		121	-
BYLLIS Tec Balish (Pa kontrate Furnizimi)	78	-	72	-	74	-	67		61	-	56	-	56		56		58		67		70		71		785	-
NOA								22	20																22	20
AXPO ALBANIA sha																							1		1	-
ENER TRADE sh.p.k.											27											60	52		139	-
OST - HUMBJET ne Transmetim	1,567	675	4,160	679	2,844	3,907	2,104	680	665	1,461	825	803	1,551	765	1,414	677	595	1,120	7,699	2	1,112	1,067	4,249	453	28,783	12,588
Ofruesi i Sherbimit te Balancimit	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]	Ujje Gjenerimi [MWh]	Retje Gjenerimi [MWh]
KESH	14,696	3,592	3,147	5,271	18,050	4,746	12,457	8,628	9,883	6,363	6,414	6,782	7,733	5,661	10,636	3,207	10,601	5,018	20,256	6,214	12,450	4,463	25,482	8,072	151,905	68,017
TOTALI	23,492	31,313	18,061	25,133	31,740	41,828	26,333	26,997	22,455	21,988	18,060	18,178	19,529	19,665	20,997	20,635	21,277	22,065	41,723	33,502	23,866	22,606	41,588	45,604	309,122	329,514
Disbalancat mujore [MWh]	7,821		7,071	10,087	664		(468)		118		136		(362)		789		(8,221)		(1,260)		4,016				20,392	

Figura 65 Disbalancat totale për vitin 2020 (MWh), Burimi OST sh.a.

2.2.3 Monitorime të tjera të lidhura me veprimtarinë e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike

- **Monitorimi periodik i treguesve dhe të dhënave kryesore të Sektorit të Energjisë Elektrike për vitin 2020.**

Të dhënat kryesore të sektorit të energjisë elektrike për vitin 2020, jepen në tabelën e mëposhtme në kolonën “Fakt”, të krahasuara me kolonën “Target”, ku pasqyrohen vlerat e vendosura si target në Kapitullin VI “Plani i zbatimit” të VKM-së Nr. 253, datë 24.4.2019 “Mbi miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik”.

Krahasim target-fakt i disa prej të dhënave të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar për vitin 2020 (GWh)		
	Target	Fakt
Humbjet në shpërndarje (import nga OSHEE)	1 241	1 458
Humbjet në transmetim (OST)	162	172
Klientë te kualifikuar Industri (të lidhur në OST)	782	811
Familjare	2 910	2 957
Kërkesa totale e energjisë	7 150	7 589
Gjenerimi Neto nga KESH	3 950	3 090
Koncesionare dhe PPE	1 935	2 223
Gjenerim Neto i Brendshem	5 888	5 313
Humbje totale në shpërndarje (%)	20	21.48
Mbledhja e të ardhurave (%)	95	95.8

2.2.4 Transaksionet e kryera nga KESH sh.a, OST sh.a. dhe FTL sh.a. në Treg të hapur (parregulluar) gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, ERE ka monitoruar përmes raportimit periodik blerjet e energjisë elektrike në treg të hapur nga shoqëritë e rregulluara FTL sh.a. dhe OST sh.a., ku rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë në treg të hapur nga këto dy shoqëri të ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik është rreth 54.98 EUR/MWh.

OSSH sh.a. ka blerë në treg të parregulluar me qëllim sigurimin e furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga VKM 244/2016, dhe sipas Rregullave të përkohshme të tregut si dhe Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr, 103/2016, i ndryshuar.

KESH sh.a. gjatë vitit 2020 ka shitur/blerë energji elektrike në treg të parregulluar kryesisht për optimizim, në zbatim të “Rregullores së Tregtimit të Energjisë Elektrike nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare KESH sh.a.” miratuar me Vendimin Nr. 2762/8, datë 06.06.2019, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e pronarit të KESH sh.a. dhe “Rregullave të përgjithshme të organizimit të aktivitetit tregtar nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.” të miratuar me Vendimin Nr.5233/1, datë 12.06.2020, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerit.

OST sh.a. ka blerë në treg të parregulluar me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit në zbatim të detyrimeve që burojnë nga VKM Nr. 244/2016, dhe sipas Rregullave të përkohshme të tregut si dhe Rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr, 103/2016, i ndryshuar.

Më poshtë po paraqesim një tabelë me të dhëna të transaksioneve të kryera gjatë vitit 2020:

(MWh)	Transaksionet e KESH ne treg te hapur gjate vitit 2020												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total 2020
Transaksionet hyrese nga interkoneksion	0	-796	-690	-4,870	-6,288	-8,574	-7,182	-1,200	-914	0	-372	-4,712	-35,598
Transaksionet dalese nga interkoneksion	0	0	0	0	1,900	1,150	0	3,455	20,154	0	2,740	12,255	41,654
Transaksione ne tregun e brendeshem	12,960	0	0	0	1,106	-5,424	-4,836	17,424	0	0	-2,002	5,320	24,548
(MWh)	Transaksionet e FTL (OSHEE Group sha) ne treg te hapur gjate vitit 2020												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total 2020
Blerje ne treg te hapur	279,480	220,908	164,254	159,840	153,658	84,960	74,400	137,640	234,880	53,760	241,620	364,480	2,169,880
(MWh)	Transaksionet e OST ne treg te hapur gjate vitit 2020												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total 2020
Blerje ne treg te hapur per mbulimin e humbjeve ne transmetim	16,740	12,910	5,820	12,108	12,961	11,874	12,963	13,362	11,150	7,979	12,541	12,722	143,130

Figura 66 Transaksionet e kryera gjatë vitit 2020 nga KESH sh.a. ; FTL sh.a. (OSHEE Group sha) dhe OST sh.a.

Në grafikun e Figurës më poshtë është paraqitur balanca (hyrje – dalje) import-eksport e energjisë elektrike për periudhën 2009 – 2020.

Për 10-vjeçarin e fundit, me përjashtim të vitit 2010, 2016 (vlera të vogla) dhe ne 2020 vendi ynë rezulton të jetë një importues neto i energjisë elektrike. Sqarojmë se vlerat e paraqitura përfaqësojnë të gjitha flukset hyrëse e dalëse nga të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.




Figura 67 Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite (Burimi: OST sh.a.).

Regjistri i Pjesëmarrësve të regjistruar në tregun e energjisë elektrike gjatë vitit 2020.

Regjistri Pjesmarresve te Tregut (viti 2020)		PRODHUES	P	
		TREGTUES	T	
		FURNIZUES	F	
		FURNIZUES I SHËRBIMIT UNIVERSAL	FSHU	
		SHPERNDARJE	SH	
Nr	Emri i Subjektit	EIC Code	data e regjistrimit	Roli ne TEE
1	Albanian Energy Supplier	54X-AEG-02-1603G	26.05.2015	T; F
2	AXPO Albania	23X--150330-AA-K	28.1.2020	T; F
3	Ayen AS Energji	23X--150416-A—N	17.12.2014	P; T; F
4	Ayen Energy Trading	23X--140426-AY-W	04.05.2014	T; F
5	Danske Commodities Albania	23X--121120DCALG	30.10.2012	T; F
6	Devoll Hydropower	23X--150409-DHP5	11.06.2015	T; F
7	Energija doo Veternik	54X-EDOOV-15-020	15.12.2015	T; F
8	Energji Ashta	54X-HECASHTA-059	25.05.2012	P
9	Energy Supply-AL	34X-0000000017-C	15.05.2013	T; F
10	Erdat Lura	54X-HEC-LURA-069	17.09.2013	P
11	GEN-I Tirana	23X---120709GEN0	31.01.2011	T; F
12	Gjo-Spa Power	54X-HEC-LAPAJ075	17.09.2013	P
13	Green Energy Trading Albania	23X--150702GE--3	01.07.2015	T
14	Grupi Sistemeve Automatike	22XGSA-----N	09.05.2011	T; F
15	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	23X--130918APC-M	25.04.2011	P; T
16	KURUM International	23X--131115KI--1	17.12.2013	P; T; F
17	NOA Energy Trade	23X--150630-NE-6	10.03.2015	T; F
18	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes - OSSH sh.a.	54X-101010IOSS0U	19.02.2020	SH
19	Stravaj Energy	54X-STRAVAJ-E086	25.04.2014	P; T
20	WENERG	54X-WENERG---10E	10.06.2015	P
21	YLLIAD	29XYLLIAD-AL---W	03.03.2011	T
22	Energy Market Albania	54X-ENMARKETAL99	23.03.2017	T
23	Grid Energy	54X-GRID-ENERGYR	05.04.2017	T; F
24	Energy Financing Team Tirana	54X-EFT-TIRANA-V	24.08.2017	T; F
25	Alpiq Energy Albania	23X--141204AEA-T	29.04.2011	T; F
26	URADRIN	54X-100ID101218J	10.08.2018	T
27	Energia Gas and Power Albania shpk	23x-150309-LT-Y	22.10.2018	T; F
28	RENRGY Trading Group	54X-10IRN102618R	12.11.2018	T,F
29	Ener Trade shpk	54X-10 IET091118	21.12.2018	T; F
30	Power and Gas Operations	54X-10IPG2307196	23.07.2019	T
31	ENSCO Trading (Albania) sh.p.k	54X-110IESA1019G	02.12.2019	T
32	KESH sh.a	23X--130918APC-M	16.12.2019	F
33	Furnizuesi i Tregut të Lirë - FTL sh.a.	54X-1010IFT0220P	19.02.2020	T; F
34	Furnizuesi i Shërbimit Universal - FSHU sh.a.	54X-0101IFSH022Q	19.02.2020	F
35	EZ-5 Energy shpk	54X-11LKE250319U	25.03.2019	T;F

Figura 68 Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2020. Burimi OST sh.a.

- ❖ Në lidhje me specifikën e dytë të monitorimeve që lidhen me këto të fundit në terren thënë ndryshe pranë subjekteve të licencuara dhe pjesëmarrësve të tregut të energjisë sqarojmë se, Entit Rregullator i Energjisë, në fillim të vitit 2020, nisi monitorimin në objekte pranë tyre, me qëllim verifikimin dhe konsolidimin e të dhënave për përfundimin e raportit vjetor 2019 të ERE-s, si dhe konstatimin e ecurisë së punës së këtyre të fundit, por në vijim, duke parë se për disa praktika ishte e nevojshme marrja e informacioneve dhe të dhënave apo konstatimeve pranë të licensuarve, realizimi i takimeve me përfaqësues të licensuarve, për të mundësuar trajtimin e të dhënave të marra, monitorimet në terren për të evidentuar problematikat e hasura nga monitorimi, detyra të cilat në disa raste vështirësohen apo dhe mund të ishin të pamundura, për shkak të situatës, masave të distancimit social dhe ndalimit të zhvillimit të mblledhjeve fizike apo aktiviteteve me shumë punonjës, për shkak të situatës së shpallur të fatkeqësisë natyrore, si pasojë e pandemisë globale COVID-19, këto praktika mbeten në proces deri në normalizimin e kësaj situate, sipas udhëzimeve dhe vendimmarrjeve përkatëse.
- ❖ Evidentojmë se ERE, në zbatim të parashikimeve të pikës 5, gërma a) të Vendimit Nr. 134/2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, ka përgatitur dhe dërguar në Kuvendin e Shqipërisë raporte dhe informacione 6 mujore për gjetjet nga monitorimi.

3. LICENCIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË TË LICENCUARËVE NË SEKTORIN E ENERJISË

3.1 Licencimet dhe Kërkesat e Trajtuara gjatë vitit 2020.

Gjatë vitit 2020, ERE ka kryer një veprimtari të gjerë për licencimin e subjekteve në veprimtaritë/aktivitetet e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi.

Për të gjitha aplikimet e paraqitura, është respektuar transparenca e parashikuar në procedurat për licencim, në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror“. Në përputhje me kuadrin ligjor të mësipërm janë zbatuar afatet e publikimit në median e shkruar për marrjen e opinionit nga të interesuarit. Gjithashtu çdo aplikim për licencim i është nënshtruar një analize të kujdesëshme të rregullshmërisë dhe plotësimit me korrektësi të dokumentacionit ligjor, administrativ, financiar, teknik dhe marrjes së lejeve përkatëse të përdorimit të ujrave apo leje mjedisore, të dhëna nga institucionet e tjera në përputhje me veprimtarinë që subjektet kanë kërkuar të licencohen. Ndjekje e korespondencave, sipas çështjeve në trajtim. Gjithashtu ERE ka vijuar me ndjekjen e zbatimit të kushteve dhe rishikimit të vendimeve respektive të licensimit, trajtim të çështjeve që kanë lidhje me problematika të ndryshme të subjekteve të licencuar.

Subjektet e licencuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2020:

Nr.	SUBJEKTI	PRODHUES ENERGIJE ELEKTRIKE	KAPACITETI I INSTALUAR	VENDIMI I ERE-s
1.	“DIEZELA” sh.p.k	H/C Ljusa	1980 kW	Nr. 16, Datë 23.01.2020
2.	“KROI MBRET ENERGIJ” sh.p.k	H/C Backa 1 H/C Backa 2 H/C Backa A H/C Backa B H/C Backa C	1600 kW 4000 kW 500 kW 500 kW 720 kW	Nr. 41, date 06.03.2020
3.	“ELECTRAL BATRA HPP” sh.p.k	H/C Selita H/C Frankthi	1798 kW 2129 kW	Nr. 42, Date 06.03.2020
4.	“ERA HYDRO” sh.p.k	H/C “Strori”	2000 kW	Nr. 62, date 08.04.2020
5.	“GEGA – G ”sh.p.k	H/C “Prevall”	1750 kW	Nr. 63, date 08.04.2020
6.	“KALISI HYDROPOWER” sh.p.k	H/C “Veleshica 1” H/C “Veleshica 2”	5810 kW 8116 kW	Nr. 71, date 22.04.2020
7.	"Statkraft Renewables Albania" sh.a	Central Fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e HEC Banja	2000 kW	Nr. 212, date 17.07.2020
8.	“SEKA HYDROPOWER” sh.p.	H/C “Seke” H/C “Zais”	12667 kW 2265 kW	Nr. 146, date 10.09.2020
9.	“MATEO & CO” sh.p.k	H/C Muras	2000 kW	Nr. 155, date 07.10.2020
10.	“TIRANA ENERGIJ” sh.p.k	H/C “Mali”	1490 kW	Nr. 175, date 04.11.2020

11.	“KOKA & ERGI ENERGY STAVEC” sh.p.k	H/C Stavec	6520 kW	Nr. 176, date 04.11.2020
12.	“IDI 2005” sh.p.k	H/C “Kamican”	1860 kW	Nr, 188, date 16.11.2020
13.	“ERDY ENERGY” sh.p.k	H/C Kalis	2138 kW	Nr. 240, date 21.12.2020
14.	“HEC ZALL XHUXHE” sh.p.k	H/C Zall Xhuxhe 1” H/C “Zall Xhuxhe 2”	3487 kW 1254 kW	Nr. 241, date 21.12.2020

Gjatë vitit 2020, nga Bordi i ERE-s janë miratuar modifikimet e licencave si më poshtë:

- Me vendimin Nr. 34, datë 21.02.2020, është miratuar modifikimi i licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “HEC BISHNICA 1,2” sh.p.k., me numër. 95, Seria PV10K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE Nr. 23, datë 23.03.2010, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Bishnica” me kapacitet 2.5 MW me dy njësi gjeneruese, duke miratuar shtimin e një njësie gjeneruese, pa ndryshuar kapacitetin e instaluar si më poshte:
Numri i njësive gjeneruese: Ishte: 2 (njësi), me kapacitet të instaluar 2,5 MW.
Bëhet: 3 (njësi), me kapacitet të instaluar 2,5 MW.
- Me vendimin Nr. 87, datë 19.05.2020, u vendos për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës Nr. 402, Seria P18, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 83, datë 06.04.2018, “Për licencimin e shoqërisë “FAVINA 1” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Voskopojë” me kapacitet të instaluar 1970 kW”, por në vijim kjo procedure u përmbyll pa kryerjen e modifikimit pasi shoqëria “FAVINA 1” shpk depozitoi në ERE “*Njoftim për anulimin e kërkesës për modifikimin e licencës së prodhimit...*”, për shkak të pamundesise financiare të krijuar nga Pandemia COVID-19, për të investuar shtesën e kapacitetit të instaluar të HEC “Voskopojë” nga 1970 kW në 2400 kW.
- Një risi në fushën e prodhuesve të energjisë elektrike për këtë vit ka qenë edhe miratimi për herë të parë nga ERE me vendimin Nr. 132, datë 10.08.2020, i kualifikimit dhe pajisjes me Certifikatë të Garancisë së Originës të impiantit të prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a. Ky miratim erdhi në vijim të kërkesës së shoqërisë, bazuar në Ligji Nr. 7/2017, “*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*”; dhe të “*Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme*”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 229, datë 20.12.2019.

Gjatë këtij viti ERE ka adresuar kërkesat nga disa të licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për lënien peng të aseteve pranë bankave për financimin e ndërtimit të HEC-eve. Në vijim të këtyre shqyrtimeve Bordi i ERE në mbështetje të Nenit 16, Nenit 20 gërma b, Nenit 44, pika “1”, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, pikat 1.3 dhe 1.6 të “Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 99, datë 17.06.2016, si dhe në zbatim të Nenit 6; Nenit 7 dhe Nenit 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 119, datë 21.07.2016, ka marrë vendimet si më poshtë:

- Vendimin nr. 25, datë 10.2020, “Mbi kërkesën e shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme të ardhshme apo të tashme dhe vendosjen e hipotekës mbi asetet e paluajtshme që do ti përkasin HEC–ve “German 1” dhe “German 2”, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për efekt të dhënies së kredisë për financimin e ndërtimit të veprave hidroenergjitike “German 1” dhe “German 2”. (Miratimi i kërkesës së shoqërisë “SA’GA - MAT” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të luajtshme të ardhshme apo të tashme dhe vendosjen e hipotekës mbi asetet e paluajtshme që do ti përkasin HEC–ve “German 1” dhe “German 2”, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a., për efekt të dhënies së kredisë për financimin e ndërtimit të veprave hidroenergjitike “German 1” dhe “German 2”).
- Vendimi Nr. 153, datë 18.09.2020, “Mbi kërkesën e shoqërisë M.T.C ENERGY sh.p.k. për barrësimin dhe hipotekimin e aseteve të shoqërisë “M.T.C ENERGY” sh.p.k. në HEC Radovë, në favor të Alpha Bank, në zbatim të kontratës së huasë me Alpha Bank sh.a. Nr. 125 rep, Nr. 32 kol, datë 09.01.2020”. (miratimin e kërkesës së shoqërisë “M.T.C ENERGY” sh.p.k., për barrësimin dhe hipotekimin e aseteve fikse dhe që i shërbejnë aktivitetit të licencuar të shoqërisë “M.T.C Energy” sh.p.k. në HEC Radovë, në favor të Alpha Bank, në zbatim të Kontratës së huasë me Alpha Bank sh.a. Nr. 125 Rep, Nr. 32 Kol, datë 09.01.2020” (bashkëlidhur lista e aseteve).
- Vendimi Nr. 239 , Datë 21.12.2020 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “WENERG” sh.a., për barrësim të aseteve (makineri dhe pajisje) në favor të “OTP Albania” sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të HEC-it “Dardha 1”. (miratimin e kërkesës së shoqërisë “Wenerg” sh.a., për barrësim të aseteve (bashkëlidhur lista e aseteve si makineri, pajisje etj.) në favor të “OTP Albania” sh.a., për efekt të ristrukturimit të kredisë për fondet e përdorura me qëllim financimin e ndërtimit të HEC-it “Dardha 1”).

Të licencuarit në veprimtarinë e Tregëtimit të Energjisë Elektrike gjatë 2020:

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI I LICENSUAR	DATA E VENDIMIT TË BORDIT
------------	-----------------	-------------------------------	----------------------------------

1	“GEGA - G” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 64, datë 08.04.2020
2.	“PowerComm” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 92, datë 02.06.2020
3.	“TIRANA ENERGI” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 174, datë 04.11.2020
4.	“HEC ZALL XHUXHE” sh.p.k	Tregtim	Vendimi Nr. 242, datë 21.12.2020

Figura 70 Subjektet e licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për vitin 2020.

Gjatë vitit 2020 janë paraqitur në ERE kërkesat për rinovimin e licencave të veprimtarive të tregtimit të energjisë elektrike nga shoqëritë e licencuara në këtë veprimtari për shkak të përfundimit të afatit 5 (pesë) vjeçar dhe janë miratuar rinovimet si më poshtë:

- Rinovimi i licencës së shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., nr. 276, Seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 37, datë 18.03.2015, për një afat 5-vjeçar. (Vendimi nr.45, datë 18.03.2020, i Bordit të ERE-s).
- Rinovimi i licencës së shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., nr. 277, Seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 38, datë 18.03.2015, për një afat 5-vjeçar. (Vendimi nr. 46, datë 18.03.2020 i Bordit të ERE-s).
- Rinovimi i licencës së shoqërisë “Green Energy Trading Albania” sh.p.k., nr. 286, Seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë ekektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 59, datë 23.04.2015, për një afat 5–vjeçar. (Vendimi nr. 72, datë 22.04.2020, i Bordit të ERE-s).
- Rinovimi i licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k, nr. 291, Seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 73, datë 13.05.2015, për një afat 5-vjeçar. (Vendimi nr.80, datë 04.05.2020 i Bordit të ERE-s).
- Rinovimi i licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k, nr. 290, Seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 72, datë 13.05.2015, për një afat 5-vjeçar. (Vendimi nr. 81, datë 04.05.2020, i Bordit të ERE-s).
- Rinovimi i licencës së shoqërisë “YLLIAD” sh.p.k, nr. 9, Seria T15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 97, datë 28.07.2015, për një afat 5-vjeçar. (Vendimi nr. 157, datë 07.10.2020, i Bordit të ERE-s).
- Rinovimi i licencës së shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k., nr. 306, Seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 105, datë 18.08.2015, për një afat 5-vjeçar. (Vendimi nr. 173, datë 04.11.2020, i Bordit të ERE-s).
- Rinovimi i licencës së shoqërisë “GSA” sh.p.k., me nr. 321, Seria T11/15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike , të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 57, datë 22.06.2011 dhe rinovuar me vendimin nr. 160, datë 28.12.2015, për një afat 5-vjeçar. (Vendimi nr. 201, datë 02.12.2020).

- Rinovimi i licencës së shoqërisë “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k., nr. 322, Seria F15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-, nr. 159, datë 28.12.2015, për një afat 5-vjeçar. (Vendimi nr. 209, datë 11.12.2020).

Subjektet e licensuar në aktivitetin e Furnizimit të energjisë elektrike, gjatë vitit 2020 :

Për vitin 2020 nuk ka patur licencime të reja në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike, por edhe në këtë veprimtari ajo që ka spikatur ka qenë paraqitja e kërkesave për rinovimin e licencave të cilave u përfundonte afati dhe nga ana e ERE-s janë riovuar licencat si më poshtë:

- Rinovimi i licencës së shoqërisë “Albanian Energy Supplier” sh.p.k., nr. 277, Seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 38, datë 18.03.2015, për një afat 5-vjeçar. (Vendimi nr. 46, datë 18.03.2020).
- Rinovimi i licencës së shoqërisë “Alpiq Energy Albania” sh.p.k, nr. 291, Seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 73, datë 13.05.2015”, për një afat 5-vjeçar. (Vendimi nr.80, datë 04.05.2020).
- Rinovimi i licencës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., nr. 306, Seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 105, datë 18.08.2015”, për një afat 5 – vjeçar. (Vendimi nr. 173, datë 04.11.2020).
- Rinovimi i licencës së shoqërisë “Energia Gas And Power Albania” sh.p.k., nr. 322, Seria F15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 159, datë 28.12.2015, për një afat 5 – vjeçar. (Vendimi nr. 209, datë 11.12.2020).

Rinovimi i Licensave në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike			
Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	DATA E VENDIMIT TË BORDIT
1.	Albanian Energy Supplier” sh.p.k.,	Furnizim EE	Vendimi Nr. 46, datë 18.03.2020
2.	“Lengarica & Energy” sh.p.k.,	Furnizim EE	Vendimi nr. 173, datë 04.11.2020
3.	“Energia Gas And Power Albania” sh.p.k.,	Furnizim EE	Vendimi nr. 209, datë 11.12.2020
4.	“Alpiq Energy Albania” sh.p.k	Furnizim EE	Vendimi Nr. 80, datë 04.05.2020

Figura 71 Subjektet e licensuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për vitin 2020.

Aktiviteti i licensimit për subjektet me veprimtari në sektorin e Gazit natyror për vitin 2020

- Fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror. (vendimi i Bordit të ERE-s nr. 13, datë 23.01.2020)
- Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. për shtyrje të afatit të përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror të shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. (me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 08.04.2020, u vendos shtyrja me 90 ditë kalenderikë e afatit të procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, për shkak se shoqëria nuk mundi të plotesonte dokumentacionin e munguar të aplikimit si rezultat i situatës së veshtirë të krijuar nga Pandemia COVID 19).
- Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. për shtyrje të afatit të përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror të shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. (me vendimin nr. 65, datë 08.04.2020, u vendos shtyrja me 90 dite kalenderike e afatit të procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, për shkak se shoqëria nuk mundi të plotesonte dokumentacionin e munguar të aplikimit si rezultat i situatës së veshtirë të krijuar nga Pandemia COVID 19).

“Mbi zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBPETROL” sh.a. për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror. (me vendimin nr. 120, datë 17.07.2020, u vendos shtyrja e afatit të procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, deri në datën 06.01.2021, për shkak se shoqëria nuk mundi të plotesonte dokumentacionin e munguar të aplikimit si rezultat i vijueshmerisë së situatës së veshtirë të krijuar nga Pandemia COVID 19). Sikurse për vitin 2020 edhe për vitin 2021 kjo procedurë është trashëguar duke e ri-shtyrë në vijim afatin e trajtimit të saj deri në datën 06.04.2021.

Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBGAS” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s. (vendimi nr. 43, datë 06.03.2020). Shtyrja e afatit të vendimarrjes për licencimin e shoqërisë në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 01.07.2020. Kjo procedurë ka nisur në vitin 2019 me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 25.11.2019 dhe ka vijuar me shtyrjet respektive përgjatë vitit 2020, sipas kronologjisë së datave të vendimarrjeve të Bordit, pasqyruar në vijim. Shtyrjet e kësaj procedure kanë ardhur për shkak të pamundësisë së shoqërisë për të plotësuar në kohë dokumentacionin e kërkuar nga rregullorja e licencimit, si pasojë e kushteve të vështira të krijuara edhe nga pandemia COVID-19 dhe kufizimeve që erdhën prej saj.

- Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “ALBGAS” sh.a., në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror” të ndryshuar”, dhe “Një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “ALBGAS” sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror” të ndryshuar” (vendimi nr. 108, datë, 02.07.2020 Shtyrja e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të licencimit deri në datën 20.12.2020.

- Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 221, datë 20.12.2019, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “operatori i kombinuar i gazit natyror” ALBGAZ sh.a., të ndryshuar. (vendim nr. 109, datë 02.07.2020). Shtyrja e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të certifikimit deri në datën 20.12.2020.
- Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. për zgjatjen e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës për licencim në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror. (vendimi nr.119, datë 17.07.2020). Zgjatja e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBGAZ sh.a, për licencimin në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 10.10.2020.
- Mbi kërkesën e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s”. (vendimi nr. 179, date 04.11.2020). Shtyrja e afatit të vendimmarrjes për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a, në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror deri në datën 20.03.2021.
- Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAZ sh.a.” , i ndryshuar. (vendimi nr. 261, date 28.12.2020). Shtyrja e afatit të plotësimit të kushteve të certifikimit brenda datës 20.06.2021.
- Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., në aktivitetin e shpërndarjes të gazit natyror”, të ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, të ndryshuar. (vendimi nr. 262, datë 28.12.2020). Shtyrja e afatit të plotësimit të dokumentacionit të munguar deri në datën 20.06.2021.

Për të gjithë subjektet e licencuar nga ERE, mbahet dhe arkivohet regjistri për secilën veprimtari/aktivitet, me të dhënat e nevojshme për subjektin dhe llojin e licencës, të cilat pasqyrohen të përditësuara në faqen e internetit të ERE dhe mund të konsultohen nga çdo palë e interesuar.

Vlen të theksojmë gjithashtu se, gjatë këtij viti, ERE ka marrë në shqyrtim edhe kërkesa të tjera të të licencuarve, për të cilat është vendosur refuzimi për shkak se aplikantët nuk kanë plotësuar kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në këtë kontekst është vendosur refuzimi i 5 licencimeve nga ana e ERE-s, si dhe është vendosur mosfillimi i procedurës për 6 aplikime për licencim.

Për shkak të situates së vështirë të krijuar nga COVID -19 gjatë vitit 2020, janë paraqitur në ERE edhe kërkesa për shtyrje të afatit administrativ të vendimmarrjes finale të ERE-s, si rezultat i pamundësisë për ti plotësuar dokumentat e aplikimeve në kohë. Për këtë arsye janë marrë 9 vendime për shtyrje të këtij afati.

Subjektet e licensuar në aktivitetet e Gazit natyror për vitin 2020			
Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	DATA E VENDIMIT TË BORDIT
1.	“GSA” sh.p.k	Tregtim me shumicë	Vendimi Nr. 118, datë 17.07.2020
2.	“GSA” sh.p.k	Furnizim Gazi Natyror	Vendimi Nr. 117, datë 17.07.2020

Figura 72 Subjektet e licensuar në aktivitetin e gazit natyror 2020.

Dhënia e Autorizimeve

Gjatë këtij vitit në zbatim të legjislacionit në fuqi ERE ka marrë vendimet për dhënie autorizimi si më poshtë:

- Vendimi Nr. 30, datë 21.02.2020, mbi kërkesën e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s për shitjen e 80% të kuotave të kapitalit të shoqërisë të zotëruara nga shoqëria “Kastrati Construction” sh.p.k.
- Vendimi Nr. 75, datë 22.04.2020, mbi kërkesën e shoqërisë “SPAHIU GJANÇ” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ana e ERE-s për lënien peng në favor të Bankës Intesa San Paolo Bank sh.a. të kuotave të shoqërisë “SPAHIU GJANÇ” sh.p.k., që zotërohen 100% nga shoqëria “HYDRO INVEST” sh.p.k..
- Vendimi Nr. 141, datë 21.08.2020 mbi kërkesën e shoqërisë “KISI-BIO-ENERGJI” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin e kuotave që përbëjnë 100 % të kapitalit të shoqërisë “KISI-BIO-ENERGJI” sh.p.k. tek shoqëria “FREE CO” sh.p.k..
- Vendimi nr. 158, datë 20.10.2020, mbi kërkesën e shoqërisë “WENERG” sh.a. për marrjen e autorizimit për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “WENERG” sh.a., në favor të bankës OTP ALBANIA sh.a. (Shtyrjen me 30 ditë të vendimmarrjes së ERE-s për dhënien e autorizimit për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “WENERG” sh.a., në favor të bankës OTP ALBANIA sh.a.)
- Vendimi nr. 238, datë 21.12.2020, mbi kërkesën e shoqërisë “WENERG” sh.a. për marrjen e autorizimit të ERE-s për barrësimin e 100% të aksioneve të shoqërisë “Wenerg” sh.a., në favor të bankës OTP ALBANIA sh.a. (ish-Societe Generale Albania sh.a.)”.

3.2 Mbikqyrja e të licensuarve gjatë vitit 2020.

Gjatë këtij viti mbikqyrja e të licensuarve ka vijuar punën me kontrollin dhe vlerësimin e informacionit të siguruar nga raportimet në lidhje me veprimtarinë e licensuar për çdo subjekt. Bazuar në nenet respektive të licencave në veprimtarinë e Energjisë Elektrike si dhe atyre të Gazit Natyror. Ka patur një raportim kryesisht korrekt nga ana subjekteve respektivisht sipas veprimtarisë së licensuar çdo muaj.

Nga të dhënat e mbledhura janë përpunuar dhe analizuar treguesit tekniko-ekonomik sipas evidencave periodike ose dokumentave të tjera raportuese duke bërë edhe krahasimet me kërkesat e licencave të dhëna dhe nxjerr konkluzionet përkatëse. Është vijuar të mbahet në mënyrë të vazhdueshme database-i i nevojshëm në lidhje me raportimet mujore të të licensuarve.

Në kuadër të raportimit mujor, dhe mbikqyrjes janë evidentuar shoqëri të cilat kanë hasur problematika të ndeshura si rezultat i luhatjeve të tensionit si dhe shkëputjes së energjisë në zonën ku operojnë subjektet, në lidhje me evidentimet, ERE në mbështetje të *“Marrëveshjes së Lidhjes së Re”* miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 166, datë 10.10.2016, *“Kodit të shpërndarjes”* miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 100, datë 26.08.2008 si dhe *“Rregullores për kriteret standarde së cilësisë së shërbimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”*, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.181, datë 10.11.2017, rast pas rasti i është drejtuar me anë të shkresave përkatëse. Në kuadër të zbatimit të *“OSSH” sh.p.k “OSHEE” sh.p.k*, ku është kërkuar informacion mbi veprimet konkrete që janë ndërmarrë për zgjidhjen e problematikave të hasura nga subjektet e licensuara.

Gjithashtu është mbajtur në mbikëqyrje faqia e QKB-s (Qendrën Kombëtare të Biznesit) janë evidentuar ndryshimet e regjistruara nga ana e subjekteve dhe më tej janë vendosur kontaktet respektive dhe vendimarrjet përkatëse në lidhje për sa argumentuar dhe aplikuar.

Po ashtu gjatë këtij viti ERE, ka përfunduar procesin e monitorimi/mbikëqyrjes së plotësimit të kushteve të vendimeve të licencimit për shoqëritë prodhuese nga Centralet Eolike, të licensuara nga ERE si më poshtë:

- *“Hera” sh.p.k* është licensuar nga ERE me vendimin nr. 61, datë 02.11.2007;
- *“Alb Wind Energy” sh.p.k* është licensuar nga ERE me vendimin nr. 13, datë 28.01.2008;
- *“ERS-08” sh.p.k* është licensuar nga ERE me vendimin nr. 63, datë 13.06.2008;
- *“E Vento s.r.l Albania” sh.p.k*, licensuar nga ERE me vendimin nr. 84, datë 17.07.2008;
- *“Albanian Green Energy” sh.p.k*, licensuar nga ERE me vendimin nr. 89, datë 06.08.2008;
- *“Biopower Green Energy” sh.p.k*, licensuar nga ERE me vendimin nr. 90, datë 06.08.2008;

Në lidhje me sa më sipër, kërkesat e shoqërive të licensuara të sipërcituar u shqyrtuan edhe përgjatë vitit 2020. Gjatë këtij viti me Vendimin Nr. 19, datë 31.01.2020 u shty deri në datë 29.02.2020 afati i pezullimit të shqyrtimi i kërkesave për shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të licencimit, për të vijuar me kryerjen e monitorimeve pranë selive të këtyre shoqërive dhe pranë zonave ku do të shtrihen dhe zhvillohen projektet eolike, me qëllim evidentimin, dokumentimin dhe shqyrtimin e të gjitha rrethanave të cilat aplikuesit pretendojnë se u kanë pamundësuar zbatimin dhe realizimin e kushteve dhe afateve të parashikuara respektivisht në: Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 61, datë 02.11.2007, *“Për licencimin e shoqërisë “Hera” sh.p.k, i ndryshuar*; Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, *“Për licencimin e shoqërisë “E-Vento s.r.l Albania sh.p.k., i ndryshuar*; Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 13, datë 28.01.2008, *“Për licencimin e shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k., i ndryshuar*; Vendimin e Bordit të Komisionerëve

të ERE-s nr. 63, datë 13.06.2008, “Për licencimin e shoqërisë “ERS-08” sh.p.k., i ndryshuar; Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 84, datë 17.07.2008, “Për licencimin e shoqërisë “E Vento s.r.l Albania” sh.p.k., i ndryshuar; Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 89, datë 06.08.2008, “Për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k., i ndryshuar; Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 90, datë 06.08.2008, “Për licencimin e shoqërisë “Biopower Green Energy” sh.p.k., i ndryshuar.

Vendimi i sipërcituar erdhi për shkak të vështirësive në përfundimin e monitorimit, të shkaktuara nga shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti, dhe në vijim edhe nga COVID-19, çka solli vonesa në përfundimin e shumë procedurave dhe kufizim në lëvizje dhe pengesave të shkaktuara nga vetë shoqëritë, të cilat pavarësisht se kanë patur detyrimin për marrjen e të gjitha masave për të siguruar çdo dokumentacion të nevojshëm me qëllim përfundimin e monitorimit të parashikuar në këtë vendim në afat, kanë kërkuar zyrtarisht nga ERE kryerjen e monitorimit vetëm në disa ditë të caktuara për shkaqe të konsideruara si të arsyeshme. Më tej në lidhje me këtë procedure me vendimin nr. 83, datë 04.05.2020, u vendos sërish shtyrja me 2 (dy) muaj pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të afatit të pezullimit të parashikuar për kryerjen e monitorimeve pranë shoqërive të licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet eolike”. Sigurisht që situata e vështirë e krijuar nga COVID-19, e cila preku edhe institucionin tonë, vështirësoi koordinimin e çështjeve me objekt monitorimi, të cilat mbështeten kryesisht në grupet e punës.

Në vijim të shtyrjeve të sipërcituara, të komunikimit me MIE dhe në kuadër të plotësimit të kushteve respektive që këto shoqëri kanë patur në vendimet e licencimit, po vijohet me finalizimin e praktikave.

3.3 Certifikimet

- Gjatë vitit 2020, pasi OST sh.a., provoi përmbushjen e të gjitha kushteve të certifikimi, përfshirë edhe ato që nuk vareshin prej vullnetit të tij, ERE në mbështetje të Nenit 16 dhe Nenit 58, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; Nenit 113 të Ligjit Nr. 44/2015, “Kodi i procedurës administrative”, si dhe Nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, me Vendimin nr. 99, datë 24.06.2020, vendosi shfuqizimin e pikave 2, 3 dhe 4 të Vendimit të ERE-s Nr. 43, datë 15.03.2017 “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike “OST” sha., në përputhje me Nenin 54, pika 6, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC “Mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, i ndryshuar.

Po ashtu gjatë këtij viti Bordi i ERE-s është shprehur me vendime edhe për Certifikimin e ALBGAZ sh.a si më poshte:

- Bordi i ERE-s në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80 të ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 6-11 të “Rregullores për çertifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit nr. 100, datë

05.08.2015, ndryshuar me vendimin e Bordit nr.129, datë 31.10.2015; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, me vendimin nr. 109, datë 02.07.2020, vendosi shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të parashikuara në vendimin e bordit të ERE nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e “Operatori i kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a , deri në datën 20.12.2020, sipas kërkesës së shoqërisë.

Shkak për shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të vendimit të sipërcituar, u bë pamundësia e shoqërisë ALBGAZ sh.a për ti plotësuar në kohë si rezultat i situatës së vështirë të krijuar në vendin tonë nga pandemia COVID -19, si dhe për shkak se një pjesë e tyre nuk varej nga vullneti i saj, por nga institucionet shtetërore. Këto kushte kanë të bëjnë me bashkëveprimin ndërinstytucional dhe ndryshimet në kuadrin ligjor respektiv në fuqi dhe dorëzimin për miratim në ERE deri në datën 20.12.2020 te Programit te përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE me vendimin nr. 77, datë 26.05.2017 të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror”.

Më tej Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 261, datë 28.12.2020, në mbështetje të Nenit 16, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; Neneve 37, 50, 59, 68, dhe 80, të Ligjit Nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Neneve 6-11, të “Rregullores për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror”, miratuar me vendimin e Bordit Nr. 100, datë 05.08.2015, ndryshuar me vendimin e Bordit Nr. 129, datë 31.10.2015; si dhe Nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, vendosi të shfuqizojë pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 179, datë 08.11.2017 “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAZ sh.a. ” , i ndryshuar, si rrjedhojë e plotësimit të kushtit që kishte të bënte me dorëzimin për miratim në ERE deri në datën 20.12.2020 të Programit të përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE me vendimin Nr.77, datë 26.05.2017 të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror.

Po me këtë vendimarrje Bordi i ERE-s shtyu edhe njëherë afatin e plotësimit të kushtit të vendosur në pikën 5.2 (ndërveprimi institucional për ndryshimet në kuadrin ligjor) të vendimit Nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAZ sh.a. ” , i ndryshuar, brenda datës 20.06.2021, nga shoqëria Albgaz sh.a, duke qënë se kjo e fundit ka provuar në ERE të gjitha përpjekjet e saj për përmbushjen e këtij kushti, edhe pse nuk varet drejtpërdrejtë nga vullneti i saj. Në këtë shtyrje është marrë në konsideratë edhe situata e vështirë e krijuar në vendin tonë për shkak të COVID-19.

3.4 Programi i Pajtuëshmërisë për Operatorët e Rrjetit

Programi i Pajtuëshmërisë për OST e energjisë elektrike

- Në zbatim të përcaktimeve të vendimit Nr. 43, datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me Nenin 54, pika 6, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe

Nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë”, si dhe në zbatim të përcaktimeve të Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 30.04.2018, Zyrtari i Pajtueshmërisë së shoqërisë OST sh.a, në përmbushje të detyrave të tij, duhej të dërgonte në ERE Raportin vjetor të Pajtueshmërisë së OST sh.a për vitin 2019, brenda datës 31 mars.

Me komunikimin elektronik të datës 09.04.2020, Zyrtari i Pajtueshmërisë së OST sh.a., bëri me dije se, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore me VKM-në nr. 243, datë 24.3.2020, ka qenë i pamundur përfundimi i Raportit Vjetor brenda afatit të caktuar.

Si e tillë, ERE, duke marrë në konsideratë gjendjen e krijuar për shkak të COVID-19 dhe kufizimet e vendosura, me qëllim parandalimin e përhapjes së këtij infeksioni, me Vendimin Nr. 76, datë 22.04.2020, vendosi të pezullojë zbatimin e afatit të parashikuar në Kreun VI, gërma C, pika 1, të Programit të Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 103, datë 30.04.2018, deri jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Në vijim të sa më sipër me shkresën Nr. 4529 Prot, datë 22.07.2020, Zyrtari i Pajtueshmërisë në përmbushje të detyrave të lëna me vendimin e ERE-s Nr. 43, datë 15.03.2017 dhe në zbatim të përcaktimeve të Programit të Pajtueshmërisë të OST sh.a., miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr.103, datë 30.04.2018, dërgoi në ERE raportin e pajtueshmërisë së OST sh.a. për vitin 2019.

Nga ky raport u konstatua se OST sh.a ka vijuar më së miri me përmbushjen e detyrimeve të tij në kuadër të përmirësimit të punës në drejtim të zbatimit të parashikimeve të vendimit të certifikimit, të programit të pajtueshmërisë dhe implementimin e rekomandimeve të Zyrtarit të Pajtueshmërisë. Nga ana e ERE-s janë dhënë disa rekomandime në kuadër të përmirësimeve të përmbushjes së këtyre detyrimeve të cilat duhet të merren në konsideratë nga ana e administratës së OST sh.a dhe të raportohen nga Zyrtari në vijim përgjatë raportit të vitit pasardhës.

Programi i Përputhshmërisë për ALBGAZ sh.a

- Në zbatim të përcaktimeve të vendimit nr. 179, datë 08.11.2017, “*Mbi çertifikimin e “Operatori i kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a, Zyrtari i Pëputhshmërisë së ALBGAZ sh.a, në përmbushje të detyrave të tij, duhej të dërgonte në ERE Raportin vjetor të Përputhshmërisë së ALBGAZ sh.a për vitin 2019, brenda datës 31 mars.*

Me komunikimin elektronik të datës 08.04.2020, Zyrtari i Përputhshmërisë së ALBGAZ sh.a., ka bërë me dije se në kushtet kur, Qeveria Shqiptare, me anë të Vendimit nr. 243, datë 24.03.2020, ka vendosur “Shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, si dhe pas masave të mara për kufizimin e lëvizjes, ka rezultuar i pamundur verifikimi i të dhënave, rishikimi i korrespondecave si dhe përditësimi i informacionit për përfundimin e Raportit Vjetor të Përputhshmërisë për vitin 2019 për ALBGAZ sh.a..

Si e tillë, ERE, duke marrë në konsideratë gjendjen e krijuar për shkak të COVID-19 dhe kufizimet e vendosura me qëllim parandalimin e përhapjes së këtij infeksioni, me Vendimin Nr. 77, Datë 22.04.2020, vendosi të pezullojë zbatimin e afatit të parashikuar në Kreun VI, gërma C, pika 73, të Programit të Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 77, datë 26.05.2017, deri jo më vonë se 30 ditë pas përfundimit të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Në vijim të sa më sipër, me shkresën Nr. 142/1, datë 23.07.2020, protokolluar në ERE me Nr. 654/2 prot., datë 23.07.2020Z, Zyrtari i Përputhshmërisë, ka dërguar në ERE Raportin Vjetor të Përputhshmërisë për Albgaz sh.a. (Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror), për vitin 2019.

Sa evidentuar në kohën e depozitimit në ERE të këtij raporti, ALBGAZ sh.a, nuk kishte sjellë ende në ERE për miratim Programin e Përputhshmërisë së OST-së, në zbatim të pikës 76 të Programit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.05.2017. Për përgatitjen e Raportit Vjetor për vitin 2019, Zyrtari i Përputhshmërisë është mbështetur te programi i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i “ALBGAZ” sh.a.

Referuar raportimit të zyrtarit në lidhje me zbatimin e programit të përputhshmërisë për vitin 2019 nga ana e ALBGAZ sh.a, gjetjeve dhe rekomandimeve të tij, u konstatua se ky raportim është bërë kryesisht sipas kërkesave të programit. Nga ana e ERE-s janë bërë disa konstatime dhe janë dhënë disa rekomandime në kuadër të përmirësimeve të përmbushjes së këtyre detyrimeve, të cilat duhet të merren në konsideratë nga ana e administratës së ALBGAZ sh.a dhe Zyrtarit të Përputhshmërisë, si dhe të raportohen nga Zyrtari në vijim.

Gjithashtu në kuadër të detyrimeve dhe plotësimeve të kushteve respektive sikurse cituar edhe në Vendimin e Certifikimit të Albgaz, si rrjedhojë e plotësimit të kushtit që kishte të bënte me dorëzimin për miratim në ERE deri në datën 20.12.2020 të Programit të përputhshmërisë të përshtatur sipas atij të miratuar nga ERE me vendimin nr. 77, datë 26.05.2017 të Bordit të ERE-s, “*Mbi miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror*” ERE me Vendim Nr. 263, datë 28.12.2020 vendosi “Fillimin e Procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “ALBGAZ” sh.a.”. Praktikë e cila është në vijim për miratim në vitin pasardhës.

4. AKTIVITETI I ERE-s NË FUSHËN E RREGULLIMIT TË TARIFAVE DHE ÇMIMEVE TË ENERGISË ELEKTRIKE DHE GAZIT NATYROR

Në zbatim të Neneve 19, 20, 79 dhe 83 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, të Neneve 16, 17, 32, 75 dhe 92 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, si dhe Nenit 10 të Ligjit Nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për veprimtaritë e rregulluara dhe ato që kanë detyrimin e shërbimit publik në sektorin e energjisë, bazuar në metodologjitë respektive në fuqi.

Në këtë kuadër, veprimtaritë kryesore të ERE-s në fushën e rregullimit të tarifave dhe çmimeve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror gjatë vitit 2020 kanë qënë:

1. Shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për:

- Aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike;
- Aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike;
- Aktivitetin e furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike
- Aktivitetin e furnizimit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike;
- Aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi sipas parashikimeve të Ligjit 7/2017;
- Aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri në 2 MW për vitin 2019.
- Aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri 3 MW për vitin 2019.
- Aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror;

4.1 Shqyrtimi i aplikimeve për miratimin e tarifave dhe çmimeve të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin 2020:

4.1.1 Lidhur me aplikimin e shoqërisë OST sh.a për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021.

Shoqëria OST sh.a me shkresën Nr. 5686 Prot, datë 24.09.2020, paraqiti pranë ERE-s kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021.

Në këtë aplikim, tarifa e kërkuar nga shoqëria “OST” sh.a për vitin 2021 për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike ishte përllëgaritur në vlerën 1.31 lekë/kWh nga tarifa prej 0.75 lekë/kWh në fuqi e miratuar nga ERE.

ERE pas shqyrtimit të këtij aplikimi, vlerësoi se aplikimi i përcjellë në ERE nuk plotëson kriteret formale dhe të përmbajtjes, pasi u konstatuan mangësi në dhënien e shpjegimeve mbi aspekte të

veçanta të tij, të cilat nuk përmbushnin kërkesat dhe përcaktimet e: (i) Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, (ii) “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; (iii) “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”; (iv) “Sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, (v) “Rregullores së Procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”

Bazuar mbi këto vlerësime, Bordi i ERE me vendimin nr.163, datë 22.10.2020 vendosi mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021.

Në vijim të kësaj vendimmarrje, OST sh.a me anë të shkresës Nr. 6731, datë 09.11.2020, kërkoi rishikimin e Vendimit Nr. 163, datë 22.10.2020 të Bordit të ERE-s “Mbi aplikimin e shoqërisë OST sh.a për miratimin e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2021”.

Në vijim të kësaj kërkesë, ERE mbështetur në përcaktimet e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e procedurave të ERE-s dhe Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, vijoi me shqyrtimin e **dokumentacionit shoqëruar dhe përgjigjeve lidhur me konstatimet e kësaj vendimmarrje të përcjellë nga OST sh.a.** të cilat të mund të çonin bordin e ERE në rishikimin e vendimit nr.163, datë 22.10.2020.

Mbas shqyrtimi të këtij dokumentacioni, ERE vlerësoi se procesi i rishikimit të një vendimi nga ana e ERE-s, në zbatim të përcaktimeve të Rregullores së organizimit funksionimit të procedurave të ERE, kryhet në rast se i licencuari ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara, ndërkohë që nga analiza e dokumentacionit të përcjellë apo i shpjegimeve lidhur me konstatimet e vendimit të mosfillimit të procedurave për tarifën e transmetimi të energjisë elektrike të përcjella nga shoqëria OST sh.a në këtë kërkesë, nuk u konstatua asnjë provë e re, e cila mund të çonte në rishikimin e vendimit të Bordit të ERE nr. 163, datë 22.10.2020.

Nisur nga arsyetimet dhe analizat e kryera, dokumentacionit dhe shpjegimeve të shoqërisë nëpërmjet kësaj kërkesë, ERE vlerësoi ndër të tjera se në rast të aplikimit të një tarife të pambështetur në parimet rregullatore të Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimi të energjisë elektrike, stabiliteti financiar i tregut të energjisë do të çenohej dhe do të përballej më vështirësi të theksuara të cilat mund të përshkallëzoheshin në humbje financiare të mëtejshme për shoqëritë e rregulluara dhe rritje të kostove operative të paarsyetuara për përdoruesit e tjerë të rrjetit të transmetimit, për më tepër që koha për vlerësimin e këtij aplikimi do të ishte e pamjaftueshme dhe përtej afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Bazuar mbi këto vlersime si dhe analizave respektive, Bordi i ERE me vendimin Nr. 206, Datë 11.12.2020 vendosi Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë OST sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të EREs Nr. 163, datë 22.10.2020.

Nisur nga të dhënat e vëna në dispozicion gjatë vitit 2020, u vlerësua se tarifa aktuale e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike i kishte krijuar shoqërisë OST sh.a, rezerva të ardhurash të

mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve operative në tërësi. Në mënyrë që shoqëria OST sh.a., të mund të vijonte realizimin e aktivitetit të saj dhe përgjatë vitit 2021, lind nevoja që shoqëria të vijojë faturimin bazuar në një tarifë transmetimi të miratuar nga ERE, në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Në këto kushte, Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 266, datë 21.12.2018, vendosi lënien në fuqi të vendimit Nr. 266, datë 21.12.2018, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike deri në aplikimin për përcaktimin e tarifave të shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a., në përputhje me kërkesat e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 180, datë 08.11.2017, ku efektet në të ardhura të tarifës mesatare e transmetimit do të axhustohen/korrigjohen në zbatim të përcaktimeve të kësaj Metodologjie.

4.1.2 Lidhur me aplikimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020 dhe aplikimin e FSHU sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2020.

Bazuar në nenin 19, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ERE është institucioni përgjegjës për miratimin dhe publikimin, në përputhje me parimin e transparencës dhe duke marrë në konsideratë koston e shërbimit të ofruar, e tarifave të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike si dhe miratimin e tarifave për veprimtaritë e licencuara për të cilat është vendosur detyrimi i shërbimit publik.

Me shkresën Nr. 25971 Prot, datë 30.12.2019 shoqëria OSHEE sh.a., në rolin e shoqërisë mëmë, paraqiti në ERE aplikimin për tarifën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për nivel tensioni për vitin 2020 .

Në vijim, me anë të shkresës Nr. 3, datë 06.01.2020, shoqëria FSHU sh.a paraqiti në ERE aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike me pakicë për vitin 2020 për klientët që furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal (FSHU sh.a.).

Shoqëria OSHEE sh.a., për herë, të parë që nga momenti i krijimit të saj, filloi procesin e ndarjes administrative, menaxheriale dhe ligjore të aktiviteteve të shpërndarjes dhe furnizimit të energjisë elektrike në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë", i ndryshuar.

Më datë 01.01.2020, shoqëritë e reja të krijuara OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. filluan të operojnë si shoqëri të pavarura financiarisht nga njëra tjetra duke ushtruar aktivitetin e tyre bazuar në përcaktimet e licencave respektive.

Mbas shqyrtimit të aplikimeve të depozituara, Bordi i ERE me anë të vendimit nr. 2, datë 10.01.2020 vendosi mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2020 dhe shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020, duke cilësuar në konstatimet e kësaj vendimmarrje vlerësimet për sa i takon analizës së materialit të përcjellë si dhe plotësimit të mangësive të konstatuara, mbështetur në përcaktimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në vijim të kësaj vendimarrjeje, ERE ka patur një sërë korrespondencash lidhur me plotësimet e dokumentacionit të nevojshëm nga ana e shoqërive OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. si dhe dhënien e argumentave plotësues mbi komponentët e përcaktimit të tarifave të rrjetit të shpërndarjes si dhe çmimeve të shitjes me pakicë. Gjatë zhvillimit të këtij procesi, janë organizuar një sërë seancash teknike dhe dëgjimore me përfaqësuesit e shoqërive në fjalë dhe palët e interesit, jo vetëm si kërkesë e “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, por edhe si kërkesë në vijimësi e grupeve të interesit për t’u informuar në lidhje me këto dy aplikime.

Në vijim të situatës së paprecedentë të krijuar nga pandemia COVID-19, për shkak të pamundësisë reale për të zbatuar parashikimet e legjislacionit në fuqi, sa i përket diskutimit publik e organizimit të senceve dëgjimore me palët e interesit, masave kufizuese të marra nga Qeveria Shqiptare për kufizimin e përhapjes së virusit Covid-19, si dhe në mbështetje të Nenit 16, Nenit 20, gërma “c”, Nenit 85 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, VKM nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, nenit 67 dhe 91 pika 4 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, Nenit 15 dhe 22 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i ERE me anë të vendimit nr. 67, datë 08.04.2020 vendosi pezullimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU sh.a për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2020 dhe shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, OSSH sh.a. për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020, deri jo më vonë se 3 muaj nga përfundimi i gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë periudhës së pezullimit të procesit sa më sipër, duke qënë se vijonin masat e marra në kuadër të protokollit të qeverisë Shqiptare për mbrojtjen nga virusi Covid-19, të vetmet hapësira ligjore për kryerjen e punës, me qëllim ecurinë e procesit të shqyrtimit të aplikimeve, ishin shkëmbimi i kërkesave dhe marrja e informacionit të domosdoshëm për qëllime të kësaj praktike nga aplikuesit.

Për qëllime të analizave në kuadër të realizimit të detyrave të ERE dhe mbikqyrjes së situatës financiare-ekonomike të shoqërive OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. gjatë gjëndjes së fatkeqësisë natyrore, me anë të një sërë kërkesave për informacion drejtuar shoqërive të lartpërmendura, janë kërkuar Pasqyrat Financiare Operative, kërkesa të cilave shoqëritë nisur nga komunikimet gjatë kësaj periudhe nuk mundën ti plotësonin. Dërgimi i informacioneve të kërkuara, ishte i domosdoshëm për arsye se realizimi i treguesve tekniko-ekonomik dhe financiar i këtyre shoqërive do të shërbente për mbylljen e procesit të nisur me Vendimin nr. 2, datë 10.01.2020 të Bordit të ERE lidhur me përcaktimin e tarifave sipas niveleve të tensionit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për vitin 2020 si dhe përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2020.

Me përfundimin e afatit të përcaktuar në vendimin e bordit të ERE Nr.67, datë 08.04.2020, ERE vijoi procedurën e nisur me Vendimin e Bordit të ERE Nr.2, datë 10.01.2020, duke vlerësuar se parashikimet e shoqërive OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. të paraqitura në kërkesën për shqyrtimin e aplikimit për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit dhe çmimit të shitjes me pakicë për vitin

2020 nuk mund të merreshin më për bazë për arsye se ishte mbyllur 8 mujori i vitit 2020, ndaj çdo e dhënë e depozituar më herët kishte humbur aktualitetin dhe nuk paraqiste një pasqyrë reale të aktivitetit ushtrimor të këtyre shoqërive. Për atë kohë sa shoqëritë nuk mund të depozitonin në ERE informacionet e cilësuar të domosdoshme, përfundimi i këtij procesi kërkonte ende kohë në mënyrë që përllogaritja e tarifave sipas nivelit të tensionit për OSSH sh.a. dhe përllogaritja e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga FSHU sh.a. për vitin 2020 të kryhej bazuar në kostot reale duke justifikuar aktivitetin e të dy shoqërive.

Në vijim ERE ka dërguar kërkesa për informacion adresuar aplikuesve e për dijeni të gjithë palëve të interesit, për dërgimin e të gjithë dokumentacionit të nevojshem së bashku me shpjegimet përkatëse, për të bërë të mundur shqyrtimin e aplikimit dhe më tej vendimmarrjen e ERE-s për përmbylljen e këtij procesi.

Në mungesë të paraqitjes së të dhënave të kërkuara lidhur me realizimin e treguesve tekniko-ekonomik dhe financiar të shoqërive përgjatë vitit 2020, Bordi i ERE me vendimin Nr. 213, datë 15.12.2020, vendosi mbylljen e procedurës të nisur me anë të vendimit nr. 2, datë 10.01.2020 për shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të energjisë elektrike për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020 dhe shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të bordit të ERE-s Nr. 199, datë 12.12.2019, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë OSSH sh.a. për vitin 2021, në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Në këtë vendimmarrje, ERE vlerësoi se në kushtet e liberalizimit të tregut të energjisë elektrike dhe të drejtës të klientëve fundorë për të zgjedhur lirisht furnizuesin e tyre të energjisë elektrike, me përjashtim të klientëve fundorë të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për të cilët ERE ka miratuar tarifën e shpërndarjes prej 1.5 lekë/kWh, dhe klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 20 kV për të cilët ERE ka miratuar tarifën e shpërndarjes prej 3.9 leke/kWh, për të gjithë klientët e tjerë fundorë të lidhur me rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tjera të tensionit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të faturojë energjinë e lëvruar bazuar në tarifën mesatare të shpërndarjes së energjisë elektrike prej 4.79 lekë/kWh, të miratuar nga ERE.

Gjithashtu me vendimin nr. 214, datë 15.12.2020, Bordi i ERE vendosi mbylljen e procedurës të nisur me anë të vendimit nr. 2, datë 10.01.2020, për shqyrtimin e aplikimit të FSHU sh.a. për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2020 dhe shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të bordit të ERE-s nr. 200, datë 12.12.2019, deri në miratimin e një vendimi mbështetur në aplikimin e shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2021, për çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Efektet në të ardhurat e shoqërisë FSHU sh.a. dhe korigjimi i tyre do të bëhet mbi/nën kërkesën e lejuar për të ardhura për vitin paraardhës, sipas përcaktimeve të Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë tek Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) të miratuar me vendimin nr. 189, datë 23.11.2017.

- **Mbi përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2020.**

Në zbatim të Nenit 87, pika 4 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me Vendimin nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 144, datë 25.06.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019, Enti Rregullator i Energjisë ka përcaktuar çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për secilin muaj të vitit 2020. Përlllogaritjet e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, janë kryer në zbatim të formulës së përcaktuar në metodologjinë e lartpërmendur, e cila paraqitet si më poshtë vijon:

$$\text{ÇFMFt} = \text{CBEt} + \text{Pr} * \text{CBEt} + \text{TRrTSHt} + \text{CA ku:}$$

ÇFMFt - Çmimi i furnizimit në periudhën relevante t

CBEt - Çmimi maksimal i blerjes së energjisë për periudhën e furnizimit nga tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi (BRE).

Pr - Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (do të pranohet në masën 3% për dy vitet e para e më tej do të rishikohet bazuar në të dhënat historike)

TRrTSHt - Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante

CA - kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

Në vijim paraqiten çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2019-2020, sipas vendimeve respektive të Bordit të ERE-s, si dhe çmimet maksimale të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të këtij grupi klientësh, krahasuar me ato të vitit 2019.

Viti 2019	Vendimi	Çmimi i shitjes miratuar nga ERE (lekë / kWh) 2019	Çmimi maksimal i blerjes së energjisë nga FSHU sh.a Euro/ Mwh 2019	Viti 2020	Vendimi	Çmimi i shitjes miratuar nga ERE (lekë / kWh) 2020	Çmimi maksimal i blerjes së energjisë nga FSHU sh.a Euro/ Mwh 2020
Janar	Nr. 23, Datë 18.02.2019	18.73	114.77	Janar	Nr. 23, Datë 10.02.2020	12.49	77.75
Shkurt	Nr. 42, Datë 15.03.2019	13.92	76.95	Shkurt	Nr. 47, Datë 20.03.2020	10.50	64.45
Mars	Nr. 55, Datë 03.04.2019	13.40	73.00	Mars	Nr. 60, Datë 08.04.2020	9.56	52.00
Prill	Nr. 75, Datë 10.05.2019	13.67	74.87	Prill	Nr. 84, Datë 12.05.2020	9.50	40.00
Maj	Nr. 78, Datë 31.05.2019	13.62	75.45	Maj	Nr. 95, Datë 08.06.2020	9.50	37.00
Qershor	Nr. 111, Datë 10.07.2019	13.07	72.00	Qershor	Nr. 116, Datë 09.07.2020	9.50	35.00
Korrik	Nr. 126, Datë 08.08.2019	12.75	63.50	Korrik	Nr. 130, Datë 10.08.2020	9.50	40.85
Gusht	Nr. 138, Datë 16.09.2019	12.75	62.99	Gusht	Nr. 147, Datë 10.09.2020	9.71	42.00
Shtator	Nr. 150, Datë 10.10.2019	12.81	70.00	Shtator	Nr. 156, Datë 07.10.2020	11.75	75.90
Tetor	Nr. 165, Datë 04.11.2019	14.01	79.48	Tetor	Nr. 182, Datë 06.11.2020	11.10	73.69
Nentor	Nr. 195, Datë 12.12.2019	14.68	83.80	Nentor	Nr. 207, Datë 11.12.2020	11.32	53.79
Dhjetor	Nr. 01, datë 10.01.2020	16.57	100.00	Dhjetor	Nr. 01, datë 11.01.2021	14.82	108.88

Figura 73 Çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për vitin 2019-2020 (Burimi: ERE)

Në grafikun në vijim, paraqitet kurba lëvizëse e çmimit maksimal të blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për mbulimin e kërkesës për energji të këtij grupi klientësh për vitet 2019 – 2020:




Figura 74 Kurba levizëse e çmimit maksimal të blerjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për këtë kategori klientësh për vitet 2019 – 2020

Në grafikun në vijim paraqitet paraqitet kurba lëvizëse e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit të miratuara nga Bordi i ERE-s për vitin 2020, krahas çmimeve të shitjes për vitin 2019:




Figura 75 Kurba lëvizëse e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, të miratuar nga ERE për vitet 2019-2020

Sikurse vërehet në grafikun e mësipërm, çmimet e miratuara nga Bordi i ERE-s për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV në zbatim të përcaktimeve të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të ndryshuar, bazuar në dokumentacionin e paraqitur me anë të aplikimeve periodike të shoqërisë FSHU sh.a për vitin 2020, kanë ardhur në rënie krahasuar me çmimet e miratuara për të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Nga struktura e shitjes, evidentohet një ulje të konsiderueshme e energjisë së furnizuar për klientët të cilët furnizohen në kushtet e mundësisë së fundit në masën 32% gjatë vitit 2020 krahasuar me atë të vitit 2019, e cila ka ardhur si pasojë e lidhjes së kontratave të furnizimit në tregun e lirë nga një pjesë e klientëve të cilët furnizoheshin në kushtet e mundësisë së fundit në periudhat e mëparshme.

Ndërkohë që çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2020, ka patur gjithashtu një ulje të konsiderueshme krahasuar me atë të vitit 2019 prej 21%, e cila ka ardhur kryesisht si rezultat i uljes së çmimit të blerjes së energjisë elektrike në treg të lirë nga FMF për mbulimin e kërkesës për furnizimin e klientëve të cilët janë furnizuar në kushtet e mundësisë së fundit.

Nga analiza e raporteve periodike të vitit 2020, evidentohet se sasia e energjisë elektrike e shitur për klientët e FMF-së ka qënë 26 GWh, me një vlerë të faturuar prej 289 milion lekë, duke rezultuar në një çmim mesatar vjetor prej 11.09 lekë/kWh, ku krahasimi i realizimit si dhe diferenca e këtyre treguesve për vitet 2019-2020 paraqitet në tabelën si vijon:

Viti	Sasia (kWh)	Vlera (Lekë)	Çmimi mesatar (Lekë/kWh)
2019	38,098,488	537,217,272	14.10
2020	26,062,645	289,076,144	11.09
Diferencë	-32%	-46%	-21%

(Burimi OSHEE sh.a, ERE)

Sic vërehet në tabelën e mësipërme, ulja e sasisë së energjisë së shitur dhe e çmimit të shitjes së furnizimit të energjisë elektrike nga FMF gjatë vitit 2020, ka afektuar në ulje dhe të ardhurat e gjeneruara nga shitja e energjisë elektrike në masën 46%, krahasuar me të ardhurat e gjeneruara nga FMF gjatë vitit 2019.

4.1.3 Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albغاز sh.a” për vitin 2020 dhe vitin 2021.

Bordi i ERE me Vendimin nr. 206, datë 16.12.2019, vendosi shtyrjen e fuqisë juridike të Vendimit Nr. 60, datë 15.04.2019, të Bordit të ERE-s, në të cilën është përcaktuar se tarifa e përkohshme e transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albغاز sh.a. edhe për vitin 2020 ka qënë ajo e miratur në vendimarrjen e sipërcituar prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kwh.

Në zbatim të nenit 17, gërma “e”, të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “ERE ka të drejtë të miratojë tarifa të përkohshme transmetimi ose shpërndarjeje, në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave”.

Në mungesë të paraqitjes së një aplikimi për rishikimin e tarifës së transmetimit së shoqërisë Albغاز sh.a për vitin 2021, paraqitjes së planit të investimeve për vitin 2021 si një komponent i rëndësishëm i llogaritjes së tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2021, si dhe në zbatim të direktivave të Komunitetit të Energjisë, meqënëse aksesit në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE, Bordi i ERE me vendimin nr. 215, datë 15.12.2020 vendosi mbi shtyrjen e fuqisë juridike të Vendimit Nr. 206, datë 16.12.2019, të bordit të ERE-s, për vitin 2021 deri në miratimin e një tarife mbështetur në aplikimin e shoqërisë Albغاز sh.a. ku përditësimi dhe kompensimi i të ardhurave të kërkuara të shoqërisë Albغاز sh.a. nga të ardhurat e kërkuara të përkohshme, do të bëhet në mbështetje të përcaktimeve të nenit 17, pika “e” të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.

4.1.4 Mbi miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës të shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.

Në mbështetje të nenit 13 dhe 90, pika 11, të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshuar, nenit 19 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, ERE ka detyrimin për miratimin e Metodologjisë së përcaktimit të tarifës të shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Në zbatim të sa më sipër, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 186, datë 25.11.2019, vendosi mbi fillimin e procedurës për miratimin e Metodologjisë së përcaktimit të tarifës të shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Kjo metodologji do të gjejë zbatim vetëm mbi të licencuarin e ngarkuar me shërbimin e Furnizimit të Mundësisë së Fundit në sektorin e gazit natyror dhe do të shërbejë për përcaktimin e tarifës të shitjes së gazit natyror të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit bazuar në parime të qarta të tarifimit dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e tarifave sa më të drejta dhe transparente.

Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të përcaktohet në përputhje me parashikimet e Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, i cili do të funksionojë si një person juridik, i ndarë nga veprimtaritë e tjera të sektorit të gazit natyror, të mbajë të ndara llogaritë financiare, si dhe të përgatisë raporte financiare në lidhje me përmbushjen e detyrimit të mundësisë së fundit.

Në vijim të procedurës së nisur me vendimin sipërcituar e në përmbushje të të gjithë hapave procedural mbështetur në përcaktimet e “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE me Vendimin Nr. 38, datë 27.02.2020 vendosi mbi miratimin e “Metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”.

4.1.5 Në lidhje me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2020.

Bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi llogaritet nga ERE, në përputhje me “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 687, datë 22.11.2017.

Bazuar në metodologjinë e lartë përmendur, çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike përcaktohet nga: çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin në bandë i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në eurocent/kWh, një koeficient bonus për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.3 dhe norma mesatare e këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2019 rezultoi 50.36 Euro/MWh.

Nga të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit Lekë/EUR për çdo ditë të vitit 2019, rezultoi që kursi mesatar i këmbimit për vitin 2019 të jetë 123.01 Lekë/EUR.

Në vijim të grumbullimit të të dhënave të sipërcituara dhe në zbatim të përcaktimeve të Metodologjisë së lartpërmendur, çmimi blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2020, rezultoi 8.0532 Lekë/kWh.

Përsa më sipër, Bordi i ERE-s, me Vendimin Nr. 7, datë 16.01.2020 miratoi çmimin vjetor prej **8.0532 Lekë/kWh** që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2020.

Në kuadër të ndryshimeve të miratuara nga Këshilli I Ministrave me VKM nr.396, datë 13.5.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”, ku bonusi për promovimin e burimeve të rinovueshme u ndryshua në masën 1.2, solli si rrjedhojë rilogaritjen e këtij çmimi.

Nga sa më sipër ERE me vendimin e Bordit nr. 94, datë 08.06.2020, vendosi që çmimi i aplikueshëm për Prodhuesit Ekzistues me përparësi, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM nr. 396, datë 13.05.2020, të jetë 7.448 lekë/Kwh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi e deri në 31.12.2020.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve të miratura për prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet për periudhën 2009-2020.




Figura 76 Ecuria e çmimeve të miratuara për Prodhuesit me Përparësi.

4.1.6 Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW për vitin 2019, nga era me fuqi të instaluar deri ne 3 MW për vitin 2020.

- **Përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW për vitin 2019.**

Në mbështetje të nenit 10, pika 2 dhe 16 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 10, pika 3 të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” dhe parashikimeve të VKM nr.369, datë 26.4.2017, ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era me fuqi të instaluar respektivisht 2 MW dhe 3 MW.

Në zbatim të legjislacionit sipërcituar si dhe orientimeve të MIE ku për përcaktimin e çmimit të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike lundruese të merret në konsideratë metodologjia e vlerësimit të kostove të energjisë nga burimet e rinovueshme, e cila mbështetet tek e njëjta formulë e LCOE sipas VKM nr. 369, datë 26.04.2017, Bordi i ERE me Vendimin nr.193, datë 02.12.2019, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar në MIE dhe në ERE i subjektit i cili kishte marrë miratimin përfundimtar për ndërtimin e impiantit fotovoltaike lundrues deri në 2MW, Bordi i ERE me vendimin nr. 20 datë 31.01.2020 vendosi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike lundruese me kapacitet të instaluar deri në 2MW prej 100.025 Euro/MWh, për vitin 2019.

Në lidhje me përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga centralet fotovoltaike tokësore 2 MW, nuk rezultoi të jetë lëshuar miratim nga autoriteti shtetëror MIE për këtë teknologji gjatë vitit 2019, ndaj përcaktimi i një çmimi për këtë kategori nuk ishte i nevojshëm për arsye të pazbatueshmërisë së tij.

- **Përcaktimi i çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri 3MW për vitin 2020.**

Në zbatim të legjislacionit të lartpërmendur dhe në vijim të procedurës së nisur me Vendimin Nr. 193, datë 02.12.2019, për përlllogaritjen e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era me fuqi të instaluar deri në 3MW, mbas shqyrtimit të dokumentacionit të depozituar në MIE dhe në ERE të shoqërive të cilat patën marrë miratimin përfundimtar për ndërtimin e impianteve eolike, mbështetur në formulën për llogaritjen e LCOE, në zbatim të Metodologjisë së miratuar me Vendimin Nr.369, datë 26.04.2017, rezultoi një çmim prej 75.64 Euro/MWh.

Në tabelën në vijim paraqiten cmimet e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga era për vitin 2019 krahasuar dhe me çmimet në fuqi të vendeve të tjera të rajonit:

Shteti	Parametrat	Cmimi Euro/MWh	Periudha e mbështetjes (Vite)
Shqipëria	<3 MW	75.64	15
Kosove	<35 MW	85.00	12
Maqedonia	<5 MW	89.00	15
Serbi	deri ne 9000 ore pune	92.00	12
Mali i Zi	N/a	96.10	12

Bordi i ERE me Vendimin Nr. 271, datë 28.12.2020 vendosi mbi fillimin e procedurës për “Përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale” për vitin 2020.

Proçesi i miratimit të çmimeve për burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale, do të trajtohet gjatë vitit 2021 në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

• **Aktiviteti i prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike & HEC Ashta për vitin 2020**
 Prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike (HEC-et me fuqi deri në 15 MW) në vitin 2020, pati një rënie prej 9.7%, ndërkohë që prodhimi i HEC Ashta ka patur një rënie në nivelin 2.2% më pak, krahasuar me prodhimin e vitit 2019. Grafikut në vijim, paraqesin ecurinë e energjisë së prodhuar dhe të ardhurat e realizuara në vite nga shitja e energjisë elektrike për prodhuesit me përparësi dhe HEC Ashta:




Figura 77 Ecuria e prodhimit në vite nga Prodhuesit me Përparësi dhe HEC ASHTA.




Figura 78 Të ardhurat nga prodhuesit me përparësi (Burimi OSHEE sh.a.)

Siç vërehet nga grafiku i mësipërm, niveli i të ardhurave të realizuara nga PPE dhe HEC Ashta ka patur një rënie të konsiderueshme, sidomos për këtë të fundit. Niveli i të ardhurave në rënie ka qënë respektivisht 15.92% për PPE dhe 7.32% për HEC Ashta.

Kosto e blerjes së energjisë elektrike në zbatim të kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.

FSHU sh.a., në zbatim të VKM Nr. 244, datë 30.03.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji

elektrike”, e ndryshuar, ka për detyrim blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen nga shteti (KESH), si dhe blerjen e energjisë në tregun e parregulluar, nëpërmjet shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë (FTL) për sasinë e pasiguar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë.

Shpenzimet e FSHU sh.a. për blerjen e energjisë elektrike nga KESH sh.a. përbëjnë rreth 24% të shpenzimeve totale për blerjen e energjisë elektrike.


Çmimi mesatar i blerjes së energjisë nga Tregu i lirë për vitin 2020 ka rezultuar përafërsisht 55.53 Euro/MWh ose 6.87 Lekë/kWh.

Grafikët në vijim paraqesin strukturën e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për vitin 2020 të krahasuar me ato të vitit 2019:



(Burimi: OSHEE Group sh.a.)

Figura 79 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për vitin 2020.




(Burimi: OSHEE Group sh.a.)

Figura 80 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për vitin 2019.


Sic vërehet nga struktura e shpenzimeve e paraqitur në grafikët e mësipërm, kosto e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesë për furnizimin e klientëve fundorë gjatë vitit 2020 krahasuar me vitin 2019 të FSHU sh.a, ka pësuar një rritje prej 3% nga energjia e prodhuar prej KESH sh.a., ndërkohë që ka rezultuar me një rënie prej 21% të kostos së blerjes së energjisë nga Tregu i lirë dhe në një rënie prej 28% të kostos së energjisë së blerë nga prodhuesit me përparësi.

Grafikët në vijim paraqesin strukturën e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2020 të krahasuar me ato të vitit 2019:



(Burimi OSHEE Group sh.a.)

Figura 81 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2020.



(Burimi OSHEE Group sh.a.)

Figura 82 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2019.

Sic vërehet nga struktura e shpenzimeve e paraqitur në grafikët e mësipërm, kosto e blerjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a, për mbulimin e humbjeve të shkaktuara në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike gjatë vitit 2020 krahasuar me atë të vitit 2019 ka pësuar një rënie në masën 11% për prodhuesit me përparësi, 2% për energjinë e blerë nga HEC Ashta, në 19% për energjinë e blerë nga Tregu i lirë, ndërkohë që kosto e blerjes së energjisë së prodhuar prej burimeve të vogla të rinovueshme të energjisë elektrike nga dielli deri në 2 MW ka pësuar një rritje prej 46% për arsye dhe të futjes në operim të inpianteve të reja prodhuese fotovoltaike.

Struktura e shpenzimeve lidhur me koston e blerjes së energjisë elektrike ka pësuar një rënie domethënëse gjendur në kushtet e pandemisë COVID-19 impakti i të cilës reflektohet dhe në tregjet ndërkombëtare të energjisë. Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profilin bandë (baseload) për vitin 2020 ka rezultuar 39.00 Euro/MWh me një rënie prej 22.6% nga ai i vitit 2019 prej 50.36 Euro/MWh sic paraqitet në tabelën në vijim:

Pershkrimi	2019	2020	Diference ne % 2020-2019
HUPX Base Average Price (EUR/MWh)	50.36	39.00	-22.6%

(Burimi HUPX)

Figura 83 Çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) për vitin 2019-2020

Pavarsisht rënies së koston së blerjes së energjisë, bazuar në raportimet e FSHU sh.a. viti 2020 ka rezultuar dhe me një ndryshim në të ardhurat të gjeneruara nga shitja e energjisë elektrike ndaj klientëve fundorë, respektivisht me një rritje prej 7.54% për klientët familjarë dhe me një rënie prej 9.29% për klientët jo familjarë ku në total të ardhurat e realizuara nga shitja e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. gjatë vitit 2020, kanë rezultuar me një rënie prej 1.34% krahasuar me të ardhurat e vitit 2019, sic reflektohet në tabelën në vijim:

Pershkrimi	Sasia (kWh)		Diference ne sasi 2020-2019	Diference ne % 2020-2019
	2020	2019		
Jo Familjare	2,062,090,577	2,263,212,008	(201,121,431)	-8.89%
Familjare	2,956,700,850	2,750,191,028	206,509,822	7.51%
Total	5,018,791,427	5,013,403,036	5,388,390	0.11%
Pershkrimi	Te ardhura (Lek)		Diference ne lek 2020-2019	Diference ne % 2020-2019
	2020	2019		
Jo Familjare	26,447,061,015	29,155,802,162	(2,708,741,147)	-9.29%
Familjare	28,095,065,686	26,126,107,697	1,968,957,989	7.54%
Total	54,542,126,701	55,281,909,859	(739,783,158)	-1.34%

(Burimi OSHEE Group sh.a.)

Figura 84 Sasia dhe të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për periudhën 2019-2020

Sic vërehet në tabelën e mësipërme, pavarsisht rënies së koston së blerjes së energjisë për qëllim të furnizimit të klientëve fundorë që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, sic dhe shpjeguar më lartë në këtë raport, kufizimet e ndodhura në periudha të ndryshme gjatë vitit 2020 prej pandemisë

COVID-19, kanë impaktuar të ardhurat nga shitja e energjisë elektrike si rrjedhojë e uljes së konsumit nga klientët jo familjarë me rreth 8.89% dhe rritjes të konsumit nga klientët familjarë me 7.51%.

4.1.7 Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite.

Në grafikun dhe tabelën në vijim, paraqitet ecuria e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike të miratuara ndër vite nga ERE në zbatim të legjislacionit në fuqi:




Figura 85 Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike të miratuara nga ERE ndër vite

Tipi i Aktivitetit	Njesia	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Prodhimi	Leke/kWh	0.78	0.78	0.40	0.63	1.00	1.00	1.00	1.45	1.45	1.45			
Hec-et egzistuese deri në 15 MW	Leke/kWh	6.50	6.50	7.40	7.57	7.77	7.53	7.53	7.636	7.448	7.448	8.5652	8.4582	* 8.0532 * 7.448
Hec-et e reja deri në 15 MW	Leke/kWh	9.37	9.37	6.00	6.89	9.30	9.73	7.95	7.636	7.448	7.448	8.5652	8.4582	* 8.0532 * 7.448
Implantet fotovoltaike 2MW	Euro/MWh										100.00	71.20		
Implantet fotovoltaike Lundrues 2MW	Euro/MWh												100.025	
Implantet Eolike MW	Euro/MWh										76.00		75.64	
Furnizuesi Publik me Shumicë	Leke/kWh	1.61	1.61	2.03	1.48	2.20	2.20	2.20	3.00	3.00				
Transmetimi	Leke/kWh	0.50	0.50	0.60	0.60	0.65	0.65	0.65	0.65	0.65	0.65	0.75	0.75	0.75
Tarifa mesatare e Shpërndarjes	Leke/kWh	5.70	5.70	5.70	6.30	5.00	5.00	5.00	4.79	4.79	4.79	4.79	4.79	4.79
Çmimi Mesatar për Klientet e Shërbimit Universal	Leke/kWh	8.45	8.45	9.53	9.53	9.53	9.53	9.53	10.70	10.70	10.70	10.70	10.70	10.70
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin 35 kV	Leke/kWh								1.50	1.50	1.50	1.50	1.50	1.50
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin 20 kV	Leke/kWh										3.90	3.90	3.90	3.90

Figura 86 Tarifat dhe Çmimet e energjisë elektrike periudha 2008 - 2020.

Në tablën e mësipërme, evidentohet çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga Prodhuesit Ekzistues me përparësi prej 8.0532 lekë/kWh sipas vendimit Nr.7, datë 16.01.2020 të Bordit të ERE dhe çmimi i aplikueshëm për Prodhuesit Ekzistues me përparësi prej 7.448 lekë/kWh në zbatim të ndryshimeve të VKM nr. 396, datë 13.05.2020 i miratuar me Vendimin nr. 94, datë 08.06.2020 të Bordit të ERE.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve mesatare të realizuara të shitjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a.




Figura 87 Çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike nga FSHU sh.a. për periudhën 2009 – 2020.

Bazuar në përlogaritjet mbështetur në strukturën e shitjes të shoqërisë FSHU sh.a. për vitin 2020, çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike i realizuar për klientët fundorë ka rezultuar 10.87 lekë/kWh, duke ardhur në një rënie prej 1.45% nga çmimi mesatar i shitjes së energjisë elektrike i realizuar në vitin 2019. Tabela në vijim paraqet çmimet mesatare të realizuara të shitjes së energjisë elektrike për kategoritë e ndryshme të klientëve fundorë sipas niveleve përkatëse të tensionit krahas çmimeve të miratuara nga ERE për vitin 2020:

Kategoria e Klienteve	Çmimi i Miratuar 2020		Çmimi mesatar i realizuar 2020	
	Aktive	Ne pik	Aktive	Ne pik
Kliente ne 20/10/6 kV	11.00	12.65	11.00	12.66
Furra buke dhe prodhim mielli 20/10/6 kV	7.10	8.17	7.57	8.74
Kliente te Lidhur ne 20/10/6 kV Matja ne TU (Kabine me nje abonent)	12.40	14.26	12.40	14.27
Kliente te Lidhur ne 20/10/6 kV Matja ne TU (Kabine me shume se nje abonent)	14.00	16.10	13.90	16.10
Kliente ne 0.4kV	14.00	16.10	14.00	16.09
Furra buke dhe prodhim mielli ne 0.4 kV	7.60	8.74	7.60	8.74
Objekte fetare	9.50	10.93	9.50	10.93
Familjare	9.50		9.50	
Ambjente te perbashketa	9.50		9.50	
Çmimi mesatar	10.70		10.87	

(Burimi OSHEE Group sh.a.)

Figura 88 Çmimi mesatar i realizuar i shitjes së energjisë elektrike për kategoritë e ndryshme të klientëve fundorë.

Çmimi faktik prej 7.57 lekë/kWh për kategorinë “Furra buke e prodhim mielli” për nivelin e tensionit 20/10/6 kV ka rezultuar më i lartë se ai i miratuar nga ERE prej 7.10 lekë/kWh për shkak të aplikimit nga ana e FSHU sh.a. të tarifës 7.6 lekë/kWh për ata klientë të kësaj kategorie të cilët ndryshe nga klientët e tjerë fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal, janë të lidhur në tension te mesëm ndërsa matjen e kanë në tension të ulët.

4.2 Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit për vitin 2020

Në mungesë të përditësimit të të dhënave të Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) lidhur me tarifat dhe çmimet e energjisë elektrike për vendet e rajonit, baza e këtyre të dhënave për vitin 2020 është marrë nga publikimet e EUROSTAT.

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike në eurocent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për klientët jofamiljarë për vitin 2020. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për klientët jofamiljarë për vendet e rajonit është 11.67 lekë/kWh.




Figura 89 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve jofamiljarë në vendet e rajonit për vitin 2020

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike në eurocent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për klientët familjarë për vitin 2020. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për klientët familjarë për vendet e rajonit është 11.92 lekë/kWh.




Figura 90 Çmimet e energjisë elektrike të klientëve familjarë në vendet e rajonit për vitin 2020

5. RREGULLIMI I SEKTORIT TE GAZIT NATYROR

5.1 Projekti TAP(Trans Adriatic Pipeline)

Projekti TAP ka për qëllim të lehtësojë transportin e gazit natyror të prodhuar në fushat e gazit në territorin e Republikës së Azerbajxhanit dhe për të furnizuar sipas Marrëveshjeve përkatëse të Shitjes së Gazit Shah Deniz (SD), por kryesisht të lehtësojë zhvillimin e fazës së II të fushës së Gazit Shah Deniz (SD).

Në 15 Nëntor 2020, Projekti TAP përfundoi. Ndërtimi i tubacionit tokësor përmes Greqisë, Shqipërisë dhe Italisë ka përfunduar në përputhje me të gjitha kriteret dhe standartet e një projekti gjigand. Kufizimet e COVID -19 ishin tek të gjitha vendet pritëse të TAP në vitin 2020, megjithatë, TAP vendosi një numër lehtësimesh të cilat ishin të suksesshme në parandalimin e vonesave të dukshme dhe kjo bëri që:

- Në Greqi të gjitha punimet kryesore të ndërtimit përfunduan. Dorëzimi nga projekti në operim/funksionim është përfunduar dhe mbushjet me gaz janë paraqitur tek të pesta (5) pjesët e tubacionit.
- Në Shqipëri, të përfundojë ndërtimi dhe mbushja me gaz e të gjitha seksioneve dhe provat e sigurisë janë paraqitur të gjitha pjesët e tubacionit.
- Në Itali, punimet e ndërtimit kanë përfunduar dhe është prezent gazi të gjitha pjesët e tubacionit. Pavarësisht kufizimeve për shkak të COVID – 19, në Itali, ku punimet kanë patur një ngadalësi, janë arritur një numër pikash kyçe gjatë vitit 2020 përfshirë përfundimin e tubacionit detar (në mënyrë të suksesshme mbi 98.4 km sipas planifikimit) dhe përfundimin e mikro-tunnelit në Blloqet 2 tek pjesa tokësore e gazsjellësit.

Pronat/Asetet tek të gjitha vendet pritëse(Greqi,Shqipëri,Itali) janë dorëzuar për operim dhe tani janë në kontroll nga kompaniaTAP AG sipas marrëveshjeve të nënshkruara.

Duke patur parasysh të gjitha arritjet teknike, në datën 15 Nëntor 2020 TAP realizoi Datën Komerciale të Operimit (**COD**) **ashtu si dhe** ishte parashikuar tek Vendimi i Përfundimit të Komisionit Europian dhe Paragrafi 4.10.2 i Opinionit Përfundimtar të Përbashkët i Autoriteteve Rregullatore në vend mbi përjashtimin e TAP nga kërkesat e aksesit të palëve të treta, rregullimit të tarifave dhe veçimit të pronësisë përcaktuar në Nenet 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të Direktivës 2009/73/EC.

Momentimi i Datës Komerciale të Vendosjes në Funksion (COD) në datën 15 Nëntor, përbën fillimin e periudhës 25 vjeçare të përjashtimit nga aksesit i palëve të treta, rregullimi i tarifave dhe veçimi i pronësisë. Që nga kjo datë dhe në vazhdim, Transportuesit e TAP duhet të paguajnë tarifa, si përcaktohet sipas Kodit të Tarifave të TAP dhe publikuar tek faqja zyrtare e TAP.

Korridori Jugor i Gazit (SGC)

Korridori Jugor i Gazit (SGC) është një nga zinxhirët më të ndërlikuar të gazit në botë, i cili sjellë Gaz nga rajoni Kaspikut, një rezervë e konsiderueshme mbi 100 triliard NM³Gaz, kjo do të thotë se rezervat janë disa herë më të mëdha dhe që garantojnë një siguri furnizimi, duke diversifikuar furnizimin me gaz nga Rusia, duke patur parasysh që nevojat për konsum të Europës për gaz është rreth 400 miliard NM³ në vit. Parashikohet që kjo sasi gazi do të vijë dhe ka filluar të vijë në drejtim

të tregjeve Europiane, kjo po ndodh dhe është herë e parë e një projekti të madh, dhe faktikisht u realizua brënda vitin 2020. Gazi Natyror nga fusha e Shah Deniz tashmë po bënë një rrugë prej 3,500 km nga Deti Kaspik në Europë. Kjo padyshim që kërkojë përmirësimin e disa infrastrukturave ekzistuese dhe zhvillimin e një zinxhiri të tërë për gazsjellësat e rinj që i përkasin këtij rajoni, dhe pikërisht:

- Zhvillimin e Shah Deniz II, në të cilën vazhdon periudha e shpim-konturimit (Rump-Up), për shtimin e prodhimit të gazit në Detin Kaspik.
- Përfundojë zgjerimi i impiantit të përpunimit të gazit në terminalin e Sangachal në bregun e Detit Kaspik në Azerbajxhan dhe dërgimi i gazit në Turqi për fazën e parë nëpërmjet projektit TANAP, në Korrik të vitit 2019.
- Përfunduan tre projekte gazsjellësish në zhvillim të njehershëm:
 - Gazsjellësi i Kaukazit të Jugut (SCPX) – Azerbajxhan, Gjeorgji
 - Gazsjellësi Trans Anatolian (TANAP) – Turqi
 - Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) – Greqi, Shqipëri, Itali
- Zgjerimi i rrjetit Italian të transmetimit të gazit.
- Mundësi për lidhje të tjera, Bullgari, me rrjetet e gazit në Europën Juglindore, Qendrore dhe Perëndimore

TAP tashmë është shtrirë përmes Greqisë, Shqipërisë, në tabanin e detit Adriatik dhe u bashkua me Sistemin Italian të Transmetimit të Gazit në zonën e San Foca në Italinë Jugore, çka mundëson lëvizjen e mëtejshme drejt tregjeve evropiane.




Figura 91 Rrjeti i transmetimit të gazit në rajonin tonë

Zhvillimi i Projektit TAP nga Kompania TAP AG. Aksionerët e Kompanisë

Gjatë vitit 2020 nuk kemi patur ndryshime aksionerësh, për këtë janë njoftuar të gjitha palët e interesuara përfshi edhe tre Autoritetet Kombëtare, ajo Greke, Italiane dhe Shqiptare.

Tashmë aksionerët e TAP AG janë: SOCAR (Azerbajxhan) me 20%, BP(Angli) me 20%, SNAM S.p.A (Itali) me 20%, Fluxys (Belgjikë) me 19%, Enagas (Spanja) me 16% dhe Axpo (Zvicrane) me 5%.

TAP një projekt strategjik për Shqipërinë dhe Europën Jug-Lindore

- TAP është pjesa Europiane dhe pjesa kryesore e Korridorit Jugor të Gazit, një projekt i rëndësishëm nga ana strategjike dhe ekonomike për BE dhe Komitetin e Energjisë.
- TAP është i domosdoshëm për të siguruar akses të besueshëm tek një burim i ri i gazit natyror nga Deti Kaspik dhe në një rrugë të re. TAP forcon diversifikimin e burimeve dhe rrugëve të furnizimit dhe mundëson gazifikimin e Europës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor, përfshirë gazifikimin e vendit tonë. TAP kontribuon në mënyrë aktive në krijimin dhe funksionimin e tregut Shqiptar të gazit.
- Ndër të tjera, TAP mbështet synimet e BE për tu bërë neutral ndaj klimës deri në vitin 2050 dhe nxit arritjen e synimeve të dekarbonizimit të BE dhe Komunitetit të Energjisë në mënyrë të veçantë TAP lejon përdorimin e mëtejshëm të gazit (natyror, të rinovueshëm, ose dekarbonizuar) duke zëvendësuar karburantet më të ndotura si qymyri, nafta/benzina dhe vajërave të rënda në transport, sektorët e ngrohjes dhe gjenerimit të energjisë, të përdorura më tepër në Europën Jug-lindore dhe Ballkanin Perëndimor.
- Gazsjellesi TAP është projektuar për të dyfishuar kapacitetin e tij deri në 20 Miliard NM³në vit (deri në 20 bcm / në vit) dhe për të dhënë mundësi çdo pale të interesuar të paraqesë një kërkesë në lidhje me gazsjellësin TAP, për sa kohë perputhet me kushtet teknike dhe rregullatore nga Opinioni Përfundimtar i Përbashkët.
- Në përgjithësi, TAP do të lehtësojë ndërlidhjen më të madhe midis vendeve në rajonin e Europës Jug Lindore dhe krijimin e një tregu rajonal të gazit plotësisht të integruar me Tregun European. Nëpërmjet këtij projekti vëndi jonë i jepet mundësia e krijimit të një njeje të domosdoshme për rajonin sepse jep mundësinë edhe të ruajtjes nëntokësore të gazit si dhe një terminal të gazit të lëngët LNG.

STATUSI I LEJUESHMËRISË së TAP

Para përfundimit të ndërtimit, përpjekjet e statusit të lejimit u përqëndruan tek paketat e Çertifikatës së Përdorimit/Shfrytëzimit dhe paraqitja e tyre tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për miratim para Datës së Vendosijes në Funkcion (COD).

Çertifikata e Përdorimit/Shfrytëzimit ishte leja e parë që ju dorëzua TAP-it pas përfundimit të punimeve të ndërtimit për të gjithë infrastrukturën e gazsjellësit të tij në territorin Shqiptar, përfshirë pajisjet/objektet në pjesën tokësore dhe atë detare.

Çertifikata e Përdorimit është një dokument zyrtar i nxjerrë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e cila çertifikon që ndërtimi i gazsjellësit është kryer në përputhje me termat dhe kushtet

e Lejes së Ndërtimit dhe që ndërtimi kur ai të përfundojë është i përshtatshëm për tu përdorur brenda të gjitha rregullave të sigurisë teknike dhe ambientale.

Aplikimet për Çertifikatën e Përdorimit filluan në vitin 2019 për secilën leje të Ndërtimit të nxjerrë për të gjitha pjesët tokësore dhe detare si dhe për stacionet e gazsjellësit në Shqipëri

Leja e Gazsjellësit për pjesën Tokësore është marrë në muajt Maj 2020 dhe Gusht 2020.

Në muajin Qershor 2020, TAP aplikoi tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë që të ndajë punimet për pjesën detare të gazsjellësit në dy faza, për të aplikuar për Çertifikatën e Përdorimit/Shfrytëzimit për punimet e përfunduara të instalimit të gazsjellësit para Datës së Vendosjes në Funkcion (COD). Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e ka miratuar atë, në Korrik 2020.

Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë inspektimet në terren për të gjitha pjesët e mbetura të lejuara nga TAP u organizuan dhe zhvilluan sipas paraqitjes së të gjitha Paketave të Çertifikatës së Përdorimit/Shfrytëzimit. TAP i mori të gjitha Çertifikatat e Përdorimit/Shfrytëzimit deri në 24 Shtator 2020. **Kjo në sajë të një pune të jashtëzakonëshme të kryer nga Ministria e Infrastrukturës dhe e Energjisë, jo që vetëm nuk solli pengesë, por shpejtoj procedurat që tubacioni të vendosej në punë në kohën e planifikuar.**

LIÇENSA PËR TË OPERUAR

Ndërkohë që është zhvendosur në fazën e operimit/funksionimit, TAP ka liçensa shtesë, autorizime, dhe leje që kanë lidhje me këtë fazë të projektit që duhet të merret nga autoritetet dhe ministritë e Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë përpara “Datës së Planifikuar për tu Vendosur në Funkcion” (në përgjithësi “*Liçensa për të Operuar*” ose “*LtO*”). Në këtë drejtim, TAP koordinoi shumë mirë punën me Autoritetet Rregullatore (NRA) dhe autoritetet e tjera në vend për të marrë liçensën e operimit (LtO) në kohën e duhur.

a) *Liçensa e Transmetimit*

ERE i ka dhënë TAP, me Vendimin nr. 14/31.01.2019, *Liçensën nr. 436 për Veprimtarinë e Transmetimit të Gazit Natyror në territorin e Republikës së Shqipërisë* për të përmbushur disa kushte të caktuara. TAP filloi punën për zbatimin e këtyre kushteve para dhe pas Datës së Vendosjes në Funkcion (COD). Si pasojë TAP ka paraqitur çertifikatat vërtetuese në ERE, sipas Vendimit të ERE Nr. 14 datë 31.01.2019 sipas Nenit 3(14) për dhënien e Gazsjellësit Trans Adriatik në Shqipëri Liçensën e Transmetimit për Territorin Shqiptar për një periudhë prej 25 vjetësh nga data e vendosjes në funksion. Përveç kësaj, TAP e ka informuar ERE që, sipas dispozitave të Paragrafit 4.5.3 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP është përjashtuar nga detyrimet për të paraqitur në ERE Planin Dhjetë-Vjeçar të Rrjetit të Transmetimit, çdo vit, si përmendur në Nenet 3(6) – 3(8) të vendimit të ERE Nr. 14 datë 31.01.2019 për dhënien e Liçensës së Transmetimit të Gazsjellësit Trans Adriatik. ERE përcaktojë disa kushte në liçensë që duheshin të plotësoheshin para fillimit të operimit të TAP. Në përfundim TAP-i paraqiti plotësimin e të gjitha kushteve brenda afateve të përcaktuara.

b) *Çertifikatat e Palëve të Treta për pajisjet e presionit*

Çertifikatat e Palës së Tretë (për pajisjet e presionit) janë siguruar për të gjitha pjesët e lejuara dhe objektet në Shqipëri.

TAP i ka regjistruar pajisjet e presionit tek Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial (STII) për dhe ka paraqitur Çertifikatat e Pajtueshmërisë për pjesët e gazsjellësit dhe pjesët detare tek Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

c) Çertifikatat për Mbrojtjen nga Zjarri

Janë marrë çertifikatat për Mbrojtjen nga Zjarri dhe të gjitha të tjerat që aplikohen vetëm për infrastrukturën tokësore.

d) Çertifikata e Pronësisë e TAP

Çertifikatat e Pronësisë të TAP do të merret nga Drejtoritë në vend të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës pas përfundimit të punimeve të ndërtimit për objektet e përhershme (stacionet e kompresimit në Shqipëri dhe valvulat e bllokimit në Shqipëri) dhe pas nxjerrjes së Çertifikatës së Përdorimit për punimet e ndërtimit.

Çertifikatat e Pronësisë të TAP do të mbulojnë pronat/objektet e përhershme të ndërtuara nga TAP në bazë të Ligjit nr. 107/2014 “Mbi Zhvillimin dhe Planifikimin Territorial” si dhe legjislacioni i sektorit dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave (të cilat aplikohen vetëm për Projektin TAP).

Çertifikatat e Pronësisë janë të ndryshme nga Çertifikatat e Pronësisë së Tokës dhe të drejtat/përdorimi i pronës që TAP ka marrë ose është në proces të marrjes ose ndryshimit me qëllim vendosjen në funksion të objekteve në territorin Shqiptar.

Aplikimi për Çertifikatat e Pronësisë do të fillojë pasi janë marrë projektet përfundimtare të ndertesave nga Kontraktoret.

e) Autorizime të tjera dhe procedura të konsumatorëve

Përveç sa më sipër dhe si pjesë e procesit të Liçensës së Operimit, TAP ka marrë Autorizimin e Punës sipas inspektimit të objektit nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shëndetësore.

Njoftimi për të gjitha Pajisjet Matëse të instaluar nëpër Stacione i është paraqitur Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë.

Autorizimet për Përdorimin e Radio Frekuencave gjatë Operimit (23 në total) janë marrë nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare në muajin Gusht 2020. (EPCA).

Procedurat doganore dhe tatimore që aplikohen për TAP gjatë fazës së kolaudimit (commissioning phase) të cilat janë marrë respektivisht në muajt Shkurt dhe Gusht 2020. Në Shtator 2020, TAP është lidhur me Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë në lidhje me procedurat doganore dhe tatimore që TAP duhet të ndjekë dhe të përmbushë gjatë fazës së Operimit.

Aspekti Rregullator i Projektit TAP

Përveç kontributit të tij të rëndësishëm për krijimin e tregut të gazit në Shqipëri, **TAP është i veçantë/unik nga ana rregullatore, për Shqipërinë si vënd kandidat për në BE:**

- TAP tejkalon juridiksionin e vendit tonë, një Palë Kontraktore në Komunitetin e Energjisë, e cila po transponon dhe përafuron në mënyrë aktive legjislacionin kombëtar me bazën ligjore të BE për energjinë (energjinë elektrike dhe gazin natyror) dhe të dy Shteteve Anetare të BE (Italia dhe Greqia);

- ERE i ka dhënë TAP, së bashku me Autoritetet Rregullatore Greke dhe Italiane (Autoritetet Rregullatore në vend NRA) (respektivisht RAE dhe ARERA), *përjashtimin nga dispozitat thelbësore të Direktivës së Tretë të BE për Gazin* (aksesin e palës së tretë, tarifën e rregulluar dhe veçimin e pronësisë) për një periudhë 25 vjeçare nga data e vendosjes në funksion të TAP;

Marrja e Vendimit të Përjashtimit përfshin **një bashkëpunim të shkëlqyer midis ERE dhe dy Autoriteteve të tjera Rregullatore**. Kjo për shembull tregohet tek dokumenta të ndryshëm të përbashkët që janë nxjerrë nga Autoritetet Rregullatore, si Opinioni i Përbashkët mbi Përjashtimin, Vendimi i Përbashkët për Çertifikimin e Operatorit të Pavarur të Transmetimit, Udhëzimet për menaxhimin dhe ndarjen e kapacitetit, dokumenta që kanë lidhje me testimin e parë të tregut, miratimin e Programit Rregullator të Pajtushmërisë së TAP, të Kodit të Tarifave, miratimin e Kodit të Rrjetit të TAP

PROGRESI I MARRËVESHJEVE PËR PROJEKTIN TAP

Marrëveshjet Komerciale

Në Nëntor 2013, TAP nënshkroi marrëveshje për transportin e gazit për kapacitetin fillestar prej 10 miliard meter kub në vit me tre transportues: Azerbajxhan Gas Supply Company (AGSC), SOCAR dhe Axpo Trading të cilat do të luajnë rolin e transportuesit të TAP nga Data e Vendosjes në Funksion (COD). SOCAR do të kryejë rolin e AGSC (Kompania e Furnizimit me Gaz në Azerbajxhan) si transportuese e TAP, në Mars 2036.

Në Mars 2016, marrëveshjet e transportit të gazit me AGSC dhe SOCAR në lidhje me Kapacitetin Fillestar të TAP u ndryshuan sipas Kapacitetit të Rezervuar tek Pikat e Daljes së TAP në Greqi. Ky ndryshim u fillua për të shmangur furnizimin me gas të zonave të tejmbushura të sistemit DESFA.

TAP organizoi Forumin e parë me Aksionerët në datën 12 Nëntor 2020, për të diskutuar rregullisht dhe për të trajtuar sfidat dhe mundësitë që kanë lidhje me shërbimet e transportit që ofron TAP. Autoritetet Rregullatore janë njoftuar për organizimin e Forumit të Aksionereve në datën 23 Tetor 2020.

TAP shpalli ankandet e para të rezervimit të kapacitetit platforma PRISMA, në datën 14 Nëntor, përmes ankandeve për kapacitetin e ditës në avancë në Melendugno dhe në Kipoi. **Shqipëria nuk mund të futej në këtë ankand sepse ende nuk ka ndërtuar rrjetin për furnizimin e konsumatorëve të tillë si TEC Vlorë, me një kapacitet të prodhimit të energjisë 100MWh/ditë.**

Marrëveshje të Tjera

Në muajin Shkurt 2013, u nënshkrua marrëveshja ndër – qeveritare midis Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë dhe u ratifikua në Itali sipas Ligjit nr. 153/2013, ku qeveritë e këtyre tre shteteve u angazhuan për mbështetjen e tyre të plotë për realizimin e projektit. Takimi i parë i Komisionit të Implementimit përcaktuar nga marrëveshja ndër qeveritare midis Italisë, Shqipërisë dhe Greqisë u mbajt në Tiranë në datën 25 Janar 2016 me pjesëmarrjen e TAP.

Si pasojë, TAP ka nënshkruar marrëveshje me qeverinë pritëse (**Host Government Agreement HGAs**) me Greqinë dhe Shqipërinë. Komisioni Europian ka nxjerrë një vendim në datën 3 Mars 2016 ku deklarohet se Marrëveshja me qeverinë Pritëse të Greqisë (**Greek HGA**) përputhet me Rregullat e BE

të Ndhimes së Shtetit (**State Aid**).

TAP finalizoi Marrëveshjet e Interkonjeksionit (**IAs**) me TANAP Doğalgaz İletim A.Ş. për Pikën e Interkonjeksionit të Kipoi.

TAP nënshroi Marrëveshjen e Interkonjeksionit me Snam Rete Gas S.p.A për Pikën e Interkonjeksionit të Melendugno dhe Marrëveshjen e Interkonjeksionit me DESFA S.A për Pikën e Interkonjeksionit të Nea Mesimvria.

Aktualisht TAP po përfundon diskutimet për Marrëveshjet e Interkonjeksionit me ICGB AD për Pikën e Interkonjeksionit të Komotini.

Përditësimi i Ecurisë së Projektit TAP

Në datën 1 Korrik 2019, TAP nisi Testimin e Tregut për vitin 2019, një proces komercial përmes të cilit transportuesit e gazit natyror mund të fitojnë akses tek kapaciteti afatgjatë i TAP, duke lejuar zgjerimin në të ardhmen të kapacitetit të gazsjellësit.

TAP e kreu Testimin e Tregut sipas një regjimi rregullator të përshtatur, të përfshirë tek Udhëzimet për Testimin e Tregut 2019 të Gazsjellësit Trans Adriatik (Udhëzimet). Këto Udhëzime u miratuan nga Autoritetet Rregullatore në muajin Qershor 2019 dhe u kërkua zbatimi i dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatoreve të Energjisë mbi Aplikimin e Përjashtimit të TAP AG, datë 6 Qershor 2013, dhënë nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC dhe Kodit të Tarifave të TAP me Rregulloren e BE 2017/459 për krijimin e Kodit të Rrjetit mbi Mekanizmat për Alokimin e Kapacitetit për sistemet e transmetimit të gazit (**CAM NC**).

Në datën 21 Tetor 2019, TAP publikoj së bashku me Snam Rete Gas dhe DESFA një Raport për Vlerësimin e Kërkesës (DAR), për të treguar përfundimin e fazës së Vlerësimit të Kërkesave.

Raporti për Vlerësimin e Kërkesës përmend treguesit jo detyrues të kërkesës në mënyrë të përmbledhur për çdo pikë interkonjeksioni të TAP me Operatorët fqinjë të Sistemit të Transmetimit të cilët kanë nisur proceset e Kapacitetit në Rritje sipas dispozitave të CAM NC, SRG dhe DESFA. Përveç kësaj po ashtu Raporti për Vlerësimin e Kërkesës përfshin treguesit jo detyrues të kërkesës të marra nga ana e TAP për pikën e interkonjeksionit të Kipoi (me TANAP), për pikat e interkonjeksionit në Shqipëri (me Alb gaz) dhe në Komotini (me ICGB). **Duhet të theksojmë se pikat e daljes në Shqipëri janë në Fier dhe Kuçovë dhe me Market Testin që po bëhet, do të shtohet edhe një në Korçë. Pika e daljes në Kuçovë(24'') është ndërtuar duke pasur parasysh detyrimin e TAP nga Opinioni i Përbashkët i Përgjithshëm i Rregullatorëve të Energjisë nga përjashtimi i TAP nga kërkesat për qasjen e palëve të treta, rregullimi i tarifave dhe ndarja e pronësisë të përcaktuara në nenet 9, 32, 41 (6), 41 (8) dhe 41 (10) të Direktivës së Gazit 2009/73 / EC dhe (FJO) ndërsa detyrimi për ndërtimin e pikës së daljes Fieri(16'') është në Marrëveshjen për Zhvillimin e Tregut të Gazit të miratuar nga Këshilli i Vendimi i Ministrave Nr. 233, datë 21/03/2017. Por e rëndësishme është që në vendin tonë të filloj ndërtimi i infrastrukturës së gazit, sepse konsumator që duhet të përdorin gazin në kemi, dhe nuk është problem që në çdo kohë të bëhet lidhja me rrjetin e transmetimit të TAP.**

Menjëherë pas publikimit të Raportit për Vlerësimin e Kërkesës (DAR), në datën 22 Tetor 2019, TAP filloi fazën e Koordinuar të Projektit. Gjatë kësaj faze TAP dhe OST fqinje kryen studime teknike për projektet për rritjen e kapacitetit nga ana e tyre të Pikave të Interkonjeksionit dhe bashkëpunuan për publikimin e përbashkët të draft Propozimit të Projektit në datën 20 Janar 2020. Në përfundim të konsultimeve publike në datën 21 Shkurt 2020, TAP dhe OST fqinje vazhduan përmirësimin e Propozimeve të Projektit, për ta paraqitur atë për miratim tek ARERA, RAE dhe ERE në Tetor 2020, sipas dispozitave të Nenit 28 të Kodit të Rrjetit mbi Mekanizmat për Alokimin e Kapacitetit (CAM NC). Pasi u diskutua me Autoritetet Rregullatore në datën 4

Qershor 2020, OST kanë shpallur në faqet e tyre të internetit fazën Detyruese të Ofertimit për Testimin e tregut për vitin 2019 që do të zhvillohet në Korrik 2021, ndërkohë që Faza e Informimit do të fillojë të paktën 2 muaj para kësaj.

TAP, së bashku me SRG dhe DESFA, planifikojnë të shpërndajnë në mënyrë jo formale Propozimet e Projektit me Autoritetet Rregullatore në muajin Janar 2021 dhe ta dërgojnë atë për miratim së shpejti pas kësaj.

Ecuria/përditësimi i projektit TAP – 100% i përfunduar

- Në datën 15 Nëntor 2020 TAP ka filluar funksionimin komercial.
- Që nga data 15 Nëntor dhe në vazhdim TAP ka filluar ankandet për rezervimin e kapacitetit tek Platforma për Rezervimin e Kapacitetit PRISMA.
- Në datën 31 Dhjetor 2020 TAP filloi transportin e parë të gazit në Itali dhe Greqi.

Në vitin 2020 TAP u bë një OST me të drejta të plota dhe filloi funksionimin komercial.

Disa nga arritjet rregullatore të cilat çojnë në momentet kyçe të funksionimit komercial.

- Në Qershor 2020, ERE së bashku me Autoritetet Rregullatore të Greqisë dhe Italisë miratuan Kodin e Rrjetit të TAP, i cili përfshin rregullat që drejtojnë funksionimin komercial të sistemit të transportit të TAP.
- Në muajin Gusht 2020, TAP hapi procesin e regjistrimit për çdo palë të interesuar për tu bërë një palë/transportues i regjistruar. Kjo është e nevojshme për rezervimin në të ardhmen të kapacitetit për gazsjellësin TAP.
- Që nga data 15 Nëntor 2020, TAP finalizoi profilin e saj tek Platforma Europiane e Transparencës dhe filloi të publikojë informacionin ditor/orar mbi kapacitetin teknik, atë në dispozicion dhe të rezervuar si dhe çdo informacion mbi transparencën që kërkohet nga rregullorja e BE dhe Legjislacioni Shqiptar i Gazit Natyror 102/2015.
- TAP finalizoi dhe ngarkoi faqen zyrtare të internetit ku shfaqen të gjitha informacionet mbi aktivitetin operacional të TAP, përfshirë Platformën Elektronike të të Dhënave ku tregu i gjerë dhe konsumatorët e TAP duhet të aksesojnë të dhënat operacionale për çdo pikë interkonjeksioni (p.sh. rrjedhat fizike, kapacitetet teknike, ato në dispozicion, kapacitetet e rezervuara dhe të dhënat e matura, etj).
- TAP bashkëpunoi me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë (EnCS) dhe ERE (si dhe Autoritetet Rregullatore Greke dhe Italiane) në lidhje me zbatimin e kërkesave të certifikimit të Udhëzuesit të Operatorit të Pavarur të Transmetimit, përfshirë Programin Rregullator të Pajtuëshmërisë të TAP. Në muajin Shtator 2020, ERE ka miratuar Programin e Pajtuëshmërisë Rregullatore të TAP për funksionimin.

Që nga Data e Vendosjes në Funkzion – 15 Nëntor 2020 dhe në vazhdim:

- Ka filluar funksionimin periudha prej 25 vjetësh e përjashtimit nga aksesi i palës së tretë, rregullimi i tarifës dhe veçimi i pronësisë që i janë dhënë TAP nga Komisioni Europian.
- TAP u bë Operator i Pavarur i Sistemit të Transmetimit me të drejta të plota (ITO TSO).
- Filluan të hynë në fuqi Marrëveshjet e Transportit të Gazit me Transportuesit e TAP.
- Që nga kjo datë dhe në vazhdim Transportuesit e TAP duhet të paguajnë tarifën, si përcaktohet në përputhje me Kodin e Tarifës së TAP dhe publikuar tek faqja zyrtare e TAP.
- Afati 25 vjeçar i Liçensës së Transmetimit që i është dhënë TAP nga ERE në datën 31 Janar 2019, filloi funksionimin dhe si pasojë TAP u liçensua për të kryer aktivitetet e transportit të gazit natyror në territorin Shqiptar për një periudhë 25 vjeçare.
- 878 km të gazsjellësit, pjesë e Koridorit Jugor të Gazit hynë në fazën e funksionimit. Rrjedha nga Azerbajxhani në Itali dhe Greqi filloi në 31 Dhjetor 2020. Një vlerësim i përafërt i sasive të energjisë dhe volumeve të gazit që transportohen nga TAP midis datave 31 Dhjetor 2020 dhe deri në 19 Janar 2021:

31 Dhjetor 2020 – 19 Janar 2021	Total KWh	Total MNm ³
Pika e hyrjes e TAP (Kipoi)	2,916,055,437	248,312,295
Pika e daljes e TAP (Nea Mesimvria - Greqi)	646,610,042	55,507,296
Pika e daljes e TAP (Melendugno – Itali)	2,203,725,976	187,742,884

- TAP do të drejtojë ankandet e kapacitetit sipas Kalendarit të Ankandëve të ENTSOG tek Platforma për Rezervimin e Kapacitetit e PRISMA. Midis datës 15 Nëntor dhe në përfundim të vitit 2020 TAP drejtojë ankandet e ditës në avancë dhe ato mujore për rezervimin e kapacitetit të sigurt dhe kapacitetit komercial të kthyer tek TAP tek Pika e Interkonjeksionit e Kipoi, ajo në Melendugno dhe Pika e Interkonjeksionit në Nea Mesimvria.
- **Për momentin, nga Shqipëria nuk del gaz, mbetet pezull rrjeti i transmetimit të gazit në Shqipëri dhe rezervimi i kapacitetit në Fier ose në Kuçovë i planifikuar për pikat e daljes. Është tepër emergjente ngritja e infrastrukturës së gazit sepse jo vetëm është më ekonomike përdorimi i tij, por ka edhe emetime shumë herë më të vogla, duke ulur në masë të konsiderueshme ndotjen e ambientit. Konsumatori i parë duhet të jetë TEC-i i ndërtuar në Vlorë, i cili ende nuk është vënë në funksion. Theksojmë se me vendosjen në punë të TEC-it me gaz kostoja e importit të energjisë elektrike përgjysmohet si dhe do të ndikojë në uljen e humbjeve teknike për jugun e Shqipërisë.**
- **Zhvillimi i projektit IAP (Ionian Adriatic Pipeline) sepse do të shërbente si një magjstral kryesor ku do të furnizonte të gjitha qytetet e shqipërisë që nga Fieri e deri në Shkodër, dhe jo vetëm, por do të shërbente edhe një nyje lidhëse me rajonin tonë; Mali i Zi, Kosovë, Bosnje – Hercegovina deri në Kroaci.**
- **Zhvillimi i Projektit për ruajtjen nëntokësore të gazit në rajonin e Dumresë së bashku me projektin e LNG do ta bënin vëndin tonë një nyje (hub) për rajonin ku ndodhemi.**

Zgjatja e Përrjashtimit të TAP

Në datën 15 Qershor 2020, TAP na kërkoi në mënyre formale, ne, Autoriteteve Rregullatore për zgjatjen/shtyrjen e datës kur “infrastruktura të vendoset në funksion” (që do të thotë datën komerciale të funksionimit), duke qënë që kësaj date i referohemi tek Përrjashtimi. Në lidhje me këtë, TAP paraqiti aplikimin për shtyrjen ku përcakton strukturën e Përrjashtimit (përrfshirë shtyrjen e parë), si dhe arsyetimin se pse shtyrja e dytë mund të jetë e domosdoshme për fillimin komercial të funksionimit të TAP. TAP shpjegoi me detaje vonesat për pengesat madhore përtej kontrollit të saj. Duhej të plotësohej vetem kushti që ka të bëjë me datën kur “infrastruktura të vendoset në funksion” që është i rëndësishëm për aplikimin e TAP dhe jo permbajtja dhe kushtet e mbetura të Përrjashtimit.

Në vijim të kësaj,

- ARERA miratoi vendimin mbi shtyrjen, ku përrfshihet opinioni i përbashkët i Autoriteteve Rregullatore, nëpërmjet Deliberazione (në gjuhën Italiane) 231/2020/R/gas datë 23.06.2020.
- ERE miratoi Vendimin nr. 104 “mbi miratimin e Opinioneve të përbashkëta të rregullatorëve të energjisë mbi kërkesën e TAP AG për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së vendimit të përrjashtimit”, nga parashikimet e neneve 9, 32 dhe 41(6) dhe (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC” datë 29.06.2020, që më pas ju dërgua Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë nga ERE në datën 30.06.2020.
- RAE i njoftoi BE në datën 30.06.2020, Vendimin e saj nr. 1037/2020 në lidhje me ‘miratimin e kërkesës së kompanisë TAP AG që zgjat përrjashtimin e gazsjellësit TRANS ADRIATIC PIPELINE (TAP) nga dispozitat e Neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) Direktiva 2009/73/EC.

Për më tepër, duke qënë të sigurt për datën komerciale të vendosjes në funksion 15 Nëntor 2020, në datën 4 Nëntor 2020, TAP ka paraqitur kërkesat për tërheqjen e aplikimit për një shtyrje të dytë të Vendimit të Përrjashtimit tek Autoritetet Rregullatore Italiane, Greke dhe Shqiptare si dhe tek Ministria Italiane për Zhvillimin Ekonomik. **ERE ka konfirmuar në datën 10 Nëntor që Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka marrë tërheqjen e aplikimit të TAP për shtyrjen e dytë.**

Aktivitetet e Transparencës dhe REMIT

Në përputhje me Rregulloren e REMIT (Regulation Energy Market Integrity and Transparency), Rregullimi i Tregut të Energjisë Integritetit dhe Transparencës, dhe Rregulloren që Zbaton REMIT, TAP ka publikuar në faqen e saj të internetit dhe tek Platforma e Transparencës së ENTSOG (Shoqatën e Sistemit të Transmetimit Europian të Gazit) “Mesazhin e saj të parë Urgjent” mbi Tregun në datën 12 Tetor, ku njoftonte tregun se TAP po përgatitej të fillonte funksionimin tregëtar/komercial. Ky mesazh i parë u ndoq nga 2(dy) mesazhe të tjera në datat 11 dhe 12 Nëntor, nëpërmjet të cilave TAP njoftoi se në bashkëpunim me OST fqinje, fillojnë në 15 Nëntor 2020 ankandet e ditës në avancë për Pikën e Interkonjeksionit të Melendugno dhe fillimin e ankandëve mujore në Pikën e Interkonjeksionit të Nea Mesimvria në datën 21 Dhjetor 2020. Për më tepër, në datën 20 Nëntor 2020 TAP ka publikuar një Mesazh tjetër Urgjent mbi Tregun ku shpallej që TAP do të jetë në gjendje të sigurojë në treg Kapacitet Tregëtar në drejtim të Kundërt (**Commercial Reverse Capacity**) në muajin Dhjetor 2020. Kapaciteti Komercial në Drejtim të Kundërt ofrohet nga TAP përmes një ankandi të vetem si kombinim i Pikës hyrëse të Interkonjeksionit në Melendugno dhe Pikës dalëse të Interkonjeksionit në New Mesimvria.

Për më tepër TAP e ka plotësuar profilin e saj, tek Platforma e Transparencës së ENTSOG, sipas detyrimeve të transparencës së Rregullores 715/2009 mbi kërkesat e Transparencës. TAP ka përditësuar informacionin

operacional tek ENTOSOG TP, si atë për kapacitetet në dispozicion, të rezervuara dhe teknike, për ndërprerjet e planifikuara të kapacitetit të sigurt dhe te planifikuara të kapacitetit të ndërprerë, si dhe informacionin mbi tarifat. Po ashtu TAP ka publikuar planifikimin vjetor të mirëmbajtjes sipas afateve të vendosura nga Rregullorja 715/2009 e datës 15 Nëntor. TAP vazhdon të dërgojë të dhëna të grumbulluara operationale për ENTOSOG për arsye transparence, çdo ditë ose orë.

Gjatë gjithë fazave TAP i ka raportuar (Këshilli European i Rregullatorëve të Energjisë) ACER përfundimin dhe kryerjen mujore të marrëveshjes së furnizimit me gaz. Gjatë fazës së operimit, TAP ka filluar raportimin tek ACER për përfundimin e marrëveshjeve të furnizimit me gaz për operimet sipas detyrimeve të TAP tek REMIT dhe Rregullorja e Implementimit të REMIT.




Figura 92 Projekti TAP në Shqipëri

TAP po bashkëpunon dhe do të vazhdojë bashkëpunimin me ERE për çështje të caktuara, si:

- Pajtueshmëria në vazhdim me kushtet e vendosura për TAP tek Liçensa e Transmetimit e dhënë nga ERE (që do të thotë paraqitja në ERE e çertifikatave të sigurisë për palët e treta çdo vit, përgatitja dhe paraqitja e një Raporti Operacional që nga data 15 Shkurt e çdo viti, paraqitja e pasqyrave financiare dhe raporteve të auditit që nga data 30 Qershor e çdo viti, etj).
- Proçesi i Testimit të Tregut dhe miratimi i Propozimit të Projektit, para fillimit të Detyrueshëm të Testimit të Tregut në muajin Korrik 2021.
- Përmbushja e detyrimeve të tjera të cilat rrjedhin nga vendimet e nxjerra nga ERE dhe nga legjislacioni i miratuar nga Parlamenti.
- ERE po bashkëpunon edhe me hartimin e Librit të Rregullave për fazën e Operimit të TAP pas fazës së ndërtimit të Tij.

Market Testi për Zgjerimin e Kapacitetit

Tashmë ka filluar Market Testi për zgjerimin e kapacitetit. Ai është harmonizuar me dispozitat e Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e Përrjashtimit të TAP AG, datë 6 Qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, (“Opinion

Përfundimtar i Përbashkët”) i Kodit të Tarifave të TAP¹ me Rregulloren e BE 2017/459 duke krijuar kodin e rrjetit mbi Mekanizmat e Alokimit të Kapacitetit tek sistemet e transportit të gazit (“CAM NC”).

Sipas Paragrafit 4.1.7 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, Udhëzimet miratohen nga Autoritetet kompetente Rregullatore të Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë. (“Autoritetet”), përkatesisht ARERA, RAE dhe ERE.

Kërkesa për Zgjerimin e Kapacitetit

Për kapacitetin e tij fillestar, TAP përjashtohet nga dispozitat e aksesit të palëve të treta, tarifave të rregulluara dhe veçimi i pronësisë sipas afateve të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët. Përjashtimi nga tarifave të rregulluara dhe veçimi i pronësisë po ashtu aplikohet për Kapacitetin e Zgjerimit aktual të ndërtuar të TAP.

Sipas Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, TAP duhet të kryejë një Testim të Tregut të paktën çdo dy vjet, duke filluar jo më vonë se Data e saj Komerciale e Vendosjes në Funkcion (‘COD’)

Neni 26 i Mekanizmit për Alokimin e Kapacitetit për Kodin e Rrjetit i kërkon Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të kryejnë një procedurë të koordinuar dhe që bazohet tek tregu për të vlerësuar nevojën për rritje kapaciteti.

Testimi i Tregut

Testimi i Tregut është një procedurë transparente, e hapur dhe jo diskriminuese. Procesi pasqyron kontekstin Rregullator unik dhe specifik të Transportuesit dhe përfshin udhëzimet se si TAP do të marrë pjesë në procesin e gjerë për rritjen e kapacitetit të percaktuar në Kapitullin V të Mekanizmit për Alokimin e Kapacitetit të Kodit të Rrjetit.

TAP kërkon që çdo Projekt Zgjerimi duhet të përmbajë dispozita të veçanta për të qënë në përputhje me Opinionin Përfundimtar të Përbashkët. Konsultimi duhet të përmbajë informacionin sipas Nenit 27 (3) të Mekanizmit të Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit (CAM NC). Kjo do të përfshijë rregullat të cilat drejtojnë Fazën Detyruese, përfshirë çdo alternativë tjetër për mekanizmin e alokimit në kuptim të Nenit 30 të Mekanizmit të Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit. Kjo alternativë tjetër e Mekanizmit të Alokimit mund të parashikohet të jetë e nevojshme për të lejuar pajtueshmërinë me rregullat e përcaktuara në Pjesën 3 të Kodit të Tarifave të TAP. Ajo po ashtu duhet të përfshijë mekanizmin e ankandit të përcaktuar në Pjesën 3. 3. 1 (e) të Kodit të Rrjetit të TAP.

Pas konsultimit, TAP dhe OST Fqinje do të finalizojnë hartimin e Projektit të propozuar për Zgjerimin dhe do ta paraqesin për miratim tek Autoritetet përkatëse. Sipas Nenit 28 (2) të Mekanizmit të Alokimit të Kapacitetit të Kodit të Rrjetit (CAM NC), brenda 6 muajsh nga marrja e propozimit përfundimtar të projektit nga Autoriteti i fundit përkatës, ato duhet të publikojnë vendime në koordinim me njëri – tjetrin mbi propozimin e projektit. Propozimet e projektit ku përfshihen një ose me shumë Kërkesa për Lidhje mund të trajtohen në mënyrë individuale sipas një afati të ndarë, pasi këto kërkesa nuk i nënshtrohen testit ekonomik, por vetëm testit të realizueshmërisë teknike. Sipas Paragrafeve 4.7.5 dhe 4.7.8 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët, kostot për këto kërkesa do të

¹ Miratuar në Nëntor 2013 nga Autoritetet Rregullatore Italiane, Greke dhe Shqiptare. Po ashtu është miratuar një ndryshim në muajin Korrik 2018.

përballohen nga pala e tretë që e ka bërë kërkesën, sipas legjislacionit të vendit në kohën kur është bërë kërkesa.

Market Testi do të shërbejë për zgjerimin e kapacitetit në hyrje të projektit por gjithashtu edhe pikën e lidhjes që është kërkuar në Korçë, sepse ajo e Fierit dhe e Kuçovës tashmë ekzistojnë.

5.2 Aktet nënligjore të nxjerra nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria për Sektorin e Gazit Natyror.

Është bërë një punë e madhe për hartimin e legjislacionit sekondar për sektorin e gazit natyror kjo si nga ministria e linjës, ashtu edhe nga ERE dhe Albغازi, rreth 80 akte ligjore, nënligjore dhe urdhëra kanë kompletuar të gjithë kornizën ligjore për një funksionim normal të tregut të gazit në vëndin tonë. Më poshtë po i trajtojmë shkurtimisht sipas radhës vetëm ato që janë miratuar gjatë vitit 2020:

- **VKM nr. 702, datë 9.9.2020** “Për miratimin e procedurës dhe të kritereve për emërimin e administratorit të përkohshëm, i cili do të jetë përgjegjës për administrimin e përkohshëm të shoqërisë ndaj së cilës është vendosur detyrimi i shërbimit publik, të cilës i është hequr licënsa”.
- **VKM nr. 857, datë 04.11.2020**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, pjesa e gjashtë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, të ndërtimit dhe të operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, të hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte.”
- **VKM nr. 294, datë 14.04.2020**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, pjesa e pestë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
- **VKM nr. 659, datë 27.08.2020**, “Për miratimin e rregullave teknike dhe të kritereve të sigurisë, pjesa e shtatë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
- **VKM nr. 678, datë 02.09.2020**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, pjesa e tetë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
- **VKM nr. 679, datë 02.09.2020**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, pjesa e nëntë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
- **Urdhëri nr. 170, datë 08.06.2020, i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë**, “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së kartës së identifikimit për inspektorin që kryen inspektim teknik në sektorin e gazit natyror”,
- **Urdhëri nr. 184, datë 17.06.2020, i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë**, “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën e tyre për shkeljet në aktivitetet në sektorin e gazit natyror”,

- **Urdhër nr. 279, datë 1.10.2020 i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë**, “Për përcaktimin e rregullave për ushtrimin e funksionit mbikëqyrës të ministrisë në aktivitetin e operatorëve të gazit natyror për koordinimin e operacioneve në terren”
- **Urdhër nr. 280, datë 1.10.2020 i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë**, “Për miratimin e formës dhe të praktikave në marrëdhëniet ndërmjet strukturës përgjegjëse, që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror në ministri, dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror”.
- **Urdhër nr. 281, datë 1.10.2020 i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë**, “Për përcaktimin e rregullave për përmbajtjen e urdhrimit të inspektimit, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), në rolin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror, për kryerjen e inspektimeve në objektet e transmetimit, shpërndarjes dhe depozitimit të gazit natyror, të terminaleve të gazit natyror të lëngëzuar, si dhe të objekteve të tjera të gazit”.

5.3 Aktet nënligjore të miratuara nga ERE gjatë vitit 2020 për ushtrimin e veprimtarisë në sektorin e Gazit Natyror.

Vendimmarrjet e mëposhtme lidhen me miratimin e kuadrit ligjor të ERE-s në funksion të zbatimit të ligjit 102/2015 për sektorin e gazit natyror si dhe përgatitja e kushteve të tregut me fillimin e operimit të gazit në vitin 2020, i cili përkon me startimin e projektit TAP:

Në lidhje me Projektin TAP

Gjatë vitit 2020 është bërë një punë cilësore lidhur me vendimmarrje të rëndësishme dhe të nevojshme për realizimin në kohë dhe vendosjen në operim brenda afateve kohore të projektit madhor TAP AG. Gjatë vitit 2020, është zhvilluar një punë intensive në lidhje me miatimin e disa vendimeve të domosdoshme, nga autoritetet e të tre vendeve ku kalon projekti i TAP AG, sipas kërkesave të paraqitura nga ky i fundit:

1. Vendimi nr.97, datë 15.06.2020 “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit TAP AG”

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, neneve 13; 15, pika 1, gërma "a"; 16, pika 24 dhe nenit 108, të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e gazit natyror" i ndryshuar; Direktivës 2009/73/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 13 Korrikut 2009; Rregullores së Parlamentit Evropian dhe Këshillit 942/2019 e datës 5 Qershor 2019; Rregullores së Parlamentit Evropian dhe Këshillit 715/2009 e 13 korrikut 2009 e ndryshuar me Vendimin e Komisionit të 24 gusht 2012, Rregullores së Komisionit të BE 312/2014 e datës 26 Mars 2014; Rregullores së Komisionit të BE 2017/459 e datës 16 Mars 2014; Vendimit të Komisionit Evropian të datës 16 Maj 2013, i cili përmban "Përfundimin e tubacionit Trans Adriatik nga kërkesat për qasjen e palëve të treta, rregullimin e tarifave dhe ndarjen e pronësisë, të percaktuara në nenet 9, 32, 41(6), 41(8) dhe 41(10) të Direktivës 2009/73/EC; Dispozitave të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatoreve të Energjisë mbi Aplikimin e Përfundimit të TAP AG, datë 6 Qershor 2013, lëshuar nga Autoritetet sipas Direktivës 2009/73/EC, (“Opinionit Përfundimtar i Përbashkët”), Nenit 4.7.1 të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët; Dispozitat e Rregullores 715/2009 dhe të Kodeve Europiane të rrjetit të cilat nuk janë në konflikt me Opinionin Përfundimtar të Përbashkët; Letra

dërguar nga TAP AG më datë 20 Dhjetor 2019; Letra dërguar nga TAP AG më datë 10 Qershor 2020; si dhe neneve 15 dhe 26 të "Rregullores të Organizimit, Funkcionimit dhe Proçedurave të ERE-s", miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.06.2020, shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi "Miratimin e Kodit të Rrjetit TAP".

2. Vendimi nr.105, datë, 29.06.2020. "Mbi miratimin e zyrtarit të përputhshmërisë(ZP) së TAP AG dhe kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të përputhshmërisë"

Në zbatim të Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim: Direktiva 73/09); Rregullores 713/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009; Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në vijim Rregullorja 715/09); Paragrafi 4.10.2 i Opinionit përfundimtar të përbashkët përshkruan që në përputhje me nenin 36 (9) të Direktivës së gazit, Përfundimi do të humbë efektet e tij 3 vjet pas miratimit në rastin kur ndërtimi i TAP nuk ka filluar akoma dhe 6 vjet pas miratimit në rastin kur infrastruktura nuk është vendosur akoma në funksion, derisa Komisioni të vendosë që çdo vonesë tjetër është për shkak të pengesave kryesore përtej kontrollit të personit të cilit i është dhënë përjashtimi.

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 16 dhe 19 të Ligjit Nr.102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" dhe nenit 15 të "Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Proçedurave të ERE", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.96, datë 17.06.2016, nenit 5 gërma 'c' të "Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr 65, datë 26.03.2018, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.06.2020, shqyrtoi relacionin dhe draftin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror për Miratimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë (ZP) të TAP AG.

3. Vendimi nr.149, datë 10.09.2020. "Mbi miratimin e "Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme" paraqitur nga TAP AG në bazë të "Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion" në kuadër të proçedurës së përjashtimit për gazësjellësin TAP AG"

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, neneve 13; 15, 16 dhe nenit 108, të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, si dhe nenit 15 të "Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Proçedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.09.2020, shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi miratimin e "Programit Të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme, paraqitur nga TAP AG.

Në lidhje me vendimet e tjera për aktet nënligjore për gazin natyror kemi miratuar:

1. Vendimi nr.145, datë 28.08.2020.”Mbi fillimin e procedurës për miratimin e draftit të ‘Kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit’”

ERE miraton “Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit për Klientët Fundorë”, duke përfshirë këtu edhe hartimin në mënyrë transparente të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të përgjithshme, në shërbimin e furnizimit të ofruar nga të Liçensuarit në aktivitetin e furnizimit publik në Sektorin e Gazit Natyror. Në këtë rregullore përcaktohet se Kontratat e furnizimit me gaz natyror nuk duhet të kenë pengesa në ushtrimin e të drejtave të klientit fundorë dhe nuk duhet të paraqesin metoda të padrejta ose ç’orientuese të shitjes, matjes, faturimit dhe/ose pagesës. Kontratat e furnizimit me gaz natyror nuk duhet të përmbajnë dispozita që mund të parandalojnë ose pengojnë klientin nga ndërprerja e njëanshme e kontratës, sipas afateve dhe kushteve të vendosura në këto Rregulla dhe/ose ndryshimi pa pagesë i furnizuesit sipas rregullave të ndryshimit të furnizuesit, të miratuara nga ERE.

Kjo metodologji shërben për përcaktimin e tarifës së shitjes së gazit natyror të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, bazuar në parime të qarta të tarifimit dhe detajimin e të dhënave të nevojshme për përcaktimin e tarifave sa më të drejta dhe transparente në këtë fushë të rëndësishme. Në mbështetje të nenit 16 dhe neneve 75, 89, 92, 93 dhe 94 të Ligjit nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" i ndryshuar, si dhe nenit 26 të “Rregullores të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.08.2020, shqyrtoi relacionin nr. 98/4 Prot, datë 26.08.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e draftit që parashikon kushtet e përgjithshme të Kontratës Tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit.

2. Vendimi nr.148, datë 10.10.2020 ‘Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat për dhënien e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror’”

Është iniciuar procedura për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat për dhënien e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror. Objektivi i kësaj rregulloreje është të sigurojë nxitjen e investimeve në infrastrukturën kryesore të re, duke garantuar funksionimin e tregut të gazit natyror. Qëllimi i kësaj rregulloreje është: Të përcaktojë rregullat për një procedurë përjashtimi transparente, jo diskriminuese dhe të arsyetuar në përputhje me rregullat e paketës së tretë të energjisë. Procedura që aplikohen për përjashtimin në këtë Draft rregullore, janë bazuar në parashikimet e nenit 78 të ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

Në mbështetje të nenit 16 dhe 32 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 38, nenit 43, pika 1 dhe nenit 78 të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, (ERE) në mbledhjen e tij të datës 10.09.2020, shqyrtoi relacionin nr.99/3 datë 03.09.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat për dhënien e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror.”

3. Vendimi nr.164, datë 22.10.2020. ‘Mbi fillimin e procedurës për miratimin e ‘Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror’

Në mbështetje të nenit 16; të Ligjit Nr. 43/2015 ‘Për Sektorin e Energjisë Elektrike’, i ndryshuar; nenit 16; të Ligjit Nr. 102/2015 ‘Për Sektorin e Gazit Natyror’, i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26 të ‘Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s’, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, shqyrtoi relacionin me nr. 114/1 Prot, datë 16.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e ‘Rregullave për monitorimin e tregut të Gazit Natyror’.

4. Vendimi nr.165, datë 22.10.2020. ‘Mbi fillimin e procedurës për miratimin e ‘Kodit të Matjes të Gazit Natyror’

‘Kodi i matjes’ është tërësia e normave minimale të detyrueshme për matjen dhe regjistrimin e gazit natyror. Kodi i Matjes përcakton kërkesat teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes të Gazit Natyror, që do të jetë i përshtatshëm për matje, për mbledhjen e të dhënave, regjistrimin e tyre dhe zbatimin e procedurave përkatëse sipas Rregullave të Tregut dhe Marrëveshjeve midis Palëve . Draft Kodi i Matjes së Gazit Natyror u hartua si dokument në zbatim të Ligjit nr.102/2015 ‘Për Sektorin e Gazit Natyror’, i ndryshuar, dhe si pjesë e veçantë nga Kodi i Transmetimit të Gazit në Shqipëri.

Në mbështetje të nenit 16; të Ligjit Nr. 43/2015 ‘Për Sektorin e Energjisë Elektrike’, i ndryshuar; nenit 4 pika 39, nenit 104 pika 1, nenit 116 pika 4 të Ligjit Nr. 102/2015 ‘Për Sektorin e Gazit Natyror’, i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26 të ‘Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s’, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, shqyrtoi relacionin me nr. 114/2 Prot, datë 16.10.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e ‘Kodit të matjes të Gazit Natyror’.

5. Vendimi nr.166, datë 22.10.2020. ‘Mbi miratimin e ‘Kushteve të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit’

Në mbështetje të nenit 16 te Ligjit nr. 43/2015, ‘Për Sektorin e Energjisë Elektrike’, të ndryshuar; nenit 4 pika 33 dhe 44, nenit 93 pika 1 dhe nenit 92 pika 1 të Ligjit Nr. 102/2015 ‘Për Sektorin e Gazit Natyror’, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të ‘Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s’, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.10.2020, shqyrtoi relacionin me nr. 114/5 Prot, datë 19.10.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi miratimin e ‘Kushteve të përgjithshme të Kontratës Tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit’.

6. Vendimi nr.193, datë 20.11.2020. ‘Mbi fillimin e procedurës për miratimin e liçensës tip për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror’

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe seksionit II, neni 22, 23 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.11.2020, shqyrtoi relacionin me nr. 123/1 prot., datë 19.11.2020 për fillimin e procedurës për miratimin e liçensës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoritë Gazit Natyror.

7. Vendimi nr.193, datë 20.11.2020. ‘Mbi fillimin e procedurës për miratimin e liçensës Tip për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të Gazit Natyror’.

Qëllimi i këtij Dokumenti të Aktit Rregullator për Depozitimin e Gazit është të konfirmojë kriteret që do të përdoren në përcaktimin e procedurës më të përshtatshme të depozitimit të gazit për Republikën e Shqipërisë, duke pasur parasysh fazat e hershme të projekteve të depozitimit në vëndin tonë. Të përcaktojë kriteret më të përshtatshme të aksesit për këto ambjente depozitimi, pavarësisht se ende jemi në fazën fillestare; nuk kemi infrastrukturë gazi, nuk kemi konsum gazi, por kemi kushte depozitimi jo vetëm për vëndin tonë, por edhe për të gjithë rajonin, gjë që bën Shqipërinë të jetë një vend kyç (HAB) për depozitim. Të mbështesë zhvillimin e mjediseve të depozitimit të gazit në Shqipëri, të promovojë zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një industrie efikase, ekonomike dhe të koordinuar të gazit në Shqipëri, të eksplorojë masa shtesë për të promovuar zhvillimin e ambjenteve të depozitimit të gazit në vëndin tonë.

ERE ka hartuar draftin bashkëlidhur duke përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimit e të liçensuarit mbështetur në parashikimet e Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar. Enti Rregullator i Energjisë (ERE) është organi i ngarkuar nga Ligji nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, me të drejtën për të dhënë liçensë të operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror. Të liçensuarit që fitojnë të drejtën për të ushtruar aktivitetin e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, janë subjekt të kushteve të kësaj liçense, si dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e Bordit të ERE-s për liçensimin.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe seksionit II, neni 22, 23 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 20.11.2020, shqyrtoi relacionin me nr. 123/1 prot., datë 19.11.2020 për fillimin e procedurës për miratimin e liçensës TIP për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike;

8. Vendimi nr.203, datë 04.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e licensës për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së”.

ERE ka hartuar draft-liçensën dhe kushtet e saj për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së, duke përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimit e të liçensuarit mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar. Draft liçensa me kushtet e saj për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNL-së, saktëson spektrin e të drejtave dhe detyrimeve për çdo subjekt që liçensohet në ushtrimin e këtij aktiviteti.

Draft liçensa saktëson spektrin e të drejtave të ERE në raport me të liçensuarin, në mbështetje të ligjit nr.102/2010 “Për sektorin e gazit Natyror” si dhe legjislacionit të miratuar në zbatim të tij.

Në mbështetje të nenit 16, pika 11, nenit 22, nenit 23 të Ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" i ndryshuar, si dhe nenit 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 04.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 127/2 prot, datë 02.12.2020, të Drejtorive Teknike, mbi fillimin e procedurës për miratimin e liçensës për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNLsë.

9.Vendimi nr.68, datë 22.04.2020, “Mbi miratimin e “Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror” në Shqipëri”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe neneve 16 dhe 44, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.04.2020, shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, për miratimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror, në Shqipëri.

10. Vendimi nr.204, datë 04.12.2020. “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror”.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 16; nenit 29, pika 2, të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 04.12.2020, shqyrtoi relacionin me nr. 127/3 prot, datë 02.12.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror”.

11.Vendimi nr.218, datë 15.12.2020. ‘ Mbi fillimin e procedurës për miratimin e standarteve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit’

Në mbështetje të neneve 20, gërma “ë”; 81, pika 3, gërma “ç”; 94, pika 2, gërma “b” dhe “ë” të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 16, pika 16 dhe 20; 17, pika 1, gërma “ë”; 96, pika 11; 98, pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, neneve 52/2 dhe 56 të Ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, nenit 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Rregullores mbi Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundor, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 203, datë 18.12.2017, Rregullave mbi Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit të Furnizimit me Gaz Natyror për Klientët Fundor, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 09.07.2018, Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundor, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018, Rregullores për Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, neneve 15 dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 03.09.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, shqyrtoi relacionin nr. 132/5 Prot, datë 11.12.2020, të Drejtorisë Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve.

12. Vendimi nr.263, datë 28.12.2020. ‘Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, ‘Albgaz’ sh.a.’.

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 47, pika 1, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; pikës 76, të Programit të përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.05.2017; nenit 19, pika 1, gërma “f”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE – s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE – s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, shqyrtoi relacionin me nr.142/7 Prot., datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, si dhe Drejtoria e Gazit Natyror, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, ALBGAS sh.a.”.

13. Vendimi nr.265 datë, 28.12.2020. ‘Për miratimin e ‘Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror në Shqipëri’:

Në mbështetje të nenit 16, pika 24, të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, të nenit 16, të ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të

datës 28.12.2020, shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, me nr.142/8prot, datë 24.12.2020 “Për miratimin e rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror” në Shqipëri.

14. Vendimi nr.266 datë, 28.12.2020. “Për miratimin e ‘Kodit të matjes së Gazit Natyror’” në Shqipëri.

Në mbështetje të nenit 4, pika 33, 44; nenit 104, pika 1 dhe nenit 116, pika 4, të Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” i ndryshuar, të nenit 16, të ligjit nr.43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, i ndryshuar, nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, me nr.142/9, prot, datë 24.12.2020 “Për miratimin e Kodit të matjes së gazit natyror” në Shqipëri.

15. Vendimi nr.267, datë 28.12.2020. “Mbi fillimin e procedurës për të miratuar ‘Kushtet për të liçensuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror’” në Shqipëri.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit Nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; VKM nr. 533, datë 25.07.2019 “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të liçensuarve në sektorin e gazit natyror, të cilët ushtrojnë aktivitetin e transmetimit, të shpërndarjes dhe furnizimit me gaz natyror”; nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE – s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, shqyrtoi relacionin me nr.142/10 Prot, datë 24.12.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për të miratuar “Kushtet për të liçensuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror” në Shqipëri.

16. Vendimi nr.268, datë 28.12.2020. “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të përdorimit të terminalit të gazit natyror të lëngshëm(GNL) në Shqipëri.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neneve 16 dhe 74, të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, shqyrtoi relacionin me nr. 142/11 Prot, datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të përdorimit të terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL)” për Shqipërinë.

17. Vendimi nr.269, datë 28.12.2020. “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL” në Shqipëri.

Në mbështetje të nenit 16, të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 16, pika 1, germa a), të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe 26, të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Proçedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, shqyrtoi relacionin me nr. 142/12 Prot., datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-s” në Shqipëri.

Vendime të tjera të marra për Gazin Natyror gjatë vitit 2020

- 1. Vendimi nr.5, datë 10.01.2020** “Mbi fillimin e procedurës për liçensimin e shoqërisë “GSA” Sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror”.
- 2. Vendimi nr.6, datë 10.01.2020** “Mbi fillimin e procedurës për liçensimin e shoqërisë “GSA” Sh.p.k në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror”
- 3. Vendimi nr.13, datë 23.01.2020**, “Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "Albpetrol" Sh.a. për liçensim në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror”.
- 4. Vendimi nr.38, datë 27.02.2020**, “ Mbi miratimin e metodologjisë së përcaktimit e tarifës të shitjes së gazit natyror nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit “
- 5. Vendim nr.43, datë 06.03.2020**, “Mbi kërkesën e Shoqërisë “Albgaz” Sh.a për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ERE-s.”
- 6. Vendim nr. 51, datë 26.03.2020**, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e liçensimit në ushtrimin e veprimtarive në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid-19 dhe shpalljes së gjëndjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”.
- 7. Vendim nr. 65, datë 08.04.2020** , “Mbi kërkesën e Shoqërisë “Albpetrol” Sh.a. për shtyrje të afatit të përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për liçensim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror të shoqërisë “Albpetrol” Sh.a.”
- 8. Vendim nr. 69, datë 22.04.2020**, “Mbi kërkesën e Shoqërisë “GSA” Sh.p.k., për zgjatje të afatit të përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për liçensim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror”.
- 9. Vendim nr. 70, datë 22.04.2020** “Mbi kërkesën e Shoqërisë “GSA” Sh.p.k., për zgjatje të afatit të përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për liçensim në aktivitetin e tregtimit të gazit natyror”.
- 10. Vendim nr.77, datë 22.04.2020**,“Mbi kërkesën e zyrtarit të përpuethshmërisë së Albgaz Sh.a., për shtyrjen e afatit të dorëzimit të raportit vjetor të përpuethshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazit Natyror”.
- 11. Vendim nr. 96, datë 08.06.2020** “Mbi fillimin e procedurës për liçensimin e Shoqërisë “Mobigas alba” Shpk., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).
- 12. Vendim nr.108, datë, 02.07.2020** “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për liçensimin e shoqërisë “Albgaz” Sh.a., në aktivitetin e shpërndarjes së

gazit natyror” të ndryshuar”, dhe “një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për liçensimin e shoqërisë “Albgaz” Sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror” të ndryshuar”.

- 13. Vendim nr. 109, datë 02.07.2020** “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 221, datë 20.12.2019, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi Çertifikimin e Shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Albgaz Sha., të ndryshuar.
- 14. Vendim Nr. 117, Datë 17.07.2020,** “Mbi liçensimin e shoqërisë “Gsa” Sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror (shitje me pakicë)”.
- 15. Vendim nr.118, datë 17.07.2020** “Mbi liçensimin e shoqërisë “Gsa” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë)”.
- 16. Vendim nr.119, datë 17.07.2020** “Mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” Sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes së Bordit të ERE”.
- 17. Vendim nr.120, datë 17.07.2020** “Mbi kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE-s.”
- 18. Vendim nr. 133, datë 10.08.2020** “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE nr. 51, datë 26.03.2020 “Mbi disa ndryshime të përkohëshme në procedurat e liçensimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid-19 dhe shpalljes së gjëndjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”
- 19. Vendim nr. 177, datë 04.11.2020** “Mbi kërkesën e shoqërisë “Mobigas alba” shpk., për t’u tërhequr nga aplikimi për t’u liçensuar në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë)”.
- 20. Vendim nr. 179, datë, 04.11.2020** “Mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sha., për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të Bordit të ERE”.
- 21. Vendim nr. 215, datë 15.12.2020** “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 206, datë 16.12.2019, “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz sh.a” për vitin 2021”.
- 22. Vendim nr. 261, datë 28.12.2020** “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.” , i ndryshuar.
- 23. Vendim nr. 262, datë 28.12.2020** “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 10.11.2017, “Për liçensimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e shpërndarjes të gazit natyror”, të ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 10.11.2017, “Për liçensimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, të ndryshuar.

5.4 Bashkëpunimi me ALBGASZ për vitin 2020.

Shoqëria Albgaz Sh.a. në cilësinë e Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror në Republikën e Shqipërisë, veprimtaria e të cilës liçensohet dhe rregullohet sipas dispozitave të ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, paraqesim zhvillimet kryesore përgjatë vitit 2020 si më poshtë:

Së pari, gjatë vitit 2020, Albgaz sh.a ka kushtëzuar si asnjëherë më parë mbarëvajtjen operative të shoqërisë si dhe është detyruar në pezullimin apo shtyrjen e projekteve që rrjedhin nga Gaz-Mastërplani, reflektuar këto nëpërmjet VKM nr. 87/2018.

Megjithëse viti pandemik ngriti sfida të paprecedenta për departamente të ndryshëm, disa arritje u realizuan kryesisht në kuadrin rregullator, të ngritjes së kapaciteteve dhe të dyja projekteve si më poshtë:

1. Bashkëpunim për Kodin e Rrjetit të Transmetimit.

Pavarësisht kushtëzimeve që shoqëruan këtë vit, shoqëria Albgaz sh.a është angazhuar për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator, duke bashkëpunuar për të sjellë në formatin zyrtar ‘Kodin e Rrjetit të Transmetimit’. Kodi i Rrjetit u hartua nga konsulenti MJM Energy Ltd., si pjesë e termave të referencës të dakordësuara ndërmjet Albgaz sh.a, dhe konsulentit ECA Ltd nëpërmjet financimit nga BERZH.

Draft-kodi ju nënshtrua një seri shqyrtimesh nga Albgaz sh.a përpara se të dërgohej për opinion dhe miratim pranë Entit Rregullator të Energjisë – ERE. Një kohë e nevojshme ishte në dispozicion nga ERE e cila bëri konsultimet e nevojshme me palët e treta dhe institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe arriti në miratimin e tij. Kodi i Rrjetit u miratua nga ERE me vendimin nr. 68/2020.

2. Aplikimi për Liçensë si Operator i Sistemeve të Depozitimit.

Albgaz Sh.a., si Operator i Kombinuar i Gazit Natyror (ligji 102/2015, neni 80, pika 1), ka të drejtën të aplikojë edhe për Liçensë si Operator i Sistemeve të Depozitimit, me kusht që të respektojë ndarjen për çdo operator sistemi. Albgaz sh.a, vazhdoi përpjekjet për plotësimin e dokumentacionit lidhur me këtë liçensë.

Enti Rregullator i Energjisë ka filluar procedurën për miratimin e Rregullores për Depozitimin e Gazit Natyror si dhe ka kërkuar opinion nga Albgaz sh.a, në cilësinë e një pale të interesuar. Nga ERE janë plotësuar të gjitha aktet nënligjore me synimin e pajisjes me liçensën e depozitimit të Albgaz.sh.a.

3. Albgaz ka bashkëpunuar dhe dhënë opinion lidhur me Kodin e Matjes së Gazit Natyror, miratuar së fundmi nga ERE me vendimin nr. 266/2020. Iniciativa për këtë kod u ndërmor nga ERE.
4. Ngritja e kapaciteteve të Albgaz sh.a, është marrë përsipër nga konsulenti i pajtuar Economic Consulting Associates Ltd, i cili vazhdoi programin e mbetur nga viti 2019 edhe përgjatë vitit 2020.

Në kushtet e kufizimit të lëvizjeve dhe kontakteve si masa parandaluese ndaj pandemisë Covid-19, programi vazhdoi ecurinë nëpërmjet prezantimeve online. Temat e këtij programi trajtuan Metodologjinë e Tarifës si dhe operacionalizimin e saj në kontekstin e tregut shqiptar.

Tema tjetër e programit përfshinte operacionalizimin e Kodit të Rrjetit si një ushtrim praktik konkret dhe që u konkretizua pikërisht me miratimin e këtij dokumenti.

5. Projektet e realizuara.

Albgaz realizoi procedurat për projektimin dhe ndërtimin e dy qendrave të mirëmbajtjes së Gazsjellësit TAP në Shqipëri, konkretisht: Qendra e Mirëmbajtjes në Fier (në operim) dhe Qendra e Mirëmbajtjes në Korçë (në fazë ndërtimi), pas përmbylljes të procedurave tenderuese. Këto projekte u realizuan në kuadër të marrëveshjes ndërmjet TAP AG dhe Albgaz sh.a me objekt realizimin e

shërbimit të mirëmbajtjes së gazsjellësit nëpërmjet ndërmarrjes së përbashkët Albanian Gas Services Company SHA.

Projekte të tjera potenciale të cilat nuk vazhduan në fazat pasardhëse.

a) Projekti PIP01, Fier CP-Vlora TPP, vazhdon të ndiqet nga Albgaz sh.a me shumë interes, mbasi projekti potencialisht përfshin drejtpërdrejt kompaninë si operator të rrjetit të transmetimit.

b) Ndjekja dhe zbatimi i kërkesave që rrjedhin nga procedurat për krijimin e projektit Jonian Adriatik Pipeline (IAP).

c) Ndjekja e punës pas studimit të fizibilitetit për projektin e interkoneksionit me Kosovën, ALKOGAP.

Albgaz është përfshirë në procesin e negocimit Teknik dhe atij ligjor përsa i përket marrëveshjes në lidhje me pikën e lidhjes në Korçë (Exit Point) me TAP, proces i cili është në vijim dhe në koordinim të plotë me aktorët e tjerë të interesit duke përfshirë Ministrinë e Infrastrukturës dhe të Energjisë, si përfaqësuese e interesave të shtetit Shqiptar.

Aktivitetit i Albgaz është një proces kompleks, i shtrirë në kohë, sepse aktivitete të tilla, si ato në sektorin e gazit, janë shumë intensive në “investime kapitale”, si në volume projektimi dhe financimi, ashtu dhe në shtrirje kohore, por rezultati final i tyre i pritshëm dhe gradual është:

1. Kërkimi Tekniko-Financiar për realizmin e një “projektit pilot” të LNG në “shkallë të vogël” (small scale LNG);
2. Krijimi i kushteve për përftimin e investimeve të huaja direkte në këtë segment të ekonomisë;
3. Rritja e punësimit në sektor dhe në industritë që kanë impakt prej sektorit të gazit;
4. Përmirësimi i furnizimit me energji në nivel industrial, shërbimesh dhe rezidencial;
5. Krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm industrial dhe ulje kostosh energjitike në nivel prodhimi “mallrash dhe shërbimesh”;
6. Ulje në përgjithësi e “faturës energjetike” të konsumatorit familjar fundor;
7. Krijimi i kapaciteteve njerëzore në vend në drejtim të para-projektimit, projektimit, menaxhimit të investimeve duke rezultuar në zbatimin efektiv dhe eficient të aktiviteteve përkatëse në industrinë e gazit;
8. Konsolidimi i bashkëpunimit institucional me agjensitë europiane si ENTSO-G, GIE dhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë ECS.

5.5 Disa Probleme për të Ardhmen në Sektorin e Gazit Natyror

- Bashkëpunimi me Entet Rregullatore të Energjisë së shteteve fqinje, Greqi dhe Itali, si dy shtete anëtare të BE-së, koordinimi i të gjitha akteve nënligjore dhe rregullore në përputhje me Direktivën 2009/EU dhe Rregulloren 715/EU, dhe një sërë rregulloresh të tjera që kanë të

bëjnë me transparencë, diskriminimin e palëve të treta si dhe marrjen e vendimeve të përbashkëta për këtë qëllim.

- Bashkëpunimi me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vienë për akte e tjera të nënligjore dhe përmirësimin e atyre ekzistuese si dhe konsulenca e vazhdueshme për problemet që dalin gjatë implementimit të Direktivave dhe të Rregulloreve.
- Bashkëpunimi me Ministrinë së linjës (MEI) për domosdoshmërinë e ndërtimit të infrastrukturës së gazit, si një nevojë urgjente për hapjen e tregut të gazit natyror në vëndin tonë. Aktualisht gazi është prezent dhe duhet që të filloj përdorimi i tij. Janë identifikuar pesë projekte prioritare të miratuara edhe nga Këshilli i Ministrave dhe kërkohet fillimi i ndërtimit të tyre, sigurisht sipas prioritetit që ato kanë.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e linjës (MIE) për amendimin e ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ndryshuar, për plotësimin e kushteve të certifikimit të Operatorit të Transmetimit të Gazit Natyror, Albgaz Sh.a.
- Bashkëpunimi me Albgaz Sh.a, në aspektin rregullator, për të gjitha problemet që hasen për hapjen e tregut të gazit natyror, kualifikimin, transparencën dhe përmirësimin e akteve të domosdoshme.
- Bashkëpunimi me Institucionet Kombëtare dhe Ndërkombëtare për problemet e gazit si; **CEER** (Këshilli Europian i Rregullatorëve të Energjisë), **ACER** (Agency for the Cooperation of Energy Regulators) Agjencia për Kooperim e Rregullatorëve të Energjisë për Europën), **GRI SSE**, **SOUTH SOUTH-EAST GAS REGIONAL INITIATIVE** (GRI SSE, (Iniciativa e Rregullatorëve për Grupin e Gazit për Rajonin Jug – Juglindje), **MEDREG**, Working Group Gas Natural, Shoqata e Rregullatorëve të Energjisë dhe të Gazit Natyror për rajonin e Mesdheut, **ENTSO-G** (Observër në Shoqatën e Sistemit të Transmetimit Europian të gazit), **IGU** (Unioni Ndërkombëtar i Gazit), **OME** (Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë), **ECRB**, Gas Working Group, Bordi i Rregullatorëve të Energjisë të vëndeve të Komunitetit të Energjisë, marrja pjesë në studimet e tyre dhe mundësia e thithjes së investimeve të huaja për zhvillimin e infrastrukturës në vëndin tonë.

6. MBI RAPORTIMIN E ERE – S NË LIDHJE ME ZBATIMIN DHE NDJEKJEN E PLOTËSIMIT TË REKOMANDIMEVE TË “REZOLUTËS SË KUVENDIT TË SHQIPËRISË PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË PËR VITIN 2019”.

Në zbatim të pikës 1 të Kapitullit 2 të “Manualit të monitorimit vjetor dhe periodik” miratuar me vendimin nr. 134/2018 të Kuvendit të Shqipërisë dhe “Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2019”, ERE ka raportuar përgjatë vitit 2020 lidhur me punën e kryer për ndjekjen, zbatimin e plotësimin e rekomandimeve dhe detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vitin 2019, në mënyrë periodike si më poshtë vijon:

Dëshirojmë gjithashtu ndër të tjera t’ju informojmë se, me qëllim ndjekjen e detyrave të Rezolutës, ERE me Vendimin nr. 123, dt. 17.07.2020, ka miratuar kalendarin e masave për fillimin e zbatimit dhe ndjekjen e plotësimin të rekomandimeve të rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Entit

Rregullator të Energjisë për vitin 2019, miratuar nga ana e Kuvendit, e mbi këtë kalendar ka vijuar ndjekjen e detyrave të lëna nga rezoluta, nga strukturat e ERE – s të ngarkuara për ndjekje.

Gjithashtu me dije se për shkak të masave e kufizimeve si rezultat i protokollit për parandalimin e përhapjes së COVID – 19, nga ana e ERE – s është vijuar puna nëpërmjet mjeteve të komunikimit online për zhvillimin e mbledhjeve të Bordit të ERE – s , po në këtë prizëm duke patur pamundësi të krijimit të kushteve të distancimit social për realizimin e takimeve me palët, konsultimet e praktikave të ERE – s janë zhvilluar nëpërmjet komunikimeve shkresore. E njëjta procedurë është ndjekur dhe për monitorimin e të liçensuarve duke shmangur sa më shumë monitorimet në terren dhe duke ndjekur monitorimet nëpërmjet mjeteve shkresore.

Në vijim, realizimin dhe ndjekja e detyrave të caktuara nga Rezoluta e Kuvendit si dhe masat e marra nga ERE për ndjekjen dhe zbatimin e detyrave të lëna.

- **ERE të ndërmarrë hapat e nevojshëm për implementimin dhe monitorimin e ndarjes së “OSHEE” sh.a., në kuadër të shoqërive të reja të krijuara, proces i cili ka filluar që nga 1 janari i vitit 2020 dhe që duhet të shoqërohet me ndarjen funksionale dhe organizative, si dhe llogarive dhe kostove midis Furnizuesit të Shërbimit Universal dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, duke mundësuar një qasje të drejtë në hapjen e tregut të energjisë elektrike në vend, si dhe një shërbim të sigurt, transparent dhe me cilësi të klientëve fundorë.**

Me qëllim ndjekjen e kësaj detyrë të rezolutës por edhe në zbatim të detyrave më të cilat ligji nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, ngarkon ERE, në kushtet e pamundësisë për të zhvilluara seanca dëgjimore të cilat për shkak të ballafaqimit dhe diskutimeve, japin një panoramë të saktë të rrethanave dhe ecurisë së procesit të ndarjes së OSHEE sh.a., ERE ka proceduar me korrespondenca më Operatorin e Shpërndarjes të Energjisë Elektrike të cilit i ka kërkuar të raportojë mbi masat e marra për plotësimin e kushteve që faktojnë dhe evidentojnë ndarjen e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU sh.a., dhe me konkretisht:

- Masat e marra për përcaktimin e saktë të strukturave organizative dhe proceseve të menaxhimit të portofolit të energjisë elektrike në përputhje me funksionet dhe veprimtaritë që mbulon secili operator;
- Masat e marra për pavarësinë e burimeve njerëzore dhe administrative (përfshirë por pa u kufizuar në adresat e veçanta të e – mailit, faqet e internetit, IT, protokollin, burimet njerëzore etj.) të tre shoqërive.
- Ecurinë e evidentimit, ndarjes dhe transferimit të aseteve tek secila shoqëri.
- Procesin e kontraktimit dhe faturimit midis të tre shoqërive si dhe shoqërive dhe shoqërisë mëmë për shërbime që ofrohen nga kjo e fundit.
- Të tjera që mendoni se sqarojnë procesin e ndarjes sipas parashikimeve të ligjit të mësipërm.
- Pasqyrat financiare të audituara të shoqërive OSHEE GROUP sh.a., për vitin 2019 si dhe Pasqyrat financiare operative periodikisht gjatë vitit 2020 të shoqërive bija OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a., OSHEE GROUP sh.a. ka bërë me dije ndër të tjera, se situata e krijuar nga Covid – 19 ka vështirësuar ndjeshëm ecurinë e procesit të ndarjes së OSHEE sh.a. Po ashtu nga komunikimi me OSHEE aktualisht janë përfunduar Pasqyrat Financiare të vitit 2019 të

audituar nga grupi i eksperteve të emëruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të cilat janë përcjellë në Tetor 2020, në ERE.

OSHEE sh.a. po ashtu ka bërë me dije edhe se në dt. 08.09.2020 ka miratuar Planin e ndarjes funksionale të OSHEE sh.a.". Në këtë plan veprimi janë paraqitur targeta të procesit të ndarjes që në fakt lidhen që me fillim vitin 2020, por nuk ka një raportim të mirëfilltë në lidhje me implementimin e këtij plani veprimi. Për sa më sipër, me qëllim mbikëqyrjen e zbatimit të këtij plani veprimi është vijuar komunikimi me shoqërinë për të raportuar në lidhje me ecurinë e implementimit të këtij plani veprimi sipas targetave të vendosura.

Në këtë kuadër, nga ana e OSHEE sh.a. është raportuar periodikisht dhe në takimet e Komitetit drejtues të ngritur për implementimin e programit të reformës së sektorit, ku një vëmendje tejet e veçantë i kushtohet procesit të ndarjes së OSHEE sh.a. në këtë Komitet drejtues marrin pjesë përfaqesues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ERE-s, Bankës Franceze për Zhvillim dhe Bankës Gjermane pr Zhvillim, KfW. Në këto raportime nga ana e OSHEE është vënë theksi në vështiresitë e ndarjes për shkak të situatës si dhe masat që po merren në bashkëpunim dhe me zyrën rajonale të zbatimit të reformës së ngritur pranë MIE-s për monitorimin dhe përshpejtimin e këtij procesi.

Në vijim të shkresave të ERE ka qënë edhe Ministria e Infratrakturës e cila me korrespondencën e saj të përgjatë vitit 2020, i është drejtuar OSHEE sh.a., me shkresë me anë të së cilës, ka kërkuar mobilizimin maksimal për implementimin në një kohë sa më të shkurtër të masave të parashikuara në Planin e Veprimit mbi Ndarjen Funksionale të OSHEE sh.a., Si një hap ngushtësisht të lidhur me liberalizimin e tregut të energjië elektrike, hapjen e mëtejshëm të tij dhe që faktin angazhimin serioz të palës Shqiptare për zbatimin e detyrimeve që lindin si palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

- **Në funksion të procesit të rëndësishëm të implementimit të ndarjes së OSHEE sh.a., Kuvendi rekomandon që ERE-ja të bashkëpunojë ngushtë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me palët e interesit, si dhe me aktorët ndërkombëtarë, veçanërisht Sekretariatit e Energjisë në Vjenë, Austri. Gjithashtu, po në këtë kuadër është i një rëndësie të veçantë edhe përpilimi dhe miratimi i programit të përputhshmërisë së Operatorit të sistemit të shpërndarjes me praktikat më të mira ndërkombëtare.**

Me qëllim ndjekjen e ecurisë së detyrës sa më sipër, ERE i është drejtuar Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike, edhe në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, i cili në nenin 72, pika 3 gërma b, parashikon ndër të tjera se; *"...Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të hartojë një program pajtueshmërie që përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, si dhe të sigurojë që respektimi i programit të monitorohet në mënyrën e duhur...."*

ERE me vendimin e bordit nr. Nr. 257, dt. 21.12.2020 ka miratur **e programit të pajtueshmërisë të OSSh sh.a.** program i cili është konsultuar dhe me Sekretariatit e Traktatit te Energjisë në Vienë.

- **Për të mundësuar njohjen e bursës së re në komitetet e bursave të vendeve të BE-së, ERE-ja, bazuar në legjislacionin përkatës, të marrë masat e nevojshme për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), rolin, përgjegjësitë e tij, si dhe të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë në Tregun e Bashkuar.**

Me qëllim lehtësimin e sa më sipër, ERE me vendimin nr. 40, dt. 06.03.2020 ka miratuar tashmë rregulloren e kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO – s dhe operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në tregun e bashkuar. Ky vendim është përshendetur si një detyrë e kryer tashmë në Bordin Rregullator të Vendeve të Komunitetit të Energjisë (ECRB) si dhe në grupin e punës për krijimin e tregut të përbashkët midis Shqipërisë, Italisë, Malit të Zi dhe Serbisë (AIMS) ku ERE ka luajtur dhe vazhdon të luajë një rol aktiv dhe ku nëpërmjet bashkëpunimit me Entin Rregullator të Italisë do të kërkohet mbështetja për njohjen e NEMO – s në komitetet e bursave të vendeve të BE-së.

Ndërkohë ERE është pjese aktive e grupeve të punës, udhëhequr nga USAID mbi bashkimin e tregjeve Shqipëri – Kosovë, dhe në vijim të dakortësisë së dy rregullatorëve për nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit mes tyre, do të marra masa të njëkohësishme me Rregullatorin e Kosovës për çeljen e procesit të përzgjedhjes së NEMO-s dhe ne takimin e fundit është paraqitur dhe draft marrëveshja e Rregullatorëve për mundësimin e bashkimit të tregjeve e cila është duke u diskutuar midis paleve dhe konsulentit të angazhuar nga ana e USAID.

Në vijim të krijimit të Bursës nga ana e OST sh.a. dhe KOSTT, do të bashkëpunohet për nominimin e bursës si NEMO në përputhje me vendimin e sipërcituar.

- **ERE-ja, në bashkëpunim me institucionet dhe operatorët brenda vendit, si dhe me rregullatorin e Kosovës, të vijojë punën për përcaktimin e hapave që duhen ndërmarrë në lehtësimin e kuadrit rregullator për operimin efikas të bursës në të dyja vendet. Krijimi dhe operimi i bursës do t'u japë mundësi si operatorëve të tregut, prodhuesëve, furnizuesëve, tregtarëve, ashtu edhe klientëve të kenë një çmim referues mbi të cilin mund të operojnë, si dhe hap mundësinë e operatorëve të tregjeve fqinje për të operuar në këtë treg.**

Në përputhje dhe me Memoradumin e bashkëpunimit me Entin Rregullator të Kosovës ka vijuar bashkëpunimin nëpërmjet takimeve të grupeve të përbashkëta të punës në kuadër të bashkimit të tregjeve të energjisë elektrike midis Shqipërisë dhe Kosovës nëpërmjet iniciativës së mbështetur edhe nga ana e USAID.

Bursa e energjisë elektrike është krijuar tashmë nga operatorët e sistemit të transmetimit të të dy vendeve, dhe pritet të aplikojë në të dy vendet për njohjen si NEMO dhe do të operojë tregun e përbashkët të një dite më parë dhe atë brenda një dite.

Po ashtu në bashkëpunim me Entin Rregullator të Kosovës është bashkërenduar puna për njohjen dhe ku është e nevojshme miratimin e marrëveshjeve operationale të lidhura midis të dy operatorëve të sistemit të transmetimit, që ka të bëjë me krijimin e një zone të përbashkët kontrolli midis Shqipërisë dhe Kosovës pas njohjes së kësaj të fundit nga ana e ENTSO-E në Prill të vitit të kaluar si dhe operimit tregtar të linjës 400 kV Shqipëri – Kosovë u realizua në 14 Dhjetor 2020.

Vlen të sjellim në vëmendje, se ERE së fundmi, me vendimin e bordit nr Nr. 197, Dt. 26.11.2020 “Mbi miratimin e rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për zyrën e koordinimit të ankandeve në europën juglindore (SEE CAO) për kufijtë Shqipëri – Greqi, Shqipëri – Mali zi dhe Shqipëri – Kosovë”, ka dhënë kontributin e nevojshëm

institucional e ligjor për plotësimin e kuadrit ligjor duke shtuar, përkatësisht kufijtë: Kosovë (XK) KOSTT <> Shqipëri (AL) OST; Kosovë (XK) KOSTT <> Mali i Zi (ME) CGES; Kosovë (XK) KOSTT <> Maqedoni e Veriut (MK) MEPSO.

Po në këtë prizëm është për tu theksuar se linja 400 kV Shqipëri – Kosovë filloi operimin tregtar duke lejuar alokimin e kapaciteteve të interkonjeksionit ndërmjet të dy Operatorëve të Sistemit me dt. 14.12.2020.

- **ERE, pas miratimit të ndryshimeve të nevojshme në ligjin nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar nga Kuvendi më 14 maj 2020, të monitorojë me rigozitet përmbushjen nga ana e OST-së të të gjitha kushteve të çertifikimit.**

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 43, dt. 15.03.2017, ka vendosur “Miratimin përfundimtar të çertifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, OST sh.a.” në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, si dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC.

Po ashtu me Vendimin e Bordit nr. 207, dt. 16.12.2019, është vendosur: Miratimi i kërkesës së OST sh.a. për shtyrjen e afatit të zbatimit të pikës 2 të vendimit të ERE-s nr. 43, dt. 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të çertifikimit të Operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC “Mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të komunitetit të energjisë”, deri në dt.n 16.06.2020.

Kushti i referuar më sipër, ka të bëjë me: Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Ekonomisë.

Në lidhje me sa më sipër rezulton se, në ndryshimet e miratuara të Ligjit nr. 43/2015 “Sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, në dt.n 14 Maj 2020, ndër të tjera janë reflektuar edhe ato që çojnë në plotësimin e këtij kushti.

Sa më sipër, nga ana e ERE-s është konstatuar se Parlamenti Shqiptar me Ligjin nr. 61/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, ka miratuar disa shtesa dhe ndryshime të cilat konsistojnë në:

- Neni 31, pika 1 ishte: “Linjat e reja të interkoneksionit që ndërtohen nga Operatori i sistemit të transmetimit apo nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.”

Bëhet: “Linjat e reja të interkoneksionit, që ndërtohen nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.”

- Pika 8 e nenit 60, me pëmbajtje ERE në ushtrimin e kompetencave të parashikuara në pikat 1, 6 dhe 7, të këtij neni, duhet të marrë mendimin nga ministri përgjegjës për energjinë. shfuqizohet.

Me miratimin e ndryshimeve ligjore si më sipër, rezulton se janë plotësuar tërësisht kushtet e parashikuara në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 43, dt. 15.03.2017

Në përputhje me sa më sipër, me Vendimin nr. 99, Dt. 24.06.2020, ERE konstatoi se OST sh.a. ka përmbushur tërësisht kushtet e parashikuara në vendimin e ERE nr. 43, dt. 15.03.2017 për çertifikimin e shoqërisë dhe kjo detyrë është ezauruar tashmë. Vendimi ju bë me dije gjithashtu dhe Sekretariatit të Energjisë në Vienë si pjesë e këtij procesi të rëndësishëm.

- **ERE, për vonesat e ndryshimeve që duhet të bëhen nga ana e MIE-së në aktet që përcaktojnë pronësinë e Albgaz sh.a. për përmbushjen e kushteve të vendimit të certifikimit, të shfrytëzojë Platformën Ndërinstitucionale Online, të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë, e cila është në dispozicion të institucioneve të pavarura si një mjet i ri që synon rritjen e autoritetit të institucioneve të pavarura, si dhe përfshirjen e Kuvendit të Shqipërisë si katalizator ndërmjet institucioneve të pavarura dhe atyre qeveritare për zgjidhjen e problemeve. Certifikimi i Albgaz sh.a. është me mjaft rëndësi si në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 102/2015, Për sektorin e gazit natyror, i ndryshuar, ashtu edhe në funksion të pjesëmarrjes së Albgaz sh.a. në rrjetin ENTSO-G (Rrjetin Europian të Operatorëve të Transmetimit të Gazit Natyror).**

Me qëllim adresimin e detyrës së përcaktuar sa më sipër, ERE iu drejtua Shoqërisë Albgaz sh.a. duke i bërë me dije se përpara se ERE të marrë hapat e nevojshëm e të parashikuar edhe në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2019, është e nevojshme që Albgaz sh.a. të bëjë me dije në lidhje me masat e marra së fundmi, për të adresuar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, problematikën e krijuar për shkak të mos reflektimit të ndryshimeve të nevojshme në ligjin nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, që do të mundësonin plotësimin e kushteve të certifikimit të shoqërisë.

Në vijim ERE i është drejtuar edhe Ministri së Infrastrukturës dhe Energjisë duke kërkuar nga MIE informacion në lidhje me hapat e nevojshëm të ndërmarrë nga Ministria e që do të mundësojnë reflektimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore në ligjin nr.102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, që do të mundësonin plotësimin e kushteve të certifikimit të shoqërisë Albgaz sh.a., sikurse edhe të ndryshimeve në aktet e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e Ministrisë përgjegjëse për shoqërinë Albgaz të ndryshme nga pronësia e kompanive të tjera (të tillë si Albpetrol).

Më tej, për qëllime të trajtimit dhe zgjidhjes së kësaj problematike ERE i është drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, duke kërkuar informacion në lidhje me modalitetet për të aksesuar në Platformën Ndërinstitucionale Online të Kuvendit, për të vijuar me tej me propozimet konkrete që do të japin zgjidhje kësaj problematike të zgjatur në kohë, me qëllim gjithashtu për përmbushjen e sa lënë detyrë nga Rezoluta.

- **ERE-ja të vijojë punën për monitorimin dhe përditësimin e planit të masave në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit sipas fushës së veprimtarisë së shoqërive të ndara tashmë, si dhe të ndjekë zbatimin me rigorozitet të gjetjeve dhe vërejtjeve të bëra gjatë monitorimit duke u fokusuar në zgjidhjen e ankesave të klientëve me përgjegjësi dhe në kohë sa më të shkurtër. Gjithashtu, t'i kushtojë vëmendje procedurës sesi merr dijeni klienti për trajtimin e ankesës, për të bërë të mundur dokumentimin e informimit të çdo klienti ankues për rezultatin e trajtimit të ankesës nga OSHEE-ja, si një aspekt shumë i rëndësishëm i transparencës dhe mbrojtjes së konsumatorit.**

Me vendimin e bordit të ERE nr. 217, dt. 15.12.2020 ERE ka vendosur për rishikimin e “Planit të masave për Operatorin e shpërndarjes të energjisë elektrike ‘OSHEE’ sh.a., për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 201, dt. 03.09.2018. Duke u mbështetur në detyrat e lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, gjendja e faktit që lidhet me ndarjen efektive të Furnizuesit të Shërbimit Universal nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, lindi nevoja e përditësimit të këtij plani masash me qëllim reflektimin e sa më sipër si dhe përmirësimin e përditësimit e atyre dispozitave që lidhen me detyra të lëna në këtë

plan e për të cilat rrethnangat kanë ndryshuar për shkak të monitorimeve të ushtruara ndaj shoqërisë përgjatë vitit 2019 e 2020 dhe ndarjes së kompanive.

- **ERE-ja të vijojë punën për mbrojtjen e konsumatorit përmes monitorimeve periodike për të bërë të mundur përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së shërbimit, si dhe zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve.**

Për zbatimin e kësaj detyre nga ana e ERE – s i është bërë me dije OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. njoftimi për fillimin e monitorimit me objekt:

- Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë;
- Trajtimi dhe status i ankesave/kërkesave të përdoruesëve dhe klientëve për periudhën përgjatë vitit 2020;
- Zbatimi i afateve dhe procedurave të ndjekura për ankesat e dërguara në ERE dhe institucionet e tjera përgjatë vitit 2020;
- Afatet dhe procedurat për trajtimin e kërkesave dhe ankesave për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes;
- Zbatimin e rregullores për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Në kuadër të zbatimit të masave të distancimit social për shkak të parandalimit protokollit mbrojtjes për mos përhapjen pandemisë COVID – 19, është vijuar me tej me përcjelljen e dokumentave lidhur me objektet e monitorimit të cilat më pas do të monitorohen në vend nëse lind e nevojshme.

Gjatë vitit 2020, për shkak të pandemisë globale e marrjes së masave nga ana e Qeverisë Shqipëtare për shmangien e përhapjes së virusit Covid – 19, shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për një periudhë rreth 4 mujore në Republikën e Shqipërisë, e vijimit të kufizimeve jo vetëm në veprimtarinë e institucioneve por edhe lëvizjen e lirë të njëjërzve, ka qënë i pamundur monitorimi në terren i të liçensuarve për sa i përket mbikëqyrjes së veprimtarisë së tyre në funksion të garantimit të të drejtave të klientëve të energjisë. Pavarësisht sa më sipër, nuk ka munguar kontrolli i ERE në të liçensuarit, me mënyrat alternative të mbikëqyrjes në distancë, duke kërkuar në mënyrë periodike informacion në lidhje me çdo aspekt të veprimtarisë së të liçensuarit që lidhet me ushtrimin e funksionimeve të ngarkuara nga liçensa e për të garantuar të drejtat e klientëve të energjisë.

Në vijim të punës me qëllim mbikëqyrjen e të liçensuarve sa i përket detyrimeve për respektimin e afateve dhe procedurave për të garantuar aksesin në rrjet, ERE ka vijuar me një sërë korrespondencas me të liçensuarit me qëllim, mbrojtjen e të drejtave të klientëve të energjisë sa i përket së drejtës për akses në rrjet.

Për këtë qëllim, në kushtet e pamundësisë për të ushtruar monitrimet në terren, ERE ka kërkuar nga OSSH sh.a., informacion dhe dokumentacion në lidhje me procedurat dhe afatet e lidhjeve të reja në sistemin e shpërndarjes; Aplikimet e regjistruara në OSSH sh.a. për lidhje të reja në Sistemin e Shpërndarjes përgjatë vitit 2020; Afatet proceduriale të ndjekura nga ana e OSSH sh.a. për miratimin apo refuzimin e secilit aplikim për lidhje të reja në Sistemin e Shpërndarjes përgjatë vitit 2020 mbi bazën sample/kampionit (10 aplikimet e para të regjistruara në çdo muaj kalendarik) si dhe numrin e aplikimeve të refuzuara përgjatë vitit 2020 dhe arsytet e këtyre refuzimeve.

Metodika e mësipërme u vlerësua si një mënyrë efiçiente për të verifikuar dhe konstatuar respektimin nga ana e OSSH sh.a. të parashikimeve të Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e shpërndarjes, të miratuar me Vendimin nr. 166, dt. 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin Nr.177, dt. 08.11.2016.

- **Të caktojë afate konkrete për OSSH-në dhe FSHU-në për vënien sa më shpejt në punë të sistemit të ri të faturimit, të paktën në disa projekte pilot të identifikuara nga vetë OSSH-ja, i cili lehtëson në mënyrë të ndjeshme leximin e matjes së energjisë, krijon mundësi dhe opsione të reja duke përfshirë edhe leximin periodik disamujor, si dhe në përfundim të konsultimeve me palët e interesit, aty ku kushtet teknike të kompanisë e lejojnë, të sigurojë përfshirjen në kontratën Tip për vitin 2020 të kësaj mënyre leximi të sistemit të matjes.**

Për plotësimin e kësaj detyre të rezolutës ERE ka kërkuar ndër të tjera nga OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. që:

- të paraqesin në ERE një analizë tekniko – ekonomike ku të paraqesin qartë përfitimet që do të sjellë kjo mënyrë leximi dhe faturimi, për secilën nga shoqëritë (reduktimin e kostove, efiçencën dhe saktësinë e procesit);
- problematikat që mund të lindin nga ky proces dhe parandalimin e tyre, si dhe pritshmërinë lidhur me përmirësimin e transparencës ndaj klientëve;
- efektet e pritshme në drejtim të uljes së numrit të debitorëve dhe përmirësimit të llogarive të arkëtueshme;
- Evidentimin e saktë të klientëve që do të përfshihen në projekt duke mbajtur në konsideratë që kushtet teknike të shoqërisë e lejojnë;
- Mënyrën e njoftimit të klienteve të cilët do të nënshtrohen projektit pilot;
- Mënyrën e faturimit të tyre e cila nuk duhet të jetë në zërin *vlerë referuese* pasi bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi;
- Parashikimin e kësaj mënyre leximi në sistemin e Menaxhimit të marrëdhënieve me Klientin;
- Raportimit pas përfundimit të projektit pilot lidhur me ecurinë e procesit;
- Formën e pasqyrimin në bilancin energjetik dhe rakordimin me pjesëmarrësit e tjerë të tregut që afektohen ky projekt;
- Përgatitjen e një fushate informuese për tu realizuar në zonat ku parashikohet të implementohet projekti ku të jenë evidentuar të drejtat e detyrimet që u lindin palëve (ofruesve të shërbimit dhe klientit) si dhe opinionin e tyre në lidhje me këtë projekt;
- Evidentimin e akteve ligjore dhe nënligjore që do të duhet të ndryshohen në mënyrë bërjen e mundur të zbatimit të procesit të leximit disamujor;

Në vijim të sa më sipër, i është kërkuar FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a. po ashtu të bëjë me dije në lidhje me ecurinë e projektit pilot për vënien në testim të sistemit të ri të faturimit, në disa zona të identifikuara nga vetë OSSH sh.a., i cili mund të lehtësojë në mënyrë të ndjeshme leximin e matjes së energjisë dhe raportimin në lidhje me:

- Analizën në lidhje me të dhënat e gjeneruar nga projekti pilot i iniciuar që në vitin 2019.

- Analizën në lidhje me marrëdhënien dypalëshe të FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a. me qëllim garantimin e një procesi leximi e faturimi sa më të saktë e të drejtë.
- Rezultatet e implementimit të sistemit të faturimit mbështetur në vendimin e bordit të ERE – s nr. 58/2020 si dhe të dhëna krahasuese në lidhje me numrin e ankesave të regjistruara gjatë kohëzgjatjes së efekteve juridike të këtij vendimi, krahasuar më të njëjtën periudhë një vit më parë.

Nga ana e FSHU janë përcjellë në ERE shpjegime në vijim të kërkesës sonë për informacion, në lidhje me impaktin që ka patur vendimi i ERE nr.58/2020, në numrin e ankesave të adresuara për zgjidhje pranë FSHU sh.a..

Nga ana e FSHU dhe OSSH u bë me dije se: FSHU evidenton se ankesat e depozituar nga muaji Mars 2020 deri në Qershor 2020 për faturim me vlerë referuese sipas vendimit Nr. 58 datë 26.03.2020 lidhur me gjendjen e fatkeqësisë natyrore, kanë qënë si në vijim:

- Vlere Referuse Mars 2020 Total – 1789
- Vlere Referuse Prill 2020 Total – 318
- Vlere Referuse Maj 2020 Total – 114

Sic shihet edhe nga të dhënat e mësipërme, numri më i madh i ankesave të regjistruara ka qënë ai në muajin e parë të fillimit të efekteve juridike të vendimit të bordit të ERE nr. 58/2020, e vlerësojmë se një fakt i tillë ka ndodhur si rrjedhojë e mungesës së informacionit.

Ajo që konstatua se mungonte në analizë ishte:

- numri i ankesave të gjetura të drejta e të zgjidhura,
- objekti i ankesave më të shumta të adresuara në FSHU sh.a. gjatë kësaj periudhe,
- afatet e zgjidhjes së këtyre ankesave,
- informimi i klientëve të energjisë elektrike për zgjidhjen e dhënë,
- raporti i ankesave për qëllime të zbatimit të vendimit të përkohshëm të ERE nr. 58/2020 me numrin total të ankesave të regjistruara në FSHU sh.a..

Duke e vlerësuar se një analizë e tillë është e rëndësishme për të patur një pasqyrë të qartë të ecurisë së zbatimit të vendimit të përkohshëm të Bordit të ERE-s nr. 58, datë 26.03.2020, si dhe të shkallës së kënaqësisë së klientëve të energjisë me këtë praktikë të faturimit të klientëve të energjisë elektrike, ERE ka vijuar korespondencën me FSHU-në me qëllim adresimin e sa më sipër.

Në funksion të sa cituar dhe në mbështetje të; (i) Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, (ii) Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, (iii) Ligjit nr. 9902, dt. 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, (iv) Ligjit nr. 9887, dt. 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të tilla si: (i) Rregullores mbi Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundor, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 203, dt. 18.12.2017, (ii) Rregullave mbi Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit të Furnizimit me Gaz Natyror për Klientët Fundor, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 161, dt. 09.07.2018, (iii) Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundor, miratuar me Vendimin

e bordit të ERE-s nr. 15, dt. 10.01.2018, (iv) Rregullores për Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e ERE-s nr. 181, dt. 10.11.2017, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, dt. 03.09.2016, ERE në vendimin Nr. 218, Dt. 15.12.2020 vendosi: “Fillimin e procedurës për miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të liçensuarit në aktivitetin e furnizimit”.

Kjo rregullore u është dërguar për diskutim dhe komente palëve të interesit, dhe ERE është në pritje të sugjerimeve apo rekomendimeve të këtyre palëve me qëllim miratimin përfundimtar të saj.

- **ERE të nxisë hapjen e diskutimit publik me të gjitha palët e interesuara dhe të përpilojë propozimet e nevojshme ligjore për përdorimin e teknologjive të reja për stacionet e ngarkimit të automjeteve elektrike përfshirë rregullimin e tarifimit të këtij shërbimi.**

Me qëllim adresimin e kësaj risie në kuptim të përdorimit të teknologjive të reja të mjeteve të transportit, ERE ka kryer një sërë korrespondencash me palë interesi me qëllim hapjen e diskutimit publik në lidhje me sa më sipër.

Për këtë qëllim ERE i është drejtuar Bashkisë Tiranë për të marrë një informacion në lidhje me

- Numrin aktual të njësive të karikimit elektrik të automjeteve, të ngritura nga ana e Bashkisë Tiranë.
- Modalitetet e sigurimit të këtij shërbimi për subjektet publike apo private.
- Të dhëna në lidhje me numrin e subjekteve (publike apo private) që përdorin këtë lloj teknologjie, nëse i disponojnë.
- Planet e zhvillimit të këtyre njësive në të ardhmen.

Në lidhje me këtë detyrë të rezolutës, ERE i është drejtuar po ashtu dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë duke sjellë në vëmendje se kuadri ligjor dhe rregullator në Shqipëri, nuk e ka adresuar aktualisht çështjen e rregullimit tarifor të këtij shërbimi që në fakt është një fazë fillestare testimi nga Bashkia Tiranë, dhe nëse MIE ka një plan të mbështetjes së këtyre teknologjive në rang Republike, apo ka projektuar iniciativat për ndërhyrjen e nevojshme në ligjin “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, të cilat do t’i hapnin rrugë rregullimit të kategorisë së përdoruesve të këtij shërbimi dhe tarifimit për këtë shërbim.

Gjithashtu ERE ka kërkuar edhe opinionin e Sindikatës Shqiptare të taksive, Shoqatës Tirana, Shoqata e Taksive të klasit të parë, si dhe Shoqata Univers, si palë direkte interesi në këtë sipërmarrje duke kërkuar nga këta të fundit informacion, në lidhje me:

- Numrin e subjekteve që ofrojnë këtë shërbim taksit, me automjete elektrike, në rang Republike,
- Interesin e subjekteve që ofrojnë shërbimin taksit, në përdorimin e kësaj teknologjie,
- Kostot financiare të përdorimit të energjisë elektrike nga subjektet që përfitojnë prej kësaj teknologjie, krahasuar me kostot financiare mesatare të subjekteve që përdorin lëndë djegëse,
- Sugjerime mbi zhvillimin e kësaj teknologjie në Shqipëri.

Në mënyrë që të jepte opinionin e saj lidhur me krijimin e kuadrit ligjor rregullator apo ndryshimet ligjore të legjislationit, në fuqi të cilat mund të krijojnë kushtet e përdorimit të teknologjive të reja për stacionet e ngarkimit të automjeteve elektrike përfshirë rregullimin e tarifimit të këtij shërbimi,

ERE si një anëtare e një sërë organizatash dhe institucionesh ndërkombëtare të cilat kanë në fokus të tyre rregullimin e mbikqyrjen e sektorit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror, ndjek rregullisht takimet e organizuara nga këta të fundit me qëllim azhurnimin me kuadrin ligjor rregullator evropian të sektorit të energjisë por edhe informimin mbi incentivat europiane në fushën e energjitikës.

Nga sa më sipër ERE mbetet e angazhuar duke marrë pjesë në diskutimet apo seminarët e organizatave të ndryshme lidhur me politikën në nivel qeverisës por edhe rolin rregullator në mbështetjen e teknologjive të reja, siç janë edhe stacionet e ngarkimit të automjeteve elektrike. ERE ka vijuar komunikimin me palët e interesit si shoqata e bashkive të Shqipërisë dhe me OSSH sh.a., me qëllim marrjen e informacionit në lidhje me interesin publik të shfaqur pranë këtij operatori për të ngritur njësi të tilla shërbimi publik apo privat.

Gjithashtu do të vijohet me studimin e këtyre praktikave nga rregullatorë në vendet e tjera me të cilat ERE bashkëpunon për të përpunuar dhe propozuar zgjidhjet përkatëse në vijim.

- **ERE të jetë proaktive dhe të mbajë parasysh në përgatitjen e kuadrin ligjor dhe rregullator të impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike nga dielli edhe aktet e reja të miratuara nga Bashkimi Evropian, të cilat do të transpozohen së shpejti edhe në vendet e traktatit të energjisë, pra edhe në vendin tonë. Bashkimi Evropian i kushton një rëndësi të veçantë kësaj kategorie klientësh/prodhuesish, duke rritur të drejtat e tyre në operimin në tregun e energjisë elektrike. Nxitja dhe thithja e investimeve në impiante të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si centralet fotovoltaike, eolike, biomasë etj., duke respektuar standardet mjedisore, sjellin një diversifikim gradual të prodhimit të energjisë, tepër i domosdoshëm për sistemin energjetik të vendit, ndaj ERE-ja në bashkëpunim me aktorët e tjerë në vend duhet t'i kushtojë një rëndësi të veçantë.**

ERE ka qënë aktive dhe ka dhënë opinionin e saj lidhur me Draft-metodologjinë e propozuar nga ana e MIE – s “Për përcaktimin e çmimit të energjisë së prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, me fuqi të instaluar deri 2MËp”, pjesë e së cilës kanë qënë dhe parashikime lidhur me tarifën dhe fuqitë e impianteve vetëprodhuese të energjisë elektrike.

Po ashtu dhe gjatë diskutimeve me palët e interesit për draft ndryshimet e ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme e inicuar nga ana e MIE-s, pjesë e së cilës parashikohet të jenë dhe impiantet vetëprodhuese të energjisë elektrike, ERE ka luajtur një rol aktiv duke shprehur opinionet e veta gjatë këtyre takimeve.

Po në këtë kuadër i është kërkuar Bankës Botërore ndihmë për financimin e një asistence teknike e cila do të ndihmojë ndër të tjera për përpilimin dhe zbatimin e metodologjisë për kalkulimin e obligimit të energjive të rinovueshme pjesë e të cilës do të jetë dhe skema e kompensimit të impianteve vetëprodhuese.

- **Të punojë për krijimin e një tregu të garancive të origjinës. Garancia e origjinës është një dokument, i cili i provon konsumatorit se një pjesë ose e gjithë sasia e dhënë e energjisë së konsumuar prej tij është prodhuar prej burimeve të rinovueshme. Krijimi i këtij tregu do të rriste vlerën e investimeve të bëra në vendin tonë për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, si dhe mundësinë e njohjes së tyre në vendet fqinje duke marrë parasysh edhe orientimin e politikave në nivel kombëtar, por edhe të tyre të Bashkimit Evropian.**

Në lidhje me rekomandimin më sipër, ERE me vendimin nr. 229, dt. 20.12.2019, ka miratuar tashmë “Rregulloren për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”.

Deri më tani është kërkuar dhe lëshuar vetëm një Garanci origjine me vendimin e Bordit të ERE – s nr. 132, date 10.08.2020, me anë të të cilit është vendosur kualifikimi i impiantit të prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, në pronësi të shoqërisë DEVOLL HYDROPOWER sh.a..

Në vijim të përmbushjes së rekomandimit të Kuvendit të Shqipërisë, nga ana jonë gjithashtu është hartuar dhe aktualisht mbahet regjistri në të cilin do të regjistrohen periodikisht të gjithë të licencuarit që do të pajisen me Garanci të origjinës. Në këtë regjistër pasqyrohen të dhëna në lidhje me: emrin e shoqërisë, NUIS, tipin e impiantit, kapacitetin e instaluar, prodhimin vjetor të energjisë, numri dhe seria e licensës, vendimi i ERE-s për licencimin e shoqërisë, vendimi i ERE – s për GO dhe afati i vlefshmerisë së Garancive të Origjinës.

Në po këtë kuadër janë zhvilluar edhe takime online me përfaqësues të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë së Vienës, organizatës ndërkombëtare të standarteve të garancisë së origjinës, IREC, për krijimin e një regjistri të unifikuar me standartet e BE-së dhe të rajonit të Garancive të Origjinës si dhe ndihma që mund të ofrohet nga Sekretariati i Vienës apo dhe organizatës IREC për përpilimin e një database për Garancitë e origjinës së vendeve të rajonit përfshirë dhe Shqipërinë që Çertifikat e Origjinës të njihen në vendet Rajonit dhe BE – së.

Në këtë kuadër ka patur dhe kërkesa nga Përfaqësues të kompanive të BE – së të cilët janë interesuar për njohjen e Garancive të Origjinës të prodhuesëve Shqipëtarë dhe marrjen e praktikave të vendeve të cilat kanë kaluar tashmë këtë proces si Bullgaria apo Kroacia.

- **ERE të bashkëpunojë me MIE-në për të kërkuar nga KESH – i të përshpejtojë propozimin ndaj Asamblesë së Përgjithshme të saj për krijimin e një fondi garancie dhe mënyrën e menaxhimit të tij për të siguruar sadopak uljen e riskut hidrologjik në vit të thatë, si dhe, duke marrë parasysh ndryshimet në aktet e miratuara, të konsiderojë mundësinë që edhe shoqëria FTL sh.a. të kontribuojë në menaxhimin e riskut hidrologjik për garantimin e furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë.**

Nga ana e jonë është kërkuar informacion KESH sh.a. dhe MIE, për ecurinë e procesit lidhur me masat e marra për krijimin e një fondi garancie dhe mënyrën e menaxhimit të tij për të siguruar uljen sadopak të riskut hidrologjik në vit të thatë. Gjithashtu ndryshimet e fundit të VKM nr. 244, dt. 30.03.2016, e ndryshuar, në të cilën ERE ka qënë pjesëmarrëse aktive në përpilimin e saj mbi “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarëve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” vijnë në këtë frymë.

Problematika është diskutuar me palët dhe i është vënë theksi dhe gjatë procedurës për miratimin e Kontratës Tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesi i shërbimit universal FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë në përmbushje të VKM 244/2016 të ndryshuar. Duhet theksuar gjithashtu se deri me sot nga ana e KESH sh.a. nuk janë njoftuar masat e marra në këto drejtim.

- **T'i kushtojë vëmendjen e duhur rekrutimit të një stafi sa më profesional dhe cilësor në mënyrë që ERE të zhvillohet si një institucion i pavarur me kapacitete të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme për t'u përballur me sfidat e sektorit dhe që trajton në mënyrë më aktive mangësitë në tregjet kombëtare të energjisë, siç theksohet edhe në progres – raportin e KE – së.**

Rekrutimi i stafit të nevojshëm për plotësimin e strukturës organizative me ekspertizën e mjaftueshme është realizuar në mënyrë tranzitore deri në kryerjen e procedurave të rekrutimit të stafit në përputhje me Ligjin “për nëpunësin civil” pjesë e së cilës është dhe stafi i Rregullatorit.

Për sa më sipër është proceduar me ndryshimet e nevojshme në Rregulloren e organizimit të brendshëm të ERE – s, e cila u miratua me vendimin nr. 199 dt. 27.11.2020 dhe do të vijohet me procedurat e zhvillimit të konkursit për marrjen në punë të punonjësve sipas procedurave të legjislacionit për nëpunësin civil dhe Departamentin e Administratës Publike.

- **Të vijojë punën për zhvillimin e tregut të gazit dhe krijimin e lehtësive për hapjen e tregut të gazit natyror në vendin tonë, si një kusht i rëndësishëm për të garantuar sigurinë afatgjatë të furnizimit me gaz natyror dhe diversifikimin e burimeve në vend, si dhe të jetë në bashkëveprim të vazhdueshëm me entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë për marrjen e vendimeve dhe nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse për projektin TAP-AG.**

Pothuajse katër vjet e gjysëm që nga fillimi i ndërtimit, Gazsjellësi Trans Adriatik, ky i fundit tashmë është plotësisht i kompletuar. Gazsjellësi TAP është mbushur me gaz natyror nga kufiri Greko – Turk deri në terminalin që merr tubacionin në Italinë Jugore. Pasi janë bërë provat e qëndrueshmërisë të tubacionit si dhe të gjitha provat teknike të nevojshme dhe domosdoshme për fillimin e operacionit të operimit, projekti filloi operimin me sukses me 15.11.2020. Duam të theksojmë se tashmë Shqipëria, është e lidhur me një rrjet ndërkombëtar të gazit.

Bashkangjitur këtij informacioni gjenden të listuara edhe aktet që lidhen me Sektorin e gazit natyror, për të cilat ERE ka filluar procedurën apo i ka miratuar tashmë.

- Gjatë vitit 2020 është vijuar lidhur me vendimmarrje të rëndësishme dhe të nevojshme për realizimin në kohë dhe vendosjen në operim brenda afateve kohore të projektit madhor TAP AG. Gjatë katërmujorit të fundit të vitit 2020, është zhvilluar një punë intensive në lidhje me miatimin e disa vendimeve të domosdoshme, nga autoritetet e të tre vendeve ku kalon projekti i TAP AG, sipas kërkesave të paraqitura nga ky i fundit.
- Miratimi i “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme” të propozuar nga TAP AG;
- Miratimi i kërkesave lidhur me disa shtesa në Vendimin e Bordit të ERE – s nr. 105, datë 29.06.2020, “Për Oficerin e Përputhshmërisë së TAP AG, dhe i kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë;
- Miratimin paraprak të “Opinionit të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi kërkesën e TAP AG për zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit të Përfundimit”;
- Miratimi i ICAM (Initial Capacity Allocation Mechanism) kapaciteti fillestar i alokimeve;
- Miratimi i të gjitha kërkesave të çertifikimit për udhëzuesin e operatorit të pavarur të transmetimit (ITO) për TAP, të cilat janë paraqitur zyrtarisht pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vienë (materiale konfidenciale) të cilat ndodhen në fondin”

- Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE – s nr. 179, dt. 08.11.2017, “mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” Alb gaz sh.a.”, i ndryshuar.
 - Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, Alb gaz sh.a.
 - Për miratimin e Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror, në Shqipëri.
 - Për miratimin e “Kodit të matjes të gazit natyror në Shqipëri”
 - Mbi fillimin e procedurës për të miratuar “Kushtet për të liçensuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror në Shqipëri
 - Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullave të përdorimit të terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL)”.
 - Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL” në Shqipëri.
- **ERE të vijojë të jetë aktive në dhënien e mendimeve dhe opinionëve për shuarjen e detyrimeve reciproke midis operatorëve publikë të sektorit të energjisë elektrike dhe marrjen e masave për parandalimin e krijimit të tyre në të ardhmen si në kuadër të VKM-së së miratuar në vitin 2019, ashtu edhe gjatë procesit të shqyrtimeve të propozimeve të konsulencës, që pritet të jetë funksionale pranë MIE – së.**

Problematika e mësipërme ka qënë në mënyrë të vazhdueshme në fokusin e ERE – s, dhe për këtë qëllim si dhe zbatim të detyrës së lënë nga rezoluta, ERE ka vijuar punën me qëllim adresimin e kësaj problematike me palët e përfshira në këtë problematikë si dhe palët përgjegjëse për zgjidhjen e saj. Për këtë qëllim ERE i është drejtuar shoqërive KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. duke i kërkuar informacion mbi ecurinë zbatimit të parashikimeve të VKM nr. 126 dt. 11.02.2015 “Për Përcaktimin e shumave të shuarjes, me kompensim, të Detyrimeve ndërmjet institucioneve buxhetore dhe jo-buxhetore që financohen nga buxheti, KESH sh.a., OSHEE sh.a. dhe Ministrisë së Financave, si dhe VKM-se nr. 253, dt. 24.4.2019 “Për miratimin e planit të konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergetik”, sa i përket njohjes dhe shlyerjes së detyrimeve të prapambetura reciproke mes tyre si dhe operatorëve të tjerë të sektorit të energjisë elektrike.

Përveç sa më sipër, ERE i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë duke kërkuar informacion mbi procesin e shqyrtimeve të propozimeve të konsulencës që siç parashikohet në Rezolutë, pritet të jetë funksionale pranë MIE – s, lidhur me shuarjen e detyrimeve reciproke midis operatorëve publike të sektorit të energjisë elektrike.

Në këtë kuadër nga ana e Zyrës së Implementimit të Reformës ngritur pranë MIE – s është raportuar së fundmi në takimin e Komitetit Drejtues të ngritur për implementimin e programit të reformës së sektorit, ku një vëmendje tejet e veçantë i kushtohet procesit të gjetjes së zgjidhjeve për shlyerjen e detyrimeve reciproke midis operatorëve të sektorit si dhe gjetjen e një zgjidhje për moskrijimin e tyre në të ardhmen.

Në këtë Komitet ku janë pjesëmarrës përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ERE, Bankës Franceze për Zhvillim dhe Bankës Gjermane KfW të dy Ministrisë kanë marrë angazhimin për përpilimin e një plani masash afatgjatë dhe përpilimin e kontratave midis palëve për njohjen dhe shlyerjen e detyrimeve reciproke si dhe për shlyerjen e detyrimeve që institucionet buxhetore kanë ndaj FSHU sh.a. Plani i masave pritet më tej të miratohet ose nga dy Ministrisë ose nga Këshilli i Ministrave.

Së fundmi, shoqëria KESH sh.a. ka bërë me dije ERE – n mbi gjendjen e detyrimve të ndërsjellta deri në 30.09.2020, ndërmjet **OST - KESH per energjinë; OSHEE - KESH për energjinë; Detyrimet për HUA.**

Nga ana tjetër edhe OST sh.a. me të sajën e dt. 26.10.2020 ka bërë me dije mbi statusin e detyrimeve reciproke, ndërmjet **KESH sh.a. - OST sh.a; OSHEE Group - OST sh.a.; për Huatë.**

ERE në vendimarrjet e saj për tarifatat e kompanive nuk i ka konsideruar si kosto të tepërta dhe të justifikuar marrëdhëniet e ndërsjellta ndërmjet tyre deri në përfundimin e shuarjes së tyre sipas VKM – ve përkatëse.

- **Gjatë vitit 2020, me miratimin nga ERE të strategjisë për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë elektrike, ajo duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë implementimit të kësaj strategjie në përputhje me direktivën e BE – së “Për sigurinë e sistemit dhe sistemeve informatike”.**

Në lidhje me sa më sipër, ERE i është drejtuar të tre shoqërive KESH sh.a., OST sh.a., dhe OSHEE sh.a. duke kërkuar informacion mbi masat e marra për implementimin e kësaj Strategjie megjithëse raportimi periodik sipas rregullores së sigurisë kibernetike parashikon një raportim të gjërë brenda muajit Janar.

Po ashtu pas miratimit të Rregullores është zhvilluar një takim me Autoritetin Kombëtar për Çertifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) pranë Këshillit të Ministrave për bashkëpunimin në fusha të përbashkëta dhe zgjerimin e rregullores dhe në fushat që lidhen me objekte të Gazit natyror apo dhe të centraleve prodhues private dhe përfshirjen e tyre në listën e infrastrukturave kritike. Në këtë takim u ra dakort për vijimin e bashkëpunimit midis dy institucioneve për trajnime të përbashkëta, krijimin e grupeve punës të përbashkët apo dhe shkëmbimin e rezultateve të monitorimit dhe raportimit për infrastrukturën kritike të sektorit që mbulon rregullorja. Në vijim u diskutua dhe do të shihet mundësia e përpilimit dhe nënshkrimit të një Memorandumi bashkëpunimi midis të dy institucioneve ku të vihen bazat e këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Po ashtu pjesmarrja aktive në Grupet e punës të ngritur nga ana e Sekretariatit për cyber security në vëndet e rajonit ka vijuar edhe gjatë kësaj periudhe.

- **Të caktojë afate konkrete për OSSH – në për përfundimin e plotë të studimit të vlerësimit të humbjeve të energjisë elektrike në traktin e lidhjes nga njësjia gjeneruese deri në pikën e lidhjes me rrjetin e OSHEE sh.a. Proçesi i uljes së humbjeve në rrjet nga ana e OSSH-së sh.a. për të arritur targetet e vendosura duhet të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të ERE-s dhe raportimeve periodike të Rregullatorit.**

ERE i është drejtuar OSSH sh.a., duke kërkuar të bëjë me dije afatet konkrete për përfundimin e plotë të “Studimit të vlerësimit të humbjeve të energjisë elektrike në traktin e lidhjes nga njësjia gjeneruese deri në pikën e lidhjes me rrjetin e OSSH sh.a.”.

Proçesi i uljes së humbjeve në rrjet nga ana e OSSH sh.a. për të arritur targetet e vendosura, është në vëmendjen e vazhdueshme të ERE-s dhe raportimeve periodike të Rregullatorit duke lënë detyrë për përfundimin e këtij studimi nga ana e OSSH sh.a. të përditesuar jo më vonë se data 31.12.2020. një kopje e studimit është percjellë në fund të muajit Dhjetor nga ana e OSSH dhe është duke u studjuar nga ana e ERE – s për të nxjerrë detyrat përkatëse.

- **ERE t'i kushtojë vëmendje të veçantë ndjekjes dhe parandalimit të problematikave që mund të lindin nga implementimi i projektit pilot të sistemit të ri të faturimit, duke kërkuar një analizë tekniko – ekonomike, ku shoqëritë të paraqesin qartë përfitimet që do të sjellë kjo mënyrë leximi dhe faturimi, si reduktimi i kostove, eficienta dhe saktësia e procesit, si dhe pritshmërinë lidhur me përmirësimin e transparencës ndaj klientëve.**

ERE i është drejtuar FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a. duke i kërkuar ndër të tjera;

- Paraqitjen e një analize tekniko – ekonomike ku të përfshihen qartë përfitimet që do të sjellë kjo mënyrë leximi dhe faturimi, për secilën nga shoqëritë (që do të përfshijnë reduktimin e kostove, eficientën dhe saktësinë e procesit).
- Problematikat që mund të lindin nga ky proces dhe parandalimin e tyre, si dhe pritshmërinë lidhur me përmirësimin e transparencës ndaj klientëve si dhe efektet e pritshme në drejtim të uljes së numrit të debitorëve dhe përmirësimit të llogarive të arkëtueshme.
- Evidentimin e saktë të klientëve që do të përfshihen në projekt duke mbajtur në konsideratë që kushtet teknike të shoqërisë e lejojnë.
- Mënyrën e njoftimit të klientëve të cilët i janë nënshtruar apo do të nënshtrohen projektit pilot.
- Mënyrën e faturimit të tyre e cila nuk duhet të jetë në zërin *vlerë referuese* pasi bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
- Parashikimi i kësaj mënyre leximi në sistemin e Menaxhimit të marrëdhënieve me klientin.
- Raportimit në ERE pas përfundimit të projektit pilot lidhur me ecurinë e procesit.
- Formën e pasqyrit në bilancin energjetik dhe rakordimin me pjesëmarrësit e tjerë të tregut që afektohen ky projekt.
- Përgatitjen e një fushate informuese për tu kryer në zonat ku parashikohet të implementohet projekti ku të jenë evidentuar të drejtat e detyrimit që u lindin palëve (ofruesve të shërbimit dhe klientit) si dhe opinionin e tyre në lidhje me këtë projekt.
- Evidentimin e akteve ligjore ose/dhe nënligjore që duhet të ndryshohen në mënyrë bërjen të mundur të zbatimit të procesit të leximit disamujor.
- Informacion në lidhje me ecurinë e projektit pilot për vënien në testim të sistemit të ri të faturimit, në disa zona të identifikuar nga vetë OSSH, i cili mund të lehtësojë në mënyrë të ndjeshme leximin e matjes së energjisë.
- Analizën në lidhje me të dhënat e gjeneruara nga projekti pilot i iniciuar që në vitin 2019 nga ana e tyre.
- Analizën në lidhje me marrëdhënien dy palëshe të FSHU sh.a. dhe OSSH sh.a. me qëllim garantimin e një procesi leximi e faturimi sa më të saktë e të drejtë.
- Rezultatet e implementimit të sistemit të faturimit mbështetur në vendimin e bordit të ERE nr. 58/2020 si dhe të dhëna krahasuese në lidhje me numrin e ankesave të regjistruara gjatë kohëzgjatjes së efekteve juridike të këtij vendimi, krahasuar më të njëjtën periudhë një vit më parë.

Me tej ERE do të vijojë diskutimi dhe komunikimet përkatëse me OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a..

- **ERE të vijojë të ndjekë në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse të shoqërisë FSHU sh.a. deri në zgjidhjen përfundimtare. çështjen e ankesave të klientëve, të cilët janë faturuar nën emërtimet “energji e pamatur” dhe “dëm ekonomik” në periudhën tetor 2008 — prill 2011.**

Gjate viteve 2018 – 2019 ERE ka proçeduar me monitorime me qëllim mbikëqyrjen e ecurisë së trajtimit të ankesave të regjistruara në OSHEE nën emërtimin “dëm ekonomik” dhe “energji e pamatur” për periudhën 2008 – 2011, me qëllim verifikimin e zbatimit të vendimit të ERE – s lidhur me anulimin e kësaj kategorie të faturave të klientëve të energjisë elektrike. Nga korrespondencat me FSHU sh.a. përgjatë vitit 2020, nuk ka një raport të saktë në lidhje me sistemit që janë bërë, për raste për të cilat është ushtruar ankim gjatë viteve 2011 deri në 2018.

Në vijim, duke marr në konsideratë edhe kufizimet që diktojnë masat e Qeverisë Shqipëtare me qëllim mbrojtjen nga Covid – 19, ERE do të ruajë korrespondencë të vazhdueshme me të licencuarin dhe do të vijojë me kërkesën për informacion në lidhje me ankesat e klientëve të energjisë elektrike, të cilët janë faturuar nën emërtimin “energji e pamatur” dhe “dëm ekonomik” në periudhën Tetor 2008 – Prill 2011, duke kërkuar një vlerësim mbi statusin dhe numrin e kontratave të klientëve të cilët kanë paraqitur ankim në OSHEE me objekt “dëm ekonomik” apo “energji e pamatur”.

- **ERE, për zgjidhjen e problematikës së pronësisë së kabinave elektrike të bëjë propozimet përkatëse edhe për ndryshime ligjore, nëse është e nevojshme, apo të japë rekomandimet e nevojshme për institucionet përkatëse dhe të kërkojë edhe ndërhyrjen e Kuvendit përmes Platformës ndërinstitucionale online, të ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë, e cila është në dispozicion të institucioneve të pavarura si një mjet i ri që synon rritjen e autoritetit të institucioneve të pavarura, si dhe përfshirjen e Kuvendit të Shqipërisë si katalizator ndërmjet institucioneve të pavarura dhe atyre qeveritare për zgjidhjen e problemeve.**

ERE i është drejtuar shoqërisë OSSH sh.a., duke kërkuar që përpara se të gjenden zgjidhjet e domosdoshme që do të adresojnë njëherë e mirë këtë problematikë, të kemi dijeni për qëndrimin e tyre në lidhje me zgjidhjen më efikente e afatgjatë. Propozimet për ndërhyrjet që vlerësohen të nevojshme në kuadrin ligjor dhe në kuptim të ndryshimeve në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neni 71/1 e që do jepenin zgjidhjen më të mirë jo vetëm për interesit e OSSH sh.a. në cilësinë e operatorit përgjegjës për mbarëvajtjen e këtyre njësive të shërbimit me qëllim garantimin e furnizimit me energjisë elektrike, por mbi të gjitha pa çënuar intereset e palëve të treta në këtë proçes. Ndryshimet e fundit në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, në lidhje me të drejtën e shfrytëzimit të kabinave në përdorim (uzufrukt) nga ana e OSSH, në fakt kanë dhënë ndërkohë një zgjidhje ligjore e që e adreson këtë problematikë të konstatuar në vitet e shkuara.

- **Të vijojë punën për krijimin e tregut të përbashkët të energjisë elektrike Shqipëri-Kosovë, si një ndër hapat e nevojshëm për krijimin e tregut rajonal të energjisë elektrike. Krijimi i këtij tregu do të përmirësojë sigurinë e furnizimit me energji elektrike për dy vendet tona, duke marrë në konsideratë faktin se dy vendet tona kanë sisteme komplementare të prodhimit të energjisë elektrike. Gjithashtu, integrimi i tregjeve ndikon ndjeshëm në rritjen e konkurrencës së shitjes së energjisë elektrike në tregun me shumicë dhe, për rrjedhojë mund të sjellë edhe ulje të çmimeve të energjisë elektrike në tregun me pakicë.**

Lidhur me këtë pikë ERE ka vijuar angazhimin si pjesë aktive e grupeve të punës ngritur për këtë qëllim edhe përgjatë vitit 2020. Po ashtu janë zhvilluar dhe takime të Komitetit drejtues për ngritjen e bursës së energjisë elektrike pjestare të së cilës janë përfaqësues nga MIE, ERE, OST, KOSTT dhe përfaqësues të USAID dhe IFC si donatorë të cilët janë angazhuar në financimin e asistencës teknike për krijimin e tregut të një dite me parë dhe operimin e Bursës së energjisë elektrike.

Roli i ERE – s ka qënë tejet aktiv në këto grupe pune duke shprehur gjithashtu vullnetin për bashkëveprim edhe me të ngushtë në nivel ekspertësh për vijimin dhe përfundimin e suksesshëm të këtij procesi tejet të rëndësishëm.

Po ashtu ERE vijon të jetë proaktive në harmonizimin dhe adaptimin e kuadrit rregullator dhe teknik për këtë qëllim, duke koordinuar procesin me Rregullatorët rajonale kryesisht me Kosovën dhe me operatorë të sistemit të transmetimit dhe tregut.

7. AKTIVITETI I ERE-S NË ZHVILLIMIN E LEGJISLACIONIT SEKONNDAR DHE NDRYSHIMET E TJERA LIGJORE TË NDODHURA GJATË VITIT 2020

7.1 Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të përshtatjes së tyre me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

Pjesë e rëndësishme e aktivitetit të ERE – s është hartimi i legjislacionit sekondar, që përbën edhe kuadrin rregullator në sektorin e energjisë elektrike dhe atë të gazit natyror. Ky kuadër është plotësuar nga ERE në një pjesë të konsiderueshme dhe aktualisht janë në proces përpunimi disa akte me rëndësi në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar si dhe ligjit 102/2015 “Për sektorin e gazit”, i ndryshuar.

Me gjithë vështirësitë e krijuara përgjatë vitit 2020 si rezultat i situatës së krijuar nga pandemia COVID – 19, ERE ka ndërmarrë hapat e nevojshëm nëpërmjet komunikimit online përgjatë të gjithë vitit 2020 si brenda institucionit, ashtu edhe në komunikimin me palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, duke krijuar mundësi njohje me përmbajtjen e dokumenteve, mundësinë e konsultimit dhe dëgjimit të palëve të interesuara. Çdo dokument, i cili ka hyrë në procesin e përgatitjes, shqyrtimit si dhe të rishikimit, është publikuar në faqen zyrtare të ERE – s për t’i siguruar mundësi aksesit përpara vendimmarrjes, palëve të interesuara për këto praktika. Në finalizim të këtyre proceseve të konsultimit publik dhe me palët e interesit, ERE është shprehur me vendimmarrje. Mbledhjet vendimmarrëse gjatë vitit 2020 kanë qënë të hapura për publikun për sa kohë nuk janë diktuar kufizimet si rezultat i situatës së krijuar nga pandemia Covid-19. Prej datës 11.03.2020 e në vijim, mbledhjet vendimmarrëse të Bordit janë zhvilluar pa prezencën e publikut por pa kufizuar të drejtat e të interesuarve për informim, ankimim dhe pjesëmarrje në procedurë.

Gjatë vitit 2020, ERE shënon disa vendimmarrje të rëndësishme në lidhje me shqyrtimin e akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të përshtatjes së tyre me Ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar.

Më poshtë listohen disa nga vendimmarrjet e rëndësishme që lidhen me hartimin apo ndryshimin e ketyre akteve:

VENDIMET E ERE VITI 2020

1. Vendimi Nr. 12, datë 23.01.2020, “Mbi disa ndryshime në kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike mes shoqërisë së ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi”

Kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike është miratuar me Vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s. Kjo vendimmarrje e ERE në vijim ka pësuar ndryshime e shtesa me vendimet e Bordit të ERE me Vendimin nr. 147, datë 30.09.2016, si dhe me Vendimin nr. 255, datë 24.12.2018. Këshilli i Ministrave ka miratuar me VKM nr. 883, datë 27.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licënsuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar. Në nenin 11, pika 2 të VKM-së nr. 883, datë 27.12.2019, sipërcituar, është sanksionuar se: *“Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE”*.

Ndryshimet e pësuara janë si vijon, kudo në kontratë OSHEE sh.a. në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë do të zëvendësohet me shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë FTL sh.a. Në fund të pikës 1 të nenit 10, togfjalëshi “të OSHEE Sh.a.” bëhet “me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.” si dhe në fund të pikës 3 të nenit 13 shtohet togfjalëshi “me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes”. Fuqia juridike e kontratës së ndryshuar me këtë vendim, lidhur mes FTL sh.a. dhe çdo prodhuesi me përparësi të energjisë elektrike për shitblerjen e energjisë elektrike, i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve dhe deri në përfundimin e afatit të parashikuar në kontratat respektive të lidhura.

2. Vendimi Nr. 38, datë 27.02.2020, “Mbi miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifës së shitjes së gazit natyror nga furnizuesi i mundësisë së fundit”

Qëllimi i kësaj metodologjie, është përcaktimi i tarifës të shitjes së gazit natyror të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim si dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e çmimeve të drejta dhe transparente.

Kjo metodologji do të zbatohet për të licënsuarin e ngarkuar për shërbimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit në sektorin e gazit natyror, i caktuar në përputhje me përcaktimet e nenit 90 dhe 91 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit natyror” i ndryshuar.

3. Vendimi Nr. 40, datë 06.03.2020, “Mbi miratimin e rregullores së kërkesave dhe procedurave për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar”.

Rregullorja përcakton në mënyrë të detjuar kërkesat dhe procedurat për përcaktimin e operatorit të emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar.

“Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”: Është subjekt ligjor i cili përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë për të kryer detyrat që kanë lidhje me bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe të tregut të brenda të njëjtës ditë sipas kësaj rregullore.

Operatorët e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMOs) duhet të veprojnë si operatorë të tregut, në tregun lokal ose tregun rajonal, për të kryer në bashkëpunim me OST lokal ose OST rajonal, bashkimin e tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda të njëjtës dite. Detyrat e tyre do të përfshijnë marrjen e porosive nga pjesëmarrësit e tregut, për të patur një përgjegjësi tërësore për përputhjen dhe ndarjen e porosive sipas rezultateve të tregut të ditës në avancë dhe atij brenda të njëjtës dite, për të publikuar çmimet dhe shlyerjen e kontratave që rezultojnë nga tregtimi sipas marrëveshjeve dhe rregulloreve përkatëse me pjesëmarrësit.

4. Vendimi Nr. 68, datë 22.04.2020, “Mbi miratimin e kodit të rrjetit të transmetimit të gazit natyror”

“Kodi i Rrjetit të Transmetimit” është hartuar nga shoqëria ALBGZ sh.a në zbatim të dispozitave të Ligjit Nr.102/2015, datë 23/09/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” i ndryshaur. Qëllimi i Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit Natyror, është të ofrojë një bashkësi termash dhe kushtesh standarde të hapura dhe transparente për transportin e gazit natyror përmes sistemit të transmetimit të gazit në Shqipëri, nga subjekte të licensuara nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Hartimi i Kodit të Rrjetit të Transmetimit të Gazit është bazuar në Kodin e TAP dhe ka integruar në të elementë nga Kodet e vendeve të tjera, përbën draftin e parë të plotë për sistemin e transmetimit të gazit natyror në Shqipëri. Në përmbajtje të tij jepet një shpjegim i qartë i lidhjes së Kodit të Rrjetit të Transmetimit me akte të tjera rregullatore të cilat kontribuojnë në rregullimin e funksionimit të sistemit të transmetimit.

5. Vendimi Nr. 73, datë 22.04.2020, “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal për furnizimin e klientëve fundorë”

Kontrata tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti në rastin konkret KESH sh.a., dhe furnizuesi i shërbimit universal për furnizimin e klientëve fundorë. Kjo Kontratë (së bashku me Shtojcat e saj) rregullon të gjithë marrëdhënien e shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike ndërmjet Palëve për periudhën kohore 1 Janar – 31 Dhjetor. Duke marrë në konsideratë faktin se pjesa me e madhe e konsumatorëve të energjisë elektrike, furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, kjo kontratë është një ndër elementet kryesor për garantimin e sigurisë së furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve në vendin tonë.

6. Vendimi Nr. 97, datë 15.06.2020, “Mbi miratimin e kodit të rrjetit TAP”

Bordi i ERE, së bashku me Rregullatoret e Italisë (ARERA) dhe Greqisë (RAE), me Vendimin Nr. 97, datë 15.06.2020, vendosi të miratojë Kodin e Rrjetit TAP. Ky Kod i Rrjetit lidhet me Sistemin e

Transportit të TAP, ku përfshihen rregullat dhe procedurat për funksionimin e Sistemit të Transportit të TAP, si dhe paraqiten në detaje të drejtat dhe detyrimet e Transportuesit, Palëve të Regjistruara dhe Tregëtarit/Furnizuesit në lidhje me rezervimin dhe përdorimin e Produkteve të Kapacitetit. Ky Kod i Rrjetit zbatohet për të gjitha Palët e Regjistruara dhe Tregëtarët/Furnizuesit dhe është pjesë përbërëse e çdo Marrëveshje të Transportit të Gazit.

7. Vendimi Nr. 106, datë 02.07.2020, “Mbi miratimin e rregullave të tregut shqiptar të balancimit të energjisë elektrike”

Miratimi i Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit ka si qëllim kryesor të themelojnë menaxhimin me bazë tregu të balancimit të Sistemit Elektroenergjitik, që operohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, të përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, në tregun e balancimit, të mundësojnë përgjegjësi të qarta të balancimit për pjesëmarrësit e tregut, të përshkruajnë të drejtat dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimit të balancimit, të krijojnë një mekanizëm për përcaktimin e çmimit të shërbimeve balancuese të prokuruar nga OST si dhe mekanizmin për llogaritjen e çmimit të shlyerjes së disbalancave dhe pagesave financiare të disbalancave për Palët Përgjegjëse të Balancimit dhe çështje të tjera që lidhen me operimin e tregut balancues. Ky dokument shumë i rëndësishëm u krijua me objektivin për të krijuar një mekanizmi balancues eficient, transparent dhe jodiskriminues që përcakton përgjegjësitë e balancimit dhe nxit pjesëmarrësit e tregut të kryejnë balancimin si dhe të ofrojnë shërbime balancuese.

8. Vendimi Nr. 112, datë 09.07.2020, “Mbi miratimin e Rregullores për profilet e standartizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalancave, nuk janë të disponueshme”.

Rregullorja për profilet e standartizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalancave, nuk janë të disponueshme u hartua në mbështetje të neneve 69, gërma f dhe 86, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar. Kjo rregullore siguron zbatimin e përcaktimeve të pikës (6) të nenit 86 dhe gërmës (f) të nenit 69 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe aplikohen në përputhje me detyrimet e Traktatit të komunitetit të energjisë, që të mundësojnë hapjen e tregut me pakicë të energjisë elektrike në vendin tonë, në rastet kur klientët kërkojnë të ndryshojnë furnizuesin e energjisë elektrike.

9. Vendimi Nr. 126, datë 30.07.2020, “Mbi miratimin e Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike”

Rregullorja për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike përcakton rregullat dhe masat që duhet të ndërmerren nga subjektet e Liçensuara nga ERE në sektorin e energjisë elektrike të cilët kanë përgjegjësi të garantojnë sigurinë kibernetike në infrastrukturat kritike që zotërojnë dhe operojnë. Garantimi i sigurisë kibernetike në sistemin elektroenergjitik siguron funksionimin e pandërprerë të Sistemit Elektroenergjitik Shqiptar dhe për rrjedhojë furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të konsumatorëve në vendin tonë.

Kjo rregullore përcakton detyrimin e operatorëve që zotërojnë ose operojnë infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë elektrike për të vendosur dhe zbatuar masat e duhura gjatë projektimit, instalimit dhe funksionimit të rrjetit ose pajisjeve të përdorura prej tyre, në mënyrë që të garantojnë sigurinë,

disponueshmërinë, integritetin dhe funksionimin e qëndrueshëm të sistemit elektroenergjitik. Operatorët duhet të paraqesin pranë ERE, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje raporte për çdo ndërhyrje të paplanifikuar, cënim ose incident në fushën e sigurisë, disponueshmërisë dhe integritetit të rrjeteve të tyre të komunikimit elektronik, si dhe çdo ndërhyrje, dëmtim që ka ndikim në funksionimin e rrjeteve dhe/ose të statusit të tyre të shërbimit.

10. Vendimi Nr. 149, datë 10.09.2020, Mbi miratimin e “Programit të përputhshmërisë rregullatore/regulatory compliance programme” paraqitur nga TAP AG në bazë të “opinionit të përbashkët përfundimtar/final joint opinion” në kuadër të procedurës së përjashtimit për Gazsjellësin TAP”.

Në zbatim të Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim: Direktiva 73/09); Rregullores 713/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009; Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në vijim Rregullorja 715/09); Paragrafi 4.10.2 i Opinionit përfundimtar të përbashkët përshkruan që në përputhje me nenin 36 (9) të Direktivës së gazit, Përjashtimi do të humbë efektet e tij 3 vjet pas miratimit në rastin kur ndërtimi i TAP nuk ka filluar akoma dhe 6 vjet pas miratimit në rastin kur infrastruktura nuk është vendosur akoma në funksion, derisa Komisioni të vendosë që çdo vonesë tjetër është për shkak të pengesave kryesore përtej kontrollit të personit të cilit i është dhënë përjashtimi.

11. Vendimi Nr. 162, datë 20.10.2020, “Mbi miratimin e rregullores mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë”

Rregullorja mbi procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik të akteve të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë është një Rregullore e cila zbatohet për rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik që zhvillohen nga ERE në proceset vendimmarrëse të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimit publik. Përveç kësaj në objektin e këtij dokumenti parashikohet se kjo Rregullore përcakton rregullat mbi organizimin e procesit të njoftimit dhe të konsultimit publik të projekt-akteve që miratohen për kompetencë nga ERE sipas parashikimeve të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, të ndryshuar, si dhe Ligjit nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, Ligjin nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Lidhur me detyrimin për njoftimin dhe konsultimin publik. Rregullorja përcakton se ERE do të marrë të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë: publikimin në faqen e internetit të ERE të projektaktit dhe relacioni shpjegues mbi projektaktin, publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të planit vjetor që lidhet me procesin e vendimmarrjes së akteve normative, dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri tek miratimi i aktit përfundimtar.

12. Vendimi Nr. 166, datë 22.10.2020, “Mbi miratimin e Kushteve të përgjithshme të Kontratës Tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit”

Kushtet e përgjithshme të Kontratës Tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit, është një dokument i rëndësishëm i cili ka për qëllim mbrojtjen e palëve në ofrimin e shërbimit të furnizimit me gazin natyror si shërbim publik, në kuadër të aktivitetit të shërbimit publik të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor dhe objekti i tij është furnizimi me gaz natyror nga ana e Furnizuesit të Liçensuar i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të furnizimit, dhe detyrimi i klientit për të paguar gazin natyror të konsumuar, në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara në të.

13. Vendimi Nr. 197, datë 26.11.2020, “Mbi miratimin e rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për zyrën e koordinimit të ankandeve në europën juglindore (SEE CAO) për kufijtë Shqipëri – Greqi, Shqipëri – Mali Zi dhe Shqipëri – Kosovë”.

Përgjat vitit 2020 u realizua nga ENTSO – E njohja e zonës së kontrollit të Operatorit të Transmetimit të Kosovës (KOSTT). Në këtë kontekst me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së lidhjes ndërmjet KOSTT me ENTSO – E, Kosova njihet si zonë kontrolli e pavarur, ku në bashkëpunim me OST sh.a., bazuar në marrëveshjen për krijimin e bllokut të kontrollit Shqipëri – Kosovë, do të operojnë brenda këtij blloku, në përputhje me rregullat e ENTSO-E.

SEE CAO ka përgatitur ndryshimet përkatëse të Rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit të SEE CAO, me qëllim aplikimin e tyre në kushtet e përfshirjes edhe të KOSTT si përfituese e shërbimeve të SEE CAO, dhe i ka përcjellë ato tek Operatorët e transmetimit që preken nga ky ndryshim, me qëllim miratimin e tyre nga Autoritetet Rregullatore Kombëtare përkatëse. Version më i përditësuar i “Rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për Zyrën e koordinimit të ankandeve të Kapaciteteve të interkonjeksionit në Europën Jug – Lindore (SEE CAO)” që është aktualisht në fuqi, është miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 154, datë 28.09.2017.

Në këtë kërkesë për miratim të Rregullave të harmonizuara të alokimit, rezulton se janë shtuar:

1. Shtojcë Specifike për Kufijtë e zonave të ofertimit të mundësuar nga SEE CAO në Rregullat e harmonizuara të alokimit për të drejtat afatëgjata të transmetimit;
2. Shtojca 1 “Lista e kufijve të zonës së ofertimit ku aplikohet HAR përfshirë informacionin mbi tipin e të drejtave afatëgjatë të transmetimit të alokuara;
3. Rregullat për alokimin e kapacitetit ditor eksplicit në zonat ofruese kufitare të ofruar nga SEE CAO;
4. Shtojca 1 “Lista e zonave ofertuese ku aplikohen rregullat e ankandit”; Rezulton se në dokumentat e mësipërme janë shtuar, përkatësisht kufijtë: Kosovë (XK) KOSTT <> Shqipëri (AL) OST; Kosovë (XK) KOSTT <> Mali i Zi (ME) CGES; Kosovë (XK) KOSTT <> Maqedoni e Veriut (MK) MEPSO.

14. Vendimi Nr. 202, datë 02.12.2020, “Mbi miratimin e Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”.

Rregullorja për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit u hartua me qëllim përcaktimin e procedurave eficiente dhe praktike për shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., për tregtimin në treg të parregulluar, të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore, sigurimin e shitjes së energjisë elektrike me çmime sa më të larta, nxitjen e pjesëmarrjes së tregtarëve në procesin e shitjes së energjisë elektrike dhe konkurrencës në procesin e shitjes së energjisë elektrike, sigurimin e transparencës si dhe mundësi të barabarta për të gjithë tregtarët dhe pjesëmarrësit në procedurat e shitjes së energjisë elektrike dhe së fundmi përputhja e saj me legjislacionin në fuqi. Rregullorja për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit ka për objekt të saj përcaktimin e procedurave të shitjes së tepricave të energjisë elektrike, nga Furnizuesi i Tregut të Lirë SH.A., si shoqëri e liçensuar në sektorin e energjisë elektrike, që ushtron aktivitetin e tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike.

15. Vendimi Nr. 236, datë 15.12.2020, “Mbi miratimin e kodit të etikës të punonjësve të Entit Rregullator të Energjisë”.

Rregullorja e brendshme e organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 199/2020, përcakton në mënyrë të përgjithshme çështje që lidhen me respektimin e normave dhe kodit të etikës në punë nga punonjësit e ERE. Kjo rregullore do të shërbejë si një kod rregullash të detyrueshme për zbatim nga çdo strukturë e ERE. Qëllimi kryesor rregullores është të përcaktojë marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të Bordit të ERE, personelit të ERE dhe Kodin e sjelljes profesionale që ata duhet të zbatojnë. Dispozitat e këtij Kodi identifikojnë parimet udhëzuese të korrektësisë, sjelljen e anëtarëve të Bordit dhe të punonjësve të Entit, në lidhje me vlerat në kuadër të etikës publike, të paañësisë, pavarësisë, konfidencialitetit dhe transparencës. Rregullat dhe parimet e përcaktuara në këtë Kod janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë punonjësit e ERE – s, pavarësisht nivelit të pozicionit të punës, hierarkisë dhe funksionit që ato ushtrojnë.

16. Vendimi Nr. 257, datë 21.12.2020, “Mbi miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OSSH sh.a”

Programi i Pajtueshmërisë së shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a) synon shmangien e sjelljeve diskriminuese të OSSH sh.a ndaj pjesëmarrësve të tjerë në tregun e energjisë elektrike, posaçërisht në favor të shoqërive bija, si dhe ofron mekanizmat për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e tij. Programi përcakton detyrimet specifike të punonjësve të OSSH sh.a., për përmbushjen e këtij objekti dhe transpozon në mënyrë të plotë kërkesat e Direktivës 2009/72/EC, në pajtim me Nenin 72 të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike. Gjithashtu, Programi i Pajtueshmërisë përcakton të drejtat dhe detyrimet e Zyrtarit të Pajtueshmërisë për të raportuar çdo shkelje të dispozitave të lart.përmendura ligjore.

17. Vendimi Nr. 265, datë 28.12.2020, “Mbi miratimin e Rregullave për monitorimin e tregut të gazit natyror, në Shqipëri”

Rregullat për Monitorimin e Tregut të Gazit Natyror u hartuan si dokument bazuar në Ligjin 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar, dhe përcaktojnë mënyrën dhe procedurat për monitorimin e funksionimit të Tregut të Gazit Natyror si dhe veprimtari të caktuara të Operatorëve të Transmetimit dhe të Shpërndarjes për funksionimin e Tregut të Gazit Natyror në Republikën e Shqipërisë. Monitorimi dhe kontrolli i funksionimit të tregut të gazit natyror realizohet nga ERE dhe ka për qëllim rritjen e efikasitetit, konkurrencës dhe transparencës së tregut të gazit natyror, si dhe identifikimin e parregullsive. Rregullat për Monitorimin e Tregut të Gazit Natyror parashikojnë detyrimet e të licencuarit në veprimtaritë e transmetimit, të shpërndarjes dhe të furnizimit, të furnizuesit të mundësisë së fundit për të përcjellë në ERE të dhënat dhe informacionet e nevojshme në lidhje me cilësinë e sigurimit të shërbimeve tregtare.

18. Vendimi Nr. 266, datë 28.12.2020, “Mbi miratimin e Kodit të matjes së gazit natyror” në Shqipëri”

Kodi i Matjes së Gazit Natyror është hartuar në përputhje me Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar dhe si pjesë e veçante nga Kodi i Transmetimit të Gazit në Shqipëri. Ky dokument përcakton kërkesat teknike për matësit dhe instalimet e matjes në pikat e transmetimit dhe/ose shpërndarjes së klientit dhe përcakton se personat e lidhur me këtë Kod janë tregtar me pakicë dhe/ose shumicë si dhe Operator i Sistemit të Transmetimit, Operator i Sistemit të Shpërndarjes dhe/ose Operatori i Kombinuar i gazit natyror.

Akte për të cilat ERE ka filluar procedurën dhe është në proces konsultimi me palët e interesit janë:

1. “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit dhe të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit në sektorin e energjisë elektrike”.
2. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin dhe miratimin e rregullores mbi procedurat për dhënien e së drejtës së përjashtimit për infrastrukturën e re të gazit natyror”.
3. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e licencës tip për veprimtarinë e operimit në hapësirat e depozitimit të gazit natyror”.
4. “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Rregullores për përcaktimin e kriterëve për ushtrimin e aktivitetit të depozitimit të gazit natyror”.
5. Vendim nr. 218, datë 15.12.2020 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e standardeve të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të licencuarit në aktivitetin e furnizimit”.
6. “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (Remit).
7. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e programit të përputhshmërisë së operatorit të sistemit të transmetimit për gazin natyror, “Albgaz” sh.a.
8. Mbi fillimin e procedurës për të miratuar “kushtet për të licencuarin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për sektorin e gazit natyror” në Shqipëri.

9. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “rregullave të përdorimit të terminalit të gazit natyror të lëngshëm (GNL)” në Shqipëri.
10. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “metodologjisë së llogaritjes së tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL” në Shqipëri.
11. Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020.
12. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe procedurën për kompensimin e prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.

Gjatë vitit 2021, ERE do të vijojë punën me qëllim miratimin apo azhurnimin e legjislacionit sekondar të miratuar në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”.

7.2 Proçeset gjyqësore në të cilat ERE ka qënë palë gjatë vitit 2020

7.2.1 ERE në Cilësinë e Palës së Paditur në proçeset gjyqësore.

ERE ka qënë palë e paditur në proçese gjyqësore përgjatë vitit 2020.

1. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë – Tiranë**, ka përfunduar çështja administrative me Nr. themeli Nr. 5858 Akti, datë 30.12.2019, me palë ndërgjyqëse: Paditës: Shoqëria “Wonder” shpk; i Paditur: Enti Rregullator i Energjisë (ERE); Person i tretë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR), Shoqëria "Energo-Sas" sh.p.k; Objekt gjykimi: Shfuqizimin si të paligjshëm të vendimit të Bordit të Enti Rregullator i Energjisë (ERE) Nr. 171, datë 07.11.2019. Njohjen e të drejtës së palës paditëse për tu pajisur me licensën për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike sa i përket hidrocentralit Sasaj. Detyrimin e palës së paditur ERE të pasjisë palën paditëse me licensën përkatëse. Gjykata ka vendosur rrëzimin e Kërkesë – Padisë. Shoqëria “Wonder” shpk ka ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Për shkak të situatës kaotike në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor si rrjedhojë e shtrëngimeve të diktuar nga pandemia Covid – 19, nga kjo Gjykatë nuk ka ende njoftim për caktimin e datës së proçesit.
2. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor - Elbasan**, ka përfunduar çështja civile me numër akti 1881, me palë ndërgjyqëse Paditës: M. E. (trashëgimtarët ligjorë të saj), të paditur: L. H., Enti Rregullator i Energjisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, A. E., shoqëria “Amal” shpk, me objekt gjykimi: pavlefshmëri absolute kontrate. Gjykata ka vendosur rrëzimin e Kërkesë – Padisë.
3. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë – Tiranë**, ka përfunduar çështja me Nr. 5731 akti, datë 16.12.2019, me palë ndërgjyqëse: Paditës: Shoqëria “Albtek Energy” shpk; I Paditur: Enti Rregullator i Energjisë; Person i tretë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Objekt gjykimi: Detyrimi i Entit Rregullator të Energjisë, të përcaktojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike të hedhur në rrjet, të shoqërisë “Albtek Energy” shpk, nga fillimi i hedhjes në treg të kësaj energjie. Gjykata ka vendosur pranimin e Kërkesë – Padisë. ERE ka ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Për shkak të situatës kaotike në të gjitha nivelet e sistemit

gjyqësor si rrjedhojë e shtrëngimeve të diktuar nga pandemia Covid – 19, nga kjo Gjykatë nuk ka ende njoftim për shortin apo caktimin e datës së procesit.

4. **Gjykata Administrative e Apelit – Tiranë**, ka përfunduar çështja me nr. 388/113 regjistri, datë 22.10.2019 regjistrimi, me palë ndërgjyqëse: Padiës: Shoqëria Anlo Oil & Gas Sh.a.; I Paditur: Enti Rregullator i Energjisë; Person i trete: Shoqëria “Albgaz” Sh.a.; Objekt gjykimi: Shfuqizimi i Vendimit nr. 60, datë 15.04.2019 të Entit Rregullator të Energjisë. Gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Aktualisht çështja është e mbyllur pasi nuk është ushtruar Rekurs nga palët.
5. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë – Tiranë, çështja** me nr. 2404 Akti, datë, 11.06.2020 me palë ndërgjyqëse: **Padiës:** Shoqëria "DEVY" Shpk, **I Paditur:** Enti Rregullator i Energjisë (ERE), **Person i tretë:** Shoqëria Konçensionare "MP-HEC" shpk me NIPT K93826001D, regjistruar me date 26.02.2009 me adresë Durrës, Rrashbull, shtëpi private poshtë kantinës se verës; **Objekt gjykimi:** 1. Shfuqizimin e vendimit nr. 37, datë 27.02.2020 të Entit Rregullator të Energjisë; 2. Shfuqizimin e vendimit nr. 10, datë 20.01.2020 të Entit Rregullator të Energjisë; 3. Shfuqizimin e vendimit nr. 187, datë 25.11.2019 të Entit Rregullator të Energjisë. Aktualisht kjo çështje gjyqësore është akoma në fazën e gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë Tiranë.
6. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë – Tiranë, Çështja administrative** me nr. 34346 Akti , datë, 17.09.2020, me palë ndërgjyqëse: **Padiës:** Shoqëria "MP-HEC" Shpk, **I Paditur:** 1. Enti Rregullator i Energjisë (ERE), 2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, (OSSH) SH.A, me **Objekt gjykimi:** 1- **Ndryshimin e pikes 1 të Aktit Administrativ** Vendim i Bordi të ERE Nr.89 datë 22.5.2020, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.109/2020 në piken 3 të tij; Rrëzimin e kërkesës së shoqërisë “MP – HEC” sh.p.k, për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 22.4.2020, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 187, datë 25.11.2019, “Mbi liçensimin e shoqërisë “MP-HEC” sh.p.k.”, Në pranimin pjesërisht të kërkesës së shoqërisë , “MP-HEC” shpk, me Nr 656/1 Prot i ERE date **28.04.2020** “Rishikim i Vendimit Nr. 74 datë, 22.04.2020 të Bordit të ERE “Miratimin e disa ndryshimeve të Vendimit të Bordit të ERE nr. 187, datë 25.11.2019”. **Shfuqizimin e Pikës 1, germa “b”, 2 - Konstatimi i Pavlefshmërisë Absolute** të ndryshimeve të Vendimit Nr. 187 datë 25.11.2019, të botuara në Fletoren Zyrtare Nr 176/2019. **3-Konstatimin e Pavlefshmërisë Absolute** të Aktit Administrativ Urdhër nr.4057/2 datë 16.07.2020 të OSSH. **4 - Pagimi solidar** i dëmit të shkaktuar nga veprimet e palës së paditur në shumën 30 000 Euro deri në datën e ngritjes së padisë me detynimin e të paditurve për të paguar edhe dëmin e pritshëm nëse do të rritet nga veprimet antiligjore të të paditurve. Kjo çështje gjyqësore është në fazën e administrimit të hetimit gjyqësor.
7. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë – Tiranë** Çështja administrative me nr. 4266 Akti, datë, 02.11.2020 me palë ndërgjyqëse: **Padiës:** Besim Pasha, Hasan Pasha, Hazis Lala, Abdi Toci, Sherif Koleci, Sail Koleci, Avni Koleci, Dhimiter Koleci, **I Paditur:** - Enti Rregullator i Energjisë, Rr. "Viktor Eftimiu", Tiranë.- Shoqëria “Seka Hydropoëer” shpk, shoqërin tregtare me NUIS L32116020A, përfaqësuar nga administratori z. Sokol Muceku. **Objekt gjykimi:** Shfuqizimi i Vendimit Nr.146, dt.10.09.2020, "Mbi liçensimin e shoqërisë "Seka Hydropower" shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjise elektrike nga HEC-et "Sekë" me kapacitet të instaluar 12667 kW dhe “Zais” me kapacitet të instaluar 2295 kW, me kapacitet total të instaluar 14962 kW". Kjo çështje gjyqësore është në fazën e administrimit të hetimit gjyqësor.
8. **Padiës: AREA - Shoqata Shqiptare e Energjive të Rinovueshme, me seli në Tiranë**, Rruga e Elbasanit, Vila Nr. 71, Tiranë, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 3538 date 25.03.2013 me NIPT L32218451U, e përfaqësuar nga Kryetare e Bordit Znj. Anita

Shushku, shtetase nga Zelanda e Re, e lindur në Shkodër (Shqipëri), me 24.04.1965, banuese në Rugën Nikolla Tupe, Pall. 2/1, Ap. 19 Tiranë, mbajtëse e pasaportës L13048425; Tel: 0692085594; Email info@areasso.org. **I Paditur: Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë** Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë; Enti Rregullator i Energjisë (ERE), Adresa: Blvd "Bajram Çurri, Rr. Viktor Eftemiu 1023 Tiranë. **Person i trete: Ministria e Infrastrukturës dhe Enegjisë së Republikës së Shqipërisë**, Rruga "Abdi Toptani", Nr. 1, Tiranë, **Objekt gjykimi**, 1. Shfuqizimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 13.05.2020 "Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave,"Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi, 2. Shfuqizimi i Vendimit Nr. 94 datë 08.06.2020 të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) "Mbi çmimin e apilkueshëm për prodhuesit ekzistues me përparësi, për vitin 2020, në zbatim të ndryshimeve të miratuara me VKM-në Nr. 396 datë 13.05.2020", 3. Marrja e masës së pezullimit të zbatimit të Vendimit Nr. 94 datë 08.06.2020 të Entit Rregullator i Energjisë (ERE) deri në përfundimin e shyrtimit gjyqësor të çështjes. Kjo çështje gjyqësore është në fazën përgatitore.

7.2.2 ERE në Cilësinë e Palës së Tretë në proceset gjyqësore në kuadër zbatimit të kompetencave ligjore.

Përgjatë vitit 2020, ERE ka marrë pjesë në cilësinë e përsosur të tretë në procese gjyqësore:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë – Tiranë, ka nisur gjykimi i çështjes administrative me nr. Akti 3109, me palë ndërgjyqëse: Paditës: A. M.; Të paditur: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Person i tretë: Enti Rregullator i Energjisë; Objekt: Pavlefshmëri fature tatimore. Proçesi gjyqësor ka përfunduar me Vendimin për shpalljen e Moskompetencës lëndore.
2. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, ka nisur gjykimi i çështjes civile me Nr.Regj.Them. 13412 viti 2020, me palë ndërgjyqëse: Paditës: A. R.; I paditur OSHEE - FSHU Sh.a, Person i trete: Enti Rregullator i Energjisë; Objekt: Pavlefshmëri e pjesëshme e titujve ekzekutiv "Faturë Tatimore Shitje e energjisë elektrike",
3. **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë – Vlore** Çështja administrative me nr. Akti 1101 **Paditës:** Shoqëria MP HEC shpk, **Të paditur: 1.** Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin – Seman; **2.** Operatori i Sistemit të Shërndarjes (OSSH) sh.a, Tiranë, me **objekt: 1.** Shpërblimi i dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar deri në këtë moment në shumën prej 25 000 Eurosh, dhe dëmit që do të krijohet deri në marrjen e formës së prerë të Vendimit që zgjidh në themel çështjen. **2.** Detyrimi i Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor Shkumbin Seman - Fier, të nxjerrë Aktin Administrativ "Konfirmim me shkrim për miratim në heshtje të "Miratimit përfundimtar të prurjes së ujit, të projektit të përmirësuar të HEC "NICE". Për fuqinë e instaluar 2.27 MË". **3.** Marrja e masës së sigurimit të padisë, duke i vendosur palët në gjendjen para zgjidhjes së konfliktit. **4.** Pezullimin e zbatimit të aktit Proçesverbal "çmontim sistemi matje" datë 17.07.2020 ora 16:50 të dalë në zbatim të Urdhërit Nr.4057/2 datë 16.07.2020 të OSSH, duke e detyruar OSSH të rilidhë impiantin HEC Nice me rrjetin shtetëror shpërndarës të Energjisë Elektrike, 35 KV Lozhan dhe montimin e matësit. Kjo çështje është në fazën e vazhdimit të gjykimit në seanca përgatitore. ERE në këtë proçes gjyqësor është nën cilësinë e ndërhyrësit dytësor .
4. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë** - Çështja Gjyqësore me paditës: "SELISHTE" shpk, i paditur "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare" (KESH) sha, me objekt: pagim shume. Gjykata ka vendosur rrezimin e Kërkesë Padisë.

5. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane** Çështja Gjyqësore me paditës: “OSHEE” sha, i paditur: Shoqëria "OST" sha, person i tretë: Enti Rregullator i Energjisë dhe shoqëria Ionian Refining & Trading Company (IRTC), me objekt: Shpërbllim dëmi. Kjo çështje gjyqësore është në fazën përgatitore.
6. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë** - çështja gjyqësore me paditës: A.R e paditur: **Oshee - Fshu sh.a** Bulevardi "Gjergj Fishta", ndërtesa nr. 88, h. 1, njësia administrative nr. 7, 1023 Tiranë, Shqipëri **persona të tretë: Ere – Drejtoria juridike dhe e mbrojtjes se konsumatorit** adresa: Blv "Bajram Curri", rr. Viktor Eftimiu 1023 Tiranë. E-mail erealb@ere.gov.al, **Objekti:** *Pavlefshmëri e pjesëshme e titujve ekzekutiv "faturë tatimore shitje e energjisë elektrike" për periudhën e faturimit prill 2020 e në vijim, faturuar për vlerën 14 lek/kwh. Për shpalljen e pavlefshme të kushtit të padrejtë, për rritjen e çmimit 14 lek/kwh detyrimin e Fshu s/i.a, për të njohur çmimin 7.6 lek/kwh për klientin me kontratë nr. c/102000. anulimin e faturave përkatëse për çmimin 14 lek/kwh dhe lëshimin faturave të korrektuara me çmimin 7.6 lek/kwh. Detyrimin e Fshu sh.a, për të kthyer diferencat në vlerë leku sipas faturave për çmimin me 14 lek/kwh, së bashku me kamatat. Kjo çështje gjyqësore është në pritje te caktimit të dates se séances pergatitore nga gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.*
7. **Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë**, në procesin gjyqësor me pale **paditës:** A. R, i biri i Perlatit, lindur më 05.02.1969, **të paditur:** Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, **person i tretë:** Enti Rregullator i Energjisë, me **objekt:** 1. Detyrimin e të paditurit, Operatorin i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) t'i japë paditësit informacionin lidhur me nëse shoqëria "ALBTEK ENERGY" shpk prodhon energji elektrike, dhe nëse energjia që prodhon hidhet në rrjetin e shpërndarjes. 2. Dëmshpërbllim për dëmin jopasuror në masën 300 000 lekë. 3. Dhënien e Vendimit me ekzekutim të përkohshëm në lidhje me kërkimin në pikën 1 të objektit të padisë. 4. Rimbursimin e shpenzimeve gjyqësore. Në këtë proces gjyqësor është ndryshuar trupa gjyqësore dhe jemi në pritje për vazhdimësinë e procesit gjyqësor nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë Tiranë.
8. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë** - Çështja Gjyqësore me pale Nr.Regj.Themeltar 13206/2020.paditës: Shoqëria Bell shpk **TE PADITUR:** Furnizimi i Shërbimit Universal FSHU sha; Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (Oshee sh.a) **PERSONI TRETË: Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE), OBJEKTI: Shpërbllim dëmi.** Kjo çështje gjyqësore është në fazën paraprake të shqyrtimit Gjyqësor.
9. **Gjykata Apelit Civil në procesin gjyqësor** me Nr. nr.2861 Akti dhe me palë ndërgjyqëse: **Kërkues:** S.L; **Palë e interesuar:** Enti Rregullator të Energjisë (ERE), Operatori I Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) Sh.a **Objekt:** Lëshim dublikate të urdhërit të ekzekutimit.Çështja ka përfunduar me pranimin e kërkesës nga pala kërkuese.
10. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë**, në procesin gjyqësor me pale ndërgjyqëse: **paditës:** Shoqëria MTC ENERGY shpk, **të paditur:** Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE) sha, **person i tretë:** ALBSIG sha, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Enti Rregullator i Energjisë (ERE), me **objekt:** 1. Shpërbllim dëmi jokontraktor në shumën 98.000 Euro. 2. Shpërbllimi i dëmit kontraktor në shumën prej 31862600 Lekë të rinj, që i korrespondon energjisë elektrike të paprodhuar 4138000 kwh. 3. Kërkimi i fitimit të munguar. Ky proces gjyqësor është akoma në fazën e paraprake të hetimit gjyqësor.

7.2.3 ERE në Cilësinë e Palës Paditëse në proceset gjyqësore.

Përgjatë vitit 2020, ERE ka marrë pjesë në cilësinë e paditësit në 1 proces gjyqësor:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë – Tiranë, çështja administrative me Nr. 31159-01771-80 Akti. Është ngritur Padi me palë ndërgjyqëse: Paditës: Enti Rregullator i Energjisë; i paditur: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Person i tretë: OSHEE sha, Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Objekt: Konstatimin absolutisht të pavlefshëm të vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me Nr. 33 datë 07.04.2020 dhe Nr. 34 datë 07.04.2020.

Gjykata ka vendosur rrëzimin e Kërkesë – Padisë. ERE ka ushtruar ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Për shkak të situatës kaotike në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor si rrjedhojë e shtrëngimeve të diktuar nga pandemia Covid-19, nga kjo Gjykatë nuk ka ende njoftim për shortin apo caktimin e datës së procesit.

7.3 Zhvillimi i seancave Dëgjimore në ERE

Në vitin 2020 për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19, mbështetur në (i) Vendimin e datës 09.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri, (ii) Aktin Normativ të Këshillit të Ministrave nr.2 dt. 11.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, (iii) Aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr.3 dt. 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid – 19”, iv) Aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr.8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr.3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID - 19”, v) Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 24.03.2020 me anë të të cilit është vendosur “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore” në të gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, me Urdhër nr. 53, datë datë 11.03.2020 “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” i ndryshuar, është pezulluar zhvillimi i seancave dëgjimore në ambjentet e Entit Rregullator të Energjisë.

Deri më datë 11.03.2020, janë zhvilluar 26 seanca dëgjimore të organizuara nga ERE, nga të cilat 3 seanca dëgjimore janë zhvilluar në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis operatorëve të liencuar në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, 18 (tetëmbëdhjetë) seanca dëgjimore me palët e interesuara në kuadër hartimit ose rishikimit të akteve nënligjore apo të akteve administrative në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe atë të Gazit Natyror, 1 (një) seancë e cila lidhej me ankesa të klientëve ndaj shoqërisë OSHEE sh.a për faturimin e energjisë elektrike dhe 4 (katër) seanca me të liçensuar kryesisht për plotësim dokumentacioni.

8. VEPRIMTARIA E ERE-S NË FUSHËN E MBROJTJES SË KONSUMATORIT DHE MBIKQYRJES SË STANDARTEVE.

Zbatimi dhe Mbikëqyrja e masave sa më efektive për garantimin dhe mbrojtjen e klienteve të energjisë elektrike apo gazit natyror, zë një vend të veçantë në veprimtarinë e ERE, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar si dhe atë nr.102/2015 Për sektorin e gazit natyror, I ndryshuar. Struktura ZAM (zgjidhjes së ankesave dhe mosmarrëveshjeve e ERE), Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, standardeve dhe performancës, mbështetet kryesisht në punën e saj në parimet kryesore që konsistojnë në adresimin nëpërmjet dhënies së rekomandimeve për të licënsuarit apo zgjidhjeve për të gjitha ankesat dhe konfliktet direkte që lindin si rrjedhojë e marrëdhënies midis të licënsuarve apo licënsuarve dhe klientëve

ERE në veprimtarinë e saj, synon të garantojë dhe përforcojë mbrojtjen e interesave të klienteve në aspektin individual, por edhe garantimin e së drejtës së tyre për informacion si një aspekt shumë i rëndësishëm i të drejtave të tyre të granatuara nga legjislacioni në fuqi. Përpos mbikqyrjes që marrëdhënia mes klientëve dhe të licënsuarve, të garantojë të drejtat e palëve por pa shmangur detyrimet e parashikuara për ta, në fokus të ERE është edhe mbrojtja indirekte e interesave të klientëve në tërësi nga abuzimet e aktorëve dominantë në tregun e energjisë elektrike. Mbikqyrja konstante e aktivitetit të të licënsuarve garanton shmangien e sa më sipër. Nëpërmjet monitorimeve peridoke si në format klasike të vëzhgimit në terren por edhe nëpërmjet mbikqyrjes dokumentare të aktivitetit të të licënsuarve, ERE ka mbikëqyrur shërbimet që ofrojnë të licënsuarit ndaj klientëve të energjisë, sa i përket cilësisë së këtij shërbimi dhe trajtimit të barabartë e jodiskriminues të tyre.

Prioriteti i ERE-s në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet klientëve të energjisë dhe të licënsuarve, vazhdon të mbetet ndër veprimtaritë kryesore të saj, që vijnë si detyrim i zbatimit të parashikimeve të nenit 24 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe nenit 98 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar. Edhe gjatë vitit 2020 ka vijuar veprimtaria e ERE-s në drejtim të mbrojtjes së interesave të klientëve, me draftimin e miratimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe monitorimit të zbatimit nga të licënsuarit të “Kushteve të Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë” të akteve nënligjore të tilla si “Rregullore për Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, Rregullore për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, Përditësimin të Planit të masave për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike OSHEE sh.a, sot FSHU sha, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike, (etj).

Me qëllim bërjen sa më efieçente të procesit të marrjes së informacionit nga ana e klientëve të energjisë por edhe të ndërgjegjësimit të tyre lidhur me proceset e funksionimit të tregut të energjisë elektrike, ERE ka përgatitur informacione orientuese të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Këto informacione kanë të bëjnë me të drejtat e klienteve, kushtet e furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit, procedurat dhe afatet e trajtimit të ankesave, kontrollin e matësit të energjisë, procesin e ndërprerjes së kontratës së energjisë (i përkohshëm/i përhershëm), procesin e

lidhjes së një kontrate të re, informacion në lidhje me kuadrin ligjor në fuqi mbi klientët në nevojë, të dhënat e nevojshme lidhur me cilësinë e shërbimit etj.

Mbrojtja e konsumatorit.

Një pjesë e rëndësishme e punës së strukturës së ERE për zgjidhjen e ankesave dhe mosmarrëveshjeve (ZAM), të klientëve të energjisë dhe të liçensuarve, lidhet me trajtimin e ankesave të regjistruara në ERE për zgjidhje apo orientim.

Përgjatë vitit 2020, në ERE janë regjistruar 165 ankesa të klientëve të Energjisë elektrike ndërkohë që gjatë vitit 2019 janë paraqitur dhe trajtuar 183 ankesa. Një pjesë e këtyre ankesave janë regjistruar të përsëritura, pasi ka rezultuar se nga ana e të liçensuarit ndaj të cilit është adresuar ankesa, nuk është trajtuar në afat apo klienti ka qënë i pakënaqur me përgjigjen e tij. Objekti i ankesave të paraqitura ka konsistuar në kryesisht në shkeljen e kushteve të përgjithshme të “Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientet Fundorë”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 15, datë 10.01.2018 në të cilat përcaktohen detyrimet reciproke të palëve në kontratë. ERE në referencë të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, dhe akteve nënligjore, si: “Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë”; “Rregullores për Trajtimin e Ankesave të Paraqitura nga Klientët dhe për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve midis të Liçensuarve në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror” dhe “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurave të ERE-s, ka trajtuar dhe analizuar ankesat e klientëve të energjisë elektrike duke ia përcjellë shoqërisë FSHU sh.a, së bashku me udhëzimet përkatëse. Përveç sa më sipër, ka ende ankesa që paraqiten në ERE për shkelje të pretenduara nga Klientet të kuadrin ligjor përpara hyrjes në fuqi të igjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

8.1 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë 2020.

Nga të dhënat e administruara konstatohet se ankesat me objekt “mbifaturim” zënë vendin kryesor në trajtimin e ankesave, të ndjekura nga ankesat me objekt “energji e pamatur” dhe “matje jashtë kushteve teknike”. Janë evidentuar gjithashtu dhe ankesat me objekt kryesisht mos respektimit të së drejtës për “lidhje të re” në sistemin e shpërndarjes; ndryshim tarifimi; kolaudim matësi; vlerë referuese; ndryshim i të dhënave të kontratës etj.

Ankesa për “energji e pamatur“, gjatë vitit 2020 rezultojnë të jenë 44.

Vihet re se shpesh këto ankesa janë të mbartura ndër vite dhe përfshijnë faturime të energjisë elektrike, të cilat kanë ardhur si pasojë e kontrolleve të ushtruara nga shoqëria “CEZ Shpërndarje“ sh.a, përgjatë periudhës 2011-2013, ku vihet re se në shumicën e rasteve të paraqitura, proçes-verbalet e mbajtura për konstatimin e ndërhyrjeve të paautorizuara në sistemin e matjes janë kryer jo në prezencën e klientit, në bokse kolektive të matësive të energjisë elektrike si dhe raste ku është lëshuar më shumë se një faturë, brenda 1 (një) viti, që përmban “energji të pamatur”.

Në figurën me poshtë jepen të pasqyruara ankesat e trajtuara nga ERE për vitin 2020 dhe evidentohet ndryshimi në përqindje të njëzive kategori të ankesave krahasuar me vitin 2019.

ANKESA TE RREGJISTRUARA DHE TRAJTUARA NGA ERE




Figura 93 Ankesat e regjistruara dhe te zgjidhura nga ERE

Nga analizimi i figurës së mësipërme evidentohet sipas objektit të ankesës, pesha specifike që zënë sipas secilës kategori të ankesave që janë adresuar në FSHU nga ERE, si në vijim për vitin 2020;

- 44 ankesa për “mbifaturim”,
- 34 ankesa për “dëm ekonomik”/ “energji e pamatur”,
- 16 ankesa për “ matje jashtë kushtit teknik”
- 7 ankesa për “keqtarifim”,
- 5 ankesa për “lidhje të re”,
- 5 ankesa për “faturim afrofe”,
- 54 ankesë të ndryshme,

Pavarësisht mënyrës së zgjidhjes të gjitha ankesave të dërgura nga ERE, rezulton se në disa raste Shoqëria e furnizimit “FSHU” sh.a, nuk ka njoftuar ERE-n në lidhje me zgjidhjen e dhëne dhe në disa raste as klientin, pavarësisht se mund të jetë bërë korrigjimi në sistem kur është konstatuar gabim. Janë evidentuar gjithashtu dhe ankesat me objekt kryesisht “Vlerë referuese”, “kërkesë informacioni”; “ndryshim tarifimi”; “kolaudim matësi”; dëmshperblim per djegie; ndryshim kontrate; kërkesë për marrjen e masave për sigurimin e furnizimit me energji elektrike; kërkesë për spostimin e panelit te matjes.

Ankesat për mbifaturimin e energjisë elektrike.

Nga të dhënat statistikore të ERE konstatohet se pjesën më të madhe të ankesave e zënë ankesat me objekt “mbifaturimin” e energjisë elektrike, duke zënë një total prej 44 ankesash, ose rreth 26.7 % e totalit të ankesave të regjistruara në ERE. Ankesat në lidhje me mbifaturimin e energjisë elektrike janë shkaktuar nga problematika të ndryshme si: mos rakordimi i gjëndjes së hedhur në sistem me

gjëndjen reale të matësit, gabime njerëzore nga ana e faturuesëve, vonesa në hedhjen e të dhënave të matësve të rinj në sistem. Këto problematika rrisin peshën financiare që iu ngarkohet klientëve duke ulur nivelin e arkëtimeve. Për të gjitha këto ankesa, ERE ka kërkuar nga shoqëria “FSHU” sh.a, verifikimin e praktikave dhe procedurave lidhur me faturimet e kryera së bashku me korrigjimet përkatëse që duhen realizuar në zbatim të afateve të përcaktuara për trajtimin e ankesave.

Ankesat për Energji e pamatur /Dëm Ekonomik.

Ankesat për energji te pamatur/dëm ekonomik zënë vendin e dytë në totalin e ankesave të trajtuara ne ERE me 34 ankesa ose rreth 20.6 % të totalit të ankesave të regjistruara në ERE. Këto ankesa janë faturime të energjisë elektrike, të cilat janë të mbartura si pasojë e kontrolleve të ushtruara nga shoqëria “CEZ Shpërndarje“ sh.a, përgjatë periudhës 2011 – 2013, ku vihet re se, procesverbalet e mbajtura për konstatimin e ndërhyrjeve të paautorizuara në sistemin e matjes janë kryer jo në prezencën e klientit, në bokse kolektive të matësve të energjisë elektrike. ERE në zbatimin të Vendimit Nr. 90 të Bordit të ERE – s, ia ka parashtruar këtë problematike ish shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a, disa herë ku ka evidentuar ankesat e klienteve të energjisë elektrike të cilët janë faturuar me faturimin nën emertimin “energji e pamatur” dhe “dëm ekonomik” dhe ka kërkuar anulimin e mënjëhershëm të këtyre faturimeve.

Ankesat për faturim aforfe

Gjatë vitit 2020 konstatohet ankesat për “faturim aforfe” të energjisë elektrike të trajtuara nga ERE. Janë paraqitur dhe trajtuar vetem 5 (pesë) ankesa ose rreth 3 % e totalit të ankesave të regjistruara në ERE.

Faturimi i energjisë elektrike për matje jashtë kushteve teknike

Gjatë vitit 2020 janë evidentuar një numër relativisht jo i madh i ankesave me objekt “matjet jashtë kushteve teknike”, në krahasim me vitin 2019 ku ishin rreth 10 ankesa, ndërkohë që gjatë 2020 konstatohen 16 ankesa ose 9.7 % e totalit të ankesave të adresuara nga ERE. Ky faturim është bërë në rastet e evidentimit të matësve të energjisë elektrike, jashtë klasës së saktësisë në matje ose për shkak të dëmtimit të tyre.

Ankesat për keqtarifim

Gjatë vitit 2020 konstatohen rreth 7 ankesa ose rreth 4.2 % e totalit të ankesave të regjistruara në ERE. Këto ankesa konsistojnë kryesisht në ndryshim tarife për kategorinë shërbime furnizimi si dhe lidhjes për furnizimin me energji elektrike në TM dhe pika e matjes në TU.

Ankesa/kërkesa të ndryshme


Në grupin e ankesave të klasifikuara “të ndryshme” janë futur ankesat me objekt: faturim fiktiv, vlerë referuse, kërkesë informacioni, dëmshperblim, spostim transformatori, shtesë fuqie, kërkesë për kthim përgjigje nga FSHU sh.a. etj, apo vijim komunikimi me FSHU sh.a. nëpërmjet ERE. Në grupin e ankesave të ndryshme konstatohen rreth 54 (pesëdhjetë e katër) ankesa të cilat zënë 32.7 % të totalit të ankesave të regjistruara në ERE, e rezulton se përgjithësisht kjo kategori ankesash gjenerohet për shkak të vonesave nga ana e FSHU sh.a. në trajtimin e kërkesave të adresuara kryesisht ne FSHU

sha, apo mungesës së informacionit nga ana e klientëve të energjisë elektrike. Lidhur me këto problematika ERE, i ka trajtuar duke dërguar shkresa përcjellese kompanisë “OSHEE” sh.a, ku ka kërkuar verifikimin rast pas rasti të problematikave. Në lidhje me ankesat e regjistruara në FSHU nga të gjitha burimet, qoftë drejtëpërdrejtë në qendrat e kujdesit të klientit, nga ERE, platforma e – albania, apo nëpërmjet institucioneve të tjera, ERE ka kërkuar informacion në FSHU në lidhje jo vetëm me numrin total të këtyre ankesave të regjistruara por edhe numrin e ankesave të trajtuara në afat, atyre për të cilat është dhënë zgjidhje dhe janë marrë masat e nevojshme për korrigjimin nga ana e FSHU si dhe ankesat e patrajtuara apo të trajtuara jashtë afatit. Gjatë vitit 2020, për shkak të pandemisë globale e marrje së masave nga ana e qeverisë shqipëtare për shmangien e përhapjes së virusit Covid – 19, shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për një periudhë rreth 4 muaj në Republikën e Shqipërisë, e vijimit të kufizimeve jo vetëm në veprimtarinë e institucioneve por edhe lëvizjen e lirë të njërëzve, ka qënë i pamundur monitorimi në terrën i të liçensuarve për sa i përket mbikëqyrjes së veprimtarisë së tyre në funksion të garantimit të të drejtave të klientëve të energjisë. Pavarësisht sa më sipër, nuk ka munguar kontrolli i ERE në të liçensuarit, me mënyrat alternative të mbikëqyrjes në distancë, duke kërkuar në mënyrë periodike informacion në lidhje me çdo aspekt të veprimtarisë së të liçensuarit që lidhet me ushtrimin e funksioneve të ngarkuara nga liçensa e për të garantuar të drejtat e klientëve të energjisë.

Me qëllim mbikëqyrjen e performancës së FSHU sh.a. sa i përket zbatimit të detyrimeve që burojnë nga ligji dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, me qëllim marrjen e një pasqyre mbi statusin e mbrojtjes së të drejtave të klientëve të energjisë elektrike sa i përket furnizimit me energji elektrike, në kushtet e jashtëzakonshme të punës si për ERE – n ashtu dhe për Furnizuesin e Shërbimit Universal, gjatë pandemisë e cila vijon të impaktojë Shqipërinë, u vlerësua i rëndësishëm, raportimi nga ana e FSHU, i statusit të respektimit të të drejtave të klientëve të energjisë elektrike si dhe zbatimit të detyrimeve ndaj klientëve të furnizimit me energji elektrike. Për këtë qëllim ERE ka kërkuar informacion nga FSHU sh.a. për numrin total të ankesave të regjistruara pranë FSHU sha, që nga data 01.01.2020 deri më 31.12.2020 (nga të gjitha burimet) si dhe Numrin total te ankesave për të cilat është dhënë zgjidhje/përgjigje dhe është informuar klienti në një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2019 rezultoi se, totali i ankesave të paraqitura në FSHU nga të gjitha burimet ishte 132438, nga të cilat 123,366 prej tyre kishin marrë zgjidhje, duke rezultuar niveli i zgjidhshmërisë së ankesave totale në masën 93.2%. Konstatohet se kjo vlerë për vitin 2020 paraqitet në masën 132307 ankesa nga të cilat rezulton se nga ana e FSHU është dhënë zgjidhje për 131326 prej tyre, duke rezultuar kështu niveli i zgjidhshmërisë së ankesave për vitin 2020 në masën 99 %.






Grafiku në të majtë, paraqet numrin e ankesave të ardhura në FSHU në total përgjatë 12 muajve. Brenda këtyre shifrave, është gjetur shumatori duke mbledhur gjithë llojet e ankesave gjatë muajve të vitit 2020 si prsh: pagesa për ankesa/kreditime; ankesa për faturim,

cilësi shërbimi, ankesa në lidhje me matësat; ndryshim i të dhënave të kontratës. Muajt Maj dhe Qershor janë muajt që kanë regjistruar numrin më të lartë të ankesave, respektivisht 15,032 dhe 15,647 ankesa në total. Vetëm 5,505 gjatë muajt Mars ku është dhe fillimi i përhapjes së pandemisë COVID – 19 dhe nisjes së kufizimeve në gjithë Republikën e Shqipërisë.

Sipas të dhënave të raportuara nga ana FSHU, pasqyruar edhe në grafikun në të djathtë, konstatojmë se muajt me numrin më të lartë të ankesave të zgjidhura gjatë 2020 janë Prill dhe Qershor, të cilët në fakt janë edhe muajt me numrin më të lartë të ankesave të regjistruara. Qershori ngelet një muaj i cili regjistron një numër relativisht të lartë ankesash por njëkohsisht edhe zgjidhshmëri të lartë. Vlerësojmë se metodat alternative të regjistrimit të ankesave në FSHU kryesisht nëpërmjet postës elektronike gjatë periudhës së pandemisë, kanë prodhuar një numër më të lartë kërkesash/ankesash, pikërisht për shkak të lehtësisë së adresimit të menjëhershëm të tyre nëpërmjet kësaj metode, pa qënë nevoja për tu drejtuar në qendrat e kujdesit të klientit.



Në diagramën në të majtë, janë shfaqur të pesta llojet e ankesave të ilustruara në formën Chart ku numërohen Grand Total i ankesave për secilën çështje të regjistruara nga të gjitha burimet dhe të zgjidhura nga FSHU gjatë 2020. Është shpërndarë në formë përqindje edhe lloji i ankesës. Gjithashtu, FSHU raporton në ERE përqindjen e ankesave të zgjidhura gjatë 2020 për secilën çështje edhe Grand Totalin e tyre. Ankesa për Pagesa/kreditime sipas shifrave që raportohen arrin në masën 57% të zgjidhura. Ankesë për Faturim janë zgjidhur të gjithë të ardhurat ose ndryshe 100% të nivelit. Vetëm 15% të zgjidhura

për Cilesi Shërbimi apo 477 nga 3119. Shifër kjo e ulët duke marrë parasysh se Cilësia e Shërbimit është një çështje delikate që lidhet direkte me konsumatorin. Sa i përket çështjeve të lidhura me Matjet, është kaluar shifra regjistruar, 114% kjo përqindje është me e madhe për anksat e zgjidhura në krahasim me ato të ardhura për shkak të ankesave të regjistruara në fundin e vitit 2019 dhe të zgjidhura në muajt e parë të vitit 2020. Çështja sa i takon ndryshimin e të dhënave të kontratës është një përqindje tepër pozitive dhe arrin në 94. Në Grand Total FSHU sh.a ka arritur të menaxhojë dhe japë zgjidhje rreth 99% të këtyre ankesave gjatë 2020 ose 131,326 raste.

Viti 2020 paraqiti sfida të mëdha veçanërisht për operatorin e sistemit të shpërndarjes por edhe për furnizuesin e shërbimit universal FSHU sha, sa i përket mbarëvajtjes së punës në kushtet e pandemisë, e rritjes së konsumit të klientëve familjarë që merrnin shërbimin e furnizimit me energji elektrike për një kohë më të gjatë se mesatarja e viteve të tjera, për shkak të kufizimeve në lëvizjen e lirë. Nga ana tjetër, puna e operatorëve të sipërcituar u vështërsua përgjatë vitit 2020 edhe për shkak të rrijës së numrit të punonjësve të infektuar e pamundësisë reale e objektive të OSSH për kryerjen e procesit të leximit të matësive të energjisë elektrike sipas parashikimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Në këto rrethana ERE e pa të nevojshme të ndërhyjë nëpërmjet një mekanizmi të përkohshëm lehtësues. Me vendimin nr. 58 Datë 26.03.2020 mbi përcaktimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike, gjatë periudhës së zbatimit të aktit normativ të këshillit të ministrave nr.8, date, 24.03.2020 “për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr.3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid – 19”, të ndryshuar si dhe vkm nr.243, datë 24.03.2020 “për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”, Bordi i ERE, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesës dhe shpjegimeve të dhëna nga OSSH sh.a., vendosi: Të miratojë modalitetet e faturimit të energjisë elektrike, gjatë periudhës së zbatimit të aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.8, datë , 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr.3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid – 19”, të ndryshuar si dhe VKM nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore.”

Vendimmarrja e mësipërme krijoi kushtet për OSSH sha, që në rrethanat e kufizimeve të lëvizjes së lirë por edhe me qëllim mbrojtjen e punonjësve të tij, të kryejë leximin e matësave njëherë në 3 muaj, duke faturuar përgjatë kohëzgjatjes së efekteve juridike të këtij vendimi, konsumin e energjisë elektrike të të njëjtit muaj të vitit paraardhës. Në muajin e fundit të kohëzgjatjes së këtij vendimi, OSSH procedoi me leximin e matësit e lëshimin e faturës korigjuese duke iu referuar të dhënave reale të matjes.

Zbatimi me korrektesë i vendimmarrjes së mësipërme, qëndroi në vëmendjen e ERE, e cila kërkoi nga FSHU (duke qënë se marrëdhënia e klientit rregullohet drejtëpërdrejtë me FSHU e cila gjeneron faturën për Klientin, ndërkohë që leximi i matësit kryehet nga OSSH), informacion në lidhje me numrin e ankesave të regjistruara përgjatë kohës së shtrirjes së efekteve juridike të vendimit të bordit të ERE nr58/2020.

Numri më i madh i ankesave të regjistruara ka qënë ai në muajin e parë të fillimit të efekteve juridike të vendimit të bordit të ERE nr.58/2020, e vlerësojmë se një fakt i tillë ka ndodhur si rrjedhojë e mungesës së informacionit, për të cilën në pikën 10 të vendimit të sipërcituar ishte parashikuar: *OSSH të marrë të gjitha masat për publikimin e këtij vendimi në faqen e internetit të shoqërisë si dhe në median elektronike e të shkruar për sa është e mundur.*

Në fakt në lidhje me sa më sipër, ERE konstatoi se në faqen zyrtare të OSSH është publikuar njoftimi për shtyp në lidhje me sa më sipër, dhe gjithashtu përfaqësues të OSHEE group apo edhe OSSH sha në ditët vijuese kanë marrë pjesë median vizive me qëllim informimin e publikut në lidhje me sa më sipër. Publikime në lidhje me sa më sipër u konstatuan edhe në një sërë mediash të shkruara menjëherë pas kësaj vendimmarrje të ERE. Sa më sipër, rezulton se nga ana e OSSH janë bërë përpjekjet më të mira për të informuar klientët e energjisë elektrike në lidhje me këtë vendim të përkohshëm të ERE. Në vijim të analizës së të dhënave të ankesave të regjistruara pranë FSHU për faturim me vlerë referuese sipas vendimit Nr.58 date 26.03.2020, rezulton se ky numër ka patur një rënie të ndjeshme, duke arritur në masën 114 ankesa të regjistruara në muajin Qershor.

Një rënie të ndjeshme ka patur gjithashtu edhe numri i klientëve të faturuar me vlerë referuese përgjatë kohëzgjatjes së vendimit të ERE nr.58/2020 nga 369,743 në muajin mars, në 21,602 në muajin qershor çka në vetvete përbën afërsisht 1.7% të bazës totale të klientëve.

Gjatë procesit të faturimit në zbatim të Vendimit 58/2020 të ERE – s rezulton se janë zbatuar pikat e përcaktuara në vendim duke marrë në konsideratë tipologjitë e klientëve siç përcaktuar në Vendim, si dhe duke marrë masa që 90% e klientëve të faturuar me "vlerë referuese zëvendësuese" gjatë muajit mars 2020 të sistemohen dhe të balancohet energjia e konsumuar brenda muajve prill – maj 2020.

ERE ka vijuar punën mbikëqyrëse sa i përket mbrojtjes të të drejtave të klientëve të energjisë, e veçanërisht për impaktin që mund të ketë patur në nivelin e kënaqësisë së klientëve efekti i kësaj vendimmarrjeje. ERE ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur interes të klientëve të energjisë edhe gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyror, duke vendosur në dispozicion të klientëve që donin të adresonin ankesë në ERE adresën elektronike, postën fizike në abjentet e ERE për të depozituar ankesën me qëllim mbrojtjen kësajsoj jo vetëm të klientëve por edhe të punonjësve të ERE nga përballja me rrezikun e përhapjes së epidemisë. Megjithëse në ERE është regjistruar vetëm një ankesë për faturim me vlerë referuese sipas vendimit të bordit të ERE nr.58/2020, ERE ka kërkuar nga FSHU informacion të zgjeruar në lidhje me numri i ankesave të gjetura të drejta e të zgjidhura, afatet e zgjidhjes së këtyre ankesave, informimi i klientëve të energjisë elektrike për zgjidhjen e dhënë, si dhe raporti i ankesave për qëllime të zbatimit të vendimit të përkohshëm të ERE nr.58/2020 me numrin total të ankesave të regjistruara në FSHU sh.a.

Me vendimin e bordit të ERE Nr. 217, Datë 15.12.2020 ERE ka vendosur për rishikimin e “planit të masave për operatorin e shpërndarjes të energjisë elektrike ‘OSHEE’ sh.a., për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 201, datë 03.09.2018. Duke u mbështetur në detyrat e lëna nga Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, gjendja e faktit që lidhet me ndarjen efektive të Furnizuesit të Shërbimit Universal nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, lindi nevoja e përditësimit të këtij plani masash me qëllim reflektimin e sa më sipër si dhe përmirësimin e përditësimit të atyre dispozitave që lidhen me detyra të lëna në këtë plan e për të cilat ERE ka thënë se kanë ndryshuar për shkak të monitorimeve të ushtruara ndaj shoqërisë përgjatë vitit 2019 e 2020.

Në fokus të Punës së ERE ka qënë edhe *mbrojtja e të drejtave të klientëve të Energjisë elektrike që kanë përfituar apo përfitojnë shërbimin e furnizimit nga FMF.*

Për këtë qëllim ERE ka kërkuar nga FSHU sh.a. i cili ka kryer gjatë vitit 2020 funksionet e Furnizuesit të Mundësisë së fundit, në lidhje me masat e marra për përmbushjen e parashikimeve të Rregullave për kushtet e shërbimit të furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.247, datë 11.12.2018, sa i përket afateve të sigurimit të shërbimit si dhe mbrojtjes së të drejtës së klientëve të energjisë elektrike që kërkojnë të marrin shërbimin në kushtet e furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së fundit, përmbushjen e detyrimit për informim të klientëve që mund të marrin shërbimin e furnizimit nga FMF, nëpërmjet publikimit të këtij informacioni edhe në formën e broshurave apo në formë elektronike. Nga ana e FSHU sha është bërë me dije se aplikuesve që kanë paraqitur kërkesën për lidhje të re ju është mundësuar lidhja e kontratës dhe furnizimi me energji elektrike brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara në *Rregullat për kushtet e furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe kushtet kontraktore për shërbimin e furnizimit me energji elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE – s, Nr.247, data 11.12.2018. Për klientet që janë interesuar për të lidhur një kontratë të furnizimit me energji elektrike nga FMF ofrohet gjithë informacioni i nevojshëm prane çdo zyre të Kujdesit ndaj Klientit të FSHU sh.a. Po kështu janë duke u marrë masa që ky informacion i detajuar të publikohet përveçse në faqen zyrtare të OSHEE Group SH.A edhe në faqen zyrtare të internetit të FSHU SH.A., e cila është aktualisht në proces rristurimi.

Të licencuarit që ushtrojnë verimtari me interes publik si OSSH dhe FSHU kanë qënë vecanerisht në fokusin e ERE. Mes të tjerave ERE ka kërkuar nga OSSH që në zbatim të nenin 12 pika 1 të “Rregullorja mbi procedurat për paraqitjen e një kërkesë, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit kur klienti dyshon në saktësinë e të dhënave të aparatit matës të energjisë elektrike të *paraqesë informacion 4-mujor në ERE në lidhje me kërkesat e klientëve për verifikimin e saktësisë së aparatit matës të energjisë elektrike*”.

Nga ana e OSSH sha është bërë me dije se gjatë vitit 2020 janë bërë 2175 verifikime të aparatit matës, me kërkesë të klienteve të Energjisë, duke shënuar numrim më të madh të kërkesave për verifikim muajt mars – qershor.



Siç shihet dhe vizualisht edhe nga grafiku në krahë, gjatë muajve maj, qershor ka pasur një rritje të ndjeshme të numrit të kërkesave të klienteve të energjisë elektrike për verifikim të matësve, ku vlerësojmë se ka ardhur si rrjedhojë e akumulimit të nevojës/ kërkesës së klienteve për verifikim të aparatit matës gjatë muajve mars – prill kohë në të cilën Republika e Shqipërisë ka qënë në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe karantinës.

ERE i ka kushtuar dhe vazhdon ti kushtojë një vëmendje të veçante mbikëqyrjes së aktivitetit të të licencuarve sa i përket garantimit të të drejtave të klientëve të energjisë elektrike, e veçanërisht sigurimit të

një shërbimi të furnizimit me energji elektrike të pa ndërprerë dhe brenda standarteve të cilësisë së shërbimit. Sipa raportimeve të OSSH, ndërprerjet vetëm në rrjetin TU prekin një numër të vogël konsumatorësh dhe OSSH ka krijuar të gjitha mundësitë nëpërmjet sistemit të komunikimit Callcenter për njoftimin dhe minimizimin e kohës së riparimit. Në faqen zyrtare të OSSH jepet në harte gjeografike skemat dhe numrat e telefonit të njoftimit, komunikimit me klientin deri në rikthimin e energjisë elektrike. Për të siguruar një panoramë me të qartë e të detajuar në lidhje me sa më sipër, ERE ka kërkuar nga FSHU sha dhe OSSH sha informacion lidhur me:

- Numrin e raportime të regjistruara në shërbimin telefonik të FSHU sh.a. (call center) përgjatë vitit 2020 për ndërprerje të energjisë elektrike.
- Numrin e raportime të regjistruara në shërbimin telefonik të FSHU sh.a. (call center) përgjatë vitit 2019 për ndërprerje të energjisë elektrike.
- Të dhëna të kategorizuara mbi llojin e ndërprerjeve të konstatuara për të cilat është raportuar (të planifikuara, të paplanifikuara, për defekte teknike, etj.) si dhe procedurën e ndjekur për adresimin e tyre në kohë.

Qëllimi i një analizë mbi të dhënat e sa më sipërme, është vlerësimi i një panorame më të qartë në lidhje me ndryshimet cilësore të shërbimit të furnizimit te energjisë elektrike në mënyrë të pandërprerë dhe uljes së numrit të ndërprerjeve të paplanifikuara. Aktualisht nuk rezulton të këtë informacion nga FSHU sha në lidhje me sa kërkuar.

Vëmendje i është kushtuar nga ana e ERE dhe përditësimit të kuadrit ligjor që rregullon marrëdhënien e klientit me furnizuesin por edhe garanton për të shërbimin e furnizimit me energji elektrike sipas standarteve. ERE ka kërkuar në mënyrë të përsëriur edhe përgjatë vitit 2020 nga OSSH që jo vetëm në zbatimin ligjit nr.43/2015 "Për Sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar por edhe Udhëzimin Nr. 3, datë 20.6.2019, "Për miratimin e procedurës së lehtësuar të autorizimit për lidhjen në sistemin e shpërndarjes të projekteve të vogla të rinovueshme për vetëprodhuesit e energjisë elektrike nga

dielli” operatorët e rrjetit të shpërndarejs dhe atij të transmetimit të marrin masat në bashkëpunim për të propozuar për miratim në ERE ndryshimet në Kodin e Shpërndarjes dhe në Kodin e Matjes, të cilët aktualisht janë në fuqi, ata të miratuar para hyrjes në fuqi të ligjit aktual.

- *Gjatë vitit 2020 janë miratuar gjithashtu një sërë aktesh që synojnë të rregullojnë posaçërisht spektrin e të drejtave dhe detyrimeve të klientëve të energjisë elektrike, sic janë :*

Rregullore për profilet e standartizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalancave, nuk janë të disponueshme” miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 112, datë, 09.07.2020.

Kjo Rregullore vendosi Kriteret për përcaktimin e profileve standarte të ngarkesës që aplikohen për çdo kategori Klientësh Fundor për të cilët matja e konsumit real në intervale kohore nuk është e disponueshme.

- Një tjetër akt që tutelon të drejtat dhe detyrimet e klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror, është *standardet të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror nga të liçensuarit në aktivitetin e furnizimit*, për të cilin ka filluar procedura me vendimin e bordit të ERE Nr. 218, Datë 15.12.2020.

Qëllimi i Standardeve të Trajtimit të Ankesave të Klientëve të Energjisë Elektrike nga të Liçensuarit në Aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike (në vijim Standardet) është sigurimi i një procesi të drejtë dhe efektiv të trajtimit të ankesave të klientëve të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e shërbimit të furnizimit me energji dhe gaz dhe të rritet besimi dhe pëlqimi i klientëve për këtë shërbim të ofruar nga të liçensuarit.

- *Miratimi i Treguesve e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit për vitin 2021*, me vendimin e bordit të ERE miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 255, Datë 21.12.2020. Rregullorja për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, specifikon treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike, si dhe performancën në lidhje me sigurinë e rrjetit për Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST), sipas Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Me hyrjen në fuqi të standarteve të miratuara me vendimin e bordit të ERE sipërcituar, OST e cila ka Detyrimin e Shërbimit Publik që të përmbushë standardet e cilësisë të furnizimit të specifikuar nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit dhe kjo Rregullore, do të marrë masat e nevojshme për të ruajtur dhe aplikuar këto standarte të Cilësisë së Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit.

- *Kushtet të përgjithshme të kontratës tip të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë që përfitojnë nga shërbimi publik i furnizimit”,* miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 166, Datë 22.10.2020. miratimi i këtij akti, konsiston në rregullimin e ofrimit e shërbimit të furnizimit me gaz natyror si shërbim publik, në kuadër të aktivitetit të shërbimit publik të furnizimit me gaz natyror për klientët fundor.

- *Kodi i Matjes Të Gazit Natyror”,* miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 266 Datë, 28.12.2020. Kodi i Matjes përcakton kërkesat teknike të ndërtimit dhe shfrytëzimit të sistemit të matjes të Gazit Natyror, që do të jetë i përshtatshëm për matje, për mbledhjen e të dhënave, regjistrimin e tyre dhe zbatimin e procedurave përkatëse sipas Rregullave të Tregut dhe Marrëveshjeve midis Palëve.

“Metodologjia e Përcaktimit të Tarifës së Shitjes së Gazit Natyror nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”. Qëllimi i kësaj metodologjie, është përcaktimi i tarifës të shitjes të gazit natyror të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit bazuar në parime të qarta të llogaritjes së kostove që lidhen me këtë shërbim si dhe detajimi i të dhënave të nevojshme për përcaktimin e çmimeve të drejta dhe transparente.

E drejta për akses në rrjet

Në zbatim të aktivitetit mbikëqyrës mbi të licencuarit, ERE ka vijuar me një sërë korrespondencash me të licencuarit me qëllim, mbrojtjen e të drejtave të klientëve të energjisë I përket së drejtës për akses në rrjet.

Për këtë qëllim, në kushtet e pamundësisë për të ushtruar monitorime në terren, ERE ka kërkuar nga OSSH sha, informacion dhe dokumentacion në lidhje me procedurat dhe afatet e lidhjeve të reja në sistemin e shpërndarjes, Aplikimet e regjistruara në OSSH sh.a. për lidhje të reja në Sistemin e Shpërndarjes përgjatë vitit 2020, Afatet procedurale të ndjekura nga ana e OSSH për miratimin apo refuzimin e secilit aplikim për lidhje të reja në Sistemin e Shpërndarjes përgjatë vitit 2020 mbi bazën sample/kampionit (10 aplikimet e para të regjistruara në çdo muaj kalendarik) si dhe numrin e aplikimeve të refuzuara përgjatë vitit 2020 dhe arsyet e këtyre refuzimeve.

Metodika e më sipërme u vlerësua si një mënyrë efiçente për të verifikuar dhe konstatuar respektimin nga ana e OSSH sha të parashikimeve të Rregullores së procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e shpërndarjes, të miratuar me Vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin Nr.177, datë 08.11.2016.


Nga raportimi i OSSH në lidhje me sa më sipër, rezultoi se, aplikimet totale të regjistruara për vitin 2020 për lidhje të re dhe shtesë fuqie sipas kategorizimeve të fuqive figurojnë si më poshtë:

Mbi të dhënat regjistruara rezultojnë tre llojet e fuqive: 0 – 20 kw; 20 – 50 kw; dhe mbi 50kw ku përputhen me llojin e kërkesës Lidhje e re, dhe Shtesë Fuqie. Grand totali që mundësohet për Lidhjet e reja dhe Shtesë Fuqie arriti në 13831 aplikime. Nga këto 13831 aplikime, totali i Lidhjeve të reja shkon në 11267 aplikime apo rreth 81.5 % të aplikimeve totale, nga ana tjetër janë 2564 aplikime për Shtesë Fuqie ose 18.5% e gjithë aplikimeve.

Totali i aplikimeve për 2020 është 13831 e shtrire në 11 rajone. Kryeson Tirana me 4388 aplikime në Grand Total ose ndryshe 31% të aplikimeve për gjithë llojet e fuqive. E fundit renditet Kukësi me 288 aplikime ose vetem 2% të Totalit.

LIDHJET E REJA


Totali- 13831 aplikime




Ndarë në fuqi, janë raportuar 12265 aplikime per fuqin 0-20 kw, ndryshe 89% e gjithë aplikimeve nga gjithë rajonet janë përqëndruar në këtë kategori. Qyteti i Tiranës ka numrin më të madh të aplikimeve për këtë kategori me 3892, nga ana tjetër Kukësi me 263. Në kategorinë 20 – 50 kw janë regjistruar 968 aplikime që konsistojnë në 7% e Totalit të gjithë aplikimeve. Tirana përmban mbi 30% e aplikimeve në këtë kategori.

LIDHJET E REJA NE SHPERNDARJE

Kliente ne 0-20 kw



Kliente ne 20-50 kw



Për sa i përket numrit të aplikimeve për fuqinë mbi 50 kw, shifra është e vogël në 11 rajonet, 598 aplikime të regjistruara apo vetëm 4%. Rezultojnë 173 aplikime në Tiranë në këtë kategori më shumë nga të tjerat dhe vetëm 5 në Kukës që përbejnë më pak.


Për afatet proceduriale të ndjekura mbi bazën sample/ kampionit (10 aplikimet e para të regjistruara në çdo muaj kalendarik) janë përlogaritur mesataret e të 3 kategorive për 11 rajonet e Republikës gjithashtu dhe mesatarja e Grand Totalit. Për kategorin 0 – 20 kw rezulton një mesatare 12.89 mbi bazën e sample/kampionit për 10 aplikimet e para të regjistruara në çdo muaj kalendarik i afatit procedural i ndjekur.

Për kategorin 20-50 kW raportohet një shifër 18.08 dhe 48.02 për kategorinë mbi 50kw. Mesatarja e Grand Total është 26.33.

Në afatin kohor të llogaritur kanë ndikim faktorët si më poshte: koha e plotësimit të dokumentacionit nga abonentit (në raste kur që konstatohen mungesë dokumentacioni); mosprezenca e abonentit në objekt, gjatë azhurnimit teknik ; pagesa e abonentit e cila duhet të kryhet brenda një afati 5 ditor; kohëzgjatja e kryerjes së përfundimit të punimeve nga abonentit (përfundimi i objektit shtrirja e linjës etj).

LIDHJET E REJA NE SHPERNDARJE

Kliente ne mbi 50 kw



Në Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes Miratuar me Vendimin Nr.166, datë 10.10.2016, të Bordit të ERE, e ndryshuar me Vendimin Nr.177, datë 08.11.2016 të Bordit të ERE, parashikohet se, Afati i realizimit të Lidhjes së re do të jetë: i. jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar deri në 10 kw ii. jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 10 – 20 kw. iii. jo më shumë se 20 ditë pune për fuqi të instaluar 20-50 kë dhe iv. jo më shumë se 60 ditë pune për fuqi të instaluar mbi 50 kw. Nga raportimet mbi bazë sample të përcjella nga OSSH rezulton grafiku si më poshtë.

LLOJI I LIDHJES	AFATI LIGJOR	GJENDJA
0-20 Kw	20 dite	12.89 dite
20-50 kw	20 dite	18.08 dite
mbi 50 kw	60 dite	48.02 dite

Janë raportuar rreth 1032 aplikime të refuzuara në 11 rajonet e Republikës së Shqipërisë. 32% ose 332 aplikime të refuzuara i takojnë Tiranës numrit më të lartë. Vetëm 20 në qytetin e Kukësit që përbën numrin më të ulët të aplikimeve dhe refuzimit të tyre. Kategoria e parë e fuqisë, 0-20 kw përmban numrin më të lartë të aplikimeve të refuzuara, gjithashtu numrin më të lartë të abonentëve të lidhur me këtë fuqi. 900 refuzime aplikimesh ose 87% e Grand Total të ktyre aplikimeve të refuzuara përgjatë 2020. Raportohen 272 ose 30% e refuzimeve në këtë fuqi për abonentët e Tiranës, më pak në qytetin e Kukësit afro 2% ose 16 refuzime aplikimesh. Në kategorinë 20-50 kë listohen 70 refuzime, 30 në Tiranë, ndiqet nga Shkodra me 10 ashtu si dhe Durrësi, asnjë në Berat dhe Elbasan. Mbi 50kw janë 62 refuzime ku 24 janë raportuar në Tiranë, më shume nga gjithë rajonet.

Arsyet e aplikimeve të refuzuara përgjatë vitit 2020 kanë rezultuar nga Mungesa e Dokumentacionit, Mosbërjen e pagesës për një kohë të gjatë, Aplikant Debitor, Objekt i papërfunduar, Probleme mbi pronësinë. Ndarë në 3 llojet e Fuqisë dhe Shumën totale siç emërtohet Grand Total.

Në vijim të punës me qëllim mbikqyrjen e të liçensuarve sa i përket detyrimeve për zbatimin e Kushteve të Liçensës për shërbimin e Transmetimit, një pjesë tejet e rëndësishme e ushtrimit të aktivitetit nga ana e OST sh.a. është edhe zbatimi i kushteve dhe afateve të parashikuara në Rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, të miratuar më vendimin e Bordit të ERE, nr. 87, datë 20.04.2018. Për këtë qëllim ERE ka kërkuar nga OST informacion të detajuar në lidhur me:

- Aplikimet e regjistruara në OST sh.a. për lidhje të Reja në Sistemin e Transmetimit përgjatë vitit 2020.
- Afatet proceduriale të ndjekura për miratimin apo refuzimin e secilit aplikim për lidhje të Reja në Sistemin e Transmetimit përgjatë vitit 2020.
- Në rastet e refuzimit arsyet e këtij refuzimi
- Numrin e njësisive gjeneruese që janë vënë në operim gjatë vitit 2020.

OST sh.a në shkresën e saj ka listuar aplikuesit e regjistruar në OST sh.a për lidhje të reja në sistemin e transmetimit përgjatë 2020. Në tabelën e bashkëlidhur janë shënuar afatet e datës së aplikimit nga shoqëritë aplikuese dhe kthimit të përgjigjes nga ana e OST, siç është kërkuar nga ana jonë. Një nga

kërkesat e ngritura nga ERE lidhej me rastet e refuzimit dhe arsyet që mund të lidhen me to, por gjatë 2020 evidentohet që nuk ka patur refuzime nga ana e OST.

Për sa i takon procedurave për lidhje të reja, si dhe statusit të aplikimeve për lidhje me rrjetin e transmetimit, për periudhën Janar-Dhjetor 2020 ka patur një sërë aplikimesh për mundësinë e lidhjes së centraleve prodhuese të energjisë elektrike në zona të ndryshme të sistemit elektroenergjitik, ku OST raporton 18 aplikime në total nga ku: Centrale të tipit “Gjenerues Hidrik” ka patur 1 aplikim dhe janë realizuar 2 marrëveshje lidhjeje; Gjenerues Solarë ka patur 7 aplikime dhe asnjë marrëveshje lidhjeje; për tipin Gjenerues Eolik rezultojnë 10 aplikime dhe asnjë marrëveshje lidhjeje;

Sa i takon afatit ligjor për kthim përgjigje (60 dite kalendarike) sipas Rregullores të Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit, OST sh.a ka përbushur afatet kohore në masën 100 % të rasteve të shqyrtuara gjatë vitit 2020.

Vlerësimet e OST sh.a për të miratuar apo refuzuar aplikimet e periudhës janar – dhjetor 2020 janë si më poshtë: i vetmi aplikim apo 5.6% e totalit, kërkesa është terhequr nga vet aplikuesi. 22.2% e kërkesave janë miratuar nga OST, ndërsa 72.2% e kërkesave janë vlerësuar si Opinion Paraprak.

Ndërsa për çështjen e njërive gjeneruese që janë vënë në operim gjatë vitit 2020, cekur në kërkesën e ERE, OST sh.a bërë me dije në lidhje me dy burime gjenerues në operim gjatë periudhës janar – dhjetor 2020, të cilat janë centrale hidrike të lidhura në rrjetin e transmetimit 110kV: HEC Egnatia lidhur në linjën 110kV Librazhd- Prrenjas, HEC – et Seka dhe Zais, lidhur në Nënstacionin 110/20kV Prellë.

8.2 Cilësia e Shërbimit në rrjetin e transmetimit dhe të shperndarjes se energjisë elektrike.

Me qëllim marrjen e një pasqyre sa më të qartë të aktivitetit të Sistemit të Transmetimit, ERE ka kërkuar nga OST informacion në lidhje me Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit, duke përfshirë, të dhëna për, Kohën Mesatare e Ndërprerjes (AIT), Energji e Pa Furnizuar (ENS), Cilësinë e Frekuencës (FQ), Periudhat e Njoftimit të Ndërprerjeve të Planifikuara në Sistemin e Transmetimit, Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI), Cilësia e Tensionit (VQ), si dhe Ankesat e regjistruara në OST për Cilësinë e Tensionit.

Nga ana e OST është percjellë raporti i cili është paraqitur si më poshtë në mënyrë tabelare, duke evidentuar edhe ndryshimet nga viti 2017 deri në 2020.

Parametrat e Cilësisë Furnizimit	3-mujori I i 2020	3-mujori II i 2020	3-mujori III i 2020	3-mujori IV i 2020	KPI 2020	KPI 2019	KPI 2018	KPI 2017
a) AIT(^{imes} e ndërprerjes)	8 min	8.5 min	1.89 min	15.6 min	35 min	35 min	32 min	40 min
b) ENS (energji e pafurnizuar)	118.943 MWh	96.384 MWh	24.624 MWh	223.58 MWh	463.53 MWh	467.87 MWh	420.22 MWh	527.79 MWh
c) FQ(cilësia e frekuencës)	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz	Brenda diapazonit +/- 200mHz
d) Koha e njoftimit mbi ndërprerjet e planifikuara	72	72	72	72	72	72	72	72
e) Koha e përgjigjes për lidhjen e re	Nuk ka patur aplikime	35 ditë	45 ditë	30 ditë	60 ditë	60 ditë	60 ditë	60 ditë
f) SAIDI	13 min.	21min.	6 min.	31 min.	71 min	104 min.	83.5 min	92 min.
g) VQ (cilësia e tensionit)	brenda diapazonit -10%,+5%	brenda diapazonit -10%,+5%	brenda diapazonit -10%,+5%	brenda diapazonit -10%,+5%	brenda diapazonit -10%,+5%	brenda diapazonit -10%,+5%	brenda diapazonit -10%,+5%	brenda diapazonit -10%,+5%
h) Përqindja e ankesave për cilësinë e tensionit ¹	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka	nuk ka

Ajo që evidentohet nga tabela e mësipërme dhe të dhënat e analizuarat të parametrave të cilësisë rezultojnë se, për vitin 2020 parametrat e cilësisë që lidhen me Kohëzgjatjen mesatare të ndërprerjes, energjinë e pafurnizuar mbeten në të njëjtat norma, ndërkohë që rezultojnë me ulje të lehtë indeksit të kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes (SAIDI) nga 104

min në 71 min, çka rezultojnë në një përmirësim në masën rreth 21 % siç paraqitet në grafikun në të djathtë. Nga ana e OSSH janë përcjellë në ERE raportet periodike në lidhje me treguesit për cilësinë e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të cilat rezultojnë si në vijim.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten rezultatet e treguesve të vazhdimësisë së furnizimit me energji të klientëve të OSSH sh.a gjatë vitit 2020.



Krahasim i Performances se OSSH ne TL+TM 2019-2020 Lidhur me Treguesit Kryesore SAIFI, SAIDI, CAIDI dhe N1, D1										
	SAIFI		SAIDI		CAIDI		N1		D1	
	Nr. i Konsumatoreve te prekur nga nderprerjet/ Nr. Konsumatoreve Gjithsej		Nr. i oreve te nderprerjeve gjithsej / Nr. Konsumatoreve Gjithsej		Nr. i oreve te nderprerjeve gjithsej /Nr. Kons. Te prekur nga nderprejet		Nr. total i nderprerjeve te paplanifikuara per nje klient te prekur		Kohezgjatja totale per nje klient te prekur nga nderprerjet e paplanifikuara	
	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020	2019	2020
Janar	2.7	1.7	5.0	3.75	4.0	4.0	2.4	1.4	4.3	3.1
Shkurt	3.7	2.2	8.6	5.3	4.3	4.7	3.3	1.9	7.7	4.5
Mars	2.3	1.5	4.5	2.7	4.3	3.2	1.8	1.4	3.1	2.4
Prill	2.4	1.8	5.3	3.4	4.7	3.9	1.7	1.6	3.3	3.1
Maj	2.3	1.8	4.7	2.9	4.5	3.6	1.7	1.4	3.0	1.9
Qershor	2.3	1.8	3.7	2.9	3.3	3.8	1.8	1.3	2.4	1.8
Korrik	2.6	1.9	4.4	2.8	3.0	3.1	2.3	1.5	3.6	2.1
Gusht	2.0	2.1	3.3	3.8	3.2	3.2	1.5	1.9	2.0	3.2
Shtator	2.4	1.8	4.6	4.0	3.7	4.3	2.0	1.5	3.7	3.2
Tetor	2.1	2.5	5.0	4.8	5.3	3.8	1.5	1.9	3.0	3.7
Nentor	2.4	1.3	3.7	2.1	3.1	3.7	2.1	0.9	3.1	1.4
Dhjetor	2.9	2.7	5.9	5.8	4.1	3.6	2.4	2.5	4.8	5.4
GRAND TOTAL	30	23	59	44	48	45	24	19	44	36

Këto tregues merren në shqyrtim të ndarë sipas zonave urbane dhe rurale. Referuar treguesve të performancës së OSSH sh.a., konstatohet se rrjeti i shpërndarjes për këtë periudhën është përmirësuar, por numri dhe kohëzgjatja e difekteve në zonat Rurale vazhdon të jetë akoma i lartë.

Pra, siç vërehet edhe më lart, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar bazuar në të dhënat e SAIDI dhe SAIFI, dhe CAIDI rezultojnë se këto tregues janë përmirësuar ndjeshëm, duke mbajtur në konsiderate edhe impaktin e pandemisë COVID – 19 ashtu si pasojat e lëna gjatë këtij vitit 2020.




Tabela në krah, është një analizë vizive e Treguesve Kryesore të Cilësisë së shërbimit nga OSSH gjatë dy viteve të fundit 2019 dhe 2020. Janë marrë 5 tregues të cilët janë: SAIFI (kurba e zezë); SAIDI (kurba e kuqe); CAIDI (kurba e verdhë); N1 (kurba e bardhë); dhe D1 (kurba gri). Gjatë këtyre 12 muajve të fundit ka një rënie të kurbës në çdo tregues të raportuar nga OSSH, krahas me ato të 12 muajve të 2019. Ndryshe, kjo rënie në vlera

specifike, shihet si përmirësim i këtyre parametrave.

Tabela në krah, paraqet një grafik krahasues së Grand Totalit të Treguesve Kryesorë së Cilësisë së shërbimit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për dy vitet që lamë pas 2019 dhe 2020. Në grafik janë listuar Treguesit (SAIDI, SAIFI, CAIDI, N1 dhe D1) të cilët lënë hapsirë përmirësimi nga viti në vit. Koeficienti i ndërprerjes së energjisë elektrike për klient gjate një viti apo SAIFI ka patur një rënie në total nga 30 gjatë 2019 në 23 në vitin 2020 apo ndryshe 23% më pak, qartazi ky index është përmirësuar. Koeficienti i kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjes për klient apo SAIDI ka patur pësuar një ulje rreth 25% krahas me 2019, do të thotë që keto ndërpreje janë në ulje dhe janë më të kontrolluara se një vit më parë. Ashtu CAIDI, ka një ulje në 6% të shifrës totale nga 2019 në 2020.



Nr. total i ndërprerjeve të paplanifikuara për një klient të prekur apo shënuar N1 është ulur nga 24 minuta gjatë 2019, në 19 vitin 2020 ku vihet re rënie 20%. Së fundi, Kohëzgjatja totale për një klient të prekur nga ndërprerjet e paplanifikuara (N1) ka pësuar rënie 18% në total ose thënë në shifra të tjera, janë 8 minuta më pak të ndërpreje e paplanifikuar nga 2019 në vitin 2020.

Shoqëria OSSH sha si operator i vetëm i sistemit të shpërndarjes në themel të punës së saj ka për detyrë: a- të sigurojë një regjistrim korrekt të ndërprerjeve të energjisë elektrike të shkaktuara në sistemin e shpërndarjes, për të pasur tregues të performancës për sa i përket vazhdueshmërisë së furnizimit. Treguesit duhet të jenë të besueshem, të krahasueshëm dhe lehtësisht të verifikueshëm në mënyrë që informacioni të jetë i saktë për klientët dhe të interesuarit e tjerë lidhur me vazhdueshmërinë e furnizimit; b - të përmirësojë vazhdueshmërinë e shërbimit të furnizimit në nivel kombëtar dhe për të ulur diferencat ndërmjet zonave të ndryshme të furnizimit; c- të kufizojë numrin dhe kohëzgjatjen e ndërprerjeve vjetore që pësojnë klientët, duke i siguruar një rimbursim të përcaktuar në rastet e tejkalimit të standarteve specifike të përcaktuara në këtë Rregullore; OSHEE kryen regjistrimin e ndërprerjeve, të gjata apo të shkurtra, nëpërmjet metodave që disponon, nepermjet sistemit të regjistrimit të vazhdueshmërisë së shërbimit, duke funksionuar për të gjitha linjat TL dhe TM të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe OSHEE mban regjistrin e ndërprerjeve për të gjitha llojet e ndërprerjeve të përmendura më sipër, i cili përmban a- Origjinën e ndërprerjes; b- Shkakun e ndërprerjes; c- Numrin e klienteve në TL të përfshirë në ndërprerje; d- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TL të përfshirë në ndërprerje; e- Numrin e klientëve në TM të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive; f- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për secilin klient në TM, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive; g- Numrin e klientëve në TU, të përfshirë në ndërprerje, të ndarë sipas kategorive; h- Kohëzgjatjen e ndërprerjes për klientët në TU, të përfshirë në ndërprerje dhe numrin e tyre, sipas radhës së rilidhjes, të ndarë sipas kategorive; i- Datën, orën dhe minutën e fillimit dhe përfundimit të ndërprerjes, për të gjithë klientët të përfshirë në ndërprerje. J - Çdo ndërprerje e furnizimit me energji elektrike të konsumatorit, në sistemin e shpërndarjes, e cila zgjat më shumë se 10 minuta, konsiderohet ndërprerje e gjatë, e cila regjistrohet dhe përdoret në llogaritjen e treguesve të performancës SAIDI dhe SAIFI.

Nga ana e ERE është mbikëqyrur edhe performanca e OSSH sa i përket detyrimit për njoftimin e ndërprerjeve të planifikuara të energjisë elektrike. Për sa më sipër rezulton se në faqen zyrtare të OSHEE por edhe në rrjetet sociale, janë publikuar gjatë vitit 2020 rreth 485 njoftime për ndërprerje të planifikuara, remont të rrjetit të shpërndarjes ndërkohë që në vitin 2019 ka rezultuar se ka patur rreth 572 ndërprerje të planifikuara të energjisë elektrike.

9. AKTIVITETET NDËRKOMBËTARE TË ERE-s

9.1 Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

Ndër prioritetet e ERE-s është dhe mbetet përfaqësimi sa më dinjitoz dhe aktiv i punës së Rregullatorit në aktivitetet rajonale dhe ato ndërkombëtare, duke patur si qëllim përputhjen dhe harmonizimin e praktikave të saj me praktikat e vendeve të rajonit dhe BE-së. Qëllimi i pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ERE si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit dhe bashkëpunimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj.

Për vitin 2020, me kufizimet e shtrira nga pandemia ERE ka punuar me një intensitet të lartë nëpërmjet platformave online. Duke vendosur këto prioritete, ERE ka vijuar në intensifikimin e marrëdhënieve multilaterale me organizatat ndërkombëtare si Sekretariati i Energjisë së Vjenës nëpërmjet ECRB, MEDREG, ERRA, NARUC, CEER, IGU etj. Gjatë vitit të kaluar ERE i ka kushtuar një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në trajnime, seminare, takime, workshop dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare. Interesi i stafit të institucionit tonë në këto aktivitete ka qenë i lartë për t'u njohur me eksperiencat më të mira ndërkombëtare si dhe zhvillimet e fundit në sektorin energjetik duke marrë pjesë në këto aktivitete ndërkombëtare si dhe për të prezantuar denjësisht rregullatorin në këto aktivitete me anë të fjalimeve, kryesimeve të takimeve apo Grupeve të punës apo dhe prezantimeve të ndryshme.

9.2 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare.

- ERE është anëtare e ECRB Bordit Drejtues të Rregullatorëve të Vendeve të Traktatit të Energjisë dhe merr pjesë aktive në grupet e punës së ngritura prej kësaj të fundit duke kryesur njerin prej 4 grupeve të punës së ngritura nga kjo e fundit.
- ERE është anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Evropës Juglindore dhe Euro – Azisë (ERRA), duke realizuar një pjesëmarrje të rregullt në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të ERRA-s, takimet e Komiteteve të përhershme të ERRA-s, si dhe Grupeve të punës si atij të Energjisë elektrike, atij të gazit, apo dhe atij të Tarifave e Çmimeve.
- ERE është anëtare e Shoqatës së Rregullatorëve të vendeve të Mesdheut (MEDREG) për energjinë elektrike, ku përgjatë vitit 2020 Kryetari i ERE ka mbajtur postin e zv/Presidentit të MEDREG, dhe ne asamblene e Nentorit u zgjodh President i Shoqates për një mandat dy vjeçar. Gjithashtu, stafi i ERE-s ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e grupeve të punës përfshirë dhe drejtimin e tyre për konsumatorin, marrëdhëniet institucionale, energjitë e rinovueshme, çështjet e gazit, të grupit të punës së elektricitetit duke qënë dhe draftues i materialeve apo raporteve të këtyre të fundit.
- ERE ka statusin e vëzhguesit pranë CEER (Këshilli i Rregullatorëve Evropian të Energjisë), status i cili mundëson fuqizimin dhe marrjen e njohurive të stafit të ERE-s gjatë pjesëmarrjes në grupet e punës dhe takimeve .
- ERE është pjesëmarrëse në takimet e UfM (Unioni për Mesdheun), i cili përbëhet nga 43 shteteve anëtare pjesë e Mesdheut dhe ka për qëllim të rrisë dhe forcojë bashkëpunimin rajonal si dhe implementimin e projekteve dhe iniciativave që do ti shërbenin rajonin. Në kuadër të

bashkëpunimit në sektorin energjetik, UfM-së ka të hartuar platformën për sektorin e gazit natyror si dhe dy platforma të tjera në sektorin e energjisë elektrike, lidhur me burimet e rinovueshme dhe eficiencën e energjisë.

- ERE është anëtare me të drejta të plota në South – South East Gas Regional Initiative (GRI SSE), e cila është Iniciativa e Rregullatorëve për Gazin në Rajonin Jug – Juglindje).
- Po, ashtu ERE është anëtare me të drejta të plota në OME (Observatori i Energjisë në Mesdhe dhe në Europë) forum mjaft i rëndësishëm i Mesdheut.
- Si anëtare me të drejta të plota e Forumit të Këshillimit të Ballkanit në përbërje të së cilës janë Rregullatorët e Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, Greqisë, Serbisë, Bosnës dhe Bullgarisë, stafi i ERE-s ka marrë pjesë në takimet e grupeve të punës së këtij Forumi si dhe përpilimin e raportimeve që i shërbejnë rregullatorit dhe palëve të interesit. Forumi shërben për shkëmbimin e eksperiencave midis këtyre rregullatorëve nëpërmjet krijimit të grupeve të punës në fusha me interes të përbashkët.
- Për vitin 2020 ERE ka vazhduar të mbajë një bashkëpunim të frytshëm me USAID dhe NARUC në projektin e përbashkët, të përkrahur nga USAID dhe NARUC në lidhje me hartimin e strategjise kibernetike apo dhe planit të masave për zbatimin e standarteve të cilësive në operatorit të sistemit të shpërndarjes.
Gjithashtu, ERE ka marrë pjesë në projektin e USAID & NARUC lidhur me hartimin e planeve 10-vjeçar të zhvillimit të rrjeteve të transmetimit në Europën Juglindore si dhe workshop-in e organizuar lidhur me çështjet e sigurisë kibernetike.
- ERE në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë gjatë vitit të kaluar ka marrë pjesë në Forumin e Athinës, Forumin e Gazit dhe aktivitetet e Komunitetit të Energjisë të organizuara nga Sekretariati i Vjenës si dhe grupeve të punës së këtij organizmi.

Gjithashtu, ERE ka marrë pjesë në aktivitete duke bashkëpunuar në mënyrë intensive me Sekretariatit të Energjisë së Vjenës, duke u konsultuar për vendimet kryesore dhe duke kërkuar opinion për çështjet delikate. Po ashtu dhe draft vendimet e marra prej nesh si dhe draft rregulloret e hartuara nga ana jonë i janë dërguar për konsultim Sekretariatit të Vjenës ose janë realizuar takime me to për të patur një kuptim sa më të mirë të çështjes, si dhe jemi ndihmuar nga Sekretariati i Vjenës në draftimin e akteve sekondare në kuadër të ligjeve të reja. ERE ka ndjekur në mënyrë të rregullt dhe aktive takimet e Grupeve të Punës të ECRB për çështjet e konsumatorëve, të energjisë dhe tregut rajonal të saj, burimeve të rinovueshme, statistikave, elektricitetit, eficiencës, sigurisë së furnizimit, REMIT, gazit natyror, platforma e gazit. Për realizimin e një pune sa më të mirë dhe arritjen e rezultateve të larta, ERE ka zhvilluar takime të përbashkëta me Sekretariatit të Vjenës për sa i përket implementimit të paketës së tretë legjislativë në kuadër të legjislacionin sekondar i cili ka qënë në proces draftimi dhe miratimi nga Bordi, si dhe për sa i përket implementimit të Kodeve të Rrjetit, miratimi i të cilave vjen si detyrim që rrjedh nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe ENTSO-E.

9.3 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s.

Gjatë vitit 2020 janë intensifikuar në mënyrë të mëtjshme dhe marrëdhëniet bilaterale me Rregullatorin Italian (ARERA) si dhe atë Grek (RAE). Ky bashkëpunim ka bërë të mundur realizimin në kohë të vendimeve të përbashkëta të tre rregullatorëve në lidhje me projektin TAP i cili filloi operimin në fund të vitit 2020.

Një tjetër iniciativë rajonale është ndërmarrë gjatë vitit 2020, me mbështetjen e CEI (Central European Initiative) dhe të rregullatorit Italian ARERA, duke vijuar fazën e tretë të Projektit KEP (Know-How Exchange Program) “Suporti i CEI për forcimin e autoriteteve rregullatore të energjisë në Ballkanin Perëndimor”, i cili ka si objekt shtrirjen e praktikave të njohurive për iniciativat e bashkimit të tregjeve të energjisë ndërmjet anëtarëve të BE në vendet e Ballkanit Perëndimor.

10. STRUKTURA E ENTIT RREGULLATOR TË ENERGISË DHE ADMINISTRIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neni 9 pika 1 e tij, përcaktohet se ERE është institucioni Rregullator i sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit në Shqipëri që drejtohet nëpërmjet Bordit të Komisionerëve. Bordi i Komisionerëve të ERE përbëhet nga Kryetari dhe katër anëtarë të cilët për zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Me Vendimin nr. 78, datë 29.04.2020, Bordi i ERE vendosi të miratojë strukturën organizative dhe organogramën e Entit Rregullator të Energjisë, duke përcaktuar se numri maksimal i punonjësve të ERE është 63, të cilët organizohen si më poshtë vijon:




Figura 94. Struktura Organizative e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 78, datë 28.04.2020.

Përveç Bordit të Komisionerëve, i cili është organi vendimmarrës, ERE organizohet në Sekretarin e Përgjithshëm, 7 drejtori dhe sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve.

Struktura e re e ERE-s bazohet në një ndarje të qartë, me kapacitetet e nevojshme, me qëllim përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi që lidhen me fushat e rregullimit nga ERE në zbatim të legjislacionit në fuqi, të tilla si: Mbrojtja e Konsumatorit, Hartimi dhe miratimi i Akteve Nënligjore, Zhvillimit të Tregut të Gazit natyror, Monitorimi i Tregut, Standarteve të Cilësisë, Vendosja e Tarifave dhe Çmimeve në Segmentet e Rregulluara të Tregut, Liçensimi, Modifikimi, Rinovimi dhe dhënia e Autorizimeve për operimet në aktivitetet e identifikuar në ligjet respektive, Marrëdhënia instiucionale brenda dhe jashtë vendit, Planifikimi e Hartimit i Buxhetit, Zhvillimi i Burimeve Njerëzore.

Kjo strukturë gjithashtu merr në konsideratë edhe zhvillimet më të fundit në sektorin e energjisë elektrike siç janë:

- Zbatimi i rregullores së integritetit dhe transparencës së tregjeve me shumicë të energjisë elektrike (REMIT), në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, përsa i takon hartimit të rregullores ashtu dhe monitorimit të zbatimit të saj nga ana e operatorëve të tregut, duke filluar që nga regjistrimi i paleve deri tek ruajtja e të dhënave apo marrja e indicieve për kryerjen e investigimeve të ndryshme për rastet e moszbatimit të kësaj rregullore.
- Certifikimi dhe mbikqyrja e Operatorit të Nominuar të Energjisë Elektrike, sipas rregullores të miratuar nga ERE me Vendimin e Bordit nr. 40, datë 06.03.2020.
- Miratimi dhe monitorimi i implementimit nga operatorët e rrjetit të strategjise se infrastrukturave kritike, i cili kërkon angazhimin dhe perfshirjen e një stafi të dedikuar me eksperiencë në sistemet e informimit për të përballuar këtë detyrë.
- Transpozimi i rregulloreve dhe kodeve për përafrimin e akteve nënligjore, objekt miratimi nga ERE si dhe përpunimi i të dhënave personale të të liçensuarve, në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Mbikqyrja e standarteve të cilësisë së operimit të Operatorëve të sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes dhe rolit të ri të klientëve në përputhje me parashikimet e paketës së re legjislative si vetëprodhues.
- Digjitalizimi i arkivës së Entit Rregullator të Energjisë, duke patur në konsideratë se digjitalizimi nuk është kryer prej krijimit të Entit Rregullator dhe do ti shërbejë krijimit të një arkive digjitale, e cila mund të jetë e aksesueshme në çdo moment dhe do ti shërbejë dhe më tepër rritjes së transparencës së ERE.

Përsa i takon fushës së Burimeve Njerëzore, gjatë vitit 2020 është zbatuar me përpikmëri Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar me ligjin nr.86/2012 datë 18.09.2012, i ndryshuar me Ligjin nr.44/2014 datë 24.04.2014 dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” i ndryshuar me ligjin nr.85/2012 datë 18.09.2012, ligjin nr.45, datë 24.04.2014 si dhe ligjin nr.42/2017 datë 06.04.2017.

Janë plotësuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga zyrtarët që janë subjekt i këtij detyrimi, sipas afateve kohore të parashikuara nga ligji.

Gjithashtu është mbatjur komunikimi i rregullt me ILDKPKI në zbatim të njoftimeve të dërguara prej këtij institucioni.

Në zbatim të Vendimit nr.52 date 02.04.2019 të bordit të ERE është zbatuar me përpikmëri Ligji Nr. 9584 datë 11.07.2006, ”Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, si dhe Vendimi nr. 187, datë 08.03.2017 ”Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit,

Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit” si dhe Vendimin nr. 202, datë 15.03.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të këshillit të ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore” të ndryshuar.

Në vijim të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, për përzgjedhjen, emërimin dhe promovimin në detyrë të punonjësve të ERE-s, janë zbatuar procedurat e ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe të gjithë aktet nënligjore të dala në funksion të tij.

11. ADMINISTRIMI I BURIMEVE FINANCIARE TË ERE-S GJATË VITIT 2019

Në fushën e administrimit dhe financës janë zbatuar me korrektësi aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse për administrimin e financave të ERE-s, përfshirë ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për “Prokurimet Publike”, i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe Urdhërit nr. 64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standarteve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.

Edhe për vitin 2020 është zbatuar me përpikmëri Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar me ligjin nr.86/2012 datë 18.09.2012, i ndryshuar me Ligjin nr. 44/2014 datë 24.04.2014 dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” i ndryshuar me ligjin nr.85/2012 datë 18.09.2012, ligjin nr.45, datë 24.04.2014 si dhe ligjin nr.42/2017 datë 06.04.2017.

Janë plotësuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga zyrtarët që janë subjekt i këtij detyrimi, sipas afateve kohore të parashikuara nga ligji dhe nuk ka asnjë masë penaliteti për zyrtarët tanë, që i nënshtrohen këtij Ligji.

Në të gjitha rastet janë zbatuar procedurat dhe afatet kohore në lidhje me kryerjen e prokurimeve të fondeve publike, në përputhje me ligjin e prokurimeve dhe akteve të tjera nënligjore.

Gjithashtu, ka vijuar inventarizimi i asetëve që ERE ka në administrim. Për sa i takon fondeve monetare, ato sigurohen në përputhje me ligjet respektive të sektorit të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror, dhe përbëhen nga pagesat e aplikimeve për liçensime/modifikime/rinovime dhe nga pagesat e rregullimit që ERE ka vendosur për të liçensuarit.

Ndër zërat kryesorë të shpenzimeve të ERE mund të përmendim:

- Pagat e personelit, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimet mbi të ardhurat, për të cilat institucioni ynë ka shlyer të gjitha detyrimet dhe nga sistemi elektronik “Detyrimet në kohë reale” nuk rezulton debitor apo me gjoba.
- Publikimet për informim të opinionit publik janë realizuar në zbatim të Ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Ligjit nr.102/2015 ‘Për Sektorin e Gazit Natyror’.
- Pagesat për shlyerjet e detyrimeve të shërbimeve si ujë, energji elektrike, telefon për të cilat institucioni ynë gjithashtu nuk është debitor, shpenzime për shërbime të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës si dhe amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara etj.

- Pagesat me qëllim përmbushjen e angazhimeve në cilësinë e vendit anëtar në një sërë organizatash të rëndësishme ndërkombëtare të sektorit të energjisë të tillë si MEDREG, ERRRA, IGU, CEER.

Edhe për vitin 2020 veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s në zbatim të parashikimeve të nenit 17 të ligjit nr.43/2015, është audituar nga një grup ekspertësh kontabël të regjistruar dhe të liçensuar për këtë aktivitet bazuar në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”. Në Shtojcën 1 të këtij raporti paraqitet raporti përkatës i ekspertit kontabël që lidhet me ecurinë financiare të ERE-s gjatë vitit 2020 si dhe Shtojcën 2 me raportin e performancës.

Buxheti i ERE u miratua me vendim të Bordit nr. 81, datë 29.03.2021. Ky buxhet merr në konsideratë kërkesat për funksionimin e ERE-s përgjatë vitit 2021.

Në mënyrë të detajuar ky buxhet paraqitet në tabelën e mëposhtëme.

BUXHETI PËR VITIN 2020

Nr,	Emërtimi	Vlera
I	SHPENZIME OPERATIVE	235,586,800
	Paga personeli	150,600,000
	Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	19,500,000
	Shpenzime Amortizimi	6,000,000
II	INVESTIME	5,460,000
	Totali i shpenzime të pritshme të vitit 2021	241,046,800

SHTOJCA 1 Raporti Auditimit të Pasqyrave Financiare

RAPORT I AUDITUESEVE TE PAVARUR -ENTI RREGULLATOR I ENERGISË (ERE)
[AUDITIM PËR PASQYRAT FINANCIARE TE VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2020]
[ADRESA: BLV. "BAJRAM CURRI", RRUGA "VIKTOR EFTIMIU" 1023; e-mail: erealb@ere.gov.al
TIRANË, SHQIPËRI

RAPORT I AUDITUESIT TE PAVARUR

Për: Z.Petrit Ahmeti

Kryetarit të Entit Rregullator të Energjisë

Blv. "Bajram Curri", Rruga "Viktor Eftimiu" 1023, Tiranë, Shqipëri

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2020.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **Entit Rregullator të Energjisë-ERE**, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 Dhjetor 2020, pasqyrën performancën financiare (burimeve dhe përdorimin), pasqyrën e ndryshimeve për fondet e akumuluarra dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur më datën 31 Dhjetor 2020, përfshirë shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, dhe një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar më datën 31 Dhjetor 2020, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me "Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (të përmirësuar)(SKKP), Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe Ligj nr. 43/2015 "Për sektorin e Energjisë Elektrike" [neni3 (pika 52 dhe 53); neni 11; neni 17]].

Baza për opinionin

Ne kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Entiteti në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje për t'u theksuar

Pasqyrat financiare të datës 31 Dhjetor 2020 janë përgatitur në një platformë excel referuar shënimeve të pasqyrave financiare, të cilat mund të mbartin pasiguri mbi të kuptuarin kronologjike dhe logjike skemave kontabël të aktivitetit.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare për vitin 2019 janë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pakualifikuar në datën dorezimit të raportit, në lidhje me pasqyrat financiare të mbyllyra me 31.12.2019

Përgjegjësitë e Drejtimit në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKKP dhe Ligjin nr.25/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" e Ligj nr. 43/2015 "Për sektorin e Energjisë Elektrike" (neni 17) dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Entitetit për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë .

Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të Entitetit.

Raporti i audituesve të pavarur është i vlefshme vetëm për pasqyrat financiare 2020 bashkëlidhur.

Alina

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona të auditimit janë: të arrijmë një siguri të arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi kanë ose jo anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport, i cili përfaqëson opinionin e audituesit. Siguria e arsyeshme megjithëse është një siguri e nivelit të lartë, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojmë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku pritet, që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.


Një auditim i pasqyrave financiare në përputhje me SNA-të, kërkon që ne si auditues të ushtrojmë gjykimin profesional dhe të ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku i mosbulimit si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të .
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Entiteti të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e institucionit, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Audituese Ligjore:

Alliu
Fati Alliu




E-Mail: Fato.alliu@viar.al

Audituese Ligjore:

Bujar Bendo
Bujar Bendo

Liçencë: Nr. 79; Datë: 2019
Adresa: Rruga Sami Frashëri, Nr. 19,
Hyrja 8, kati 6, Ap. 18, Tiranë
E-Mail: bujarbendo@gmail.com



Tiranë më 31/03/2021

Raporti i audituesve të pavarur është i vlefshme vetëm për pasqyrat financiare 2020 bashkënlidhur.

Mr. prot. 46/2

dt. 31. 3. 2021

**PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË (ERE)**

NIPT: K517170241

Adresa: Blv. "Bajram Curri",

Rruga "Viktor Eftimiu" 1023

e-mail: erealb@ere.gov.al

Tiranë, Shqipëri

Tiranë, më 31/03/2021


Përmbajtja

Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra Performancës (Burimet dhe Përdorimet)	2
Pasqyra e ndryshimit të Fondeve	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare	5
A. Informacion i përgjithshëm	5
B. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare	5
C. Politikat kontabile	6
1. Transaksionet në monedhë të huaj	6
2. Instrumentat financiare	6
3. Inventaret	8
4. Aktivet Afagjate Materiale (AAM-t)	8
5. Qiratë	9
6. Transaksionet me palët e lidhura	9
7. Grantet qeveritare	9
8. Të Ardhurat dhe shpenzimet	9
9. Përfitimet e punonjësve	10
10. Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara.....	10
11. Korrigjimi i gabimeve.....	10
12. Ngjarje pas mbylljes së pasqyrave financiare	10
D. Shënimet për Pozicionet Financiare	11
1. Mjetet monetare.....	11
2. Të arkëtueshme	11
3. Inventarët	11
4. Aktivet Afagjate Materiale (AAM) dhe Jo Materiale (AAJM)	11
5. Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit.....	12
6. Të ardhurat nga aktiviteti	13
7. Shpenzimet për personelin	13
8. Shpenzimet për amortizimin dhe zhvlerësimi.....	13
9. Shpenzime të tjera shfrytëzimi	14
10. Shpenzime financiare	14
11. Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve	14
12. Teprica e Fondeve më 31.12.2020	14
13. Palet e lidhura	14
14. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara.....	15
15. Kontrollat tatimore	15
16. Ngjarje pas datës së bilancit	15


Pasqyra e pozicionit financiar

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	1	114,450,199	10,544,139
Investime		-	-
Te drejta te arketueshme			
Nga aktiviteti i shfrytezimit	2	27,347,044	74,631,850
Nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Te tjera		61,801	62,754
Kapital i nenshkruar i papaguar		-	-
Inventaret			
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	3	2,657,246	3,010,594
Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte		-	-
Produkte te gatshme		-	-
Mallra		-	-
Shpenzime te shtyra			
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara			
Totali i aktiveve afatshkurtra		144,516,290	88,249,337
Aktive afatgjate			
Aktive financiare			
Aktive materiale			
Toka dhe ndertesat		-	-
Makineri e Pajisje		-	-
Mjete Transporti	4	7,426,460	9,283,076
Pajisje Zyrtare	4	1,319,196	1,648,995
Te tjera pajisje dhe Informatike	4	28,573,190	9,528,422
Aktivitet biologjike			
Aktive jo materiale			
Koncensione, patenta, licensa, makra tregtare, te drejta dhe aktive te natashme	4	9,246,847	11,138,289
Emri i mire		-	-
Parapagime per AAJM		-	-
Aktivitet tatimore te shtyra			
Totali i aktiveve afatgjate		46,565,694	31,598,781
Totali i Aktiveve		191,081,984	119,848,118
DETYRIMET DHE KAPITALI			
Detyrime afatshkurtra			
Tihujt e huamarrjes		-	-
Detyrime ndaj institucioneve te kredise		-	-
Aktetime ne avance per porosi		-	-
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	5	20,939,124	-
Deftesa te pagueshme		-	-
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit *		-	-
Te pagueshme ndaj njesive ekonomike ku ka interesa		-	-
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve	5	2,128,908	1,568,680
Te pagueshme per detyrime tatimore	5	1,246,474	1,070,030
Te tjera te pagueshme	5	296,621	60,972
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara			
Te ardhura te shtyra			11,093,819
Provizione			
Totali i detyrimeve afatshkurtra		24,611,127	13,793,500
Detyrime afatgjate			
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara			
Te ardhura te shtyra AGJ			
Provizione			
Provizione per pensione		-	-
Provizione te tjera		-	-
Detyrime tatimore te shtyra			
Totali i detyrimeve afatgjate			
Detyrime Totale		24,611,127	13,793,500
Fondet Te Akumuar - ERE		106,054,620	88,957,416
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	11	60,416,239	17,097,204
Shuma		166,470,859	106,054,620
Totali i Detyrimeve dhe i Fondeve		191,081,986	119,848,120

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Aferdita Bushi




Kryetar
Petrit Ahmeti



Pasqyra Performancës (Burimet dhe Përdorimet)

		31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Te ardhura te shfrytezimit			
Te ardhurat nga Faturimi i Operatoreve	6	213,502,681	163,554,328
Te ardhurat nga Licensimi	6	2,857,000	8,441,600
Te tjera te ardhura nga organizma mbulim shpenzimesh		-	1,645,661
Te ardhura te tjera te shfrytezimit		-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		-	-
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		-	-
Te tjera shpenzime		-	-
Shpenzime te personelit		-	-
Paga dhe shperblime	7	(122,775,775)	(96,949,701)
Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore	7	(13,390,205)	(9,788,478)
Shpenzimet per pensionet		-	-
Zhvleresimi i aktiveve atagjate materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	8	(6,512,211)	(6,600,539)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	9	(14,060,326)	(43,242,607)
Te ardhura te tjera		-	-
Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*		-	-
Te ardhura nga njesite ekonomike ku ka interesa pjesmarrese		-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike		-	-
Te ardhura nga investimet dhe huate e tjera ne njesi ekonomike ku		-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga		-	-
Interesa te arketueshem dhe te ardhura te tjera te ngjashme nga		-	-
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare		-	-
Shpenzime financiare		-	-
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme		(73,342)	(105,574)
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme per tu paguar tek		-	-
Shpenzime te tjera financiare	10	868,418	142,515
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarriet		-	-
Fitimi/(humbja) para tatimit	11	60,416,239	17,097,204
Tatimi mbi fitimin		-	-
Tatimi mbi fitimin e periudhes		-	-
Tatim fitimi i shtyre		-	-
Pjesa e tatim fitimit te pjesemarrjeve		-	-
Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve		60,416,239	17,097,204

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
 Aferdita Bushi



Kryetar

Petrit Ahmeti



Pasqyra e ndryshimit të Fodeve

	Fondet Të Akumuar - ERE	Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	Totali
Pozicioni financiar ne fillim 01.01.2019	71,858,598	17,098,818	88,957,416
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile			-
Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim	71,858,598	17,098,818	88,957,416
Rezultati viti paraardhes	17,098,818	(17,098,818)	-
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit		17,097,204	17,097,204
Pozicioni financiar ne fund 31.12.2019	88,957,416	17,097,204	106,054,620
Rezultati viti paraardhes	17,097,204	(17,097,204)	-
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	-	60,416,239	60,416,239
Pozicioni financiar ne fund 31.12.2020	106,054,620	60,416,239	166,470,859

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
 Aferdita Bushi




Kryetar
 Petrit Ahmeti




Pasqyra e flukseve monetare

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	60,416,239	17,097,204
<i>Rregullime per shpenzimet jo-monetare:</i>		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,512,211	6,600,539
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
Zhvleresimi i te drejtave te arketueshme		
Ulje ne vleren neto te realizueshme per inventaret		
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit		
Renie/(Rritje) ne te drejtat e arketueshme dhe te tjera	47,285,759	(17,927,956)
Renie/(Rritje) ne inventar	353,348	262,461
Rritje/(Renie) ne detyrime te pagueshme	10,817,626	(8,667,000)
Rritje/(Renie) ne detyrime per punonjesit		
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	125,385,184	(2,634,752)
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(21,479,124)	(19,533,077)
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	(21,479,124)	(19,533,077)
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	-	-
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to	103,906,060	(22,167,829)
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	10,544,139	32,711,968
Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare	-	-
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	114,450,199	10,544,139

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
 Aferdita Bushi



Kryetar
 Petrit Ahmeti



Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

A. Informacion i përgjithshëm

ERE është person juridik publik, i pavarur nga interesat e industrisë së energjisë dhe nga organet shtetërore. ERE është krijuar në vitin 1995 dhe aktualisht funksionon në baze të ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe ligjit nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".

Misioni i Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë është:

- Garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve, nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.
- Rregullimi i marrëdhënieve në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, i cili vendos rregullat lidhur me:
 - a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;
 - b) pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;
 - c) dhënie e autorizimeve dhe licencave në sektorin e energjisë elektrike;
 - ç) rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;
 - d) integrimin e tregut shqiptar në tregun rajonal dhe atë evropian të energjisë elektrike..

Kryetar i Entit Rregullator të Energjisë është Z. **Petrit Ahmeti**

Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj: 01.01.2020-31.12.2020.

B. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKKP) dhe Ligjin Nr. 25/2018 datë 10 Maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike.

Pasqyrat financiare të datës 31 Dhjetor 2020 janë përgatitur në një platformë excel.

Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabël Shqiptar. Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit financiar të shoqërisë në 31 Dhjetor 2019.

Qëndrueshmëria e Paraqitjes

Një njësi ekonomike ruan paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën.

Biznesi në vijimesi

Pasqyrat financiare të përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimesi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë egzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar gjatë.

Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare individuale janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale e .

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKKP-t kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime. Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

- **Zhvlërësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlërësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pamundësia e klientëve apo debitorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në vjetërsinë e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve apo debitorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së tyre. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe kontabël nëse ka nevojë për zhvlërësimin e llogarive të arkëtueshme.

- **Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Menaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe kontabël në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

C. Politikat kontabile

Shoqëria ka aplikuar politikat e mëposhtme kontabël për periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare individuale.

1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksioni. Aktivitet dhe pasivitet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtrimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e gjendjeve të bilancit emërtuar në monedhe të huaj në datën e hartimit të bilancit janë si më poshtë (në LEK):

	<u>31.12.2020</u>	<u>31.12.2019</u>
Kurset e këmbimit		
Euro/Lekë	123.7	121.77
USD/ Lekë	100.84	108.64

2. Instrumentat financiare

Instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar për një njësi ekonomike, si dhe një detyrim financiar ose instrument kapitali për një njësi ekonomike tjetër. Instrumentat financiarë të shoqërisë përbëhen nga: mjetet monetare; depozita pa afat dhe depozita me afat fiks ku njësi ekonomike është depozituesi [psh llogaritë bankare]; letra tregtare dhe kambiale tregtare; llogari, dëftesa dhe hua të arkëtueshme dhe të pagueshme; obligacione dhe instrumenta të ngjashme borxhi; zotim për të marrë një hua nëse zotimi nuk mund të paguhet në mjete monetare mjetet monetare.

Aktivitet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të mbi flukset e parasë së aktivitet financiar ose kur shoqëria transferon të drejtën kontraktuale për të marrë flukset e parasë nga aktivitet financiar në një transaksion në të cilin të gjitha rreziqet dhe përfitimet nga pronësia e aktivitet financiar transferohen. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, e cila është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Njohja fillestare

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit në fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të instrumentave financiar kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë

Instrumentin financiar. Instrumentat financiarë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe, për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, koston e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Vlerësimi i mëpasshëm

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë maten siç përshkruhet më poshtë.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse në monedhë vendase dhe të huaj dhe paraqiten me kosto.

Llogaritë e arkëtueshme, tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme financiare, tregtare dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus koston të lidhura direkt me transaksionin. Pas njohjes fillestare llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me koston e amortizuar pakësuar me humbjet nga zhvlerësimi. Provizionet për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme njihen kur shumat konsiderohen të pambledhshme. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuar me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shoqëria e çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shlyhen, anulohen apo përfundojnë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Shoqëria përgjithësisht huatë e marra dhe të dhëna i ka me palët e lidhura për të financuar fazën paraprake të zhvillimit të projekteve energjetike. Për këto aktive apo detyrime nuk është aplikuar interes.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël, Shoqëria nuk ka aplikuar vlerë të drejtë.

Netimi i instrumentave financiare

Aktivitet dhe pasivitet financiarë netohen dhe shuma neto e tyre raportohet në bilanc nëse, dhe vetëm nëse ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për të netuar shumën e njohur dhe ekziston mundësia për të shlyer në shumën neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivitet njëkohësisht.

Zhvlerësime të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktiviteti. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivitet financiarë të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Zhvlerësime të aktiveve jo - financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo- financiare të , rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse ekziston ndonjë tregues i fillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e rikuperueshme të tij. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Ç`regjistrimi instrumentave financiare

Aktivitetet financiare se bashku me fondin rezerve të zhvlerësimit ç`regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivitetin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

3. Inventaret

Inventaret regjistrohen në konatibilitet me kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e inventarit në vendin e përcaktuar. Për përcaktimin e koston të inventareve është zgjedhur metoda e koston mesatare.

4. Aktivitetet Afatgjate Materiale (AAM-t)

Njohja dhe Matja: Vlerësimi fillestar i një elementi të AAM-ve që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrat financiare është vlerësuar me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e aktiveve në vendin dhe kushtet ekzistuese (SKK 5).

Njohja Mepashme: AAM-të paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi (SKK 5).

Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet koston të elementit, nëse ajo përmbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve në bilanc. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet nga bilanci edhe nëse ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kostoja fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabël aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të koston aktuale të kësaj pjesë minus amortizimin e vlerësuar.

Amortizimi: Për llogaritjen e amortizimit të AAM-ve njësi janë ekonomike ka përcaktuar si metode të amortizimit të AAM-ve metodën e amortizimit mbi bazën e vlefës së mbetur ndësa normat e amortizimit janë përdorur normat menaxheriale si më poshtë:

Njohjet e Aktiveve Afatgjate, Normat e aplikuar, Metoda e aplikuar

Materiale

Makineri dhe pajisje	20%	Me vlerë të mbetur
Mjete transporti	20%	Me vlerë të mbetur
Mobilje dhe Orendi	20%	Me vlerë të mbetur
Të tjera	20%	Me vlerë të mbetur
Pajisje Informatike	25%	Me vlerë të mbetur
Ndërtesa	5%	Me vlerë të mbetur

Jo materiale

Konçensione, patenta, liçenca	15%	Lineare
-------------------------------	-----	---------

Tokat dhe Investimet në proces nuk amortizohen.

Ç`regjistrimi: Një zë i aktiveve afatgjate materiale ç`regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit

të aktiveve afatgjata materiale percaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria vlerëson në datën raportimi nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

Aktivët Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)

Aktivët afatgjata jomateriale përfshijnë licensat, të drejtat për përdorim dhe emri i mire.

Njohja dhe Matja: Licensat, të drejtat e përdorimit të cilat përftohen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzimet Mëpasshme: Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

Amortizimi: Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatesinë e parashikuar (SKK 5) të aktiveve të patrupëzuara që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria e vlerëson në datën e raportimit nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

5. Qiratë

Qiratë klasifikohen si qira financiare ose qira operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën me më të voglën midis vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë në datën e marrjes. Kosto financiare paraqet diferencën midis detyrimit total të qirasë dhe vlerës së drejtë të aktivit. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë kohëzgjatjes së qirasë me norma interesi të aplikueshme mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria nuk ka qira financiare.

6. Transaksionet me palët e lidhura

Palë të lidhura janë ato, kur njëra prej paleve kontrollohet nga pala tjetër ose ka influence të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjetër.

7. Grantet qeveritare

Grantet qeveritare njihen fillimisht si të ardhura të shtyra kur ka një siguri të arsyeshme se grantet qeveritare do të merren dhe shoqëria do të jetë në përputhje me konditat që i janë bashkëngjitur grantit. Grantet që kompensojnë shpenzimet e ndodhura të , njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të njëjtën periudhë në të cilën kanë ndodhur shpenzimet. Grantet që kompensojnë koston e aktiveve të , njihen në mënyrë sistematike në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

8. Të Ardhurat dhe shpenzimet

Të Ardhurat

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarësisht se kur bëhet pagesa. Të ardhurat maten me vlerë të drejtë të mallit/sherbimit të shitur neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve.

Shpenzimet

Shoqëria njih shpenzimet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcion me kryerjen e tyre në datën e raportimit. Shpenzimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës së tyre, çka kërkon gjykim të konsiderueshem nga drejtimi i .

Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

9. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është përgjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ndodhin.

Leje vjetore e paguar

Shoqëria njih si detyrim vlerën e paskontuar të kostove të çmuara lidhur me lejen vjetore për tu paguar në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

10. Angazhimet dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten vetëm në shënime shpjeguese, për sa kohë që mundësia e një daljeje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aktivitetet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënime kur një hyrje e përfitimeve ekonomike është e mundur. Vlera e një humbje të kushtëzuar njihet si provizion nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që, një detyrim ka lindur në datën e raportimit financiar, dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

11. Korrigjimi i gabimeve

Gabimet mund të shfaqen në njohjen, matjen, prezantimin ose paraqitjen e zërave të pasqyrave financiare. Paraqitjet e gabuara materiale në pasqyrën e pozicionit financiar janë materiale nëse ato, individualisht ose të grupuara, mund të ndikojnë në vendimet ekonomike që përdoruesit marrin bazuar në pasqyrat financiare. Materialiteti varet nga madhësia dhe natyra e konstatimit të gabuar ose të gjykimit të gabuar për shkak të rrethanave. Madhësia ose natyra e zërit financiar, ose një kombinim i të dyjave, mund të jetë faktor përcaktues.

Në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare individuale janë identifikuar disa zëra të për të cilat Drejtimi ka ndërmarrë një iniciativë për të ndryshuar politikën kontabël si dhe për korrigjuar efektet e këtij ndryshimi në mënyrë retrospektive në grupin e parë të pasqyrave financiare individuale, duke rivendosur gjendjen e çeljes së aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit neto për vitin më të hershëm praktik për korrigjimet e identifikueshme. Drejtimi ka vendosur që aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare në monedhë të huaj të pasqyrohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit dhe jo më me koston historike. Si rezultat, pasqyrat financiare janë riparaqitur duke reflektuar efektet siç tregohen në faqet vijuese:

12. Ngjarje pas mbylljes së pasqyrave financiare

Ngjarjet pas datës së bilancit që përmbajnë informacion shtesë të , në datën e bilancit kontabel (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese paraqiten të shpalosura në shënime shpjeguese të pasqyrave financiare kur janë materiale.

D. Shënimet për Pozicionet Financiare

1. Mjetet monetare

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Banka Kombetare Tregtare Lek	112,634,291	7,067,116
Banka Kombetare Tregtare Euro	166,578	1,160,667
Raiffaisen Bank Lek	148,758	591,957
Union Bank	770,440	621,605
Union Bank Euro	234,615	308,200
Union Bank Card	495,517	674,164
Banka Kombetare Tregtare USD	0	120,430
Shuma	<u>114,450,199</u>	<u>10,544,139</u>

Veprimet e lëvizjeve monetare në librat e arkës dhe bankës, janë veprime të autorizuara, mbështeten në dokumenta që justifikojnë pagesat dhe arkëtimet, regjistrimet janë kronologjike. Për gjëndjen në valutë është bërë rivlerësimi me kursin fiks të bankës Shqipërisë në datën 31.12.2020 dhe diferencat janë pasqyruar në rezultatin e shoqërisë.

2. Të arkëtueshme

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Klinate pa arketuar deri me 31.12.2020 (VB nr.171)	22,706,197	67,588,229
Debitor ndër vite në para 2019	4,640,847	7,043,621
Shuma	<u>27,347,044</u>	<u>74,631,850</u>

Të tjera të arkëtueshme

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Te tjera te arketueshme	61,801	62,754
Shuma	<u>61,801</u>	<u>62,754</u>

3. Inventarët

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	2,657,246	3,010,594
Shuma	<u>2,657,246</u>	<u>3,010,594</u>

4. Aktivet Afatgjate Materiale (AAM) dhe Jo Materiale (AAJM)

Aktive Afatgjate Materiale

Enti Rregullator i Energjisë -ERE
 Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur 31 Dhjetor 2020
 (Të gjitha shumat janë në LEK, nëse nuk shprehet ndryshe).

	Makineri e Pajisje	Mjete Transporti	Pajisje Zyresh	Te tjera pajisje dhe Informatike	Total
Vlera bruto e AAM me 31.12.2019		27,592,000	11,620,048	19,749,546	58,961,594
Shtesa gjate 2020				21,479,124	21,479,124
Pakesime					-
Vlera bruto e AAM me 31.12.2020	-	27,592,000	11,620,048	41,228,670	80,440,718
Amortizimi i akumuluar 31.12.2019		18,308,924	9,971,053	10,221,124	38,501,102
Pakesime					-
Amortizimi i vitit 2020		1,856,615	329,799	2,434,355	4,620,770
Amortizimi i akumuluar, 31 dhjetor 2020	-	20,165,540	10,300,852	12,655,480	43,121,871
Vlera neto e AAM 2020	-	7,426,460	1,319,196	28,573,190	37,318,847
Vlera neto e AAM 2019	-	9,283,076	1,648,995	9,528,422	20,460,493

Aktive Afatgjata Jomateriale

[REDACTED]

Gjendje me 01.01.2020 12,609,610

Shtesa investime

Pakesime

[REDACTED]

Amortizini Akumuluar

Gjendje me 01.01.2020 1,471,321

Shtesa 1,891,442

Pakesime

[REDACTED]

Vlera e mbetur neto

[REDACTED]

5. Të pagueshme për aktivitetin e shfryzimit

	Dt. 31.12.2020	Dt. 31.12.2019
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	20,939,124	-
Shuma	20,939,124	-

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Te pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore	2,128,908	1,568,680
Shuma	<u>2,128,908</u>	<u>1,568,680</u>

Të pagueshme për detyrime tatimore dhe të tjera

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Tatim mbi te ardhurat personale	1,246,474	1,070,030
Te tjera te pagueshme	296,621	60,972
Shuma	<u>1,543,095</u>	<u>1,131,002</u>

6. Të ardhurat nga aktiviteti

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Te ardhurat nga Faturimi i Operatoreve	213,502,681	163,554,328
Te ardhurat nga Licensimi	2,857,000	8,441,600
Te tjera te ardhura nga organizma mbulim shpenzimesh	-	1,645,661
Shuma	<u>216,359,681</u>	<u>173,641,589</u>

7. Shpenzimet për personelin

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Paga dhe shperblime	122,775,781	96,949,701
Shpenzime te sigurimeve shoqërore/shëndetësore	13,390,144	9,788,478
Shuma	<u>136,165,924</u>	<u>106,738,180</u>

Shpenzimet e personelit janë përlogaritur konform nenit 11 te ligjit 43/2015.

8. Shpenzimet për amortizimin dhe zhvlerësimi

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6,512,211	6,600,539
Shuma	<u>6,512,211</u>	<u>6,600,539</u>

9. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Shpenzime te lende e pare e konsumi	2,476,690	3,228,382
Sherbime te ndryshme nga te trete	5,222,172	4,893,444
Shpenzime uje energji	406,769	623,427
Mirmbajtje automjete e taksa te lidhura me to	714,409	1,212,446
Publikime ne media	883,200	1,256,900
Udhetime dieta J.vendit; kuotizacion	3,609,543	30,416,602
Poste telefon etj	747,544	974,587
Taksa dhe tarifa vendore	-	15,819
Trajnime profesionale	-	72,000
Te tjera	-	549,000
Shuma	14,060,326	43,242,607

10. Shpenzime financiare

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme	(73,342)	(105,574)
Shpenzime te tjera financiare	868,418	142,515
Shuma	795,075	36,941

11. Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve

	<u>Dt. 31.12.2020</u>	<u>Dt. 31.12.2019</u>
Rritje/Rënie fondesh gjatë vitit	60,416,239	17,097,204
Shuma	60,416,239	17,097,204

12. Teprica e Fondeve më 31.12.2020

	<u>31 dhjetor 2020</u>
Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve	60.416.239
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	6.512.211
Rritje/(Rënie) Neto e Fondeve - e korrigjuar (pa amortizimin)	66.928.450
Kontrata per investime ne proces	105.555.000
Dixhitalizimi I dokumentacionit t Arkivës	57.600.000
Bleija e pajisjeve elcktronike	23.300.000
Mbarevajtje ne institucion per aksesin e punonjesve	24.655.000
Kosulence per perpilimin e akteve sekondare-APP	0
Gjendje Mjete Monetare 31.12.2020	114.450.199
Kliente te paarketuar me 31.12.2020	27.347.044
Teprice e fondeve nga 2020 transferuar per buxhetin 2021	36.242.243

13. Palët e lidhura

Palët quhen të lidhura kur njëra prej tyre ka mundësinë të kontrollojë palët e tjera ose të ushtrroje ndikim domethënës në vendim-marrjen financiare dhe operacionale të tyre.



14. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Çështje gjyqësore

Me 31 Dhjetor 2020 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.


15. Kontrollë tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për periudhën 31.12.2020. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.


16. Ngjarje pas datës së bilancit

Me 31 Dhjetor 2020 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare
Aferdita Bushi



Kryetar
Petrit Ahmeti



Tiranë, më 31/04/2021

SHTOJCA 2 Raporti i Performancës

**Grant Thornton**

An instinct for growth™

Raport i Sigurisë së Profesionistit të Pavarur

Kryetarit dhe Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)

Enti Rregullator i Energjisë ("ERE" ose "Enti") angazhoi "GRANT THORNTON sh.p.k" ("Grant Thornton") për të shqyrtuar informacionin jo-financiar të paraqitur në Raportin Vjetor për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020 ("të dhëna e zgjedhura"), me qëllim dhënien e sigurisë së kufizuar sipas kriterëve të përshkruara më poshtë (Qëllimi i punës). Për qëllimet e këtij raporti, të dhënat e zgjedhura kanë të bëjnë me veprimtarinë e Entit në Shqipëri dhe nuk përfshijnë informacione që kanë të bëjnë me palë të tjera bashkëpunuese ose aktivitete / performanca të palëve të treta.

Qëllimi i punës

Angazhimi i dhënies së sigurisë është planifikuar dhe kryer në përputhje me Standardin Ndërkombëtar SNAS 3000, "Angazhimet e Dhënies së Sigurisë ("SNAS 3000") që ndryshojnë nga Auditimet ose Rishikimet e Informacioneve Financiare Historike", me qëllim që të japim një opinion për dhënie sigurie të nivelit të kufizuar për:

- Verifikimin e informacioneve shpjeguese cilësore dhe sasiore të paraqitura në Raportin Vjetor 2020 në mënyrë specifike për gjendjen në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në krahasim me kriteret e zbatueshme ("Kriteret e Performancës", të ilustruara në Raportin Vjetor), të cilat sigurojnë përputhshmëri ligjore me udhëzimet dhe detyrat e lëna nga Rezoluta e Parlamentit të Shqipërisë, datë 20 qershor 2020, mbështetur në Ligjin nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i ndryshuar.

Përgjegjësitë e drejtimit

Drejtimi i të Entit Rregullator të Energjisë është përgjegjës për përgatitjen, prezantimin, tërësinë dhe saktësinë e të dhënave jofinanciare të dhëna për ne, siç paraqiten në Raportin Vjetor 2020. Për më tepër, drejtimi i ERE është përgjegjës për regjistrimet e mbajtura dhe kontrollet e brendshme të përshtatshme që janë krijuar për të mbështetur procesin e raportimit dhe të përputhshmërisë ligjore. Në mënyrë të veçantë, drejtimi është përgjegjës për hartimin e kontrolleve të brendshme dhe zbatimin e tyre për të parandaluar që Raporti të ketë anomali materiale.

Përgjegjësitë e Grant Thornton

Ne kemi kryer një shërbim dhënie sigurie të kufizuar. Përgjegjësia jonë është të shprehim konkluzionin tonë bazuar në procedurat e kryera, për të dhënat e zgjedhura, siç përshkruhet më sipër në seksionin "Qëllimi i punës".

Përgjegjësia jonë është e kufizuar në informacionin shpjegues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020, të prezantuar në Raportin Vjetor për vitin 2020.

Në masën që lejohet nga legjislacioni në fuqi, ne nuk pranojmë dhe nuk marrim asnjë përgjegjësi për angazhimin tonë, ndaj kujtudo tjetër përveç ERE, përveç rasteve kur është rënë dakord në mënyrë të shkruar, me pëlqimin tonë paraprak.

Ne kemi kryer punën tonë duke mbledhur gjitha të dhënat, dokumentacionin përkatës, informacionin dhe shpjegimet që ne i konsideruam të nevojshme për të dhënat e zgjedhura të përshkruara, në seksionin "Qëllimi i punës". Procedurat e ndjekura në lidhje me të dhënat e zgjedhura përfshijnë:

- Intervistat me drejtimin dhe personelin përgjegjës për informacionin dhe supozimet përkatëse.
- Vizita në ambientet e Entit Rregullator të Energjisë.
- Rishikimit dhe vlerësimin të proceseve dhe kontrolleve të përdorura për mbledhjen, grumbullimin, vlerësimin dhe raportimin e të dhënave;
- Teste me zgjedhje mbi të dhënat e mbledhura dhe formulat, kur kërkohen.

Niveli i Dhënies së Sigurisë

Procedurat që kemi kryer janë hartuar për të ofruar siguri të kufizuar, siç specifikohet në SNAS 3000, mbi të cilat ne u bazuam për të arritur në konkluzione për angazhimin tonë. Këto procedura nuk janë aq të zgjeruara sa ato që kërkohen për dhënien e sigurisë së arsyeshme; për pasojë, merret një nivel më i ulët i sigurisë.

Kufizimet

Për të kryer punën tonë, ne u mbështetëm ekskluzivisht në informacionin e dhënë nga drejtuesit e Drejtorive të Entit Rregullator të Energjisë, të cilin ne e pranuan me mirëbesim si informacion të plotë, të saktë, të vërtetë dhe jo mashtrues.

- Si rrjedhim, ne nuk kemi kryer procedura verifikimi shtesë, përveç procedurave të përcaktuara në mënyrë të qartë në Raportin tonë në seksionin, Përgjegjësitë e Grant Thornton, të cilat rrjedhin nga metodologjia e rënë dakort reciprokisht.
- Asnjë punë nuk është kryer për të dhënat të periudhave të raportimeve të mëparshme, si dhe mbi të dhënat në lidhje me objektivat dhe parashikimet.
- Asnjë punë nuk është kryer për asgjë tjetër përveç qëllimit të rënë dakord dhe për rrjedhojë, mendimi ynë është i kufizuar për këtë qëllim.

Pavarësia

Grant Thornton zbaton kërkesat e Standardit Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë 1. Bazuar në këtë, mbajmë një sistem të kontrollit të integruar të cilësisë që përfshin politikat dhe procedurat për respektimin e parimeve morale, standardeve profesionale dhe kërkesave përkatëse ligjore dhe rregullatore. Ne jemi në përputhje me kërkesat e pavarësisë dhe standardet e tjera etike të Kodit Etikës së IFAC për profesionistët të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Audituesit (IESBA), i cili bazohet në parimet themelore të integritetit, paanshmërisë, përshtatshmërisë profesionale, konfidencialitetit dhe sjelljes profesionale. Në këtë kontekst, ekipi i dhënies së sigurisë është i pavarur nga Entit Rregullator të Energjisë dhe nuk ka marrë pjesë në përgatitjen e Raportit Vjetor për vitin 2020.

Konkluzione

Bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e marrë, asgjë nuk na ka tërhequr vëmëndjen tonë që të na bëjë të besojmë se ka ndonjë gabim ose anomali që do të ndikonte materialisht në dhënien e informacioneve rreth përputhshërisë ligjore të aktivitetit (përfshirë shënimet shpjeguese dhe referencat përkatëse) siç paraqiten në Raportin Vjetor të Entit Rregullator të Energjisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020. Për më tepër, asgjë nuk ka tërhequr vëmëndjen tonë që të bëjë të besojmë se të dhënat e paraqitura, nuk janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përmendura më lart, në seksionin "Qëllimi i punës".

Tirana, 30/03/2021

Grant Thornton sh.p.k



Kledian Kodra

